FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 108

Tiranë – E premte, 29 korrik 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 50/2022, datë 23.5.2022	Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit.....	13109
Ligj nr. 53/2022, datë 16.6.2022	Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil.....	13285
Vendim i Kuvendit nr. 61/2022, datë 14.7.2022	Për rrëzimin e dekretit nr. 13703, datë 20.6.2022, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 50/2022, 'Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit'"..	13292
Vendim i Kuvendit nr. 62/2022, datë 28.7.2022	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.....	13292
Vendim i Kuvendit nr. 63/2022, datë 28.7.2022	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit.....	13292
Vendim i Kuvendit nr. 64/2022, datë 28.7.2022	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zëvendëskryeministrit.....	13293
Rezolutë e Kuvendit datë 14.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021.....	13293
Rezolutë e Kuvendit datë 14.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2021.....	13296
Rezolutë e Kuvendit datë 14.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021.....	13298

Rezolutë e Kuvendit datë 14.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2021.....	13302
Rezolutë e Kuvendit datë 14.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2021.....	13306
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 12, datë 13.7.2022	Mbi përcaktimin e niveleve maksimale të pranisë së koksidiostatikëve dhe histomonostatikëve në qumësht, mëlçi, veshka, si dhe ushqime të tjera.....	13308
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 133, datë 18.7.2022	Për delegimin e kompetencave.....	13310
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 325, datë 8.7.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Mbi produktet mjekësore veterinare", miratuar me urdhrin nr. 370, datë 29.7.2014.....	13310
Urdhër i ministrit së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 327, datë 8.7.2022	Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa llojeve kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera, në administrim të këtyre shteteve", e miratuar me urdhrin nr. 328, datë 22.11.2011, të ministrit të Bujqësisë.....	13312
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 335, datë 13.7.2022	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Hungaria, Letonia, Ukraina, Rumania, Italia, Gjermania, Lituania, Moldavia, Sllovakia, Serbia, Estonia, Bullgaria dhe Polonia.....	13314
Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1, datë 30.5.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 81, datë 31.3.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, "Për caktimin e masës disiplinore", ndaj prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Bujar Memia.....	13317
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 85, datë 14.2.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 109, datë 18.9.2020, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mirditë"	13346
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 102, datë 28.2.2022	Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kamzë sh.a.....	13347
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 103, datë 28.2.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Fier"	13348
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 150, datë 1.4.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 84, datë 4.3.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a."	13349

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 151, datë 1.4.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 319, datë 20.8.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës Has".....	13350
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 184, datë 4.5.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 191, datë 14.5.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Pogradec"	13351
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 245, datë 2.6.2022	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a.....	13352
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 279, datë 24.6.2022	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Konispol sh.a.....	13353
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 280, datë 24.6.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 317, datë 20.8.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mat"	13354
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 281, datë 24.6.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 87, datë 4.3.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë"	13355
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 301, datë 5.7.2022	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a.....	13356
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 323, datë 14.7.2022	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan.....	13357
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 324, datë 14.7.2022	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për miratim të tarifave të shitjes së ujit me shumicë të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Durrës.....	13358
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimet nr. 183/8, datë 15.7.2022	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga projekti "Rehabilitimi i lumit Gjanica", faza II, segmenti nga ish-Ura me Shkallë deri tek Ura e Sheqit", Fier.....	13359

LIGJ
Nr. 50/2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ADMINISTRIMIN E NËNZONAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE PEIZAZHIT KULTUROR, PJESË E PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT, NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS DHE FONDACIONIT PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe nenit 172, pika 5, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet marrëveshja për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 23.5.2022.

MINISTRIA E KULTURËS E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
- dhe -
FONDACIONI PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT

MARRËVESHJA PËR ADMINISTRIMIN E NËNZONAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE PEISAZHIT KULTUROR PJESË E PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT, LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS DHE FONDACIONIT PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT

PËRMBAJTJA

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME
2. DATA E NËNSHKRIMIT, DATA EFEKTIVE DHE KUSHTI PARAPRAK
3. AFATI
4. DHËNIA E TË DREJTAVE TË ADMINISTRIMIT
5. DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE
6. PERIUDHA TRANZITORE
7. PASURIA KULTURORE E PALUAJTSHME
8. PASURITË KULTURORE TË LUAJTSHME
9. DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË FONDACIONIT NË LIDHJE ME ADMINISTRIMIN E PASURISË KULTURORE TË PALUAJTSHME
10. DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË MINISTRISË
11. PUNËSIMI, TRAJNIMI I STAFIT
12. KRYERJA E STUDIMEVE DHE ANALIZAVE
13. RUAJTJA DHE MBROJTJA E PASURISË KULTURORE
14. KUSHTE TË TJERA TË RUAJTJES DHE MBROJTJES SË PASURISË KULTURORE
15. RUAJTJA FIZIKE E PASURISË KULTURORE
16. HULUMTIMET ARKEOLOGJIKE
17. HYRJA DHE SHËRBIMET NDAJ PUBLIKUT
18. PROMOVIMI I PASURISE KULTURORE SË PALUAJTSHME
19. LEJET DHE LICENSAT 2
20. NDËRTIMI I QENDRËS SË VIZITORËVE, OBJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS . 27
21. KRIJIMI I GRUPIT SHKENCOR TË BUTRINTIT DHE FUNKSIONET E TIJ BUTRINT RESEARCH GROUP (BRG) 2
22. INVENTARI I PASURISË KULTURORE
23. FINANCIMI I FONDACIONIT, KONTRIBUTI FINANCIAR I PALËVE
24. VLERËSIMI DHE MONITORIMI
25. NGJARJA E FORCËS MADHORE
26. KONTRAKTIMI
27. SIGURIMI
28. KORRIGJIMI I RASTEVE TË MOSPËRMBUSHJES DHE NDËRHYRJA E MINISTRISË
29. ZGJIDHJA E MARRËVESHJES
30. DËMSHPËRBLIMI
31. PRONËSIA INTELEKTUALE
32. DORËZIMI
33. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

34. LIGJI I ZBATUESHËM
35. TRANSFERIMI I MARRËVESHJES
36. NJOFTIMET
37. DISPOZITA TË FUNDIT
LISTA E SHTOJCAVE
SHTOJCA 1
PASURIA KULTURORE E PALUAJTSHME
SHTOJCA 2
PLANI I BIZNESIT
SHTOJCA 3
PROTOKOLLI I BASHKËPUNIMIT
SHTOJCA 4
FORMA E MBAJTJES SË INVENTARIT TË PASURISË KULTURORE
SHTOJCA 5
AKTI I DORËZIMIT TË PASURISË KULTURORE TË PALUAJTSHME

TIRANË, SHQIPËRI **_____/_____/2021**

KJO MARRËVESHJE PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË KULTURORE TË NËNZONËS SË TRASHËGIMISË DHE PEIZAZHIT KULTUROR TË PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT lidhet

NDËRMJET:

(1) **MINISTRISË SË KULTURËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, me seli në adresën rruga "Aleksandër Moisiu", ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Znj. Elva Margariti, Ministre e Kulturës (**"Ministria"**); dhe

(2) **FONDACIONIT PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT**, me seli në adresën Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Ndërtesa 6, Hyrja 11, Apartamenti 21, 1019, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Martin Mata dhe Z. Aleksandër Sarapuli, sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve nr. 3, datë 08.10.2021 (**"Fondacioni"**)

DUKE QENË SE:

A Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë (sikurse është përkufizuar më poshtë) ngarkon Ministrinë si institucioni shtetëror qëndror përgjegjës për trashëgiminë kultorore, si dhe parashikon administrimin e pasurive kulturore në mënyrë direkte ose indirekte;

B Parku Kombëtar i Butrintit (sikurse është përkufizuar më poshtë) është një pasuri kulturore e paluajtshme me vlera universale, e regjistruar në listën e Trashëgimisë Kulturore të UNESCO -s dhe e administruar nga ZAKPKB (sikurse është përkufizuar më poshtë), një person juridk publik nën varësinë e Ministrisë;

C AADF (sikurse është përkufizuar më poshtë) ka shprehur interesin për krijimin e një fondacioni të posaçëm për administrimin indirekt të Pasurisë Kulturore (sikursë është përkufizuar më poshtë), pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit. Totali i fondeve të angazhuara nga AADF për menaxhimin më të mirë të trashëgimisë kulturore në Parkun Kombëtar të Butrintit, duke përfshirë kontributin e dhënë deri në shprehjen e interesit për krijimin e fondacionit të posaçëm si dhe kontributin sipas kësaj Marrëveshje është 6.18 milionë USD.

D Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore, me anë të vendimit nr. 3, datë 06.04.2020, pas vlerësimit të shprehjes së interesit, ka vendosur vlerësimin si partner strategjik të AADF;

E Në datën 24.02.2021, Ministria dhe AADF kanë lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit (sikurse është përkufizuar më poshtë) për themelimin e fondacionit të posaçëm për administrimin indirekt të Pasurisë Kulturore;

F Në datën 21.07.2021 me anë të vendimit nr. 858 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u krijua Fondacioni, në formën e një organizate të pavarur me qëllime jofitimprurëse pa anëtarësi dhe me objekt administrimin indirekt të Pasurisë Kulturore;

G Ministria dhe Fondacioni lidhin këtë marrëveshje administrimi me qëllim administrimin efektiv sipas një modeli administrimi që synon konservimin, mbrojtjen dhe rritjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të Pasurisë Kulturore.

ËSHTË RËNË DAKORD:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Termat e mëposhtëm dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet përkatëse si më poshtë:

"AADF" nënkupton Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim me emërtimin zyrtar "Albanian-American Development Foundation" (AADF);

"Afati" ka kuptimin e dhënë në nenin 3.1;

"Autoriteti Kompetent" nënkupton çdo autoritet, ministri, agjenci, inspektoriat, departament, gjykatë, gjykatë arbitrazhi, agjenci administrative ose komision, ose ndonjë organ tjetër qeveritar, bashkie, administrativ ose ent rregullator, (në secilin rast deri në masën ku secila nga të mësipërmet ka juridiksion mbi secilën ose të gjitha Palët, këtë Marrëveshje dhe/ose çështje të kësaj Marrëveshjeje);

"Administrim" nënkupton të drejtat e Fondacionit, përfshirë por pa u kufizuar në, përdorimin, shfrytëzimin, promovimin, të drejtën për të caktuar dhe mbledhur tarifat, çmimin e biletave, dhënien në përdorim në të gjitha format, në kuptim të Kodit Civil dhe/ose të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, e Pasurisë Kulturore, si dhe detyrimet, përfshirë por pa u kufizuar në mbrojten, ruajtjen dhe promovimin e Pasurisë Kulturore, në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, Planin e Menaxhimit dhe këtë Marrëveshje.

"Braktisje" nënkupton mospërmbushjen nga Fondacioni të të gjitha detyrimeve të Administrimit për të paktën 3 (tre) ditë, ose të mospërmbushjes së Fondacionit të disa të detyrimeve thelbësore të Administrimit për të paktën 7 (shtatë) ditë, si pasojë e mungesës së kapaciteteve teknike dhe financiare të Fondacionit. Në kuptim të këtij përkufizimi, detyrime thelbësore të Administrimit konsiderohen aksesi i publikut në Pasurinë Kulturore, përveç rasteve të parashikuara në nenin 17.2, dhe mbrojtja, veçanërisht ruajtja fizike, e Pasurisë Kulturore.

"Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve" nënkupton datën 22 shkurt 2023, ose ndonjë datë tjetër të rënë dakord nga Palët me shkrim;

"Data e Afatit Përfundimtar të Transferimit" nënkupton datën jo më të vonë se një (1) vit nga Data Efektive, ose ndonjë datë tjetër të rënë dakord nga Palët me shkrim;

"Data e Re e Afatit Përfundimtar të Kushteve" ka kuptimin e shprehur në nenin 2.4;

"Data e Re e Afatit Përfundimtar të Transferimit" ka kuptimin e shprehur në nenin 6.10;

"Data e Nënshkrimit" ka kuptimin e shprehur në nenin 2.1;

"Data e Zgjidhjes së Parakohshme" nënkupton datën e zgjidhjes së Marrëveshjes nga secila prej Palëve para datës së mbarimit të Afatit, që i njoftohet Palës tjetër në përputhje me nenin 29;

"Data Efektive" ka kuptimin e shprehur në nenin 2.3**Error! Reference source not found.**;

"Data e Transferimit" ka kuptimin e shprehur në nenin 6.1;

"Deklarata e Transferimit" ka kuptimin e shprehur në nenin 6.6;

"Ditë Pune" nënkupton çdo ditë tjetër përveç të shtunës, të dielës ose çdo dite tjetër që bankat duhet të mbyllen sipas rregullave të Bankës së Shqipërisë;

"E Drejtë e Ndërhyrjes" ka kuptimin e dhënë në nenin 28.5;

"E Drejtë Kalimi" ka kuptimin e dhënë në nenin 7.1(b);

"Fondacion" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Marrëveshje;

"Hulumtime Arkeologjike" nënkupton vlerësimin e potencialit arkeologjik, vëzhgimi sipërfaqësor (sipas nocionit klasik, si dhe metodave të reja për vëzhgimin arkeologjik, si p.sh. studimet, gërmimet arkeologjike dhe me gjeoradar etj.), sondazhet arkeologjike, gërmimi arkeologjik, monitorimi, konservimi, administrimi arkeologjik, si dhe përpilimi i dokumentacionit të nxjerrë prej kësaj veprimtarie, raporteve paraprake dhe përfundimtare, deri në botimin e rezultateve;

"Humbje" do të thotë çdo dëm, kosto, shpenzime të kryera, pagesa, humbje ose detyrime, duke përfshirë por pa u kufizuar në gjoba, shpenzimet gjyqësore, të avokatëve;

"IKRTK" nënkupton Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

"IKTK" nënkupton Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore;

"Infrastruktura Mbështetëse" nënkupton infrastrukturën në lidhje me sistemimin e ujërave të bardha dhe të zeza, rrjetin elektrik dhe linjat rezervë, që mund të jenë të nevojshme për mirëfunksionimin e Qendrës së Vizitorëve, të kryera me fonde të buxhetit të shtetit;

"Inventari i Pasurisë Kulturore" nënkupton inventarin që mban rregullisht Fondacioni në përputhje me nenin 22, në të cilin inventarizohen në formë shkresore dhe/ose elektronike Pasuritë Kulturore të Luajtshme dhe Pasuritë Kulturore të Paluajtshme në Administrim;

"KKMPK" nënkupton Këshillin Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore;

"KKTKM" nënkupton Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;

"Kushtet e Transferimit" nënkupton Kushtet e Transferimit të Ministrisë dhe Kushtet e Transferimit të Fondacionit;

"Kushtet e Transferimit të Ministrisë" ka kuptimin që i është dhënë në nenin 6.4;

"Kushtet e Transferimit të Fondacionit" ka kuptimin e dhënë në nenin 6.5;

"Kushti Paraprak" ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.2;

"Legjislacioni i Zbatueshëm" nënkupton, në lidhje me çdo Palë, çdo akt detyrues ndërkombëtar, çdo dispozitë kushtetuese, ligj, statut, rregull, rregullore, urdhëresë, traktat, urdhër, dekret, vendim, certifikatë, akt, regjistrim, licencë, franshizë, leje, autorizim, udhëzim, miratim qeveritar, pëlqim ose kërkesë të një Autoriteti Kompetent që ka juridiksion mbi Palën ose pronën e saj, të zbatueshëm sipas ligjit apo statutit;

"Lejet dhe Licencat" nënkupton çdo pëlqim, leje, licencë, autorizim, miratim ose certifikatë, lëshimi ose rinovimi i të cilave është nën përgjegjësinë e ndonjë Autoriteti Kompetent dhe që kërkohet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje;

"Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" nënkupton Ligjin nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë";

"Marrëveshja" nënkupton këtë marrëveshje administrimi dhe të gjitha shtojcat e saj, të cilat do të konsiderohen si pjesë përbërëse e saj, me ndryshimet e kryera herë pas here;

"Marrëveshja e Bashkëpunimit" nënkupton marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur midis Ministrisë dhe AADF në datën 24 shkurt 2021 për themelimin e Fondacionit;

"Marrëveshja e Grantit" nënkupton marrëveshjen e grantit të lidhur midis Fondacionit dhe AADF në datën 16.11.2021 për financimin e Fondacionit;

"Ministria" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Marrëveshje;

"Ngjarje e Forcës Madhore" ka kuptimin e dhënë në nenin 25.1;

"Njoftimi për Dëmshpërblim" ka kuptimin e dhënë në nenin 30.6;

"Njoftimi për Mospërmbushje" ka kuptimin e dhënë në nenin 28.1;

"Palë" nënkupton, sipas rastit, nga njëra anë Ministrinë dhe nga ana tjetër Fondacionin; së bashku **"Palët"**;

"Pala Dëmshpërblyese" nënkupton Palën e cila dëmshpërblen Palën e Dëmshpërblyer në përputhje me nenin 30;

"Pala e Dëmshpërblyer" nënkupton Palën e cila është dëmshpërblyer nga Pala Dëmshpërblyese në përputhje me nenin 30;

"Parku Kombëtar i Butrintit" nënkupton territorin natyror dhe arkeologjik të përcaktuar si park kombëtar sipas VKM 59;

"Partner Strategjik" nënkupton AADF, në cilësinë e partnerit strategjik të miratuar si të tillë nga Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore;

"Pasuri Kulturore" nënkupton Pasurinë Kulturore të Paluajtshme dhe Pasuritë Kulturore të Luajtshme. Në rast konflikti midis përkufizimit të Pasurisë Kulturore sipas kësaj Marrëveshjeje dhe përkufizimit të Pasurisë Kulturore sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përkufizimi përkatës sipas kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojë;

"Pasuri Kulturore e Luajtshme" do të thotë çdo pasuri kulturore e luajtshme, objektet muzeore dhe arkeologjike që nga prejardhja dhe/ose objekti lidhen ngushtësisht me Parkun Kombëtar të Butrintit, të cilat i kalojnë në Administrim Fondacionit, sipas një inventari bashkëlidhur Procesverbalit të Dorëzimit dhe/ose herë pas here gjatë Afatit;

"Pasuri Kulturore e Paluajtshme" do të thotë çdo pasuri kulturore e paluajtshme në nënzonën e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit, në administrim të

Ministrisë sipas VKM 59 dhe pasuritë e tjera të paluajtshme në funksion e që i shërbejnë Administrimit të Pasurisë Kulturore dhe ngritjes së Qendrës së Vizitorëve, sikurse janë përcaktuar në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshje dhe aktin e Dorëzimit të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme;

"Periudha e Dorëzimit" nënkupton periudhën që fillon jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të Afatit dhe përfundon jo më vonë se data e mbarimit të Afatit;

"Periudha e Korrigjimit" ka kuptimin e shprehur në nenin 28.2;

"Periudha Tranzitore" ka kuptimin e shprehur në nenin 6.1;

"Person" do të thotë çdo individ, partneritet, korporatë, shoqëri tregtare, trust, organ qeveritar, agjenci, ministri apo departament, apo një entitet tjetër, duke përfshirë pa kufizim çdo Autoritet Kompetent;

"Person i Lidhur" nënkupton, lidhur me një Palë, një shoqëri, korporatë, fondacion ose një person tjetër juridik i cili është:

(a) drejtpërdrejt ose tërthorazi në kontrollin e asaj Pale (për qëllim të këtij përkufizimi, një **"Shoqëri Mëmë"**);

(b) drejtpërdrejt ose tërthorazi në kontrollin e një Shoqërie Mëmë; ose

(c) drejtpërdrejt ose tërthorazi nën kontroll të përbashkët me një Shoqëri Mëmë;

me kusht që **"kontrolli"** kërkon mbajtjen e shumicës së të drejtave të votës së ortakëve, aksionarëve ose anëtarëve (sipas rastit) ose aftësinë për të ushtruar ndikim dominues sipas një Marrëveshje ose statutit të shoqërisë ose ndonjë dokumenti të barasvlershëm të asaj Pale;

"Plani i Biznesit" nënkupton planin e biznesit, i cili i është bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje si Shtojca 2, subjekt rishikimi nga Fondacioni në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit;

"Plani i Dorëzimit" ka kuptimin e shprehur në nenin 32.2;

"Plani i Menaxhimit" nënkupton Planin e Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit (2020-2030), i miratuar me Vendim nr. 583, datë 22.07.2020 të Këshillit të Ministrave;

"Plani i Tranzicionit" nënkupton planin e rënë dakord mes Palëve pas Datës së Nënshkrimit por jo më vonë se në Datën Efektive, i cili parashikon detyrimet e Palëve gjatë Periudhës Tranzitore dhe afatet kohore për kryerjen e tyre;

"Plani i Zbatimit" nënkupton studimin e hollësishëm inxhinierik për Punimet që do të ndërmerren për Qendrën e Vizitorëve dhe për Infrastrukturën Mbështetëse, i cili do të dorëzohet nga Fondacioni tek Ministria për miratim, duke përfshirë hartimin inxhinierik, planet e ndërtimit, kalendarin e ndërtimit, specifikimet e performancës, procedurat për inspektimin përfundimtar, miratimin dhe pranimin e Qendrës së Vizitorëve;

"Praktika e Mirë e Industrisë" nënkupton shkallën e aftësive dhe kujdesit që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një palë kontraktore me përvojë në të njëjtin lloj sipërmarrjesh (projektim, ndërhyrje restauruese e objekteve të pasurisë kulturore, administrim dhe mirëmbajtje i parqeve, siteve të trashëgimisë kulturore, ndërtim i infrastrukturës

mbështetëse, hartimi dhe implementimi i politikave mbi administrimin e siteve të trashëgimisë kulturore, menaxhim efikas i turizmit) në lidhje me projekte të një madhësie të njëjtë, fushëveprimi, shkalle, natyre dhe kompleksiteti të ngjashëm me objektin e kësaj Marrëveshjeje, sikurse njihen nga Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICCROM), Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) dhe Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet (ICOMOS);

"Pronësia Intelektuale" nënkupton patentat për shpikje, markat tregtare, markat e shërbimit, disenjot industriale, modelet e përdorimit, emërtimet e origjinës, treguesit gjeografikë, të drejtat e autorit, emrat e domain-ve, të drejtat mbi bazën e të dhënave të drejtat për të përdorur dhe mbrojtur konfidencialitetin e informacionit konfidencial (përfshirë njohuritë dhe sekretet tregtare) dhe të gjitha të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale, në secilin rast, të regjistruara ose të paregjistruara dhe duke përfshirë të gjitha aplikimet dhe të drejtat për të aplikuar dhe siguruar, rinovimet ose zgjatjet dhe të gjitha të drejtat e ngjashme ose të barazvlefshme ose format e mbrojtjes që ekzistojnë ose do të ekzistojnë tani ose në të ardhmen;

"Protokolli i Bashkëpunimit" nënkupton protokollin e bashkëpunimit të lidhur midis Ministrisë, Fondacionit dhe Institutit të Arkeologjisë më 16.11.2021, bashkëlidhur në këtë Marrëveshje si shtojca 3;

"Punime" nënkupton të gjitha aktivitetet për planifikimin inxhinierik, ndërtimin dhe kolaudimin e Qendrës së Vizitorëve në përputhje me Planin e Zbatimit;

"Qendra e Vizitorëve" nënkupton tërësinë e infrastrukturës të përbërë nga një ndërtesë për ofrimin e shërbimeve, informacionit dhe orientimeve për vizitorët, duke përfshirë pa u kufizuar në rrethimet, parkimet dhe zyrat e stafit të parashikuara për t'u ndërtuar sipas Planit të Menaxhimit dhe Planit të Biznesit, me fonde të financuara nga Fondacioni;

"Rast Mospërmbushje" nënkupton çdo Rast Mospërmbushje të Fondacionit ose Rast Mospërmbushje të Ministrisë, sipas rastit;

"Rast Mospërmbushje i Fondacionit" nënkupton çdo:

(a) Braktisje;

(b) mospërmbushje e Fondacionit për të paguar kontributin financiar brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me nenin 23.5;

(c) mospërmbushje të Fondacionit të ndonjë prej kërkesave teknike minimale të parashikuara në Planin e Zbatimit që rezulton në ndërtimin e Qendrës së Vizitorëve në shkelje të standarteve teknike të parashikuar në Legjislacionin e Zbatueshëm;

(d) rast falimentimi ose likuidimi që prek Fondacionin;

(e) shtrembërim, deklaratë e pavërtetë apo shkelje e deklarimeve dhe garancive të marra përsipër nga Fondacioni;

(f) dënim i Fondacionit për ndonjë akt korrupsioni, bashkëpunimi, pastrimi të parave ose vepra të ngjashme;

(g) shkelje tjetër që konsiderohet shprehimisht një Rast Mospërmbushje i Fondacionit në një dispozitë specifike e kësaj Marrëveshjeje;

"Rast Mospërmbushje i Ministrisë" nënkupton çdo:

i. mospërmbushje e Ministrisë për të paguar kontributin financiar në përputhje me nenin 23.2;

ii. mospërmbushje e detyrimit për të siguruar ndërtimin e Infrastrukturës Mbështetëse;

iii. shtrembërim, deklaratë e pavërtetë apo shkelje e deklarimeve dhe garancive të marra përsipër nga Ministria ;

iv. shkelje tjetër që konsiderohet shprehimisht një Rast Mospërmbushje i Ministrisë në një dispozitë specifike të kësaj Marrëveshjeje;

"VKM 59" nënkupton Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 59, datë 26.01.2022 "Për miratimin e statusit dhe sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore";

"VKM 625" nënkupton Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 625, datë 04.09.2019 "Për Miratimin e Rregullave të Administrimit të Pasurive Kulturore Publike dhe të funksionimit të Subjekteve Juridike të Themeluara në Formën e Fondacionit";

"ZAKPKB" nënkupton Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint;

"Zgjidhja e Parakohshme" nënkupton zgjidhjen e kësaj Marrëveshje para Datës së Mbarimit të Afatit, nga secila prej Palëve, në përputhje me nenin 29.

Në këtë Marrëveshje, vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe:

(a) njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas;

(b) një referencë për një gjini nuk do të përjashtojë gjinitë e tjera;

(c) fjalët për personat përfshijnë personat fizikë, organet e shoqërive, shoqatat dhe ortakëritë e paregjistruara (pavarësisht nëse ndonjëri prej tyre ka ose jo një personalitet të veçantë juridik);

(d) një referencë ndaj një Pale i referohet Ministrisë ose Fondacionit ose pasuesve të tyre, sipas rastit;

(e) referenca për çdo dispozitë ligjore do të konsiderohet se përfshin çdo akt ligjor, nënligjor, rregullore, rregull, ose urdhër për zbatimin e tij dhe çdo ri-miratim ose ndryshim të mëvonshëm të tij;

(f) fjalët "përfshirë", "të tjera", "në veçanti", "për shembull" dhe fjalë të ngjashme nuk do të kufizojnë përgjithësinë e fjalëve të mëparshme dhe do të interpretohen sikur ato të pasoheshin menjëherë nga fjalët "pa kufizim";

(g) referencat tek "me shkrim" përfshijnë shtypjen, printimin, transmetimin elektronik dhe faksimil dhe mënyrat e tjera të prodhimit ose riprodhimit të fjalëve në një formë të dukshme dhe shprehjet që referojnë tek shkrimi do të interpretohen sipas rastit;

(h) titujt e kreve dhe shtojcave, përmbajtja dhe faqja e parë janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin ose kuptimin e kësaj Marrëveshjeje;

(i) përveç kur parashikohet ndryshe, referencat tek nenet dhe shtojcat janë referenca tek nenet dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje, dhe referencat në çdo shtojcë tek paragrafët, pjesët dhe anekset, përveç nëse parashihet ndryshe, janë referenca tek paragrafët, pjesët dhe anekset e shtojcës ose pjesës së shtojcës ku shfaqen këto referenca;

(j) referencat tek kjo Marrëveshje janë referenca tek kjo Marrëveshje të ndryshuara ose të modifikuara herë pas here;

(k) referenca tek një marrëveshje, Marrëveshje, dokument ose akt do të interpretohet si një referencë tek kjo, siç është ndryshuar, plotësuar apo me shtesa herë pas here.

1.2 Shtojcat dhe secili aneks dhe shtesë e tyre përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.3 Përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, në rast të një konflikti të drejtpërdrejtë midis ndonjë dispozite të Marrëveshjes, të ndonjë shtojce, Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Planit të Biznesit, radha e përparësisë do të jetë si më poshtë:

(a) Marrëveshja;

(b) Shtojcat e saj;

(c) Marrëveshja e Bashkëpunimit;

(d) Plani i Biznesit.

2. DATA E NËNSHKRIMIT, DATA EFEKTIVE DHE KUSHTI PARAPRAK

Data e Nënshkrimit

2.1 Kjo Marrëveshje lidhet nga Palët në datën e nënshkrimit ("**Data e Nënshkrimit**") dhe vazhdon deri në datën e mbarimit të Afatit, përveç nëse zgjatet ose është objekt i zgjidhjes së parakohshme sipas kushteve të kësaj Marrëveshje.

Kushti Paraprak

2.2 Të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshje janë të kushtëzuara nga miratimi i Marrëveshjes nga Këshilli i Ministrave dhe nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ("**Kushti Paraprak**").

Data Efektive

2.3 Data e Efektive e Marrëveshjes është data e hyrjes në fuqi të ligjit me anën e të cilit miratohet kjo Marrëveshje ("**Data Efektive**").

Përfundimi i Marrëveshjes

2.4 Nëse deri në Datën e Afatit Përfundimtar të Kushteve, kjo Marrëveshje nuk është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Marrëveshja do të zgjidhet automatikisht pa nevojën për njoftim të mëtejshëm, përveç nëse Palët kanë rënë dakord për të zgjatur datën e afatit për përmbushjen e këtyre kushteve, datë e cila nuk mund të jetë më vonë se 1 (një) vit nga Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve ("**Data e Re e Afatit Përfundimtar të Kushteve**").

2.5 Asnjëra prej Palëve nuk mban përgjegjësi për asnjë humbje të Palës tjetër në rast zgjidhjeje të

Marrëveshjes sipas nenit 2.4.

3. AFATI

3.1 Përveçse në rastet e përfundimit të parakohshëm të Marrëveshjes ose shtyrje të kohëzgjatjes në përputhje me kushtet e saj, afati i Marrëveshjes është i barabartë me një periudhë që fillon në Datën Efektive dhe përfundon 10 (dhjetë) vjet më pas ("**Afati**").

3.2 Me synimin e përbashkët të administrimit të Pasurisë Kulturore në mënyrën më efektive si dhe më eficiente në terma ekonomiko-financiarë, Palët do të nisin bisedimet përkatëse për rinovimin/shtyrjen e Afatit të Marrëveshjes jo më vonë se 1 (një) vit përpara mbarimit të Afatit. Për këtë qëllim, Fondacioni do t'i paraqesë Ministrisë:

(a) planin e biznesit që mbulon periudhën kohore të shtyrjes/rinovimit; dhe

(b) raportin e plotë i cili paraqet në mënyrë të detajuar përmbushjen nga Fondacioni të detyrimeve të kësaj Marrëveshje lidhur me:

i. realizimin e investimeve sipas Planit të Biznesit;

ii. kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse në Pasurinë Kulturore gjatë periudhës së administrimit nga ana e Fondacionit;

iii. përfitimet për komunitetin vendas në drejtim të mundësive edukuese, ekonomike dhe tregtare.

3.3 Nëse Ministria nuk shprehet lidhur me dokumentacionin e mësipërm brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dorëzimi i tij nga Fondacioni, Marrëveshja do të konsiderohet e rinovuar për afatin e planit të biznesit të paraqitur nga Fondacioni me të njëjtat kushte.

3.4 Nëse Palët nuk arrijnë dakordësinë për rinovimin/shtyrjen e Afatit 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të Afatit, atëherë do të aplikohen parashikimet e nenit 32 dhe Marrëveshja do të përfundojë me mbarimin e Afatit.

4. DHËNIA E TË DREJTAVE TË ADMINISTRIMIT

4.1 Ministria, si përfaqësues i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje i jep Fondacionit të drejtën ekskluzive dhe detyrimin për administrimin indirekt të Pasurisë Kulturore dhe të të drejtave dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Marrëveshje, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

4.2 Fondacioni do të garantojë aksesin në Pasuri Kulturore për çdo kategori qytetarësh dhe në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë dhe VKM 625, Fondacioni ka të drejtën e përcaktimit dhe arkëtimit të tarifave për hyrjen e publikut në Pasurinë Kulturore sipas kushteve të kësaj Marrëveshje. Tarifat për hyrjen e publikut në Pasurinë Kulturore përcaktohen nga Fondacioni, duke respektuar një çmim mesatar të biletës së hyrjes të të gjitha kategorive të vizitorëve, nga 7 deri në 11 USD për të gjithë kohëzgjatjen e Marrëveshjes. Çmimi mesatar i biletës së hyrjes në Pasurinë Kulturore i caktuar më sipër është 75% e çmimit të biletës standarde të hyrjes për të rriturit.

4.3 Fondacioni ka të drejtën të indeksojë vlerën e çmimit mesatar të biletës së hyrjes në Pasurinë Kulturore të përcaktuar në këtë nen sipas normës së inflacionit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë dhe ta rrisë atë deri në 30% të vlerës së indeksuar.

4.4 Asgjë në këtë nen nuk kufizon të drejtën e Fondacionit për të ofruar shërbime dhe produkte të tjera për publikun në kuadër të Administrimit kundrejt tarifave të përcaktuara nga Fondacioni.

4.5 Në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje, Ministria i jep Fondacionit gjatë Afatit të Marrëveshjes të drejta ekskluzive të Administrimit të Pasurisë Kulturore. Ministria nuk do mbartë ose t'i cedojë ndonjë personi të tretë në çfarëdo forme, me apo pa shpërblim, të drejtat e Fondacionit ose ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje, përveç nëse në Marrëveshje është përcaktuar ndryshe

4.6 Ministria i jep Fondacionit të drejtën reale mbi Pasurinë Kulturore të Paluajtshme të përcaktuar në nenin 7.

5. DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE

5.1 Secila Palë garanton që gjatë Afatit të Marrëveshjes:

(a) do të veprojë në përputhje me të gjithë Legjislacionin e Zbatueshëm dhe, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të saj të qëllimshme apo të pakujdesshme, nuk do të bëjë që Pala tjetër të shkelë Legjislacionin e Zbatueshëm apo këtë Marrëveshje; dhe

(b) do t'i japë Palës tjetër të gjitha dokumentet, të dhënat, certifikatat apo informacione të tjera në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje me kërkesën e arsyeshme të Palës tjetër (gjithashtu dhe në lidhje me kërkesën e bërë ndaj Palës tjetër nga një Autoritet Kompetent për sa më sipër), dhe do t'i dorëzojë çdo Autoriteti Kompetent të gjitha dokumentet, të dhënat, certifikatat apo informacione të tjera në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje që mund të kërkohen herë pas herë nga ana e Autoritetit Kompetent.

5.2 Ministria, deklaron dhe garanton:

a) gëzimin e plotë dhe të qetë të Pasurisë Kulturore nga Fondacioni ndaj pretendimeve të palëve të treta, dhe pa ndërhyrje nga ana e Ministrisë, subjekteve publike apo palëve të treta si dhe të pengojë çfarëdolloj tjetërsimi, apo dhënie në përdorim, apo administrim të Pasurisë Kulturore apo pjesëve të saj, gjatë Afatit të Marrëveshjes ("**Gëzim i Plotë dhe i Qetë**");

b) se i ka dorëzuar Fondacionit të gjithë dokumentacionin e zbatueshëm për administrimin e Pasurisë Kulturore, përfshirë të gjitha kontratat e lidhura para Datës Efektive, të cilat i transferohen Fondacionit, nëse ka, sipas Planit të Tranzicionit;

c) se nuk do të miratojë apo në çdo formë të pranojë ushtrimin e veprimtarive artistike, kulturore, tregtare apo çdo lloj aksesi të palëve të treta në Pasurinë Kulturore, pa miratimin paraprak të Fondacionit.

5.3 Fondacioni deklaron dhe garanton se:

(a) do të ketë, mbajë dhe përmbushë kërkesat e të gjitha Lejeve dhe Licencave për të cilat Fondacioni ka përgjegjësinë për t'i siguruar dhe mbajtur gjatë Afatit të Marrëveshjes;

(b) do të administrojë Pasurinë Kulturore në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe këtë Marrëveshje;

(c) do të respektojë plotësisht Protokollin e Bashkëpunimit.

6. PERIUDHA TRANZITORE

6.1 Gjatë periudhës ndërmjet Datës Efektive dhe datës së marrjes në dorëzim të Pasurisë Kulturore nga Fondacioni ("**Data e Transferimit**"), datë e cila nuk mund të jetë më e vonë se Data e Afatit Përfundimtar të Transferimit, Palët do të zbatojnë të gjitha detyrimet në përputhje me parashikimet e këtij neni ("**Periudha Tranzitore**").

6.2 Gjatë Periudhës Tranzitore, ZAKPKB siguron mbarëvajtjen, konservimin, ruajten e Pasurisë Kulturore në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe ndërmerr çdo veprim që ka për objektiv mbarëvatjen e zakonshme në lidhje me hyrjen dhe qarkullimin e vizitorëve në territorin e Pasurisë Kulturore. ZAKPKB nuk do të ndërmarrë shpenzime kapitale për projekte të reja që nuk janë miratuar përpara Datës Efektive me përjashtim të shpenzimeve kapitale për projekte emergjente dhe vetëm pas miratimit paraprak nga Fondacioni. Fondacioni ka të drejtën, por jo detyrimin e zbatimit të projekteve të miratuara nga Autoriteti Kompetent përpara Datës Efektive. Ministria i kalon Fondacionit të gjitha të drejtat lidhur me këto projekte, përfshirë të drejtën e përdorimit, ndryshimit dhe zbatimit pa kundërshpërblim ndaj Ministrisë.

6.3 Gjatë Periudhës Tranzitore, Ministria do t'i sigurojë Fondacionit akses të plotë në Pasurinë Kulturore për të ushtruar të drejtat dhe detyrat e Fondacionit sipas Planit të Tranzicionit.

6.4 Më qëllim dorëzimin e Pasurisë Kulturore në Datën e Transferimit në përputhje me Planin e Tranzicionit, Ministria do të kryejë veprimet dhe detyrimet si vijon:

(a) Do të përfundojë procesin e inventarizimit të Pasurisë Kulturore dhe do vendosë në dispozicion të Fondacionit inventarët e Pasurisë Kulturore së Paluajtshme dhe të Pasurive Kulturore të Luajtshme, si dhe inventarët e aktiviteteve afatshkurtra dhe afatgjata në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm;

(b) Do të vendosë në dispozicion të Fondacionit dokumentacionin e mbajtur nga ZAKPKB ;

(c) Do të zgjidhë marrëdhëniet kontraktore me palët e treta, si dhe do të sigurojë zgjidhjen e kontratave të lidhura nga ZAKPKB me palë të treta dhe do të vendosë në dispozicion të Fondacionit dokumentacionin përkatës;

(d) Do t'i transferojë Fondacionit të gjithë dokumentacionin mbi marrëdhëniet kontraktuale që do t'i transferohen sipas Planit të Tranzicionit dhe do të bashkëpunojë me Fondacionin për lidhjen e kontratave përkatëse;

(së bashku "**Kushtet e Transferimit të Ministrisë**").

6.5 Më qëllim marrjen në dorëzim të Pasurisë Kulturore në Datën e Transferimit në përputhje me Planin e Tranzicionit, Fondacioni do të kryejë veprimet dhe detyrimet si vijon,:

(a) Do të hartojë aktet dhe rregulloret e brendshme për administrimin dhe operimin e Pasurisë Kulturore pas Datës së Transferimit;

(b) Do të hartojë planet e konservimit, dhe planet e investimit të Pasurisë Kulturore;

(c) Do të kryejë të gjitha procedurat për rekrutimin e stafit në përputhje me kërkesat e Planit të Biznesit dhe Planit të Menaxhimit;

(d) Do të kontraktojë personat e tretë për kryerjen e shërbimeve në përputhje me Planin e Biznesit;

(e) Do të vendosë tarifat që do aplikohen pas Datës së Transferimit për shërbimet e ofruara në përputhje me Planin e Biznesit dhe nenin 4.1

(së bashku "**Kushtet e Transferimit të Fondacionit**").

6.6 Secila Palë njofton menjëherë me shkrim Palën tjetër për përmbushjen e detyrimeve sipas neneve 6.4 dhe 6.5. Më pas Palët do të takohen për të evidentuar përmbushjen e Kushteve të Transferimit dhe do të nënshkruajnë Deklaratën e Transferimit ("**Deklarata e Transferimit**"), jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit sipas këtij neni.

Përfundimi i Marrëveshjes në rastin e mospërmbushjes së Kushteve të Transferimit

6.7 Nëse deri në Datën e Afatit Përfundimtar të Transferimit, Fondacioni nuk përmbush ndonjë ose të gjitha prej Kushteve të Transferimit të Fondacionit, ose nga i cili nuk është hequr dorë nga Ministria, Ministria ka të drejtën (por jo detyrimin) të zgjidhë këtë Marrëveshje duke njoftuar Fondacionin 30 (tridhjetë) ditë para.

6.8 Nëse deri në Datën e Afatit Përfundimtar të Transferimit, Ministria nuk përmbush ndonjë ose të gjitha prej Kushteve të Transferimit të Ministrisë, ose nga i cili nuk është hequr dorë nga Fondacioni, Fondacioni ka të drejtën (por jo detyrimin) të zgjidhë këtë Marrëveshje duke njoftuar Ministrinë 30 (tridhjetë) ditë para.

6.9 Nëse deri në Datën e Afatit Përfundimtar të Transferimit, Palët nuk përmbushin ndonjë prej Kushteve të Transferimit, nga i cili nuk është hequr dorë, secila Palë ka të drejtë (por jo detyrimin) të zgjidhë këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër 30 (tridhjetë) ditë para.

6.10 Në rastet e parashikuara në nenet 6.7, 6.8 dhe 6.9 më sipër, pas mbarimit të periudhës 30 (tridhjetë) ditore, Marrëveshja do të zgjidhet automatikisht pa nevojën për njoftim të mëtejshëm, përveç nëse Palët kanë rënë dakord për të zgjatur datën e afatit për përmbushjen e këtyre kushteve, datë e cila nuk mund të jetë më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga Data e Afatit Përfundimtar të Transferimit ("**Data e Re e Afatit Përfundimtar të Transferimit**").

7. PASURIA KULTURORE E PALUAJTSHME

7.1 Duke pasur parasysh detyrimet e Fondacionit sipas kësaj Marrëveshje, Ministria i jep Fondacionit, nga Data e Transferimit deri në përfundimin e Afatit ose Zgjidhjes së Parakohshme të Marrëveshjes, të drejtat mbi Pasurinë Kulturore të Paluajtshme, si më poshtë vijon:

(a) të drejtën për posedimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe gëzimin (por jo pronësinë), dhe të drejtën e Administrimit të Pasurisë Kulturore, në përputhje me këtë Marrëveshje, pa asnjë barrë, detyrim apo kufizim, përveç atyre të parashikuara nga Legjislacioni i Zbatueshëm, kjo Marrëveshje dhe Protokolli i Bashkëpunimit.

(b) të drejtën për kalim mbi dhe nën, si edhe hyrjen dhe daljen nga dhe në çdo vend të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme, pa ndërhyrje të panevojshme nga ndonjë palë e tretë për qëllimin e zbatimit të Marrëveshjes ("**E Drejta e Kalimit**").

7.2 Në përputhje me nenin 7.1, Ministria i dorëzon Fondacionit Pasurinë Kulturore të Paluajtshme, në çdo rast të çliruar nga të gjitha pengesat apo nga të gjitha pretendimet e palëve të treta, për të filluar Punimet dhe për të ushtruar Administrimin. Në rast se Fondacioni pengohet në ushtrimin e Administrimit në ndonjë pjesë të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme për shkak të ndërhyrjeve të palëve të treta, atëherë Fondacioni nuk është përgjegjës për ushtrimin e Administrimit në këto pjesë deri në çlirimin e tyre, në përputhje me Legjislacionin e

Zbatueshëm.

7.3 Të drejtat e Fondacionit mbi Pasurinë Kulturore të Paluajtshme rregullohen nga kjo Marrëveshje dhe nga akti për Dorëzimin e Pasurisë Kulturore të Paluajtshme, që do të nënshkruhet nga Palët në Datën e Transferimit, sipas modelit bashkëngjitur si Shtojca 5. Rrjedhimisht, kjo Marrëveshje dhe akti për Dorëzimin e Pasurisë Kulturore të Paluajtshme janë dokumentet e vetme të nevojshme në lidhje me të drejtat mbi Pasurinë Kulturore të Paluajtshme, me qëllim marrjen ose rinovimin e Lejeve dhe Licencave që mund të nevojiten për kryerjen e punimeve, përfshirë dhe lejen e ndërtimit.

7.4 Në rastin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshje, Fondacioni:

(a) i kthen Ministrisë Pasurinë Kulturore dhe të drejtat reale mbi të, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje;

(b) i kalon Ministrisë të drejtën e pronësisë dhe të posedimit mbi Qendrën e Vizitorëve.

7.5 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe këtë Marrëveshje, Pasuria Kulturore e Paluajtshme nuk do të përdoret nga Fondacioni për ndonjë qëllim tjetër, të ndryshëm nga sa parashikohet në këtë Marrëveshje.

7.6 Fondacioni do të garantojë, ose do të mundësojë që t'i garantohet hyrja në Pasurinë Kulturore të Paluajtshme Ministrisë në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, me kusht që Ministria dhe përfaqësuesit e tij do t'i nënshtrohen dhe do të respektojnë procedurat e sigurisë të zbatuara nga Fondacioni për individët të cilët kanë akses në Pasurinë Kulturore të Paluajtshme dhe nuk do të pengojnë, ndërhyjnë ose vonojnë ekzekutimin e Punimeve ose veprimtaritë e Fondacionit.

8. PASURITË KULTURORE TË LUAJTSHME

8.1 Lëvizja me qëllim ekspozimin e Pasurive Kulturore të Luajtshme jashtë Pasurisë Kulturore të Paluajtshme do të kryhet nga Fondacioni me miratimin e Ministrisë, i cili do të jepet në rast se plotësohen kushtet dhe kriteret si vijon:

(a) Fondacioni të nënshkruajë marrëveshjen përkatëse me institucionin ose subjektin pritës, e cila të parashikojë se vendi ku do të ekspozohen Pasuritë Kulturore të Luajtshme përmbush kushtet për ruajtjen dhe mbrojtjen e Pasurive Kulturore të Luajtshme, lidhur me lagështirën, temperaturën, dritën, dhe kushtet e sigurisë;

(b) Ekspozimi i Pasurive Kulturore të Luajtshme duhet të sjellë përfitim nga pikëpamja e promovimit kulturor për Parkun Kombëtar Butrint;

(c) Pasuritë Kulturore të Luajtshme të ekspozuara duhet të tregojnë pronësinë dhe/ose origjinën nga Parku Kombëtar i Butrintit;

(d) Pasuria Kulturore e Luajtshme nuk është në bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të dala në mënyrë të paligjshme në territorin e Shqipërisë;

(e) Fondacioni duhet të garantojë sigurimin dhe shoqërimin fizik të Pasurive Kulturore të Luajtshme gjatë lëvizjes së tyre, brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet kontraktimit të një shoqërie private të sigurisë fizike ose detyrimit të kërkuesit për përmbushjen e këtij kushti.

(f) Nëse për qëllim të ekspozimit Pasuritë Kulturore të Luajtshme duhet të jenë objekt mirëmbajtje, restaurimi ose konservimi, këto ndërhyrje do kryhen me shpenzimet e

kërkuesit. Pas marrjes së miratimit paraprak nga Fondacioni, kërkuesi kryen të gjitha procedurat pranë organeve kompetente për marrjen e lejeve përkatëse;

(g) Lëvizja e Pasurive Kulturore të Luajtshme, deri në rikthimin e tyre, do të kryhet me ndihmën e një kompanie të specializuar, që do jetë përgjegjëse për procedurat e paketimit, trajtimit dhe transportit të Pasurive Kulturore të Luajtshme, sipas kërkesave të Fondacionit;

(h) Transporti duhet të kryhet i shoqëruar nga një specialist i Fondacionit në përputhje me specifikat e transportit sipas karakteristikave e Pasurisë Kulturore të Luajtshme;

(i) Sigurimin e Pasuritë Kulturore të Luajtshme për të gjithë periudhën që do të jenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet policës së tipit "wall to wall", sipas vlerave të treguara nga Fondacioni që përfshin garantimin nga të gjitha risqet duke përfshirë: vjedhjen, grabitjen, vandalizmin, mangësitë në paketim, grevat, luftën, trazirat, aktet terroriste, dhe të gjitha llojet e forcave madhore;

(j) Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë, paketimin, transportin, instalimin, fotografimin, sigurimin, e Pasurive Kulturore të Luajtshme do të përballohen nga kërkuesi.

8.2 Ministria jep miratimin për lëvizjen e Pasurisë Kulturore të Luajtshme brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës nga Fondacioni.

8.3 Fondacioni është përgjegjës kundrejt Ministrisë për përmbushjen e kushteve të parashikuara në nenin 8.1.

9. DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË FONDACIONIT NË LIDHJE ME ADMINISTRIMIN E PASURISË KULTURORE TË PALUAJTSHME

9.1 Në kuadër të Administrimit të Pasurisë Kulturore, Fondacioni harton dhe zbaton strategjitë, politikat, programet dhe/ose planet e zhvillimit, procedurat dhe rregulloret e tij të brendshme për kryerjen e veprimtarive të Fondacionit, për zhvillimin, mirëmbajtjen, koordinimin, menaxhimin dhe promovimin e vlerave të Pasurisë Kulturore në përputhje me Planin e Menaxhimit dhe Legjislacionin e Zbatueshëm.

9.2 Fondacioni miraton planet vjetore të veprimtarive ekonomike dhe/ose kulturore, artistike, turistike, edukative dhe kërkimore, në përputhje me Planin e Menaxhimit dhe ia komunikon ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, sipas fushës së kompetencës.

9.3 Fondacioni siguron ekspertizën e nevojshme për mbarëvajtjen e Administrimit të Pasurisë Kulturore, nëpërmjet angazhimit të stafit të kualifikuar dhe marrjes së konsulencave nga ekspertë të fushave të ndryshme, vendas ose të huaj, kur e vlerëson se janë të nevojshme.

9.4 Fondacioni siguron qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e Pasurisë Kulturore dhe burime të tjera për të mundësuar vazhdimësinë e punës së Pasurisë Kulturore dhe menaxhimin e tyre në mënyrë efektive.

9.5 Në përputhje me nenin 21 të kësaj Marrëveshje, Fondacioni mbështet, nxit, koordinon dhe mbikëqyr kërkimet shkencore në bashkëpunim me institucione shtetërore e private, kombëtare e ndërkombëtare për promovimin, ruajtjen, pasurimin dhe ekspozimin e trashëgimisë kulturore, për menaxhimin e mirë të Pasurisë Kulturore.

9.6 Fondacioni bashkëpunon dhe informon Autoritetet Kompetente në rast se vihet në dijeni për

zhvillime të karaktereve të ndryshme që kryhen jashtë territorit të Pasurisë Kulturore, por që mund të kenë ndikim në të.

9.7 Fondacioni bashkëpunon me Autoritetet Kompetente rajonale të zonave të mbrojtura sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

9.8 Fondacioni bashkëpunon me Persona të tretë për njohjen, publikimin dhe tërheqjen e financimeve dhe donacioneve për ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin dhe përmirësimin e vlerave të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme

9.9 Fondacioni informon Autoritetet Kompetente, mbi planet e sipërpërmendura, në bazë të kërkesës së tyre, në përputhje me fushën e tyre të përgjegjësisë.

10. DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË MINISTRISË

10.1 Ministria merr masa dhe ndërhyn për ruajtjen dhe mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në rastet:

(a) e Ngjarjes së Forcës Madhore sipas nenit 25 të kësaj Marrëveshje;

(b) e parashikuara në nenin 7.2 të kësaj Marrëveshje;

(c) në rastin e gjetjeve me qëllimin katalogimin dhe kategorizimin e objekteve të pasurisë kulturore;

(d) e parashikuara në nenin 28.4 e vijues të kësaj Marrëveshjeje.

10.2 Ministria:

(a) mbështet Fondacionin në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes me qëllim mirëadministrimin e Pasurisë Kulturore dhe shërben si garant i ruajtjes së vlerave kulturore së Pasurisë Kulturore;

(b) garanton bashkëpunimin me Autoritetet Kompetente sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, si dhe subjektet private, për të siguruar zbatimin e Marrëveshjes, Planit të Menaxhimit, Planit të Biznesit dhe planeve të Fondacionit;

(c) garanton bashkëpunimin me Autoritetet Kompetente sipas fushave të tyre të përgjegjësisë në kuadër të ndërtimit të Qendrës së Vizitorëve;

(d) garanton bashkëpunimin me Autoritetet Kompetente ligjzbatuese dhe shërbimeve të tjera të emergjencës;

(e) kryen çdo detyrë ose funksion të parashikuar në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë dhe VKM 625;

(f) merr të gjitha masat e nevojshme me synim menaxhimin e çdo rreziku të identifikuar në Planin e Menaxhimit sipas nenit 19.3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

10.3 Nëse nga masat e marra nga Fondacioni sipas Legjislacionit të Zbatueshëm dhe Marrëveshjes nuk është arritur të shmangen ngjarjet që mund të ketë ndikim negativ për Pasurinë Kulturore apo që pengon administrimin efektiv nga Fondacioni dhe/ose që ndalohen nga Plani i Menaxhimit, Ministria merr masa për të ndaluar çdo zhvillim apo veprimtari brenda dhe jashtë territorit të Pasurisë Kulturore.

11. PUNËSIMI, TRAJNIMI I STAFIT

Stafi i ZAKPKB

11.1 Fondacioni do të fillojë rekrutimin e personelit të nevojshëm për administrimin efektiv të Pasurisë Kulturore sipas Planit të Tranzicionit, duke i dhënë prioritet punonjësve të ZAKPKB, pasi të kenë zgjidhur rregullisht kontratën e punës me punëdhenësin e mëparshëm. Fondacioni do të ngrejë një komision të drejtuar nga drejtori ekzekutiv i Fondacionit për vlerësimin e punonjësve të ZAKPKB.

11.2 Për efekt qartësie, Fondacioni ka të drejtën por jo detyrimin e punësimit të çdo punonjësi të ZAKPKB që komisioni i ngritur sipas këtij neni e gjykon të përshtatshëm, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.

Punësimi i banorëve të zonës

11.3 Fondacioni do të punësojë punëmarrës të kualifikuar dhe me eksperiencën e nevojshme duke i dhënë prioritet punësimit të banorëve të zonës kur është e mundur.

Trajnimi i stafit

11.4 Fondacioni do të sigurojë trajnimin e stafit të punësuar në përputhje me planin e trajnimit të miratuar nga Fondacioni gjatë Periudhës së Tranzicionit.

12. KRYERJA E STUDIMEVE DHE ANALIZAVE

12.1 Në përputhje me nenin 12.2 të kësaj Marrëveshje dhe me qëllim mirëadministrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e Pasurisë Kulturore, Fondacioni do të financojë studime, kërkime dhe analiza mbi mjedisin në të cilat ndodhet Pasuria Kulturore, infrastrukturën dhe shërbime të ndryshme që do ofrohen në kuadër të Administrimit të Pasurisë Kulturore, në përputhje me Planin e Biznesit.

12.2 Fondacioni do të kryejë, vetë ose nëpërmjet nënkontraktorëve, studime, kërkime dhe monitorime periodike, përfshirë por pa u kufizuar në:

(a) Studim hidrologjik për të gjithë basenin ujor të Parkut Kombëtar të Butrintit, dhe monitorime pasardhëse të situatës hidrologjike me një frekuencë vjetore për 7 (shtatë) vitet e para të Afatit;

(b) Studim mbi biodiversitetin e Pasurisë Kulturore dhe zonave buferike të saj, dhe monitorime pasardhëse vjetore;

(c) Studim me objekt administrimin e trafikut dhe transportit në Pasuri Kulturore dhe monitorime pasardhëse vjetore të situatës së trafikut dhe transportit. Ky studim do të fokusohet veçanërisht në përmirësimin e lidhjes ujore midis dy brigjeve;

(d) Studim mbi administrimin efektiv të fluksit të vizitorëve dhe kryerjen e anketave periodike të cilësisë për përcaktimin e kënaqësisë së vizitorëve;

(e) Program me objekt rritjen e angazhimit të komunitetit të zonës në veprimtaritë e Administrimit të Pasurisë Kulturore dhe kryerjen e trajnimeve periodike për personat e komunitetit të zonës;

(f) Plan i sigurisë dhe shëndetit, përfshirë plan evakuimi të vizitorëve, punonjësve, Pasurive Kultorore të Luajtshme dhe dokumeteve të rëndësishme.

12.3 Ministria garanton mbështetje institucionale gjatë fazës së hartimit dhe konsultimit. Përveç studimeve të parashikuara në nenin 12.2(a), nenin 12.2(b) dhe nenin 12.2(c), të cilat do t'i dorëzohen Autoriteteve Kompetente përkatëse, Fondacioni ka përgjegjësinë për implementimin e rekomandimeve të studimeve dhe planeve të parashikuar në nenet 12.2(d), 12.2(e) dhe 12.2(f).

12.4 Rregullat teknike, mënyra e prokurimit të shërbimeve të konsulencës, si dhe mënyra e financimit të tyre janë objekt i rregullave dhe vendimmarrjes së brendshme të Fondacionit.

13. RUAJTJA DHE MBROJTJA E PASURISË KULTURORE

13.1 Fondacioni është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e Pasurisë Kulturore të Paluajtshme në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë dhe këtë Marrëveshje.

13.2 Me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e Pasurisë Kulturore, Fondacioni miraton kalendarin vjetor për vitin pasardhës për ndërhyrjet ruajtëse dhe mbrojtëse në Pasurinë Kulturore, në përputhje me planin e konservimit të përcaktuar në Planin e Menaxhimit, si dhe me planin e detajuar të konservimit dhe ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, në përputhje me VKM Nr. 625.

13.3 Fondacioni kryen procedurat në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për marrjen e lejeve dhe miratimeve të nevojshme për kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, duke përfshirë edhe ato që mund të kenë ndikim në mjedis dhe natyrë, sipas nenit 19.

13.4 Në kuadër të funksioneve ruajtëse Fondacioni:

(a) Harton dhe miraton planin e detajuar te konservimit në përputhje me planin e konservimit të përcaktuar në Planin e Menaxhimit;

(b) Merr vendim mbi projektin e ndërhyrjeve ruajtëse dhe preventivin përkatës që kryhet nga subjektet e licencuara në përputhje me rregulloren e tij të brendshme;

(c) Kryen vetë ose kontrakton persona të licencuar për kryerjen e punimeve të konservimit dhe ndërhyrjeve të tjera ruajtëse, si dhe ndjek në vazhdimësi kryerjen e ndërhyrjeve nga faza e miratimit të projektit deri në mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve;

(d) Informon institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore për çdo dëmtim, zbulim apo çdo veprim të parashikuar në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë;

(e) Koordinon punën me institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore për hartimin, miratimin e projekteve të ndërhyrjeve, zbatimin e punimeve, si dhe mbikëqyrjen e kolaudimin e tyre;

(f) Mbulon shpenzimet për projektimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërhyrjes ruajtëse, sipas buxhetit të miratuar nga bordi i drejtorëve të Fondacionit;

(g) Mban informacionin për Pasurinë Kulturore, në përputhje me udhëzimet përkatëse të Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

13.5 Në kuadër të ndërhyjeve mbrojtëse Fondacioni:

(a) Kontrakton subjekte të licencuara për kryerjen e restaurimeve apo ndërhyrjeve të tjera mbrojtëse në Pasurinë Kulturore;

(b) Kryen procedurat në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë dhe nenin 19 të kësaj Marrëveshjeje për marrjen e miratimeve dhe lejeve përkatëse për kryerjen e ndërhyrjeve mbrojtëse;

(c) Garanton sigurinë fizike të Pasurisë Kulturore në përputhje me nenin 15 të kësaj Marrëveshje.

14. KUSHTE TË TJERA TË RUAJTJES DHE MBROJTJES SË PASURISË KULTURORE

Vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese

14.1 Fondacioni në veprimtaritë që organizon duhet të garantojë integritetin fizik të Pasurisë Kulturore.

14.2 Vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, përfshirë ato që mund të përdoren nga subjekti që kryen ndërhyrje për mbulimin e skelave e të strukturave mbajtëse, në territorin e Pasurisë Kulturore, si dhe fotografimi e filmimi i Pasurive Kulturore për qëllime fitimprurëse miratohet nga Fondacioni.

14.3 Vendosja e materialeve reklamuese ose informuese në Pasuritë Kulturore të Paluajtshme duhet:

(a) Të mos dëmtojnë Pasurinë Kulturore dhe të garantohet ruajtja dhe mbrojtja e saj;

(b) Të mos jenë në kundërshtim me vlerat që përfaqëson Pasuria Kulturore;

(c) Të mos përmbajnë fjalë ose simbole poshtëruese, përçmuese, diskriminuese, fyese, apo që në çdo formë cenojnë dinjitetin njerëzor, si dhe nuk duhet të promovojnë veprimtari të kundërligjshme ose diskriminuese, fyese, poshtëruese ndaj një ose disa grupeve kombëtare, etnike, raciale, fetare, ose gjinore;

(d) Të jenë në përputhje me kohëzgjatjen dhe qëllimin e veprimtarisë, për të cilin subjekti ka marrë miratimin.

14.4 Vendosja ose fiksimi i mjeteve reklamuese ose informuese miratohet në bazë të kritereve si vijon:

(a) Strukturat mbajtëse të tabelave duhet të jenë përllogaritur që t'i rezistojnë ndikimit nga fenomene të ndryshme atmosferike dhe të jenë fiksuara në mënyrë të qëndrueshme në tërësinë e tyre dhe elementët e veçantë, si dhe të jenë ndërtuar në përputhje me rregullimet e posaçme ligjore ose nënligjore për ndërtimin e tyre;

(b) Flamujt, tabelat dhe mjetet e tjera reklamuese ose informuese duhet të jenë në përputhje me dekorin, pamjen dhe karakteristikat estetike (ngjyra, forma etj.) të Pasurisë Kulturore ku do të fiksohen. Specifikimet e posaçme përcaktohen rast pas rasti në miratimin e Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

(c) Vendosja e mjeteve reklamuese ose informuese të mos cenojë aksesin e vizitorëve ose rendin e ekspozitës;

(d) Përdorimi i ngjyrave ose simboleve nuk duhet të krijojë konfuzion me shenjëzimin rrugor;

(e) Tabelat informuese ose interpretuese nuk duhet të vendosen mbi muret, monumentet, objektet dhe strukturat e tjera të pasurisë kulturore.

14.5 Procedurat për miratimin e kërkesave të veçanta ose përzgjedhjen e subjekteve miratohen me vendim të Fondacionit.

Filmimet, fotografimet dhe projektimet në Pasurinë Kulturore

14.6 Filmimi, fotografimi, si dhe projektimi në Pasurinë Kulturore miratohen nga Fondacioni në bazë të kushteve dhe kritereve si vijon:

(a) të mos dëmtojë Pasurinë Kulturore dhe të garantohet ruajtja dhe mbrojtja e saj;

(b) të mos cenojë vlerat që përfaqëson Pasuria Kulturore;

(c) të mos promovojë veprimtari të kundërligjshme ose diskriminuese, fyese, poshtëruese ndaj një ose disa grupeve kombëtare, etnike, raciale, fetare, ose gjinore;

(d) të mos cenojë aksesin e vizitave apo rendin e ekspozitës;

(e) të specifikohet koha e punës e nevojshme për realizimin e fotografimit, filmimit apo projektimit, në përputhje me rregullat e Fondacionit;

(f) projektimet me zë dhe/ose figurë në Pasurinë Kulturore nuk duhet të cenojnë pamjen e jashtme, si dhe strukturën e saj;

(g) Pasuritë Kulturore të Luajtshme të mos zhvendosen nga vendi i ekspozimit të tyre.

14.7 Procedurat për përzgjedhjen e subjektit për kryerjen e filmimit, fotografimit dhe projektimit në Pasurinë Kulturore miratohen nga Fondacioni.

14.8 Përjashtimisht subjektet që do të kryejnë filmime, fotografime dhe projektime në Pasurinë Kulturore, në kuadër të projekteve, studimeve dhe aktiviteteve që do të financohen nga vetë buxheti i shtetit dhe që do të organizohen nga institucionet shtetërore, nuk do t'i nënshtrohen procedurave të miratimit nga Fondacioni, por kanë detyrimin për njoftimin e tij.

Kryerja e veprimtarive ekonomike në Pasurinë Kulturore

14.9 Nëpërmjet kësaj Marrëveshje, Ministria jep miratimin për kryerjen nga Fondacioni dhe/ose subjektet e përzgjedhura prej këtij të fundit të veprimtarive ekonomike në Pasurinë Kulturore, në kuptimin e nenit 102 të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.

14.10 Veprimtaria ekonomike në Pasurinë Kulturore zhvillohet në përputhje me kushtet e mëposhtme:

(a) Të mos dëmtojë Pasurinë Kulturore;

(b) Të jetë në përputhje me Planin e Menaxhimit dhe Planin e Biznesit;

(c) Të mos jetë në kundërshtim me vlerat kulturore të Pasurisë Kulturore.

14.11 Tregtimi i suvenireve dhe botimeve duhet të bëhet në përputhje me kriteret si vijon:

(a) Të jetë në përputhje me tipologjinë e produkteve të mëposhtme:

i. Replika të objekteve/vlerave me përfaqësuese të trashëgimisë kulturore që ruhen dhe promovohen në pasurinë kulturore ku do kryhet veprimtaria;

ii. Riprodhim në letër, tekstil, qeramikë, plastikë, dru etj, të imazheve, objekteve/vlerave më përfaqësuese të trashëgimisë kulturore që ruhen dhe promovohen në pasurinë kulturore ku do kryhet veprimtaria;

iii. Objekte funksionale me forma dhe imazhe të përshtatshme për promovimin e vlerave të pasurisë kulturore të institucionit ku do kryhet veprimtaria;

iv. Produkte të zejtarisë tradicionale të cilët përfaqësojnë traditat kulturore autentike në materiale modele dhe mjeshtëri tipike të zonës ku ndodhet këndi SAL, të punuara me dorë dhe teknika e mjete tradicionale të artizanatit;

v. Botime (libra, guida turistike, harta, almanakë, vjetarë, katalogë, albume, dëftues të rrugëve, broshura etj.) të pajisura me ISBN, që promovojnë vlerat kulturore të vendit tonë në përgjithësi dhe të vendit ku do kryhet veprimtaria në veçanti;

vi. Replikat dhe riprodhimet që tregtohen në këndet SAL duhet të respektojnë dhe/ose gëzojnë të drejtën e autorsisë sipas ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", si dhe të marrin miratimin e institucioneve përkatëse kur këto të fundit mbajnë të drejtën e autorsisë së vlerave që do të replikohen ose riprodhohen;

vii. Të tjera, siç mund të parashikohen me ligj.

14.12 Veprimtaritë ekonomikepër ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të ndryshme duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

(a) Shërbimet apo produktet e ofruara të jenë në përputhje me Planin e Menaxhimit;

(b) Veprimtaria ekonomike të jetë në përputhje me kërkesat specifike për ruajtjen, mbrojtjen dhe vlerësimin e Pasurisë Kulturore, të parashikuara në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë;

(c) Veprimtaria ekonomike e propozuar të jetë sa më e përafërt me historikun ekonomik, social, kulturor apo shkencor të Pasurisë Kulturore.

14.13 Procedurat për përzgjedhjen e subjektit për kryerjen e veprimtarive ekonomike brenda pasurisë kulturore publike miratohen nga Fondacioni.

Kryerja e veprimtarive kulturore në Pasurinë Kulturore

14.14 Fondacioni mund të organizojë ose të lejojë zhvillimin e veprimtarive artistike e social-kulturore në mjediset e Pasurisë Kulturore që ka në administrim, sipas kalendarit të veprimtarive të miratuara nga Fondacioni dhe procedurave të brendshme të tij.

14.15 Nëpërmjet kësaj Marrëveshje, Ministria jep miratimin për kryerjen nga Fondacioni dhe/ose subjektet e përzgjedhura prej këtij të fundit të veprimtarive kulturore në Pasurinë Kulturore, në kuptimin e nenit 100 të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.

14.16 Organizimi dhe zhvillimi i veprimtarive kulturore e artistike në ambientet e Pasurisë Kulturore do të kryhet në përputhje me kushtet e mëposhtme:

(a) Të mos dëmtojë Pasurinë Kulturore ose në çdo formë të vështirësojnë ruajtjen ose mbrojtjen e pasurisë.

(b) Të mos jenë në kundërshtim me vlerat kulturore të Pasurisë.

14.17 Fondacioni miraton interesin kulturor të veprimtarive që do të përfshihen në kalendarin e veprimtarive të Fondacionit, në bazë të kritereve si vijon:

(a) Veprimtaria e propozuar të ketë një temë të caktuar me karakter kulturor dhe/ose artistik;

(b) Veprimtaria duhet të promovojë Pasurinë Kulturore;

(c) Të jetë në përputhje me Planin e Menaxhimit.

14.18 Fondacioni, rast pas rasti, mund të përcaktojë rregulla që ofrojnë standarde më të larta për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive kulturore.

15. RUAJTJA FIZIKE E PASURISË KULTURORE

15.1 Fondacioni duhet të garantojë sigurinë dhe ruajtjen fizike të Pasurisë Kulturore, përfshirë edhe nga rreziku i zjarrit, duke marrë masat e specifikuara në marrëveshjen e posaçme të nënshkruar me Ministrinë gjatë Periudhës Tranzitore, e cila i bashkëlidhet dokumentacionit të dorëzimit në Datën e Transferimit.

15.2 Fondacioni do të marrë masa për parandalimin dhe pakësimin e zjarrit me anë të mjeteve, sistemeve dhe pajisjeve të diktim sinjalizimit për shuarjen e tij. Autoriteti Kompetent për shërbimin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin ndërhyn dhe merr masat e nevojshme në rastin e rënies së zjarrit, i cili nuk vihet nën kontroll nga Fondacioni, pavarësisht masave të marra prej këtij të fundit.

15.3 Fondacioni lidh marrëveshje me Persona për ruajtjen dhe sigurinë fizike, në përputhje me kriteret e ruajtjes e të mbrojtjes fizike të objektit, të parashikuara në Planin e Menaxhimit, këtë Marrëveshje dhe marrëveshjen e posaçme sipas nenit 15.1.

15.4 Në kuadër të detyrimit të ruajtjes fizike të Pasurisë Kulturore, Fondacioni do të lidhë protokolle bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe Autoritetin Kompetent për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, jo më vonë se Data e Transferimit.

16. HULUMTIMET ARKEOLOGJIKE

16.1 Për kryerjen e Hulumtimeve Arkeologjike nga Instituti i Arkeologjisë, Palët dhe Instituti i Arkeologjisë kane lidhur Protokollin e Bashkëpunimit.

16.2 Për kryerjen e Hulumtimeve Arkeologjike nga Persona të tretë dhe pa cënuar të drejtat e Institutit të Arkeologjisë që rrjedhin nga Protokolli i Bashkëpunimit, Fondacioni do të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Persona e tretë të licencuar, ku do të përcaktohet koha, lloji i Hulumtimeve Arkeologjike që do kryhen, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve.

16.3 Fondacioni, pa cënuar të drejtat e Institutit të Arkeologjisë që rrjedhin nga Protokolli i Bashkëpunimit, mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi edhe me institute ndërkombëtare të pajisura me miratimet përkatëse të Autoriteteve Kompetente, për kryerjen e Hulumtimeve Arkeologjike me qëllim ruajtjen, konservimin dhe promovimin me qëllim edukativ të Parkut Kombëtar të Butrintit.

16.4 Të drejtat dhe detyrimet e palëve të treta do të përcaktohen në Marrëveshjen e Bashkëpunimit që do lidhet me Fondacionin. Në çdo rast palët e treta, përfshirë Instituti i Arkeologjisë, janë përgjegjës për:

(a) Marrjen e lejeve përkatëse në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë;

(b) Kryerjen e Hulumtimeve Arkeologjike nga persona të licencuar në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm;

(c) Zbatimin e të gjitha masave të sigurisë për ruajtjen e mbrojtjen e Pasurisë Kulturore, Personave dhe mjedisit;

(d) Riparimin dhe/ose shpërblimin e dëmit të shkaktuar Fondacionit, Personave apo Pasurisë Kulturore nga metodat e përdorura ose çdo shkak tjetër që lidhet direkt ose indirekt me Hulumtimet Arkeologjike në kuptim të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.

16.5 Veprimtaritë arkeologjike nga Instituti i Arkeologjisë do të kryhen pas miratimit paraprak të KKTKM dhe IKTK dhe konfirmimit nga Fondacioni lidhur me periudhën e kryerjes së kësaj veprimtarie.

17. HYRJA DHE SHËRBIMET NDAJ PUBLIKUT

17.1 Fondacioni garanton qasjen e publikut në Pasuri Kulturore në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, këtë Marrëveshje dhe rregulloret e miratuara nga vetë Fondacioni.

17.2 Hyrja dhe shërbimet ndaj publikut mund të kufizohen në përputhje me nenin 17.3 kur:

(a) Zvogëlimi i kapacitetit të vizitorëve është i nevojshëm për ruajtjen dhe mbrojtjen e Pasurisë Kulturore;

(b) Kufizimi është i nevojshëm për kryerjen e restaurimeve apo ndërhyrjeve të tjera ruajtëse apo mbrojtëse sipas planit për këto ndërhyrje të miratuar nga Fondacioni;

(c) Kufizimi është i nevojshëm si kusht për zhvillimin e një veprimtarie të lejuar sipas kësaj Marrëveshje ose e kërkojnë masat e sigurisë fizike;

(d) Ofrimi i shërbimit mund të dëmtojë pasurinë kulturore;

(e) Në rastet e parashikuara në nenin 25.

17.3 Fondacioni kufizon hyrjen dhe shërbimet në Pasurinë Kulturore vetëm pas njoftimit dhe miratimit me shkrim të Ministrisë. Në raste nevojash urgjente, të tilla si cënimi i sigurisë së shëndetit të Personave dhe ose cënimi të menjëhershëm dhe/ose të rëndë të integritetit të Pasurisë Kulturore, drejtori i Fondacionit mund të autorizojë kufizimin e hyrjes dhe të shërbimeve pa miratimin e Ministrisë, me kusht që Fondacioni të njoftojë Ministrinë menjëherë dhe të heqë kufizimet nëse Ministria nuk i miraton ato.

17.4 Fondacioni do të përcaktojë në mënyrë jo diskriminuese:

(a) rastet e hyrjes së publikut në Pasurinë Kulturore me ose pa pagesë;

(b) kategoritë e personave që mund të hyjnë në Pasurinë Kulturore pa pagesë;

(c) kategoritë e biletave të hyrjes në Pasurinë Kulturore dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të tyre;

(d) mënyrën e emetimit, shpërndarjes dhe shitjes së biletave të hyrjes, si dhe dizenjimin e tyre.

17.5 Të ardhurat, që vijnë nga shitja e biletave të hyrjes në Pasurinë Kulturore derdhen në llogarinë bankare të Fondacionit.

17.6 Fondacioni mund të ofrojë shërbime për publikun, të tilla si, por pa u kufizuar në:

(a) pritjen, përfshirë ato të asistencës e të argëtimit për fëmijët, shërbimet e informacionit, të guidave dhe asistencës didaktike, dhe qendrave të takimit;

(b) kafeterinë, ushqimin e garderobën;

(c) botimin dhe shitjen e katalogëve, fletëpalosjeve, botimeve të tjera të ngjashme, incizimeve audiovizive e informatike, çdo material tjetër informativ, si dhe riprodhimin e pasurive kulturore;

(d) menaxhimin e përmbledhjeve diskografike, të diapotekave dhe bibliotekave muzeore;

(e) menaxhimin e pikave të shitjes dhe përdorimit tregtar të riprodhimit të pasurive;

(f) organizimin e panaireve dhe manifestimeve kulturore si dhe të nismave promovuese.

17.7 Ofrimi i këtyre shërbimeve do të realizohet nga vetë Fondacioni ose nëpërmjet nënkontraktimit të palëve të treta në përputhje me nenin 26. Nënkontraktimi i palëve të treta do të kryhet në përputhje me procedurat përzgjedhëse të miratuara nga Fondacioni të cilat duhet të bazohen në parimin e eficencës dhe maksimizimit të cilësisë së shërbimeve.

17.8 Shërbimet për publikun duhet të garantojnë aksesin në Pasuri Kulturore të personave me aftësi të kufizuar.

17.9 Fondacioni mund të organizojë ose të lejojë zhvillimin e veprimtarive artistike e social-kulturore në mjediset e Pasurisë Kulturore, sipas kalendarit të veprimtarive të miratuara nga Fondacioni.

17.10 Fondacioni krijon kushte sa më të mira për vizitorët, nëpërmjet një infrastrukture bashkëkohore për zhvillimin e turizmit kulturor.

18. PROMOVIMI I PASURISE KULTURORE SË PALUAJTSHME

18.1 Fondacioni do të ndërmarrë veprimtari për promovimin e Pasurisë Kulturore të tilla si:

(a) Publikimi nëpërmjet website zyrtar i materialeve informuese, broshurave, të përshtatshme edhe për shkolla dhe/ose universitete, si dhe materialeve didatike;

(b) Ndërmarrja e veprimtarive studimore, kërkimore në përputhje me Planin e Biznesit dhe nenin 21 të kësaj Marrëveshje;

(c) Organizimi i veprimtarive të tjera njohëse, si dhe shpërndarjen e rezultatit të këtyre veprimtarive nëpërmjet website zyrtar.

18.2 Fondacioni do të ketë të drejtën të ndërmarrë çdo iniciativë dhe zbatojë çdo projekt me synim vlerësimin dhe promovimin e Pasurisë Kulturore, duke përfshirë këtu çdo formë reklamimi dhe/ose sponsorizimi. Në veçanti, por pa u kufizuar në të, Fondacioni do të ketë të drejtë të lidhë marrëveshje sponsorizimi, në formën e (i) kontributit financiar të drejtpërdrejtë, ose (ii) kontributeve në natyrë (nëpërmjet sponsorizimit teknik, duke i lejuar sponsorit të promovojë markën dhe imazhin e tij institucional përmes asociimit të tij me ndërhyrjen, objekt i kontributit të sponsorit).

18.3 Veprimtaritë e promovimit do të kryhen në përputhje me Planin e Biznesit.

19. LEJET DHE LICENSAT

19.1 Fondacioni do të aplikojë dhe marrë Lejet dhe Licencat përkatëse për fillimin e punimeve dhe veprimtarive të parashikuara në këtë Marrëveshje, përfshirë por pa u kufizuar në:

(a) lejen zhvillimore në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë;

(b) lejen e ndërtimit;

(c) vlerësimin e ndikimit në mjedis;

(d) lejen e peizazhit kulturor;

(e) lejen për ndërhyrje në pasuritë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme;

(f) licencë për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale (projektim, zbatim, mbikqyrje, kolaudim);

(g) licencë për qarkullimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme kulturore;

(h) licencë importi të pasurive kulturore;

(i) çdo leje, licencë ose miratim tjetër të nevojshëm sipas Legjislacioni të Zbatueshëm;

19.2 Ministria merr përsipër që aplikimet e Fondacionit për Lejet dhe Licencat që lëshohen nga vetë Ministria dhe/ose Autoritete Kompetente pranë Ministrisë të trajtohen me prioritet dhe brenda afateve procedurale, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, me kusht që Fondacioni të ketë përmbushur detyrimet e tij proceduriale dhe materiale përkatëse. Në rast vonesash në lëshimin e Lejeve dhe Licencave nga Autoritetet e tjera Kompetente, Ministria do të kryejë të gjitha përpjekjet e mundshme për të bashkëpunuar në nivel insitucional me Autoritetet Kompetente në fjalë për marrjen e Lejeve dhe Licencave përkatëse.

19.3 Për të mënjanuar çdo dyshim, Palët bien dakord që në rast të vonesave në lëshimin e Lejeve dhe Licencave si dhe çdo leje, licence ose miratimi të përcaktuar në këtë nen, të cilat shkaktohen për arsye që nuk lidhen me përmbushjen e detyrimeve (proceduriale dhe materiale përkatëse) nga ana e Fondacionit, atëherë Fondacioni do të përfitojë një shtyrje të afateve, e cila do të jetë jo më e vogël se kohëzgjatja e këtyre vonesave.

19.4 Në rast se Fondacioni nuk arrin të marrë lejet e nevojshme për fillimin e Punimeve për arsye që nuk lidhen me përmbushjen e detyrimeve (proceduriale dhe materiale përkatëse) nga ana e Fondacionit, ose nëse Fondacioni nuk ka përmbushur detyrimet proceduriale dhe materiale për

shkak të mos vënies në dispozicion nga ana e Ministrisë të dokumentit përkatës, Fondacionit i lind e drejta e zgjidhjes së Marrëveshjes në përputhje me nenin 29.

20. NDËRTIMI I QENDRËS SË VIZITORËVE, OBJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS

20.1 Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) muaj nga Data Efektive, Fondacioni do t'i dorëzojë Ministrisë draftin e Planit të Zbatimit. Ministria do të bëjë komentet apo ndryshimet e saj në draftin e Planit të Zbatimit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e dorëzimit, dhe Fondacioni do të paraqesë versionin final të Planit të Zbatimit me këto komente dhe/apo ndryshime tek Ministria, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga paraqitja e komenteve/ndryshimeve të Ministrisë, me kusht që në rast se Ministria nuk bën asnjë koment brenda periudhës prej 30 (tridhjetë) ditësh, atëherë Ministria do të konsiderohet se e ka miratuar Planin e Zbatimit.

20.2 Ministria dhe/ose Autoritetet Kompetente do të realizojnë Infrastrukturën Mbështetëse për funksionimin e Qendrës së Vizitorëve, në përputhje me Planin e Zbatimit, me fonde të buxhetit të shtetit.

20.3 Jo më vonë se 2 (dy) vite nga Data Efektive, Fondacioni nis Punimet për ndërtimin e Qendrës së Vizitorëve. Në përputhje me nenin 19.3, afati për nisjen e Punimeve sipas këtij neni do të shtyhet me një afat jo më të vogël se kohëzgjatja e vonesës në marrjen e Lejeve dhe Licencave të nevojshme për kryerjen e Punimeve, nëse këto Leje dhe Licenca nuk janë lëshuar brenda 2 (dy) vite nga Data Efektive.

20.4 Ministria, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe në bashkëpunim me Autoritetet Kompetente, do të marrë masat e nevojshme për devijimin e trafikut rrugor dhe mbylljen e segmentit përkatës të rrugës kombëtare nga Qendra e Vizitorëve tek hyrja në sit.

20.5 Brenda 7 (shtatë) ditëve nga njoftimi i Fondacionit për fillimin e Punimeve, Ministria cakton personat përgjegjës nga institucionet e specializuara në varësi të saj për mbikëqyrjen e Punimeve në Qendrën e Vizitorëve në përputhje me nenin 145 të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.

20.6 Gjatë ndërtimit të Qendrës së Vizitorëve, Fondacioni i dorëzon Ministrisë në mënyrë periodike raporte progresi për Punimet, ku detajohen:

(a) përshkrim të ecurisë së Punimeve për periudhën pararendëse (me përjashtim të periudhës pararendëse të fillimit të fazës ndërtimore);

(b) përshkrim të punimeve që priten të përfundojnë gjatë periudhës pasardhëse;

(c) çdo ngjarje apo rrethanë që mund të pengojë apo shtyjë afatin e ndërtimit të Qendrës së Vizitorëve.

20.7 Ministria mbikqyr ndërtimin e Qendrës së Vizitorëve në prani të një përfaqësuesi të autorizuar të Fondacionit, bazuar në një njoftim paraprak të arsyeshëm me shkrim drejtuar Fondacionit, për të verifikuar që Punimet i përmbahen Planit të Zbatimit.

21. KRIJIMI I GRUPIT SHKENCOR TË BUTRINTIT DHE FUNKSIONET E TIJ BUTRINT RESEARCH GROUP (BRG)

21.1 Fondacioni, në përputhje me Planin e Biznesit, do të krijojë Grupin Shkencor të Butrintit si një organ këshillimor për çështjet tekniko-shkencore, që do të përfshijë ekspertë të fushave të

ndryshme që mbulojnë veprimtaritë e Administrimit të Pasurisë Kulturore.

21.2 Struktura, funksionet, fusha e kërkimeve, detyra të tjera, mënyra e përzgjedhjes së ekspertëve dhe e financimit do të përcaktohen në vendimin e Fondacionit për krijimin dhe funksonimin e tij, sipas Planit të Biznesit.

21.3 Objekti i veprimtarisë së Grupit Kërkimor të Butrintit do të përshijë, pa u kufizuar në, organizimin e konferencave shkencore periodike, zhvillimin dhe publikimin e studimeve shkencore në disiplina të ndryshme që lidhen me Parkun Kombëtar të Butrintit.

21.4 Në varësi të ecurisë financiare të veprimtarisë, Fondacioni do të alokojë një fond për zhvillimet kërkimore që kanë si objekt studimi Pasurinë Kulturore. Subjektet e interesuara për kërkime në fushën e trashëgimisë kulturore (arkeologji, konservim, menaxhime etj), mjedisore (flora dhe fauna) ose komunitare mund të aplikojne për fonde pranë BRG. BRG pas vlerësimit të kërkesave këshillon Fondacionin lidhur me financimin e subjekteve të interesuara për kërkime në Butrint ose në zona më të gjera që përfshijnë në të edhe Butrintin.

22. INVENTARI I PASURISË KULTURORE

22.1 Fondacioni mban dhe përditëson rregullisht Inventarin e Pasurisë Kulturore, duke rakorduar të dhënat në përputhje me shënimet përkatëse në inventarët e mbajtur nga IKRTK.

22.2 Fondacioni cakton një person përgjegjës për mbajtjen e Inventarit të Pasurisë Kulturore në Administrim.

22.3 Inventari i Pasurisë Kulturore mbahet me kohëzgjatje vjetore, hapet me një numër rendor në fillim të vitit kalendarik dhe mbyllet në fund të këtij viti. Në rast se gjatë atij viti në Pasurinë Kulturore janë kryer ndërhyrje ose disa Pasuri Kulturore të Luajtshme kanë qenë objekt qarkullimi sipas nenit 8.1, këto veprime reflektohen në Inventarin e Pasurisë Kulturore për vitin përkatës.

22.4 Fletët e Inventarit të Pasurisë Kulturore respektivisht për Pasuritë Kulturore të Paluajtshme dhe Pasuritë Kulturore të Luajtshme mbahen në përputhje me format përkatëse në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshje.

23. FINANCIMI I FONDACIONIT, KONTRIBUTI FINANCIAR I PALËVE

23.1 Fondacioni financohet nëpërmjet kontributit financiar të themeluesve të tij, granteve dhe nga të ardhurat që rezultojnë nga veprimtaritë e lejuara, në përputhje me këtë Marrëveshje.

23.2 Në përputhje me nenin 18 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga Data e Transferimit Ministria do të transferojë në llogarinë bankare të Fondacionit, një shumë të barabartë me fondet e papërdorura dhe të mbartura të të administruara/kontabilizuara nga ZAKPKB deri në Datën e Transferimit.

23.3 Fondacioni financohet nga Partneri Strategjik nëpërmjet grantit në vlerën 4,985,000 $ (katër milionë e nëntëqind e tetëtëdhjetë e pesë mijë dollarë) sipas Marrëveshjes së Grantit. Ky grant do të disbursohet në favor të Fondacionit si më poshtë:

(a) Një pjesë e grantit do të disbursohet, në të njëjtën datë dhe me të njëjtën vlerë me kontributin e Ministrisë sipas nenit 23.2;

(b) Pjesa e mbetur e grantit do të disbursohet në vijim të kërkesave për fonde të Fondacionit, bazuar në nevojat e tij dhe në përputhje me Planin e Biznesit.

23.4 Me kërkesë të Fondacionit, dhe miratim paraprak të Ministrisë, një pjesë e fondeve të parashikuar në nenin 23.3(b), mund të disbursohen ose jepen si kontribut në natyrë gjatë Periudhës Tranzitore, më herët se disbursimi i fondeve nga ana e Ministrisë sipas nenit 23.2. Në këtë rast, nga pjesa e mbetur e grantit që do të disbursohet në favor të Fondacionit sipas nenit 23.3(b) do të zbriten shumat e disbursuara dhe vlera e kontributit në natyrë të dhënë më herët sipas këtij neni 23.4.

23.5 Në kuadër të administrimit të Pasurisë Kulturore dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Shqipërisë, Fondacioni pranon se do të kontribuojë financiarisht në Fondin Kombëtar për Kujdesin e Trashëgimisë Kulturore Materiale si më poshtë:

(a) Nga viti i parë i Marrëveshjes deri në vitin e tretë, Fondacioni do të kontribuojë respektivisht, 0.5%, 1% dhe 1.5% të të gjithë të ardhurave vjetore të Fondacionit;

(b) Duke filluar nga viti i katërt dhe deri në përfundim të Afatit të Marrëveshjes, Fondacioni do të kontribuojë çdo vit 2% të të gjithë të ardhurave vjetore të Fondacionit.

23.6 Kontributi sipas nenit 23.5 do të paguhet nga Fondacioni brenda 4 (katër) muajve të parë të çdo viti financiar, për të ardhurat e krijuara gjatë vitit të mëparshëm financiar. Përjashtimisht, për vitin e parë kontributi do të llogaritet mbi të ardhurat e krijuara për periudhën nga Data e Transferimit deri në fund të vitit financiar.

24. VLERËSIMI DHE MONITORIMI

24.1 Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga Data Efektive, Ministria ngre njësinë e monitorimit dhe i njofton Fondacionit përbërjen dhe të dhënat e kontaktit të saj.

24.2 Brenda muajit qershor të çdo viti, Fondacioni dorëzon pranë njësisë së monitorimit raportin për Administrimin e Pasurisë Kulturore gjatë vitit kalendarik të mëparshëm, i cili përmban:

(a) gjendjen e konservimit të Pasurisë Kulturore gjatë periudhës objekt monitorimi;

(b) realizimin e planeve vjetore të veprimtarive kulturore të miratuara nga Fondacioni;

(c) informacion për numrin e vizitorëve në Pasurinë Kulturore;

(d) lista e shërbimeve që ofrohen për publikun;

(e) numrin e punonjësve të Fondacionit sipas funksioneve dhe planin e trajnimit të tyre;

(f) listën e kontraktorëve të angazhuar nga Fondacioni për veprimtarinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së Pasurisë Kulturore si dhe nga një kopje të të gjitha kontratave të lidhura me kontraktorët;

(g) raportim mbi të ardhurat vjetore totale të Fondacionit;

(h) Planin e Biznesit të miratuar nga Fondacioni;

(i) realizimin e objektivave të parashikuar në Planin e Menaxhimit duke filluar nga Data Efektive.

24.3 Ministria vlerëson dhe monitoron Administrimin e Pasurisë Kulturore nga Fondacioni në bazë të raportimit të tij si më sipër. Ministria mund të ushtrojë kontroll në vend për vlerësimin e gjendjes së konservimit të raportuar nga Fondacioni, në prani të një përfaqësuesi të autorizuar

të Fondacionit, bazuar në një njoftim me shkrim drejtuar Fondacionit të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara, për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve të Fondacionit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara me udhëzim të Ministrit.

25. NGJARJA E FORCËS MADHORE

25.1 Ngjarje e Forcës Madhore nënkupton çdo ngjarje që:

(a) ndalon Palën e prekur të kryejë detyrimet e saj në përputhje me Marrëveshjen;

(b) është jashtë kontrollit të arsyeshëm, dhe jo rezultat i fajit ose neglizhencës, të Palës së prekur; dhe

(c) Pala e prekur nuk mund të shmangë një akt apo ngjarje të tillë me ushtrimin e të gjithë kujdesit dhe aftësive të arsyeshme (duke përfshirë shpenzimin e shumave të arsyeshme),

duke iu nënshtruar përmbushjes së kushteve të mësipërme, "**Ngjarja e Forcës Madhore**" përfshin por nuk kufizohet vetëm në aktet ose ngjarjet e mëposhtme:

i. fenomenet natyrore, të tilla si stuhitë, uraganet, përmbytjet, rrufetë, shpërthimet vullkanike dhe tërmetet;

ii. shpërthime ose zjarre që lindin nga rrufeja ose shkaqe të tjera që nuk lidhen me veprimet ose mosveprimet e Palës që kërkon të çlirohet nga performanca;

iii. akte te luftës, pushtimi ose akti i një armiku të jashtëm, trazira publike, trazira civile, bllokada, embargo, protesta, kryengritje, sabotazhe, epidemi, pandemi, kontaminim radioaktiv, akte terroriste, rebelime;

iv. greva (ose akt i organizuar me efekt te njejte me grevën) ose mosmarrëveshje pune;

v. ndërprerja e pjesshme ose e plotë e aktiviteteve në Pasuri Kulturore ose një pjesë të Pasurisë Kulturore gjatë vlefshmërisë së një vendimi për gjendjen e emergjencës ose të fatkeqësisë natyrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose njësisë qeverisëse vendore ku ndodhet Pasuria Kulturore;

me kusht që një Ngjarje e Forcës Madhore nuk përfshin:

(a) padisponueshmërinë e forcës punëtore, pajisjeve, materialeve, shërbimeve komunale ose burimeve të tjera (me përjashtim të rastit kur padisponueshmëria vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore);

vi. vështirësi ekonomike ose financiare apo mungesë fondesh ose pamundësi për të përmbushur detyrimin për të paguar para në afat apo pamundësi për të përftuar financim (me përjashtim të rastit kur mungesa e materialeve vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore);

vii. mungesë materialesh që nevojiten për zhvillimin, ndërtimin ose mirëmbajtjen e Pasurisë Kulturore (me përjashtim të rastit kur mungesa e materialeve vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore).

25.2 Përveçse është parashikuar në nenin 29, një Ngjarje e Forcës Madhore nuk i jep asnjërës prej Palëve të drejtën që të zgjidhë këtë Marrëveshje dhe asnjë nga Palët nuk do të jetë në shkelje të Marrëveshjes apo përgjegjëse, në rast dështimi për përmbushjen të detyrimeve të tyre respektive apo vonese, për sa kohë që ky dështim apo vonesë në përmbushjen e detyrimeve ka ndodhur për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore.

25.3 Në përputhje me nenin 25.2, afatet e parashikuara në këtë Marrëveshje do të zgjaten ditë pas dite kur njëra nga Palët pezullon detyrimet e veta nën këtë Marrëveshje për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore sipas nenit 25.1.

25.4 Pala e cënuar nga Ngjarja e Forcës Madhore do të përfitojë lehtësimin në bazë të nenit 25.2 dhe 25.3 vetëm nëse:

(a) ka njoftuar menjëherë me shkrim Palën tjetër, për Ngjarjen e Forcës Madhore, duke treguar se Ngjarja e Forcës Madhore në fjalë ka penguar apo vonuar në mënyrë të arsyeshme përmbushjen e detyrimeve të Palës së prekur dhe duke deklaruar masën e parashikuar dhe kohëzgjatjen e mundshme të Ngjarjes së Forcës Madhore në fjalë (nëse një gjë e tillë është e mundur);

(b) ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të zvogëluar ndikimin dhe zbutur pasojat e Ngjarjes së Forcës Madhore sa më shpejt të jetë e mundur; dhe

(c) përveçse kur pengohet nga një Ngjarje e Forcës Madhore, i paraqet Palës tjetër një raport (apo një plan rekuperimi dhe rehabilitimi në rast epidemie apo karantinimi që prek Pasurinë Kulturore), në lidhje me masat e marra në përputhje me nenin 25.4(b) dhe një përditësim të këtyre raporteve rregullisht sa është e nevojshme në lidhje me zgjatjen e parashikuar dhe kohëzgjatjen e mundshme të Ngjarjes së Forcës Madhore dhe në rast epidemie apo karantinimi një raport për masat zbutëse dhe të rekuperimit që janë marrë për kalimin e efekteve negative.

25.5 Neni 25.2 dhe 25.3 nuk e zhvesh Palën e prekur nga Ngjarja e Forcës Madhore nga kryerja e detyrimeve sipas Marrëveshjes ose nga përgjegjësia për moskryerjen e tyre nëse mos kryerja e tyre ka ndodhur përpara Ngjarjes së Forcës Madhore, ose nuk lidhet me Ngjarjen e Forcës Madhore.

26. KONTRAKTIMI

26.1 Fondacioni do të përmbushë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes përmes personelit të tij ose duke kontraktuar persona të tretë të pajisur me kualifikimet dhe/ose lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e punëve/shërbimeve.

26.2 Fondacioni nuk mund të transferojë Administrimin e Pasurisë Kulturore tek një palë e tretë, por mund të kontraktojë palë të treta për kryerjen e punëve dhe shërbimeve specifike në kuadër të ushtrimit të Administrimit të Pasurisë Kulturore.

26.3 Fondacioni do të prokurojë punë dhe shërbimet, si më sipër në përputhje me procedurat e veta të brendshme dhe Praktikën e Mirë të Industrisë dhe të ruajë dokumentacionin përkatës për secilën procedurë për efekt auditimi nga kompani të auditi ndërkombëtar të radhës të renditura sipas publikimeve ndërkombëtare përkatëse.

26.4 Fondacioni ka për detyrë të mbajë një regjistër të të gjithë kontraktorëve si dhe nga një kopje të të gjitha kontratave të lidhura me kontraktorët, të cilat i vë në dispozicion të Ministrisë.

26.5 Fondacioni siguron që të gjitha kontratat e lidhura me nënkontraktorët të përmbajnë:

(a) dispozita që mundësojnë që të drejtat dhe detyrimet e Fondacionit në këto kontrata t'i transferohen pa kosto shtesë Ministrisë me kërkesën me shkrim të saj, në rastin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshje;

(b) dispozita që caktojnë detyrime të konfidencialitetit;

(c) ndalime për angazhime në veprime korruptive, mashtruese apo shtrënguese, apo veprime të tjera të jashtëligjshme.

26.6 Fondacioni në asnjë mënyrë nuk çlirohet nga ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje për shkak të ekzistencës apo zbatimit të ndonjë nënkontrate nga ndonjë nënkontraktor dhe Fondacioni është tërësisht përgjegjës për veprimet, vonesën dhe pakujdesinë e nënkontraktorëve të tij si dhe të përfaqësuesve dhe punëtorëve të nënkontraktorëve sikur të ishin veprimet, vonesat dhe pakujdesia e vetë Fondacionit; dhe

26.7 Lidhja e kontratave nga Fondacioni me palët e treta nuk krijon asnjë përgjegjësi apo detyrim për Ministrinë ndaj nënkontraktorëve dhe Fondacioni dëmshpërblen dhe përjashton Ministrinë ndaj çdo përgjegjësie, pretendimi për dëmshpërblimi, padie apo procesi tjetër të ardhur si pasojë e ndonjë nënkontrate apo marrëdhënies midis Fondacionit dhe një nënkontraktori në përputhje me nenin 30.

27. SIGURIMI

27.1 Fondacioni, me shpenzimet e veta lidh dhe mban në fuqi gjatë gjithë Afatit së kësaj Marrëveshjeje të gjitha policat e sigurimit, lista e plotë e të cilave do të përcaktohet nga Bordi i Drejtorëve të Fondacionit.

27.2 Mosrespektimi i këtij neni përbën një Rast Mospërmbushje të Fondacionit.

27.3 Ministria do të përfshihet si person i bashkësiguruar në të gjitha policat e sigurimit që Fondacioni lidh dhe mban gjatë gjithë Afatit së kësaj Marrëveshjeje. Për sa kohë që Administrimi kryhet nga Fondacioni, dëmshpërblimi sipas policës së sigurimit do t'i kalojë tërësisht Fondacionit.

27.4 Pas ndodhjes së një ngjarjeje apo një seri ngjarjesh që mund të bëhen shkak për pretendime të mundshme sipas policave të sigurimit të mbajtura nga Fondacioni në përputhje me nenin 27.1, Palët bien dakord që të takohen sa më shpejt për të (i) diskutuar mbi rrethanat që mund të bëhen shkak për një pretendim dëmshpërblimi apo pretendime të mundshme dëmshpërblimi, dhe (ii) mbulimin e disponueshëm sipas policave të sigurimit të Fondacionit. Pas një takimi të tillë, Fondacioni bie dakord që:

(a) të kërkojë të gjitha riparimet dhe kompensimet e disponueshme sipas policave të sigurimit, dhe

(b) të ardhurat e marra nga siguruesit të përdoren plotësisht për të mbuluar kostot apo shpenzimet që kanë lindur, ose që do të lindin, si rrjedhojë e një ngjarjeje apo rrethane, duke përfshirë riparimin apo rindërtimin e ndonjë objekti të Pasurisë Kulturore.

28. KORRIGJIMI I RASTEVE TË MOSPËRMBUSHJES DHE NDËRHYRJA E MINISTRISË

Njoftimi për Mospërmbushje dhe Korrigjimi

28.1 Në rast se ndodh një Rast Mospërmbushjeje i Fondacionit ose një Rast Mospërmbushjeje i

Ministrisë, Pala që nuk ka kryer shkeljen i dërgon njoftim për rastin në fjalë Palës që gjendet në mospërmbushje ("**Njoftim për Mospërmbushje**").

28.2 Pala në shkelje e korrigjon Rastin e Mospërmbushjes së Fondacionit ose Rastin e Mospërmbushjes së Ministrisë, sipas rastit, brenda 30 (tridhjetë) ditësh (apo një periudhë më të gjatë siç mund të jetë parashikuar në Njoftimin për Mospërmbushje, ose siç Palët mund të bien bashkërisht dakord ndryshe) nga marrja e Njoftimit për Mospërmbushje ("**Periudha e Korrigjimit**"), me kusht që një rast i tillë mospërmbushjeje të mund të korrigjohet.

28.3 Në mbarim të Periudhës së Korrigjimit, nëse:

(a) Rasti i Mospërmbushjes së Fondacionit ose Rasti i Mospërmbushjes së Ministrisë, sipas rastit, nuk është korrigjuar; dhe

(b) Palët nuk kanë rënë dakord të zgjasin Periudhën e Korrigjimit,

Pala që nuk ka bërë shkelje ka të drejtë t'i dërgojë Palës në shkelje një njoftim për zgjidhjen e Marrëveshjes, në përputhje me nenin 29.

Shkaku për ndërhyrje

28.4 Ministria ndërhyn, duke marrë pjesërisht ose plotësisht Administrimin e Pasurisë, në rastet e mëposhtme:

(a) Braktisje;

(b) ruajtje e sigurisë kombëtare, dhe

(c) Ngjarje e Forcës Madhore kur ndërhyrja është e nevojshme për ruajtjen e integritetit të Pasurisë Kulturore,

Ministria ka të drejtë që të veprojë menjëherë në përputhje me nenin 28.5 më poshtë.

E Drejta e Ndërhyrjes

28.5 Nëse ndodh një prej rasteve të parashikuara në nenin 28.4, Ministria njofton me shkrim Fondacionin si vijon për:

(a) arsyen që justifikon ndërhyrjen për një veprim të tillë;

(b) një përshkrim të veprimit urgjent ndërhyrës, i cili mund të përfshijë marrjen përsipër plotësisht ose pjesërisht të të drejtave të Administrimit të Pasurisë Kulturore, duke përfshirë kufizimin e aksesit të Fondacionit në një pjesë ose në të gjithë Pasurinë Kulturore, dhe të drejtën për të udhëzuar personelin (përfshirë edhe personelin kyç) të Fondacionit;

(c) datën kur do të nisë ndërhyrja nga ana e Ministrisë (datë e cila mund të jetë data e vetë njoftimit);

(d) periudhën kohore që në gjykimin e Ministrisë do të jetë e nevojshme të vazhdojë ndërhyrja; dhe

(e) detyrimet e Fondacionit gjatë periudhës së ndërhyrjes

("**E Drejta e Ndërhyrjes**").

28.6 Ministria mund të ushtrojë të Drejtën e Ndërhyrjes drejtpërdrejtë ose mund të udhëzojë një palë të tretë të zgjedhur prej saj për të vepruar për llogari të saj. Në çdo rast, në çdo kohë gjatë ushtrimit të të Drejtës së Ndërhyrjes, Ministria ushtron dhe siguron që çdo palë e tretë që vepron për llogari të saj, të ushtrojë kujdesin e duhur në lidhje me Pasurinë Kulturore.

Procedura dhe kohëzgjatja

28.7 Ministria dhe Fondacioni do të takohen menjëherë pas ushtrimit të së Drejtës së Ndërhyrjes për të rënë dakord për një plan veprimi për të korrigjuar situatën dhe kthyer Palët në situatën normale për përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve të tyre sipas Marrëveshjes.

28.8 Nëse Fondacioni njofton mundësinë e tij për të rimarrë në administrim Pasurinë Kulturore, duke provuar aftësinë e tij për të vazhduar veprimtarinë e administrimit, Ministria brenda 48 orëve fillon bisedimet me Fondacionin për modalitet e kthimin e përgjegjësive të administrimit të Pasurisë Kulturore. Bisedimet duhet të përfundojnë brenda një afati 1 (një) javor.

28.9 Në rastin kur pas bisedimeve midis Palëve sipas këtij neni (i) nuk arrihet një marrëveshje, ose (ii) arrihet një marrëveshje, por Fondacioni nuk e rimerr në administrim Pasurinë Kulturore sipas një marrëveshje të tillë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data kur përfundon shkaku për ndërhyrje sipas nenit 28.4, Ministria i dërgon Fondacionit një njoftim për zgjidhjen e Marrëveshjes, në përputhje me Nenin 29.

29. ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

Zgjidhja e Parakohshme

29.1 Secila Palë ("**Pala Zgjidhëse**") mund të zgjidhë Marrëveshjen para Afatit ("**Zgjidhja e Parakohshme**") duke njoftuar Palën tjetër me shkrim sipas nenit 29.2, në rast se ka ndodhur:

(a) një Rast Mospërmbushjeje në lidhje me Palën tjetër, i cili vazhdon pavarësisht Njoftimit për Mospërmbushje nga Pala Zgjidhëse dhe Palët nuk kanë rënë dakord të zgjasin Periudhën e Korrigjimit, ose

(b) një Ngjarje e Forcës Madhore, e cila vazhdon e pandërprerë për një periudhë më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj dhe pengon Palën e prekur që të përmbushë detyrimet nën këtë Marrëveshje.

29.2 Njoftimi për Zgjidhjen e Parakohshme duhet të specifikojë Rastin e Mospërmbushjes ose Ngjarjen e Forcës Madhore, sipas rastit, që justifikon Zgjidhjen e Parakohshme dhe përcakton një datë si datë e zgjidhjes së parakohshme ("**Data e Zgjidhjes së Parakohshme**"). Data e Zgjidhjes së Parakohshme nuk mund të jetë më herët se data kur njoftimi konsiderohet si i marrë (në rastin kur Ministria ka ushtruar të Drejtën e Ndërhyrjes), sipas Marrëveshjes, dhe jo më vonë se data e parashikuar nga Plani i Dorëzimit.

Efektet e Zgjidhjes së Parakohshme

29.3 Pas Datës së Zgjidhjes së Parakohshme Marrëveshja do të pushojë së qënuri në fuqi, me perjashtim të:

(a) neneve të saj që parashikojnë vazhdimësinë e detyrimeve pas Datës së Zgjidhjes së Parakohshme; dhe

(b) të të drejtave dhe detyrimeve të Palëve të lindura përpara Datës së Zgjidhjes së Parakohshme.

29.4 Pas marrjes së njoftimit për Zgjidhjen e Parakohshme, Palët fillojnë menjëherë zbatimin e detyrimeve sipas nenit 32.

30. DËMSHPËRBLIMI

Përgjegjësia ndaj Palëve të Treta

30.1 Fondacioni do të dëmshpërblejë Ministrinë dhe çdo Person të lidhur me Ministrinë dhe do ta mbajë Ministrinë dhe çdo Person të lidhur me Ministrinë të pacënuar kundrejt palëve te treta, për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Ministria dhe çdo Person i lidhur me të, për arsye të ndonjë dëmtimi ose vdekjeje ose shkatërrimi të ndonjë prone, cënimi të të drejtave të çdo personi në masën që Humbja e shkaktuar nga akte, veprime dhe/ose mosveprime të Fondacionit dhe/ose të punonjësve dhe/ose nënkontraktorëve apo agjentëve të tij, që lidhen me administrimin e Pasurisë Kulturore, ndërtimin e objekteve sipas nenit 20 dhe/ose me kryerjen e aktiveteve që parashikohen në këtë Marrëveshje, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes së paligjshme me faj të Ministrisë dhe ose të çdo Personi të lidhur me Ministrinë, dhe ose të palëve të treta gjatë Hulumtimeve Arkeologjike ose ndonjë Ngjarje e Forcës Madhore.

30.2 Ministria do të dëmshpërblejë Fondacionin dhe do ta mbajë Fondacionin të pacënuar, kundrejt palëve të treta, për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Fondacioni, për arsye të ndonjë dëmtimi ose vdekjeje ose shkatërrimi të ndonjë prone, cënimi të të drejtave të çdo personi në masën që Humbja shkaktohet nga akte, veprime dhe/ose mosveprime të Ministrisë, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes së paligjshme me faj të Fondacionit dhe/ose të punonjësve të Fondacionit, nënkontraktorëve e tij, ose ndonjë Ngjarje të Forcës Madhore.

Shkeljet

30.3 Fondacioni do të dëmshpërblejë Ministrinë dhe çdo Person të lidhur me Ministrinë dhe do ta mbajë Ministrinë dhe çdo Person të lidhur me Ministrinë të pacënuar, ndaj palëve të treta, për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Ministria dhe çdo Person i lidhur me Ministrinë për arsye të ndonjë shkeljeje nga ana e Fondacionit ose përfaqësuesve të tij, të deklarimeve dhe garancive, detyrimeve dhe përgjegjësive që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes së paligjshme me faj të Ministrisë ose të çdo Personi të lidhur me Ministrinë, dhe ose të palëve të treta gjatë Hulumtimeve Arkeologjike, ose ndonjë Ngjarje të Forcës Madhore.

30.4 Ministria do të dëmshpërblejë Fondacionin dhe do ta mbajë Fondacionin të pacënuar ndaj palëve të treta për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Fondacioni për arsye të ndonjë shkelje nga ana e Ministrisë ose e përfaqësuesve të saj, të deklarimeve dhe garancive, detyrimeve dhe përgjegjësive që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes së paligjshme me faj të Fondacionit dhe/ose të punonjësve dhe/ose nënkontraktorëve apo agjentëve të tij, ose Ngjarje e Forcës Madhore.

Shkeljet Mjedisore

30.5 Fondacioni do të dëmshpërblejë Ministrinë dhe çdo Person të lidhur me Ministrinë dhe do ta mbajë Ministrinë dhe çdo Person të lidhur me Ministrinë të pacënuar, ndaj palëve të treta për çdo Humbje të çfarëdo lloji që ka pësuar ose do të pësojë Ministria ose çdo Person i lidhur me

Ministrinë për çdo mospërmbushje nga ana e Fondacionit e Legjislacionit të Zbatueshëm mjedisor në fuqi dhe për çdo pretendim nga cilido Person për dëmtim të shëndetit, pronës, mirëqënies ose të drejtave si rezultat i shkeljes Legjislacionit të Zbatueshëm mjedisor në fuqi nga ana e Fondacionit, me përjashtim të masës që Humbja e tillë është shkaktuar nga, ose i atribuohet neglizhencës ose sjelljes së paligjshme me faj të Ministrisë dhe/ose Autoriteteve Kompetente, dhe/ose të punonjësve dhe/ose nënkontraktorëve apo agjentëve të tyre, ose Ngjarje e Forcës Madhore, ose nga veprime ose mosveprime të palëve të treta gjatë Hulumtimeve Arkeologjike.

Njoftimet

30.6 Nëse Pala e Dëmshpërblyer merr njoftim për ndonjë kërkesë ose fillimin e ndonjë padie, veprimi, kërkese, procedimi ose hetimi të sjellë nga ndonjë Person tjetër përveç Palës Dëmshpërblyese dhe beson me mirëbesim se Pala Dëmshpërblyese mund të jetë e detyruar të sigurojë dëmshpërblimin në përputhje me këtë Marrëveshje, Pala e Dëmshpërblyer do t'i japë menjëherë Palës Dëmshpërblyese njoftimin me shkrim ("**Njoftim për Dëmshpërblim**") i cili përcakton në detaje të arsyeshme informacionin e nevojshëm në lidhje me padinë, veprimin, pretendimin, procedimin ose hetimin, që rëndon mbi Palën e Dëmshpërblyer. Dështimi i Palës së Dëmshpërblyer për t'i dërguar Palës Dëmshpërblyese Njoftimin për Dëmshpërblim, nuk do të lehtësojë Palën Dëmshpërblyese për çdo përgjegjësi që mund të ketë ndaj Palës së Dëmshpërblyer përveç në masën që dështimi për të njoftuar e pengon materialisht Palën Dëmshpërblyese në aftësinë e saj për të kundërshtuar padinë, veprimin, pretendimin, procedimin ose hetimin për të cilin kërkohet dëmshpërblimi.

30.7 Pas marrjes së një Njoftimi për Dëmshpërblim, Pala e Dëmshpërblyer dhe Pala Dëmshpërblyese mund të bien dakord që Pala Dëmshpërblyese do të marrë përsipër masat ligjore në kuadër një padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi.

30.8 Nëse Pala e Dëmshpërblyer dhe Pala Dëmshpërblyese bien dakord që Pala Dëmshpërblyese do të marrë përsipër mbrojtjen kundrejt çdo padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi për të cilën është thirrur të dëmshpërblejë Palën e Dëmshpërblyer në përputhje me këtë nen, Pala Dëmshpërblyese nuk do të zgjidhë me marrëveshje një padi, veprim, kërkesë, procedim ose hetim të tillë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së Dëmshpërblyer, përveç nëse Pala e Dëmshpërblyer nuk ka pretendim dhe padia, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi kanë si objekt kërkimin e një dëmshpërblimi monetar i cili mbulohet plotësisht nga dëmshpërblimi i Palës Dëmshpërblyese.

30.9 Nëse Pala e Dëmshpërblyer dhe Pala Dëmshpërblyese bien dakord që Pala Dëmshpërblyese do të marrë përsipër mbrojtjen kundrejt çdo padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi për të cilin është thirrur të dëmshpërblejë Palën e Dëmshpërblyer në përputhje me këtë nen, Pala Dëmshpërblyese do të informojë Palën e Dëmshpërblyer në mënyrë të arsyeshme për ecurinë e çdo padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi. Nëse kërkohet nga Pala Dëmshpërblyese, Pala e Dëmshpërblyer do të bashkëpunojë në masën e kërkuar në mënyrë të arsyeshme në mbrojtjen ose procedimin e çdo padie, veprimi, pretendimi, procedimi ose hetimi për të cilën Pala Dëmshpërblyese është thirrur për të dëmshpërblyer Palën e Dëmshpërblyer sipas këtij neni.

30.10 Asnjë Palë nuk do të dëmshpërblehet më shumë se një herë për të njëjtën Humbje. Ministria nuk do të ngarkojë me përgjegjësi Fondacionin për asnjë Humbje që mund të jetë shkaktuar nga ngjarje, veprime apo mosveprime të ndodhura përpara Datës së Transferimit.

30.11 Ky nen 30, përveç neneve 30.3 dhe 30.4, do të mbetet në fuqi për 3 (tre) vjet pas datës së përfundimit të Afatit të kësaj Marrëveshjeje dhe pavarësisht nga zgjidhja e saj, njëra Palë do t'i kërkojë shumat që i detyrohen Palës tjetër sipas këtij neni, në përputhje me këtë Marrëveshje.

31. PRONËSIA INTELEKTUALE

31.1 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Fondacioni gëzon të drejtën e Pronësisë Intelektuale mbi produktet dhe shërbimet që do të ofrojë në kuadër të Administrimit.

31.2 Ministria nuk do të cënojë të drejtat e Pronësisë Intelektuale të Fondacionit gjatë Afatit të Marrëveshjes.

31.3 Me mbarimin e Afatit të Marrëveshjes dhe në përputhje me nenin 32, Fondacioni do t'i transferojë Ministrisë ose Autoritetit Kompetent të caktuar nga Ministria për administrimin e Pasurisë Kulturore, sipas rastit, çdo dhe të gjitha të drejtat e Pronësisë Intelektuale pa kundërshpërblim.

32. DORËZIMI

Të përgjithshme

32.1 Procesi i dorëzimit fillon të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së përfundimit të Afatit (për sa kohë që nuk ndodh Zgjidhje e Parakohshme e Marrëveshjes, në të cilin rast Palët fillojnë procesin e dorëzimit sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur pas dorëzimit të njoftimit të Zgjidhjes së Parakohshme) me një inspektim të përbashkët të Pasurisë Kulturore nga Ministria dhe Fondacioni. Për efekt qartësie, në rastin e Zgjidhjes së Parakohshme, Palët mund të bien dakord për afate më të shkurtra përsa i përket neneve 32.1 deri në 32.4.

32.2 Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e inspektimit të përbashkët, Fondacioni i paraqet Ministrisë për rishikim dhe miratim, një draft të planit të dorëzimit ("**Plani i Dorëzimit**") që parashikon të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet e Fondacionit dhe të Ministrisë për transferimin e Pasurisë Kulturore tek Ministria. Plani i Dorëzimit, ndër të tjera, do të përmbajë çdo lloj informacioni që do të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Ministria dhe/apo që në mënyrë të arsyeshme do të jetë i nevojshëm apo duhet për transferimin e Pasurisë Kulturore tek Ministria. Fondacioni do ti sigurojë Ministrisë të gjithë asistencën e arsyeshme, e cila në opinionin e Ministrisë është e nevojshme për të kënaqur kërkesat e Planit të Dorëzimit.

32.3 Ministria do të bëjë komentet apo ndryshimet e saj në draftin e Planit të Dorëzimit jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga paraqitja e draft Planit të Dorëzimit nga ana e Fondacionit, dhe Fondacioni do të paraqesë versionin final të Planit të Dorëzimit duke përfshirë komentet dhe/apo ndryshimet e propozuara nga Ministria, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e komenteve/ndryshimeve të Ministrisë, me kusht që në rast se Ministria nuk bën asnjë koment brenda periudhës prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, atëherë Ministria do të konsiderohet se e ka miratuar draftin e Planit të Dorëzimit.

32.4 Fondacioni dhe Ministria do të takohen përsëri brenda 70 (shtatëdhjetë) ditëve pas takimit të parë midis Palëve të parashikuar në nenin 32.1, me qëllim fillimin e procedurave të procesit të dorëzimit. Më pas, përfaqësues të Fondacionit dhe Ministrisë do të takohen rregullisht në baza mujore, në data të vendosura paraprakisht (në orare të dakordësuara nga Fondacioni dhe Ministri) deri në datën e mbarimit të Afatit, për të diskutuar dhe për të rishikuar çdo çështje që mund të dalë, në lidhje me procesin e dorëzimit dhe/ose përmbushjen e kërkesave të Planit të Dorëzimit. Fondacioni do të përgatisë të gjitha shënimet/procesverbalet e të gjitha takimeve dhe do ja dorëzojë ato Ministrisë.

Pasuria Kulturore

32.5 Jo më vonë se data e mbarimit të Afatit ose e Zgjidhjes së Parakohshme të Marrëveshjes, Fondacioni do të kryejë dorëzimin e rregullt të Pasurisë Kulturore, të çdo aseti të trupëzuar në

Pasurinë Kulturore të Paluajtshme dhe çdo të drejtë të lidhur me Pasurinë Kulturore, përfshirë por pa u kufizuar në të drejtat e Administrimit, Gëzimin e Plotë dhe të Qetë, të Drejtën e Kalimit, pa asnjë barrë, peng, apo detyrime ndaj të tretëve, sipas udhëzimeve të Ministrisë dhe në përputhje me parashikimet e këtij neni 32.

32.6 Përfaqësues të Fondacionit dhe Ministrisë do të kryejnë inspektimet e nevojshme në terren bazuar në inventarët e përgatitur nga Fondacioni në lidhje me Pasuritë Kulturorë të Paluajtshme dhe Pasuritë Kulturore të Luajtshme. Fondacioni do të korrigjojë sa më shpejt të jetë e mundur pasaktësitë në inventarët përkatës, në përputhje me gjetjet përkatëse të përfaqësuesve të Palëve.

Punonjësit

32.7 Gjatë Periudhës së Dorëzimit Fondacioni do të:

(a) Ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të informuar punonjësit se marrëdhënia e tyre e punës përfundon në datën e përfundimit të Afatit;

(b) Japë Ministrisë informacion të mjaftueshëm mbi çdo punonjës të Fondacionit në mënyrë që Ministria (ose Autoritetit Kompetent përkatës, nëse udhëzohet nga Ministria) të ketë mundësi t'i ofrojë (në diskrecionin e saj/tij) secilit punonjës një kontratë pune e cila do të ketë efekt pas datës së mbarimit të Afatit;

(c) Sigurojë për çdo punonjës që transferohet nga Fondacioni tek Ministria, që të dhënat e këtyre punonjësve të jenë mbajtur në mënyrë të rregullt dhe ti dorëzohen Ministrisë.

Librat dhe të Dhënat

32.8 Jo më vonë se data e mbarimit të Afatit ose e Zgjidhjes së Parakohshme të Marrëveshjes, Fondacioni do t'i dorëzojë Ministrisë në formë elektronike dhe/ose kopje të printuara, nëse kërkohen në forma të tilla nga Ministria, të gjithë informacionin dhe të dhënat, të cilat në mënyrë të arsyeshme janë të nevojshme për të mundësuar administrimin efikas të Pasurisë Kulturore, përfshirë por pa u kufizuar në inventarin e Pasurisë Kulturore të Paluajtshme, inventarin e Pasurive Kulturore të Luajtshme, bilancet financiare të Fondacionit. I gjithë informacioni që do ti jepet Ministrisë, do të jetë i saktë, gjithëpërfshirës dhe i përditësuar, në çdo aspekt.

Fondet dhe të ardhurat

32.9 Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e mbarimit të Afatit ose nga Data e Zgjidhjes së Parakohshme, Palët do të përcaktojnë vlerën paraprake të fondeve financiare që do t'i transferohen Ministrisë (ose Autoritetit Kompetent përkatës, nëse udhëzohet nga Ministria).

32.10 Fondacioni do t'i transferojë Ministrisë (ose Autoritetit Kompetent përkatës, nëse udhëzohet nga Ministria) çdo të drejtë mbi të ardhurat e arkëtueshme, përfshirë të ardhura të arkëtueshme nga policat e sigurimit të pajtuara nga Fondacioni apo për llogari të Fondacionit (nëse ka), por të papaguara deri në datën e përfundimit të kësaj Marrëveshje.

32.11 Shuma përfundimtare e fondeve financiare që do të transferohen sipas nenit 32.9 dhe mënyra e transferimit të tyre do të kryhet në përputhje me planin e likuidimit të Fondacionit.

Kontratat

32.12 Jo më vonë se data e mbarimit të Afatit ose se Data e Zgjidhjes së Parakohshme të Marrëveshjes, Fondacioni i transferon Ministrisë (ose Autoritetit Kompetent përkatës, nëse udhëzohet nga

Ministria) të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga çdo kontratë ose zgjidh këto kontrata, pa përgjegjësi apo kosto shtesë për Ministrinë dhe Fondacioni do të sigurojë që kontratat përkatëse të përmbajnë këtë të drejtë të Ministrisë. Fondacioni do të dëmshpërblejë Ministrinë sipas nenit 30.3 ndaj çdo pretendimi të kontraktorit përkatës kundrejt Ministrisë, si pasojë e zgjidhjes nga Fondacioni të kontratës së tij me këtë të fundit, me udhëzim të Ministrisë.

Të tjera

32.13 Jo më vonë se data e mbarimit të Afatit ose se Data e Zgjidhjes së Parakohshme të Marrëveshjes, Fondacioni i transferon Ministrisë (ose Autoritetit Kompetent përkatës, nëse udhëzohet nga Ministria):

(a) të drejtat e Pronësisë Intelektuale që lidhen ngushtësisht me Pasurinë Kulturore;

(b) të gjitha pajisjet, materialet dhe asetet e luajtshme, përfshirë dhe të gjitha garancitë e mbi këto pajisje, materiale dhe asete;

(c) të gjitha policat e sigurimit të lidhura nga Fondacioni.

32.14 Secila Palë do të mbulojë kostot e shpenzimet e saj për transferimin e Pasurisë Kulturore tek Ministria, sipas këtij neni.

33. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

33.1 Palët do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur me mirëbesim çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga apo lidhet me këtë Marrëveshje (përfshirë çdo pretendim për ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen e saj). Pala që ngre pretendimin mbi mosmarrëveshjen njofton fillimisht përfaqësuesin ligjor të Palës tjetër. Palët do të takohen në mirëbesim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditëve Pune që nga data e parashtrimit të mosmarrëveshjes për të zgjidhur mosmarrëveshjen.

33.2 Në rast se Palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëbesim sipas nenit 33.1 më sipër, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, përveç konflikteve që kanë për objekt të drejtat reale për të cilat kompetente është gjykata ku ndodhet Pasuria Kulturore e Paluajtshme.

34. LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Marrëveshje dhe çfarëdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh nga apo lidhet me të (duke përfshirë pretendimet jashtëkontraktuale) rregullohet nga dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

35. TRANSFERIMI I MARRËVESHJES

35.1 Në përputhje me dhe sipas kërkesave të Legjislacionit të Zbatueshëm, të drejtat dhe detyrat e Ministrisë sipas kësaj Marrëveshjeje mund të transferohen pa pëlqimin e Fondacionit, tek një Autoritet tjetër Kompetent përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

35.2 Ministria do të njoftojë Fondacionin për datën kur do të hyjë në fuqi transferimi i kësaj Marrëveshjeje tek Autoriteti tjetër Kompetent përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Pas kësaj date, Ministria do të shkarkohet nga detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Autoriteti tjetër Kompetent do të marrë përsipër të gjithë detyrimet e Ministrisë sipas kësaj Marrëveshjeje.

36. NJOFTIMET

36.1 Çdo njoftim apo komunikim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të kryhet në formë të shkruar, dhe konsiderohet i dorëzuar nëse dorëzohet personalisht, me postë rekomande të parapaguar, me korrier në adresën e Palës tjetër e cila jepet më poshtë, me faks (me marrje të konfirmimit të transmetimit) në numrin e faksit të Palës tjetër, ose postë elektronike në adresën e marrësit ose (sipas rastit), me kusht që, nëse nuk është dhënë adresë postare apo poste elektronike dhe/ose numri faks për marrjen e njoftimeve, këto njoftime nuk do të dorëzohen nëpërmjet këtyre mënyrave të komunikimit.

36.2 Adresat e Palëve për njoftim do të jenë ato të dhëna më poshtë, ose një adresë tjetër që secila Palë mund t'ia njoftojë me shkrim Palës tjetër për këtë qëllim.

(a) Për Fondacionin:

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Kullat Binjake, Ndërtesa 6, Hyrja 11, Apartamenti 21

Tiranë, Shqipëri

[EMAIL]

(b) Për Ministrinë:

Rruga "Aleksandër Moisiu"

Ish Kinostudio "Shqipëria e Re"

Tiranë, Shqipëri

[EMAIL]

36.3 Një njoftim do të konsiderohet se është marrë:

(a) Në momentin e marrjes, nëse dorëzohet personalisht;

(b) Në Ditën e tretë të Punës pas datës së postimit nëse dërgohet me postë rekomande të parapaguar;

(c) Pas marrjes së konfirmimit të dorëzimit nëse dërgohet me transmetim faksimil;

(d) Në rastin e dërgesës me postë elektronike, në momentin e mbërritjes në serverin e marrësit dhe nëse dërguesi nuk merr mesazh që ka ndodhur gabim.

36.4 Çdo njoftim që konsiderohet si i marrë në një ditë që nuk është Ditë Pune, apo pas orës 17:00 në një Ditë Pune, do të konsiderohet se është marrë në orën 09:00 në Ditën e nesërme të Punës.

36.5 Të gjitha njoftimet, korrespondencat ose komunikimet e tjera ndërmjet Ministrisë dhe Fondacionit në lidhje me këtë Marrëveshje do të jenë në gjuhën shqipe.

37. DISPOZITA TË FUNDIT

37.1 Kjo Marrëveshje, së bashku me Marrëveshjen e Bashkëpunimit rregullon të gjitha veçoritë dhe

të gjitha marrëdhëniet kontraktuale në lidhje me Pasurinë Kulturore. Secila prej Palëve do të sigurohet që nënshkrimi pas Datës së Nënshkrimit i çdo marrëveshje tjetër që lidhet me Pasurinë Kulturore nuk do të sjellë si pasojë mospërmbushjen nga ajo Palë e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshje.

37.2 Kjo Marrëveshje, duke përfshirë Shtojcat e saj, përbëjnë të gjithë Marrëveshjen midis Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvëndëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, të lidhura me shkrim ose me gojë ndërmjet Palëve në lidhje me administrimin e Pasurisë Kulturore.

37.3 Në lidhje me shkëmbime të informacionit konfidencial, Pala marrëse do të mbajë konfidencial dhe nuk do t'i bëjë publik, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës dhënëse, të gjitha vizatimet, regjistrat, të dhënat, bilancet, raportet, dokumentet dhe informacionet konfidenciale, qoftë me natyrë teknike, tregtare apo financiare, që i janë dhënë nga ose në emër të Palës dhënëse në lidhje me Projektin, me përjashtim të sa më poshtë:

(a) që aktualisht apo në të ardhmen bëhet publik përveç rastit kur bëhet publik si rezultat i shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit, ose që mund të merret nga burime të tjera përveç Palëve;

(b) kur dhe në masën e kërkuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm për t'ju dhënë çdo personi të autorizuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm për ta marrë atë;

(c) kur dhe në masën e kërkuar për t'u dhënë në një gjykatë, arbitër apo gjykatë administrative gjatë procedurave para saj në të cilat Pala që jep informacionin është palë;

(d) që njëra Palë i jep një zyrtari apo punëmarrësi të saj ose një Personi të Lidhur apo zyrtari ose punëmarrësi të Personit të Lidhur të cilët e kërkojnë informacionin për t'i mundësuar kryejen e duhur të detyrave të tyre, me kusht që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitietit njëlloj me ato që parashikohen në këtë nen;

(e) që njëra Palë i jep ndonjerit prej konsulentëve, bankave, financierëve, siguruesve ose këshilltarëve të saj ose ndonjërit prej Personave të Lidhur apo konsulentëve, bankave, financierëve, siguruesve ose këshilltarëve të Personit të Lidhur, me kusht që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit njëlloj me ato që parashikohen në këtë nen 37.3;

(f) që Fondacioni i jep një donatori të mundshëm në mirëbesim (ose konsulentëve, bankave, financierëve ose këshilltarëve të tyre profesionalë), me kusht që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit njëlloj me ato që parashikohen në këtë nen 37.3; ose

Për shmangien e dyshimit, secila Palë do të jetë përgjegjëse për çdo shkelje të detyrimit të konfidencialitetit sipas këtij neni 37.3.

37.4 Kjo Marrëveshje ose ndonjë prej dispozitave të saj mund të ndryshohet vetëm pas miratimit me shkrim të të dyja Palëve, dhe duke nënshkruar instrumentin përkatës (aneksin), i cili bëhet pjesë e pandarë dhe përbërëse e Marrëveshjes vetëm pas miratimit dhe nënshkrimit nga të dyja Palët.

37.5 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Marrëveshjes dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu Palët të lidhin këtë Marrëveshje.

37.6 Në rast se një apo disa nga dispozitat që përmbahen në këtë Marrëveshje, apo në çdo instrument tjetër të cilit i referohemi këtu, do të konsiderohet, për çdo arsye, e pavlefshme, e paligjshme

ose e pazbatueshme në çdo aspekt, atëherë deri në kufirin maksimal të lejuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm, kjo pavlefshmëri, paligjshmëri apo pazbatueshmëri nuk do të ndikojë në ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshje apo të ndonjë instrumenti tjetër dhe Palët do të zgjidhin me mirëkuptim ndreqjen e kësaj dispozite në një mënyrë që ajo të mos jetë e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme.

37.7 Në rastet kur njëra Palë i jep Palës një periudhë falje, lehtësie ose shtyrje afati, ose nuk zbaton apo nuk ushtron ndonjë prej të drejtave ose mjeteve të saj ligjore, ose vonon të veprojë si më lart, të drejtat dhe mjetet ligjore të asaj Pale lidhur me këtë Marrëveshje nuk pakësohen, ose nuk shuhen në asnjë rast.

37.8 Asnjëra prej Palëve nuk konsiderohet sikur heq dorë nga ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshje, përveçse kur një heqje dore e tillë bëhet shprehimisht me shkrim. Mungesa e këmbënguljes nga secila prej Palëve për të përmbushur në mënyrë korrekte secilën prej dispozitave të kësaj Marrëveshje, apo për të përfituar nga secila prej të drejtave të saj, sipas kësaj Marrëveshje, nuk interpretohet si heqje dorë nga një dispozitë e tillë, ose heqje dorë nga të drejta të tilla në të ardhmen.

37.9 Palët në çdo kohë bëjnë të gjitha veprimet e tjera dhe nënshkruajnë dhe dorëzojnë çdo akt dhe dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm për të përmbushur dhe zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshje. Kjo Marrëveshje është bërë ekskluzivisht për përfitimet e Ministrisë dhe Fondacionit dhe asnjë palë e tretë nuk do të ketë ndonjë të drejtë më poshtë ose do të konsiderohet të jetë përfituese e kësaj, përveç kur parashikohet shprehimisht këtu.

37.10 Kjo Marrëveshje është hartuar në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

FAQJA E NËNSHKRIMIT

PËR MINISTRINË E KULTURËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

MINISTRI

Znj. Elva Margariti

_____

PËR FONDACIONIN PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT

PËRFAQËSUES TË AUTORIZUAR

Z. Martin Mata Z. Aleksandër Sarapuli

_____ _____

LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1

PASURIA KULTURORE E PALUAJTSHME

A. HARTA DHE KOORDINATAT E SIPËRFAQES SË PASURISË KULTURORE TË PALUAJTSHME QË KALOHET NË ADMINISTRIMIN E FONDACIONIT



ZONA 1

Pika	X	Y	Pika	X	Y	Pika	X	Y
1	501644.6	4401451	51	502019.8	4401347	101	501999.2	4401196
2	501649.1	4401456	52	502017.6	4401344	102	501998.3	4401195
3	501663.9	4401437	53	502016.6	4401340	103	501995.2	4401189
4	501672.1	4401437	54	502014.9	4401338	104	501993.2	4401188
5	501695.7	4401456	55	502012.8	4401338	105	501991.4	4401188
6	501712.3	4401481	56	502010.3	4401338	106	501990.5	4401189
7	501726.7	4401500	57	502009.5	4401330	107	501987.8	4401192
8	501750.9	4401527	58	502012.9	4401329	108	501980.2	4401185
9	501773.2	4401543	59	502013.1	4401329	109	501983.2	4401182

10	501798.3	4401550	60	502013.3	4401328	110	501986.6	4401176
11	501815.1	4401550	61	502014.9	4401328	111	501984.2	4401173
12	501836.6	4401552	62	502013.7	4401322	112	501979.6	4401170
13	501852.5	4401555	63	502014.6	4401322	113	501973.4	4401170
14	501871	4401557	64	502015	4401321	114	501969.5	4401167
15	501894.8	4401557	65	502014.6	4401320	115	501959.5	4401158
16	501926.9	4401551	66	502013.5	4401320	116	501956.6	4401156
17	501951.3	4401541	67	502012.6	4401319	117	501947	4401148
18	501966.6	4401531	68	502012	4401317	118	501944.5	4401140
19	501976.6	4401516	69	502011	4401315	119	501942.4	4401136
20	501988.5	4401483	70	502012.4	4401290	120	501929.3	4401125
21	501993.4	4401473	71	502013.3	4401290	121	501923	4401119
22	501995	4401472	72	502019.6	4401288	122	501919.5	4401117
23	502007.4	4401464	73	502027.7	4401280	123	501918.7	4401117
24	502006.2	4401461	74	502033.5	4401273	124	501917.1	4401118
25	502010.2	4401459	75	502034.1	4401271	125	501915	4401117
26	502011.4	4401458	76	502034.4	4401264	126	501912.4	4401115
27	502012.5	4401456	77	502033	4401262	127	501909.2	4401115
28	502013.5	4401454	78	502028.2	4401256	128	501906.6	4401115
29	502014	4401451	79	502021.1	4401260	129	501904.8	4401116
30	502013.8	4401432	80	502017.8	4401265	130	501901.1	4401118
31	502012.5	4401408	81	502016.1	4401265	131	501899.4	4401118
32	502016.6	4401400	82	502014.4	4401265	132	501890.2	4401107
33	502027.2	4401389	83	502012.2	4401265	133	501873.5	4401091
34	502030.7	4401388	84	502009.3	4401260	134	501865.6	4401091
35	502033.4	4401387	85	502008.8	4401257	135	501848.6	4401095
36	502035.7	4401382	86	502007.9	4401250	136	501836.2	4401101
37	502036.7	4401378	87	502006.8	4401244	137	501829.7	4401103
38	502035.6	4401369	88	502008	4401239	138	501819.1	4401099
39	502027.1	4401370	89	502010.9	4401237	139	501809.1	4401087
40	502026.8	4401370	90	502012.5	4401236	140	501809.5	4401081
41	502023.7	4401370	91	502013.8	4401236	141	501803.5	4401079
42	502018.7	4401368	92	502016.8	4401238	142	501798	4401077
43	502017.5	4401367	93	502017.2	4401237	143	501764.5	4401070
44	502016.6	4401363	94	502014.4	4401235	144	501737.3	4401075
45	502016.7	4401361	95	502015.8	4401232	145	501708	4401078
46	502017.5	4401359	96	502018.1	4401224	146	501701.1	4401080
47	502018.2	4401357	97	502014.3	4401220	147	501685.7	4401084
48	502019.5	4401356	98	502008.8	4401215	148	501673.8	4401089
49	502021.8	4401353	99	502000.7	4401200	149	501670.7	4401092

50	502021.4	4401351	100	501999.7	4401197	150	501662.2	4401090
151	501658.2	4401090	201	501521	4401234	251	500798.5	4401238
152	501652.6	4401086	202	501524.6	4401240	252	500787.5	4401222
153	501649.9	4401085	203	501507.9	4401263	253	500766.2	4401213
154	501639.1	4401076	204	501515.9	4401271	254	500733.6	4401218
155	501638.8	4401076	205	501501.6	4401278	255	500695.4	4401227
156	501625.9	4401071	206	501476	4401293	256	500642	4401239
157	501623.5	4401068	207	501456.9	4401294	257	500586.3	4401255
158	501622.4	4401065	208	501436.3	4401290	258	500546.5	4401264
159	501622.8	4401059	209	501414.2	4401282	259	500501.2	4401270
160	501616.5	4401060	210	501387.3	4401267	260	500455.1	4401269
161	501616.3	4401063	211	501363.6	4401263	261	500402.4	4401260
162	501612.9	4401063	212	501335.7	4401266	262	500399.5	4401273
163	501610	4401060	213	501308.7	4401270	263	500395.4	4401286
164	501604.6	4401060	214	501279.3	4401271	264	500364.2	4401457
165	501599.5	4401063	215	501250.8	4401269	265	500506.5	4401621
166	501599.4	4401071	216	501237.8	4401254	266	500769.2	4401664
167	501597.2	4401080	217	501228.5	4401254	267	501146.1	4401576
168	501583.2	4401087	218	501214.3	4401257	268	501258	4401653
169	501568.4	4401094	219	501206.6	4401259	269	501603.1	4402170
170	501568.7	4401096	220	501195.5	4401255	270	501680.5	4402154
171	501568.9	4401100	221	501176.7	4401249	271	501714.8	4402115
172	501568.9	4401100	222	501162.9	4401249	272	501686.4	4402061
173	501568.9	4401101	223	501152.9	4401250	273	501614.7	4401978
174	501569.5	4401104	224	501148.1	4401251	274	501577.2	4401955
175	501571.5	4401110	225	501129.5	4401251	275	501544.4	4401910
176	501573.9	4401115	226	501126.9	4401250	276	501534.1	4401873
177	501576.3	4401119	227	501119.7	4401247	277	501532.7	4401848
178	501579.8	4401122	228	501107.2	4401247	278	501528.3	4401840
179	501587.2	4401124	229	501100.3	4401242	279	501493.2	4401788
180	501595.1	4401128	230	501098.7	4401241	280	501471.7	4401759
181	501595.7	4401133	231	501082.9	4401228	281	501459.5	4401725
182	501595.6	4401140	232	501060.5	4401217	282	501425.4	4401638
183	501593.8	4401154	233	501052.7	4401212	283	501402.3	4401570
184	501591.8	4401172	234	501043.7	4401204	284	501402.2	4401549
185	501587.4	4401184	235	501039.1	4401204	285	501409.4	4401527
186	501580.4	4401198	236	501031.7	4401206	286	501428.4	4401490
187	501571.8	4401212	237	501025.9	4401209	287	501464.3	4401442
188	501566.5	4401218	238	501025.1	4401211	288	501498.4	4401418
189	501562.6	4401223	239	501021.7	4401218	289	501498.7	4401416

190	501559.6	4401227	240	501019.3	4401230	290	501506.1	4401408
191	501557	4401229	241	501011.1	4401253	291	501508	4401409
192	501553.6	4401230	242	500998.2	4401269	292	501508.8	4401410
193	501552	4401229	243	500976.7	4401275	293	501509.5	4401409
194	501546.5	4401225	244	500958.5	4401276	294	501517.6	4401401
195	501541.7	4401227	245	500933	4401278	295	501517.1	4401400
196	501535	4401231	246	500891.6	4401288	296	501511.1	4401394
197	501531.3	4401230	247	500862.2	4401288	297	501515.4	4401389
198	501527.1	4401227	248	500840.9	4401284	298	501520.6	4401387
199	501523.2	4401227	249	500822.7	4401275	299	501526.7	4401390
200	501521.3	4401230	250	500807	4401256	300	501533.9	4401393
301	501537.1	4401395						
302	501539.2	4401396						
303	501542.2	4401395						
304	501544.1	4401392						
305	501545.2	4401390						
306	501546.6	4401388						
307	501550.1	4401386						
308	501561	4401385						
309	501570.8	4401383						
310	501581.6	4401383						
311	501601.5	4401388						
312	501610.9	4401393						
313	501614.6	4401396						
314	501631.6	4401406						
315	501645.6	4401421						
316	501654	4401429						
317	501655.6	4401433						
318	501644.6	4401451						

Zona 2

Pika	X	Y	Pika	X	Y	Pika	X	Y
1	504284.5	4402382	51	504088.3	4402414	101	505391.1	4402899
2	504280.2	4402382	52	504127.9	4402442	102	505362.5	4402863
3	504265.9	4402383	53	504160.8	4402467	103	505357.2	4402852
4	504255.5	4402386	54	504193.4	4402494	104	505361.1	4402840
5	504243.9	4402392	55	504228.9	4402525	105	505388	4402802
6	504237.5	4402402	56	504266.7	4402559	106	505395.6	4402793
7	504240.8	4402420	57	504293.6	4402585	107	505395.9	4402763
8	504256.4	4402450	58	504319.5	4402613	108	505403.6	4402731

9	504266.5	4402472	59	504338.8	4402637	109	505396.9	4402676
10	504276.9	4402494	60	504352.8	4402659	110	505387	4402635
11	504288.3	4402506	61	504360.9	4402679	111	505375.2	4402617
12	504298.9	4402519	62	504362.2	4402688	112	505371.1	4402615
13	504307.1	4402531	63	504360.2	4402689	113	505364.6	4402618
14	504320	4402550	64	504360.2	4402690	114	505351.9	4402591
15	504335	4402554	65	504361.8	4402693	115	505357	4402584
16	504354.1	4402556	66	504363.5	4402719	116	505357.8	4402582
17	504365.2	4402553	67	504367.9	4402746	117	505355.5	4402561
18	504383.5	4402555	68	504367.2	4402762	118	505349.5	4402543
19	504398.8	4402566	69	504362.9	4402780	119	505346.2	4402534
20	504401.4	4402579	70	504347	4402812	120	505345.5	4402530
21	504398.5	4402593	71	504331.9	4402843	121	505344.8	4402526
22	504386.5	4402598	72	504329.9	4402856	122	505336.3	4402518
23	504366.3	4402597	73	504328.3	4402886	123	505325.6	4402509
24	504339.8	4402590	74	504325	4402898	124	505315.7	4402498
25	504317.3	4402578	75	504324.9	4402898	125	505277.8	4402470
26	504278.9	4402527	76	504317.8	4402937	126	505274	4402463
27	504254.2	4402506	77	504318.4	4402947	127	505256.2	4402452
28	504226.6	4402483	78	504333.1	4402977	128	505238.2	4402441
29	504191.6	4402453	79	504347	4403028	129	505236.8	4402440
30	504166.8	4402435	80	504350.4	4403058	130	505220.8	4402426
31	504145.1	4402423	81	504348.6	4403098	131	505208.8	4402417
32	504132.1	4402417	82	504347.2	4403132	132	505201.1	4402414
33	504122.7	4402401	83	504346.1	4403151	133	505180.3	4402391
34	504120.2	4402383	84	504341.6	4403176	134	505159.7	4402372
35	504124.6	4402376	85	504342	4403195	135	505139.9	4402346
36	504136	4402371	86	504336.3	4403217	136	505124.2	4402328
37	504131.7	4402368	87	504326.3	4403266	137	505102.2	4402314
38	504127.6	4402366	88	504316.2	4403293	138	505088.6	4402299
39	504119.8	4402368	89	504313.9	4403311	139	505078.3	4402290
40	504114.2	4402374	90	504568.8	4403344	140	505073.6	4402286
41	504111.1	4402373	91	505138.3	4403311	141	505055.4	4402270
42	504111.8	4402370	92	505340.5	4403269	142	505038.4	4402250
43	504109.8	4402369	93	505484.4	4403183	143	505010.2	4402195
44	504108.1	4402369	94	505494.6	4403169	144	505015.8	4402193
45	504103.8	4402379	95	505468.9	4403056	145	504989.5	4402125
46	504111.9	4402382	96	505458.6	4403025	146	504984.1	4402122
47	504106.3	4402390	97	505443.1	4402999	147	504979.7	4402115
48	504098.6	4402396	98	505426.1	4402965	148	504984.4	4402095

49	504094.5	4402400	99	505416.5	4402938	149	504985.7	4402090
50	504078.4	4402409	100	505401.1	4402919	150	504986.2	4402087
151	504979.2	4402074	201	504722.4	4401352	251	504444.1	4401550
152	504966.2	4402067	202	504713.2	4401340	252	504439.3	4401562
153	504951.3	4402067	203	504704.2	4401332	253	504428.6	4401572
154	504950.3	4402067	204	504696.7	4401329	254	504422.6	4401581
155	504947.8	4402060	205	504676.5	4401312	255	504412.2	4401616
156	504947.7	4402054	206	504651	4401276	256	504407.1	4401647
157	504951.2	4402047	207	504615.1	4401250	257	504403.8	4401675
158	504952.9	4402044	208	504605.3	4401243	258	504410.5	4401696
159	504971.6	4402036	209	504600.9	4401241	259	504425.2	4401707
160	504977	4402031	210	504580.9	4401230	260	504437	4401718
161	504979.2	4402024	211	504567.9	4401226	261	504447.3	4401720
162	504980.7	4402014	212	504549.7	4401223	262	504456.8	4401720
163	504974.3	4401996	213	504529.1	4401222	263	504467.1	4401723
164	504964.7	4401981	214	504514.1	4401219	264	504477.5	4401727
165	504959.9	4401974	215	504497.7	4401217	265	504471.7	4401740
166	504957.2	4401962	216	504472.8	4401219	266	504501.2	4401763
167	504959	4401952	217	504450.8	4401223	267	504500.9	4401769
168	504954.7	4401940	218	504433.3	4401226	268	504498.1	4401782
169	504954.6	4401933	219	504415.6	4401224	269	504489.4	4401788
170	504955.3	4401927	220	504390.2	4401220	270	504474.8	4401789
171	504954.4	4401923	221	504365.4	4401214	271	504453.7	4401783
172	504949.1	4401916	222	504351.4	4401211	272	504441.7	4401789
173	504946.3	4401912	223	504350.4	4401234	273	504434	4401793
174	504942.6	4401904	224	504384.2	4401242	274	504428.7	4401793
175	504942.2	4401898	225	504419.2	4401249	275	504424.2	4401792
176	504944.7	4401895	226	504427.4	4401255	276	504418.9	4401794
177	504949.4	4401891	227	504439.2	4401267	277	504406.6	4401806
178	504934.5	4401786	228	504436.5	4401271	278	504393.5	4401818
179	504917	4401701	229	504429.5	4401280	279	504376.6	4401838
180	504911.8	4401687	230	504431.3	4401289	280	504377.7	4401856
181	504916.6	4401673	231	504435.9	4401295	281	504379.6	4401863
182	504918.2	4401651	232	504449.6	4401303	282	504380.4	4401869
183	504908.3	4401618	233	504449.7	4401316	283	504380	4401874
184	504881.3	4401520	234	504429.1	4401378	284	504376.3	4401879
185	504871	4401498	235	504420.4	4401412	285	504372.1	4401881
186	504858.1	4401479	236	504417.8	4401418	286	504367.3	4401882
187	504847.1	4401465	237	504417.7	4401426	287	504360	4401876
188	504805.2	4401434	238	504420.1	4401430	288	504358	4401869

189	504799.5	4401437	239	504423.5	4401434	289	504355.6	4401867
190	504790.1	4401438	240	504432	4401453	290	504352.8	4401867
191	504781.8	4401436	241	504445.3	4401467	291	504350.7	4401865
192	504770.3	4401434	242	504461.1	4401476	292	504351.7	4401861
193	504760.8	4401429	243	504463.2	4401479	293	504355.2	4401858
194	504751.6	4401427	244	504475.9	4401480	294	504352.9	4401849
195	504745.4	4401425	245	504484.5	4401490	295	504350.1	4401843
196	504741.4	4401413	246	504487.5	4401504	296	504345.1	4401839
197	504736.2	4401402	247	504481.8	4401518	297	504338	4401835
198	504733.9	4401393	248	504473.3	4401524	298	504328.4	4401830
199	504731.9	4401385	249	504461	4401530	299	504315.2	4401829
200	504724.2	4401365	250	504447.4	4401542	300	504303.9	4401830
301	504291.8	4401832	351	503580.8	4401635	401	503622	4402298
302	504287.9	4401830	352	503568.5	4401643	402	503641.6	4402309
303	504281.9	4401821	353	503574.6	4401650	403	503640.1	4402351
304	504267.4	4401804	354	503573.1	4401656	404	503640.4	4402363
305	504260.6	4401797	355	503569.5	4401667	405	503640.9	4402383
306	504251.6	4401791	356	503566.9	4401676	406	503640.7	4402395
307	504242.3	4401786	357	503558.4	4401696	407	503638.3	4402405
308	504234.2	4401785	358	503539.2	4401731	408	503642	4402427
309	504228.8	4401785	359	503511.4	4401751	409	503644.6	4402433
310	504224.9	4401781	360	503474.2	4401766	410	503662.8	4402459
311	504218	4401771	361	503470.1	4401767	411	503667.3	4402462
312	504209.4	4401763	362	503473.9	4401770	412	503749.9	4402421
313	504201.7	4401758	363	503474	4401774	413	503796.2	4402366
314	504190.9	4401754	364	503470.4	4401777	414	503789.8	4402358
315	504176.4	4401758	365	503425.3	4401785	415	503797.1	4402347
316	504167.9	4401762	366	503416.2	4401788	416	503802	4402344
317	504139.2	4401776	367	503401.9	4401797	417	503807	4402339
318	504129.3	4401783	368	503384.6	4401814	418	503806	4402333
319	504126.5	4401789	369	503320.6	4401883	419	503808.9	4402329
320	504125.8	4401797	370	503274	4401933	420	503811	4402324
321	504127.8	4401804	371	503260.3	4401937	421	503813.3	4402321
322	504119.3	4401810	372	503255.7	4401944	422	503816.8	4402321
323	504111.3	4401812	373	503256.1	4401947	423	503821.8	4402318
324	504104.9	4401808	374	503261.9	4401952	424	503821.9	4402314
325	504100.5	4401798	375	503264.3	4401983	425	503826.7	4402310
326	504094.8	4401784	376	503264	4401988	426	503832	4402306
327	504091.1	4401774	377	503268.5	4402017	427	503832	4402301
328	504086.7	4401769	378	503277.7	4402067	428	503833.4	4402297

329	504081.9	4401763	379	503284.3	4402093	429	503835.8	4402293
330	504073	4401757	380	503293.5	4402109	430	503840.5	4402291
331	504042.6	4401720	381	503299.9	4402121	431	503844.5	4402294
332	504037	4401708	382	503306.5	4402130	432	503849	4402293
333	504029.5	4401672	383	503343.8	4402156	433	503850.1	4402291
334	503997.3	4401616	384	503363	4402166	434	503846.3	4402289
335	503986	4401599	385	503389.2	4402173	435	503845.1	4402287
336	503976.3	4401592	386	503395.6	4402174	436	503849.3	4402285
337	503954.1	4401583	387	503400.2	4402175	437	503853.8	4402283
338	503925.3	4401575	388	503412	4402177	438	503858.6	4402269
339	503904.5	4401571	389	503423.7	4402185	439	503853.6	4402257
340	503883.7	4401562	390	503434	4402191	440	503854.2	4402239
341	503832.8	4401556	391	503462.9	4402212	441	503867.8	4402225
342	503800.5	4401550	392	503470.3	4402216	442	503889.5	4402201
343	503772.4	4401544	393	503479	4402218	443	503904.8	4402181
344	503748.7	4401534	394	503487.8	4402219	444	503919.7	4402168
345	503738.9	4401524	395	503494.6	4402224	445	503934.1	4402154
346	503725.5	4401534	396	503520.6	4402240	446	503945.7	4402149
347	503707.4	4401544	397	503543.1	4402247	447	503960.4	4402149
348	503669.3	4401556	398	503553.2	4402249	448	503974.6	4402154
349	503650.2	4401566	399	503572.3	4402259	449	503981.3	4402162
350	503629.5	4401587	400	503603	4402286	450	503986.7	4402172
451	503988.6	4402185	501	504601	4402041	551	504365.1	4402353
452	503993.6	4402197	502	504672.1	4402044	552	504361.4	4402368
453	504004.6	4402211	503	504742	4402048	553	504359.6	4402380
454	504019.2	4402217	504	504766.4	4402046	554	504353.1	4402395
455	504039	4402218	505	504798	4402048	555	504349.5	4402401
456	504063.7	4402216	506	504856.5	4402051	556	504335.7	4402395
457	504076.4	4402208	507	504859	4402052	557	504324.2	4402387
458	504088.1	4402199	508	504886.5	4402052	558	504313.2	4402383
459	504096.5	4402191	509	504912.3	4402053	559	504303.2	4402380
460	504108	4402191	510	504942.3	4402053	560	504284.5	4402382
461	504113.9	4402194	511	504942.3	4402060			
462	504119.1	4402197	512	504929.5	4402062			
463	504130.1	4402206	513	504920.7	4402061			
464	504140.7	4402217	514	504906.3	4402061			
465	504153.7	4402225	515	504890.1	4402063			
466	504170.2	4402235	516	504825.3	4402059			
467	504182.5	4402237	517	504765.8	4402055			
468	504189.8	4402227	518	504703.8	4402056			

469	504206.5	4402222	519	504639	4402053			
470	504215.7	4402217	520	504580.9	4402052			
471	504223.7	4402211	521	504545.6	4402050			
472	504232.5	4402205	522	504533.4	4402054			
473	504247.7	4402198	523	504514.1	4402063			
474	504266	4402190	524	504513.2	4402065			
475	504278.8	4402184	525	504515.4	4402071			
476	504288.5	4402174	526	504508.8	4402079			
477	504308.9	4402156	527	504506.8	4402081			
478	504320.5	4402144	528	504503.3	4402084			
479	504334.1	4402137	529	504500.9	4402098			
480	504353.2	4402134	530	504500.7	4402119			
481	504364.7	4402133	531	504497.7	4402136			
482	504372.8	4402124	532	504492	4402152			
483	504383.2	4402112	533	504483.1	4402168			
484	504391.3	4402102	534	504466.3	4402180			
485	504402.6	4402089	535	504449.1	4402191			
486	504415.8	4402080	536	504443.4	4402201			
487	504431.3	4402074	537	504440.9	4402214			
488	504446.4	4402072	538	504439.1	4402225			
489	504459.9	4402077	539	504434.3	4402235			
490	504468.6	4402078	540	504427	4402248			
491	504479.8	4402075	541	504418.9	4402259			
492	504479.4	4402074	542	504402.2	4402264			
493	504480.4	4402071	543	504387	4402269			
494	504486	4402065	544	504373.5	4402275			
495	504506.7	4402054	545	504365.5	4402281			
496	504525.8	4402044	546	504360.2	4402292			
497	504538.2	4402039	547	504358.9	4402304			
498	504550.7	4402037	548	504357.5	4402317			
499	504575.4	4402037	549	504365.4	4402329			
500	504589	4402039	550	504367.6	4402340			

ZONA 3

Pika	X	Y	Pika	X	Y	Pika	X	Y
1	502703.9	4401651	51	503772.5	4401420	101	504390.8	4400598
2	502724.9	4401650	52	503780.1	4401401	102	504396.1	4400573
3	502753.2	4401653	53	503795.8	4401375	103	504399.5	4400557
4	502777.5	4401655	54	503814.6	4401363	104	504400.6	4400530
5	502786.1	4401651	55	503844	4401365	105	504399.2	4400518

6	502801.1	4401650	56	503859.7	4401375	106	504394	4400503
7	502824.3	4401648	57	503892.1	4401400	107	504383.9	4400490
8	502856.6	4401648	58	503899.5	4401412	108	504378.4	4400483
9	502884.4	4401647	59	503896	4401430	109	504376.4	4400480
10	502921.5	4401647	60	503887.4	4401446	110	504372.2	4400469
11	502962.5	4401648	61	503878.2	4401470	111	504359.1	4400464
12	503005.7	4401650	62	503883.2	4401475	112	504268.1	4400394
13	503035.3	4401652	63	503900.1	4401467	113	504221.6	4400341
14	503063.7	4401651	64	503923.8	4401454	114	504215.2	4400315
15	503089.7	4401650	65	503939.5	4401445	115	504243.7	4400300
16	503105.6	4401649	66	503944.6	4401412	116	504272.3	4400272
17	503139.4	4401650	67	503952.2	4401391	117	504313.6	4400218
18	503162.1	4401650	68	503964.2	4401374	118	504370.7	4400139
19	503180.7	4401660	69	503987.5	4401339	119	504385.5	4400108
20	503180.3	4401650	70	503993.5	4401321	120	504401.4	4400049
21	503186.9	4401648	71	503996.2	4401309	121	504422.6	4400024
22	503208.9	4401646	72	503999.2	4401279	122	504479.7	4399973
23	503240.6	4401647	73	504005.2	4401254	123	504498.1	4399922
24	503280.5	4401648	74	504022.7	4401211	124	504520.2	4399883
25	503339.7	4401651	75	504037.2	4401175	125	504518.9	4399871
26	503371.4	4401653	76	504051.3	4401131	126	504469.4	4399810
27	503404.1	4401656	77	504055	4401108	127	504460.3	4399793
28	503435	4401660	78	504060.1	4401098	128	504454.4	4399777
29	503455.9	4401666	79	504070	4401081	129	504451.5	4399761
30	503460.8	4401666	80	504086.9	4401058	130	504449.8	4399711
31	503473.4	4401656	81	504115.5	4401034	131	504449.7	4399642
32	503481.1	4401647	82	504122.3	4401027	132	504445.1	4399634
33	503493.5	4401632	83	504131.5	4401010	133	504334.4	4399509
34	503506.6	4401616	84	504145	4400977	134	504234.4	4399395
35	503520	4401599	85	504170.6	4400951	135	504228.2	4399401
36	503541.9	4401581	86	504185.9	4400935	136	503817.8	4399744
37	503561.3	4401565	87	504199.1	4400920	137	503629.2	4399898
38	503580.5	4401550	88	504215.1	4400894	138	503527.4	4399986
39	503594.5	4401538	89	504223.3	4400878	139	503521.8	4399990
40	503589.5	4401526	90	504234.8	4400869	140	503453.3	4400052
41	503581.4	4401505	91	504263.5	4400861	141	503243.4	4400227
42	503586.2	4401486	92	504287.8	4400840	142	503225.2	4400239
43	503597.3	4401476	93	504293.8	4400825	143	503213.3	4400236
44	503630.8	4401459	94	504308.8	4400791	144	503188.8	4400233
45	503656.7	4401449	95	504327.4	4400744	145	503166.2	4400232

46	503677.9	4401448	96	504341.8	4400709	146	503141.9	4400233
47	503690.4	4401453	97	504354	4400688	147	503117.1	4400236
48	503711.9	4401458	98	504366.1	4400666	148	503110.3	4400238
49	503737.2	4401453	99	504381.6	4400630	149	503103.1	4400242
50	503757.1	4401448	100	504384.9	4400622	150	503097.2	4400245
151	503090.8	4400248	201	501837.1	4400799	251	501744.5	4400954
152	503085.5	4400254	202	501826.4	4400855	252	501749.8	4400951
153	503073.1	4400270	203	501812.5	4400919	253	501756.4	4400949
154	503044.6	4400314	204	501809.3	4400922	254	501766.1	4400949
155	503035.1	4400329	205	501798.6	4400921	255	501770.4	4400950
156	503018.9	4400361	206	501796.1	4400925	256	501774.7	4400951
157	503009.1	4400384	207	501788.5	4400924	257	501776.1	4400951
158	503007.4	4400392	208	501783.9	4400923	258	501778.3	4400952
159	503002.6	4400397	209	501769.3	4400918	259	501779.8	4400953
160	502996.2	4400402	210	501710.1	4400907	260	501781.9	4400953
161	502986.6	4400409	211	501693.9	4400907	261	501786.8	4400950
162	502975	4400418	212	501680	4400908	262	501788.9	4400947
163	502965	4400422	213	501672.4	4400911	263	501789.6	4400945
164	502952.7	4400424	214	501660.8	4400922	264	501790.2	4400942
165	502941.2	4400424	215	501649.9	4400930	265	501791.8	4400940
166	502917.7	4400419	216	501638.7	4400939	266	501793.7	4400937
167	502896.2	4400416	217	501628.8	4400949	267	501793.8	4400936
168	502866.9	4400414	218	501641	4400947	268	501793.8	4400933
169	502824.4	4400413	219	501657.9	4400946	269	501794.1	4400930
170	502801.8	4400415	220	501669.1	4400948	270	501795.2	4400928
171	502792.2	4400417	221	501676.7	4400953	271	501797.1	4400926
172	502785.8	4400421	222	501681.3	4400959	272	501799.6	4400927
173	502783	4400427	223	501684	4400962	273	501803.4	4400927
174	502778.5	4400436	224	501687.6	4400963	274	501807.8	4400928
175	502774.4	4400453	225	501696.6	4400967	275	501808.7	4400929
176	502770.3	4400464	226	501697.8	4400969	276	501809.6	4400932
177	502765.4	4400476	227	501699	4400968	277	501809.7	4400934
178	502752.9	4400490	228	501700.8	4400967	278	501809.2	4400936
179	502736.9	4400502	229	501701.8	4400966	279	501807.5	4400939
180	502708.6	4400524	230	501705.3	4400965	280	501806.6	4400941
181	502685.7	4400540	231	501706.9	4400964	281	501806.6	4400944
182	502675.5	4400551	232	501707.8	4400964	282	501806.6	4400946
183	502675	4400552	233	501709.3	4400963	283	501806.2	4400949
184	502666.9	4400544	234	501710.7	4400963	284	501805	4400955
185	502558	4400626	235	501712	4400963	285	501806.1	4400956

186	502541.2	4400624	236	501713.2	4400962	286	501808.3	4400957
187	502529.3	4400620	237	501714.6	4400961	287	501810.5	4400956
188	502515.9	4400610	238	501717	4400960	288	501811.8	4400954
189	502508.4	4400599	239	501717.4	4400960	289	501813.2	4400952
190	502501.6	4400583	240	501718.7	4400959	290	501814.6	4400950
191	502488.7	4400558	241	501721	4400958	291	501816.1	4400948
192	502481.9	4400549	242	501725.7	4400957	292	501817.7	4400945
193	502452.6	4400541	243	501730.3	4400956	293	501819.5	4400939
194	502332.6	4400515	244	501730.9	4400956	294	501820.1	4400937
195	502245	4400495	245	501732.7	4400961	295	501820.9	4400934
196	501942.9	4400427	246	501733.3	4400961	296	501822.6	4400932
197	501924.9	4400424	247	501732.9	4400960	297	501825.2	4400930
198	501875.4	4400629	248	501733.6	4400959	298	501827	4400930
199	501848.1	4400751	249	501736.2	4400958	299	501828.1	4400931
200	501842.9	4400770	250	501739.9	4400956	300	501829.8	4400931
301	501831.6	4400931	351	501953.9	4400964	401	502060.3	4401072
302	501834.2	4400931	352	501955.8	4400964	402	502064.5	4401069
303	501836.7	4400932	353	501961.2	4400965	403	502068.3	4401067
304	501838.1	4400933	354	501966.3	4400966	404	502070.1	4401063
305	501838.5	4400935	355	501973.5	4400967	405	502071.9	4401059
306	501839.2	4400937	356	501980.6	4400969	406	502075.4	4401054
307	501841.5	4400939	357	501986.6	4400970	407	502079.3	4401051
308	501842.4	4400942	358	501990.4	4400971	408	502083.7	4401052
309	501842.4	4400944	359	501993.1	4400975	409	502088.9	4401056
310	501841.8	4400946	360	501996.2	4400978	410	502090.1	4401058
311	501846.8	4400948	361	501992.4	4400981	411	502091.6	4401061
312	501848.9	4400948	362	501991.4	4400983	412	502096.7	4401063
313	501850.6	4400947	363	501989.5	4400989	413	502101.4	4401064
314	501853.3	4400947	364	501990.7	4400991	414	502108.6	4401066
315	501857.4	4400947	365	501994.5	4400991	415	502112.7	4401069
316	501861.3	4400947	366	501999.1	4400992	416	502115.5	4401075
317	501862.8	4400947	367	502001.2	4400994	417	502117.3	4401078
318	501863.4	4400944	368	502003.1	4400993	418	502123.7	4401084
319	501864.4	4400943	369	502007.8	4400991	419	502126.1	4401086
320	501867.1	4400943	370	502007.7	4400993	420	502127.6	4401087
321	501870.1	4400943	371	502006.1	4401000	421	502129	4401088
322	501872	4400943	372	502006.6	4401008	422	502128.8	4401091
323	501875.2	4400944	373	502008.4	4401011	423	502131.7	4401095
324	501878.4	4400945	374	502013	4401013	424	502135	4401099
325	501881.4	4400947	375	502017.6	4401011	425	502139.4	4401101

326	501885.4	4400948	376	502022.5	4401010	426	502141.1	4401103
327	501889.9	4400949	377	502027.9	4401010	427	502144	4401107
328	501893.1	4400950	378	502029.8	4401013	428	502145.2	4401110
329	501896.1	4400950	379	502036.8	4401017	429	502147.6	4401112
330	501899	4400949	380	502046.5	4401020	430	502151.6	4401113
331	501902.6	4400949	381	502050.3	4401022	431	502154.2	4401113
332	501905.5	4400949	382	502055.2	4401025	432	502157.8	4401115
333	501908.7	4400948	383	502060.3	4401022	433	502160.3	4401118
334	501911.6	4400948	384	502066.9	4401025	434	502161.4	4401120
335	501914.8	4400948	385	502074.9	4401024	435	502162.5	4401126
336	501916.2	4400949	386	502077.8	4401031	436	502163.2	4401134
337	501917.8	4400951	387	502067.5	4401036	437	502164	4401138
338	501919.9	4400953	388	502069	4401039	438	502168.8	4401148
339	501922.4	4400954	389	502070.9	4401044	439	502168.3	4401152
340	501930	4400957	390	502060.4	4401050	440	502172.2	4401164
341	501935.4	4400959	391	502054	4401049	441	502176.5	4401172
342	501938.3	4400959	392	502051.8	4401048	442	502181.5	4401182
343	501940.8	4400958	393	502048.5	4401053	443	502186.5	4401181
344	501942.5	4400960	394	502050.4	4401056	444	502193.5	4401185
345	501944.8	4400961	395	502052.4	4401059	445	502194.7	4401192
346	501946.1	4400960	396	502053.1	4401062	446	502197.5	4401199
347	501947.6	4400959	397	502051.2	4401065	447	502191.2	4401200
348	501950.1	4400960	398	502049.9	4401067	448	502190.2	4401200
349	501951.5	4400961	399	502051.3	4401071	449	502189.8	4401203
350	501952.6	4400962	400	502056	4401073	450	502191	4401208
451	502192.3	4401209	501	502480.7	4401566			
452	502192.9	4401213	502	502492.5	4401576			
453	502190.4	4401218	503	502522.3	4401603			
454	502190.1	4401220	504	502539.5	4401619			
455	502192	4401224	505	502554.5	4401631			
456	502193.1	4401232	506	502600.4	4401658			
457	502194.3	4401238	507	502614.9	4401667			
458	502193.6	4401247	508	502611.7	4401659			
459	502194.2	4401252	509	502616.6	4401654			
460	502196.7	4401263	510	502633.5	4401652			
461	502199.9	4401277	511	502645.6	4401651			
462	502202.7	4401288	512	502667.5	4401651			
463	502205.3	4401297	513	502703.9	4401651			
464	502212.9	4401306						
465	502215.5	4401308						

466	502219.7	4401312						
467	502220.6	4401314						
468	502219.8	4401319						
469	502221.8	4401321						
470	502225	4401324						
471	502228.2	4401328						
472	502227.6	4401332						
473	502227.8	4401336						
474	502230.1	4401340						
475	502233.7	4401342						
476	502235.3	4401347						
477	502234	4401353						
478	502232.9	4401357						
479	502232.4	4401365						
480	502233.2	4401369						
481	502234.1	4401373						
482	502233.2	4401380						
483	502230.3	4401388						
484	502233.8	4401390						
485	502237.3	4401387						
486	502254.3	4401384						
487	502260.7	4401384						
488	502274.2	4401385						
489	502284.5	4401394						
490	502302.7	4401411						
491	502326.2	4401432						
492	502343.9	4401446						
493	502371.6	4401467						
494	502394.1	4401486						
495	502406.8	4401497						
496	502422.8	4401512						
497	502432	4401519						
498	502437.1	4401523						
499	502442.4	4401534						
500	502455.8	4401545						

B. LISTA E PASURIVE KULTURORE TË PALUAJTSHME QË KALOJNË NË ADMINISTRIMIN E FONDACIONIT

	Total	100								
Kodi RKPK	**Titulli**	**Nr.Inv**	**Katalog**	**Fusha**	**Kategoria**	**Kultura**	**Autor**	**Periudha**	**Posedues**	**Imazh**
71919	Mauzeoleumi në fushën e Vrinës	67	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
71920	Banjë publike 2 në fushën e Vrinës	68	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
73905	Varr Monumental	23	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
73906	Varr Monumental	36	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
73907	Varr në nefin e Bazilikës së Madhe	43	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
73908	Varr në nefin e Bazilikës së Madhe	44	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
73909	Kulla e Vrojtimit	56	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Mesjetare	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
73963	Pus	132	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
73998	Varr Monumental	38	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
73999	Mulliri Venecian	31	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Mesjetare	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Hershme (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74004	Termet romake pranë Bazilikës	98	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74021	Varr me muraturë	181	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74022	Varr me muraturë	182	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74023	Varr me muraturë	183	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74024	Varr me muraturë	184	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	

74025	Varr me muraturë	185	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74026	Varr me muraturë	186	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74027	Varr me muraturë	187	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74028	Varr me murature	188	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74029	Varr me muraturë	189	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74030	Varr me muraturë	190	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74031	Varr me muraturë	191	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74032	Varr me muraturë	192	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	E Panjohur (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74033	Varr me muraturë	193	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74034	Varr me muraturë	194	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74035	Varr me muraturë	195	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74036	Varr me muraturë	196	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74037	Varr me muraturë	197	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74038	Varr me muraturë	198	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74039	Varr me muraturë	199	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74040	Varr me muraturë	200	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74041	Varr me muraturë	201	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74042	Varr me muraturë	202	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74043	Varr me muraturë	203	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	

74044	Varr me muraturë	204	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74045	Varr me muraturë	205	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74046	Varr me muraturë	206	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74047	Varr me muraturë	207	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74048	Varr me muraturë	208	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74049	Varr me muraturë	209	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74050	Varr me muraturë	210	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74051	Muri rrethues nga Kulla Veneciane	217	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74052	Muri rrethues në jug të Trikonkës	218	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	E Antikitetit	ANONIM ANONIM	Antikitet (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74053	Muri rrethues nga Trikonka	219	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	E Antikitetit	ANONIM ANONIM	Antikitet (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74054	Muri rrethues nga Shtëpia e Tregtarit	220	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74055	Muri rrethues nga Porta e Ujit	221	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	E Antikitetit	ANONIM ANONIM	Antikitet (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74056	Muri rrethues nga Porta e Liqenit	222	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Arkaike	ANONIM ANONIM	Arkaike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74057	Muri rrethues nga Porta e Luanit	223	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74058	Muri mbyllës Veri-Perëndimor	224	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Mesjetare	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Hershme (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74059	Muri rrethues nga Porta Veriore	225	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74060	Muri rrethues i Akropolit	226	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	E Antikitetit	ANONIM ANONIM	Antikitet (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74061	Muri rrethues Perëndimor	227	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74062	Muri rrethues nga Porta e Liqenit	228	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	

74063	Muri rrethues helenistik	229	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74064	Muri rrethues nga Porta Perëndimore	230	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Mesjetare	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Hershme (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
74065	Muri i jashtem fortifikues	231	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Mesjetare	ANONIM ANONIM	Mesjete (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
32432	Kalaja Trekëndore e Ali Pashës,Sarandë	1379	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanim i Fortif	Italiane	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Mesme (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
36737	Qyteti antik i Butrintit	63	**Materiale e Paluajtshme**	ARKITEKTURE	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Hershme (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44679	Teatri - Parku Arkeologjik Butrint	1	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44680	Prytaneoni - Parku Arkeologjik Butrint	2	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44681	Shëtitorja - Parku Arkeologjik Butrint	3	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44682	Banesa me peristil - Parku Ark. Butrint	4	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44683	Pusi Monumental (i shenjtë)- P..A.Butrint	5	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44684	Portiku (Stoa) - Parku Ark. Butrint	6	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44685	Nymfeu i vogël - Parku Ark. Butrint	7	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44688	Porta jugore - Parku Ark. Butrint	10	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44689	Porta veriore - Parku Ark. Butrint	11	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	

44690	Porta e ujit - Parku Ark. Butrint	16	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Bizantine	ANONIM ANONIM	Mesjete (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44691	Porta perëndimore - Parku Ark. Butrint	12	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44692	Porta me kulla - Parku Ark. Butrint	13	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44693	Porta e liqenit (Skea) - P. Ark. Butrint	14	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44694	Porta e Luanit - Parku Ark. Butrint	15	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44695	Pusi i Junia Rufinës (i nuseve) Butrint	17	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44698	Nekropoli (varreza) romake- P.Ark.Butrint	20	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Varrezë	Bizantine	ANONIM ANONIM	Mesjete (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44701	Banja publike pranë teatrit - P.A.Butrin	24	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44702	Banja pranë baptisterit- Parku Ark. Butr	25	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44703	Banja Romake pranë Vivarit	26	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44704	Kulla Veneciane - Parku.Ark.Butrint	27	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Vendbanime	Italiane	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44705	Muri me mbishkrime - Parku.Ark.Butrint	28	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44706	Gimnazi - Parku.Ark.Butrint	29	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44710	Pallati Peshkopal (Trikonkës)- P.A.Butrin	34	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Bizantine	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	

44711	Kulla e Trikonkës - Parku.Ark.Butrint	35	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Italiane	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Mesme (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44712	Kështjella e Akropolit- Parku.Ark.Butrint	37	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Mesjetare	ANONIM ANONIM	Mesjetë e Mesme (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44714	Nymfeu pas murit me mbishkrim	41	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44715	Godina me tri dhoma - Parku.A.Butrint	42	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44716	Forumi Romak - Parku Ark.Butrint	45	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44717	Agoraja - Parku Arkeologjik Butrint	46	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44718	Diaporiti - Parku Arkeologjik Butrint	47	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44719	Vila Romake në Diaporit - P. Ark.Butrint	48	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
44720	Banjë Romake - Parku Arkeologjik Butrint	49	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndertesa Pub.Antik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
45116	Fusha e Vrinës - Parku Ark. Butrint	51	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Sit Arkeologjik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
45119	Vila në Vrinë - Parku Ark. Butrint	54	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Sit Arkeologjik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
45122	Akuadukti - Parku Arkeologjik Butrint	58	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
45123	Fortifikimet Arkaike - Parku Ark.Butrint	60	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Arkaike	ANONIM ANONIM	Arkaike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	

45124	Fortifikimet Klasike - Parku Ark.Butrint	61	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	E panjohur	ANONIM ANONIM	Klasike sh6-4pk (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
45125	Fortifikimet Helenistike -P. Ark.Butrint	62	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
45126	Fortifikimet Romake - Parku Ark.Butrint	63	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Romake	ANONIM ANONIM	Romake sh2pk-4pask (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
45127	Fortifikimet e Antikitetit Vonë - Butrint	64	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Bizantine	ANONIM ANONIM	Antike e Vonë (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
45128	Fortifikimet Mesjetare-Parku Ark.Butrint	65	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Park Arkeologjik	Mesjetare	ANONIM ANONIM	Mesjete (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	
135555	Shtëpia e Tregtarit venecian.	66	**Materiale e Paluajtshme**	ARKEOLOGJI	Ndërtesa Private	Helenike	ANONIM ANONIM	Helenike (-)	PARKU ARKEOLOGJIK, BUTRINT	

SHTOJCA 2

PLANI I BIZNESIT

SHTOJCA 3

PROTOKOLLI I BASHKËPUNIMIT

SHTOJCA 4

FORMA E MBAJTJES SË INVENTARIT TË PASURISË KULTURORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

KARTELË REGJISTRIMI PËR OBJEKT PASURI KULTURORE MATERIALE E PALUAJTSHME

TË DHËNA ADMINISTRATIVE				
NR. I SKEDËS				
EMËRTIMI				
FUSHA				
GJINIA				
TIPOLOGJIA				
KODI I ARKIVIT				
ADRESA				
VENDNDODHJA	RRETHI	BASHKIA	KOMUNA	FSHATI
STATUSI I MBROJTJES (KATEGORIA I, II)				
NR. I VENDIMIT , DATA E SHPALLJES				
INSTITUCIONI I SHPALLJES				
DATIMI (VITI / SHEK)				
INSTITUCIONI, ADMINISTRUES / DRKK				
PËRDORIMI FILLESTAR				
PËRDORIMI I TANISHËM				
A KA RRETHIM OBJEKTI? / GJENDJA E TIJ				
ZONA E MBROJTUR				
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TE MONUMENTIT				
KOORDINATA GJEOGRAFIKE TË ZONËS SË MBROJTUR				
PRONËSIA				

EMRI I PRONARIT (-VE)				
NR. I PRONËSISE				
ZONA KADASTRALE				
SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT / LARTËSIA E OBJEKTIT				
SIPERFAQJA E PËRGJ. E RRETHIMIT				
SIPËRFAQJA E ZONËS SË MBROJTUR				
A KA RRUGË AUTOMOBILISTIKE DERI NË MONUMENT? / GJENDJA E SAJ				
TË DHENA TEKNIKE				
PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK				
PËRSHKRIMI KONSTRUKTIV				
NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE NË VITE,	VITI	VITI	VITI	VITI
SHKALLËT E NDERHYRJES */1/2/3/4/5/* *(nga nderhyrja me e lehtë tek me thellë)*		-	-	-
GJENDJA E KONSERVIMIT *SHKALLËT E GJENDJES* */1/2/3/4/5/* *(nga problematika me e lehtë tek me rendë)*				

DOKUMENTACIONI GRAFIK DHE HARTOGRAFIK

ORTOFOTO

DOKUMENTACIONI FOTOGRAFIK

BIBLIOGRAFIA:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

APLIKIM PËR REGJISTRIM OBJEKTI PASURI KULTURORE MATERIALE E LUAJTSHME

TITULLI:	
VENDODHJA:	
FUSHA:	
KATEGORIA:	
TIPI:	
MATERIALI:	
TEKNIKA:	
KULTURA :	
PERIUDHA:	
AUTORI:	
DIMENSIONET:	
PESHA:	
VLERA:	
VENDI I GJETJES (ORIGJINA)	
VENDI I RUATJES:	
DORËZUESI:	

TË DHËNA TË TJERA:	
SHKALLA E DËMTIMIT:	
KODI RKPK	
NR. REGJISTRI	
NR.INVENTARIT	
STATUSI: TRASHËGIMI KULTURORE	PO JO
STATUSI I AKTIVITETIT TË OBJEKTIT:	☐ NË RUAJTJE ☐ NË EKSPOZIM ☐ ME QERA ☐ NË KËRKIM ☐ NË SHITJE
STATUSI I OBJEKTIT:	☐ I RREGULLT ☐ I LARGUAR ☐ I VJEDHUR
ORIGJINALE/KOPJE	
LËVIZJE E OBJEKTIT:	
INSTITUCIONI:	
POSEDUESI:	
ADRESA E PRONARIT INSTITUCIONIT:	
KOMISIONI I VLERESIMIT:	

HISTORIKU	PËRSHKRIMI
RESTAURIMI	BIBLIOGRAFIA / REFERENCA

FOTO	FOTO	SKICA

DATA E SKEDIMIT:	
SKEDUESI : EMËR MBIEMËR NËSHKRIMI	

SHTOJCA 5

AKTI I DORËZIMIT TË PASURISË KULTURORE TË PALUAJTSHME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **DHOMA E NOTERËVE TIRANË** **NR. REP** **NR. KOL**

*Sot, më_____, përpara meje Noterit _____, palët e mëposhtme nënshkruan këtë shtojcë dorëzimi të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme ("**Shtojca e Dorëzimit**"):*

(1) **MINISTRISË SË KULTURËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, me seli në adresën rruga "Aleksandër Moisiu", ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Znj. Elva Margariti, Ministre e Kulturës (**"Ministria"**); dhe

(2) **FONDACIONIT PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT**, me seli në adresën Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Ndërtesa 6, Hyrja 11, Apartamenti 21, 1019, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga [ ] ("**Fondacioni**")

Ministria dhe Fondacioni do të referohen veçmas si "**Palë**" dhe bashkarisht si "**Palët**".

DUKE QENË SE:

A Më [DD muaj VVVV], Ministria dhe Fondacioni lidhën marrëveshjen e administrimit për administrimin indirekt nga ana e Fondacionit të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme (sikurse është përkufizuar më poshtë), pjesë e Parkut Kombëtr të Butrintit ("**Marrëveshja e Administrimit**").

B Në kuadër të administrimit indirekt të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme dhe të detyrimeve të Fondacionit sipas Marrëveshjes së Administrimit, Ministria i jep Fondacionit, nga Data e Transferimit deri në përfundimin e Afatit ose zgjidhjes së parakohshme të Marrëveshjes së Administrimit të drejta reale reale mbi Pasurinë Kulturore të Paluajtshme.

C Palët kanë përgatitur këtë Shtojcë të Dorëzimit në përputhje me nenin 7.3 të Marrëveshjes ë Administrimit.

D Përveç nëse përcaktohet ndryshe këtu, termat në kapitale / të përkufizuara kanë të njëjtin kuptim që u është dhënë në Marrëveshjen e Administrimit.

PËR KËTO ARSYE, Palët deklarojnë si vijon:

1. Dorëzimi i Pasurisë Kulturore të Paluajtshme

1.1 Ministria nëpërmjet kësaj Shtojce Dorëzimi i dorëzon Fondacionit Pasurinë Kulturore të Paluajtshme, e cila përfshin çdo pasuri kulturore të paluajtshme në nënzonën e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit në administrim të Ministrisë dhe pasuritë e tjera të paluajtshme në funksion dhe i shërbejnë Administrimit të Pasurisë Kulturore dhe ngritjes së Qendrës së Vizitorëve, vendndodhja e saktë dhe sipërfaqja e së cilave është përcaktuar në *Shtojcën 1* të Marrëveshjes së Administrimit ("**Pasuria Kulturore e**

Paluajtshme").

1.2 Fondacioni ka inspektuar Pasurinë Kulturore të Paluajtshme dhe pranon dorëzimin.

1.3 Ministria i garanton Fondacionit posedimin dhe Gëzimin e Plotë dhe të Qetë të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme pa asnjë kundërshpërblim.

1.4 Fondacioni do të regjistrojë këtë Shtojcë Dorëzimi në drejtorinë rajonale përkatëse të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, brenda një afati të arsyeshëm nga Data e Transferimit të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme dhe Ministria do të bashkëpunojë plotësisht në këtë aspekt.

2. Dhënia e të Drejtave të Përdorimit të Pasurise Kulturore të Paluajtshme

2.1 Në përputhje me nenin 7.1 të Marrëveshjes së Administrimit, duke nisur nga Data e Transferimit dhe deri në përfundimin e Afatit ose zgjidhjen e parakohshme të Marrëveshjes së Administrimit, Ministria i jep Fondacionit të drejtat mbi Pasurinë Kulturore të Paluajtshmen si vijon:

(a) të drejtën reale të përdorimit (por jo pronësinë), shfrytëzimit dhe gëzimit të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme pa asnjë barrë, detyrim apo kufizim, dhe pa ndërhyrje të panevojshme nga ana e Ministrisë, subjekteve publike apo palëve të treta;

(b) të drejtën për kalim mbi dhe nën, dhe hyrjen dhe daljen nga dhe në çdo vend të Pasurisë Kulturore të Paluajtshme dhe çdo pjesë të saj, pa ndërhyrje të panevojshme nga ndonjë palë e tretë për qëllimin e zbatimit të Marrëveshjes së Administrimit; dhe

(c) të drejtën për të ndërtuar, operuar dhe mirëmbajtur Qendrën e Vizitorëve si dhe të drejtën për të Administruar Pasurinë Kulturore të Paluajtshme.

2.2 Fondacioni do të mbulojë të gjitha kostot për ndërtimin e Qendrës së Vizitorëve, sipas preventivit që do të shoqërojë Planin e Zbatimit, me përjashtim të Infrastrukturës Mbështetëse, dhe do të ketë të drejtat e përdorimit të nevojshme për të zbatuar Marrëveshjen e Administrimit.

3. **Të ndryshme**

3.1 Ministria do të nënshkruajë, dorëzojë, dhe do të paraqesë të gjithë dokumentet që do të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga drejtoria rajonale përkatëse e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe çdo autoritet tjetër kompetent për regjistrimin e të drejtave të përdorimit dhe të drejtën e kalimit në lidhje me Pasurinë Kulturore të Paluajtshme, sipas nenit 2 të Shtojcës së Dorëzimit.

3.2 Kjo Shotjcë Dorëzimi është nënshkruar nga Palët në _____ kopje (secila kopje konsiderohet si origjinale).

*****

[*pjesa e mbetur lënë qëllimisht bosh*]

FAQJA E NËNSHKRIMIT

MINISTRIA E KULTURËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

[Elva MARGARITI]

……

FONDACIONI PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT

[ ]

……

NOTERI
[ ]

Albanian-American Development Foundation

Plani i Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit

Plani i Biznesit i Nënzonës së Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor (ish Zona A3)

Plani i Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit

Plani i Biznesit i Nënzonës së Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor (ish Zona A3)

Përgatitur për
Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)

Maj 2019
Përditësuar Korrik dhe Nëntor 2021

nga

PRINCE+PEARCE
M 35a The High Street, Potters Bar, EN6 5AJ, Mbretëri e Bashkuar
T +44(0) 7973 691 927
E dprince@princeandpearce.co.uk
W www.princeandpearce.co.uk

në bashkëpunim me

Qendrën për Arkeologjinë e Aplikuar, Institutin e Arkeologjisë, University College London
dhe
Trashëgiminë Kulturore pa Kufij, Shqipëri

Drejtuesi i Ekipit: **Dr. David Prince**

Falënderime

Prince+Pearce dëshiron të falënderojë të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre për përgatitjen e këtij plan biznesi, veçanërisht stafin e sitit në Butrint dhe atë të AADF-së, së bashku me ata që ofruan pa kushte kohën, përvojën dhe ekspertizën e tyre.

Statusi i dokumentit

Puna kërkimore për këtë Plan Biznesi është ndërmarrë nga P+P ndërmjet muajit tetor 2018 dhe janar 2019.

Plani iu paraqit AADF-së në muajin janar 2019, dhe AADF-ja e miratoi atë në muajin maj 2019.

Që prej asaj kohe, për shkak të pandemisë Covid-19, zbatimi i Planit është shtyrë në një kohë kur (a) është gjykuara e sigurt për të vijuar me zbatimin e tij; (b) kur propozimet të miratohen zyrtarisht nga Qeveria e Shqipërisë dhe (c) kur të ngrihet Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit i propozuar në zbatim të legjislacionit shqiptar.

Të gjitha këto janë realizuar.

Si rrjedhojë në muajin qershor 2021, P+P u kontraktua nga AADF-ja për të bashkëpunuar në rishikimin, përditësimin dhe redaktimin e Planit të Biznesit në kuadër të këtij progresi.

Ndaj, P+P dëshiron të falënderojë në veçanti Ilir Parangonin dhe Irena Krecin të AADF-së për punën e tyre me këtë plan të rishikuar, dorëzuar AADF-së nga P+P në fillim të muajit korrik 2021.

Ashtu si edhe me versionet e mëparshme, ky dokument është përgatitur për përdorim vetëm dhe posaçërisht nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Në të janë pasqyruar të gjitha komentet e bëra nga palë të ndryshme në draftin e mëparshëm për të cilat shkojnë falënderime të veçanta.

Prince+Pearce nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi apo detyrim ligjor për përmbajtjen e tij, nëse dokumenti i vihet në dispozicion ndonjë pale të tretë pa miratimin tonë.

Ndonëse Prince+Pearce ka bërë përpjekje të arsyeshme për përgatitjen e këtij dokumenti dhe çdo parashikim apo tregues i përmendur në këtë dokument është trajtuar në mirëbesim, nuk jepet asnjë garanci që këto parashikime apo tregues do të përmbushen.

Tabela e përmbajtjes

0

0 Përmbledhje Ekzekutive

1 Hyrje

1.1 Parametrat

1.2 Konsultimi

1.3 Konteksti dhe qëllimi

1.4 Përmbledhje e marrëdhënieve me mbarë Parkun Kombëtar

1.5 Qasja dhe çështjet kyçe

1.6 Baza

1.7 Mbulimi

1.8 Përvojat e shkuara dhe mësimet e nxjerra

1.9 Qasjet evoluese

1.10 Filozofia e zhvillimit

1.11 Parimet e planifikimit të punës

1.12 Pronësia mbi tokën, mbledhja, ofrimi dhe shërbimi

1.13 Situata aktuale

1.14 Roli dhe rëndësia e komuniteteve vendase

1.15 Përmbledhja e ndërhyrjeve kapitale të propozuara

2 Drejtimi

2.1 Rregullimet aktuale të qeverisjes

2.2 Implikimet e ligjit të ri për trashëgiminë kulturore

2.3 Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

2.4 Fluksi i fondeve dhe përgjegjësia për sitin

3 Plani i Biznesit

3.1 Ngritja, roli dhe ndikimi i turizmit ndërkombëtar

3.2 Roli i politikave turistike në promovimin e qëndrueshmërisë

3.3 Bota në vitin 2030

3.4 Përballja me ndryshimin

3.5 Supozime dhe pozicioni ekzistues

3.6 Modeli financiar bazë

3.7 Punimet për konservimin e sitit (rreshtat 2 dhe 15)

3.8 Gërmimet e reja arkeologjike

3.9 Qendra e re për vizitorët (rreshti 3)

3.10 Akomodimi i stafit, strukturat në hyrje dhe rrethimi i sitit (rreshti 4)

3.11 Interpretim i ri në Kalanë Veneciane (rreshti 5)

3.12 Interpretim i ri i Fortesës Trekëndore (rreshti 6)

3.13 Hotel Livia

3.14 Shtëpia e Doganës

3.15 Interpretimi i ri i sitit (rreshti 7

3.16 Buxheti i interpretimit i të gjithë sitit
3.17 Varkat e pasagjerëve, platformat lundruese dhe vendparkimi i makinave në hyrje (rreshti 8)
3.18 Mjetet e transportit të sitit (rreshti 9)
3.19 Studimet e specializuara dhe konsultimet (rreshti 16)
3.20 Grupi Kërkimor i Butrintit (rreshti 17)
3.21 Zhvillimi i markës, marketingu dhe promovimi (rreshti 18)
3.22 Operimet jashtë sitit (rreshti 19)
3.23 Stafi i Sitit (rreshti 20)
3.24 Furnizime dhe shërbime të kontraktuara (reshti 21)
3.25 Grante (rreshti 22)
3.26 Përmbledhje – kosto (nga rreshti 27 deri te 30)
3.27 Vizitorët dhe ndikimi i tyre (nga rreshti 31 deri te 39)
3.28 Sitet për krahasim
3.29 Numri i vizitorëve
3.30 Të ardhurat nga vizitorët dhe të tjerët (rreshtat 32-38)
3.31 Burime të tjera të ardhurash – mbledhja e fondeve, sponsorizime dhe dhënie me qira e sitit
3.32 Të ardhura nga qeveria

4 Përmbledhje dhe ndjeshmëri
4.1 Profile të përgjithshme të performancës
4.2 Ndjeshmëria
4.3 Tregues të përzgjedhur të performancës
4.4 Konsiderata përmbledhëse
4.5 Përmbledhja e investimit kapital

5 Risku dhe menaxhimi i riskut
5.1 Risqe politike dhe të tjera
5.2 Risku i forcave madhore dhe katastrofave

6 Ndikimi ekonomik
6.1 Parime
6.2 Butrint
6.3 Rezultati
6.4 Përfitimet shtesë

7 Hapat e mëtejshëm
7.1 Çështjet kyçe për t'u zgjidhur
7.2 Rruga përpara

Shtojca A Përmbledhje financiare e Zonës A3: 2013-2020

Lista e figurave

Figura 1: Fokusi i Planit të Biznesit siç përcaktohet në TeR
Figura 2: Analizë e problematikave
Figura 3: Skema e siteve kryesore të adresuara në Planin e Biznesit
Figura 4: Zona A3 në kontekst
Figura 5: Fondacioni i Ri (Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit) - përshtatjet kryesore
Figura 6: Fluksi kryesor i fondeve kapitale dhe të ardhurave
Figura 7: Ofrimi dhe përgjegjësia e përgjithshme
Figura 8: Kthimet kryesore të operimit për vitin 2013-2020 (për detaje shihni Shtojcën A)
Figura 9: Datat kyçe për produktet
Figura 10: Modeli financiar bazë
Figura 11: Krahasimi ndërmjet punimeve kapitale dhe punimeve të të ardhurave për konservimin e sitit (duke përfshirë kontigjencën prej 10%)
Figura 12: Vendet kryesore të përmendura në tekst
Figura 13: Kostot e përllogaritura për shpronësimin dhe infrastrukturën e sipërfaqes së qendrës së propozuar të vizitorëve (rreshtat 11 dhe 12 referuar Figurës 10)
Figura 14: Komponentët e propozuar për qendrën e re të vizitorëve
Figura 15: Qendra e vizitorëve: axhenda fillestare e akomodimit, vlerësuar në dy faza të barabarta
Figura 16: Mundësitë që paraqiten në mbarë sitin dhe itineraret e transportit
Figura 17: Kosto të aksesit në sit
Figura 18: Varkat e pasagjerëve, platformat lundruese dhe vendparkimi i makinave
Figura 19: Studimet e specializuara, konsultimet dhe monitorimi (duke përfshirë kontigjencën prej 10%)
Figura 20: Grupi Kërkimor i Butrintit (duke përfshirë kontigjencën prej 10%)
Figura 21: Shpenzimet jashtë sitit (duke përfshirë kontigjencën prej 10%).
Figura 22: Stafi i Sitit dhe kontraktorët e pavarur (kutia rozë)
Figura 23: Menaxherët e linjës - rolet dhe përgjegjësitë
Figura 24: Rritja e parashikuar për stafin me kohë të plotë
Figura 25: Pagat e sugjeruara për stafin
Figura 26: Përllogaritje të furnizimeve dhe shërbimeve të kontraktuara
Figura 27: Përmbledhjet e investimit (duke përfshirë një kontingjencë prej 10%)
Figura 28: Tarifat aktuale (2021) për hyrje në Butrint
Figura 29: Çmimet krahasuese - çmimet e hyrjes për të rritur në USD
Figura 30: Rritja e parashikuar e numrit të vizitorëve 2022-2028 (Viti operacional 1 deri në 7)
Figura 31: Përmbledhja e të ardhurave
Figura 32: Fondet e kërkuara nga Qeveria dhe AADF-ja
Figura 33: Përmbledhjet financiare bazë (duke përfshirë një kontigjencë prej 10%)
Figura 34: Profilet e performancës
Figura 35: Vlerësim i gjerë i ndjeshmërisë
Figura 36: Treguesit e përzgjedhur të performancës
Figura 37: Përmbledhja e investimit kapital

Shkurtesa

AADF	Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim
P+P	Prince + Pearce Limited
TeR	Termat e Referencës
STB	Sit i Trashëgimisë Botërore
UCL	University College London
CHwB	Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Shqipëri
PMI	Plani i Menaxhimit të Integruar
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
VJU	Vlerë e Jashtëzakonshme Universale
Ramsar	Konventa Ramsar për Ligatinat e Rëndësisë Ndërkombëtare, Veçanërisht si Habitat i Shpendëve të Ujit

Shënim: Termat "Zona A3", "Siti A3", "Nënzona eë Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor" si dhe "Zona Arkeologjike" përdoren në vend të njëra-tjetrës

0 Përmbledhje Ekzekutive

Të gjitha planet e biznesit janë hipotetike.

Ato synojnë të bëjnë parashikime për sjelljen (financiare, ekonomike, shoqërore) në të ardhmen, ku në shumicën e rasteve, bazohen në informacion të pamjaftueshëm, të keqpërcaktuar dhe ndonjëherë edhe të panjohur. Ato nevojiten për modelimin ose projektimin e këtij informacioni për shumë vite në të ardhmen. Gjithashtu, për shkak të nevojës, ato duhet të marrin në konsideratë prirjet ekonomike lidhur me luhatjet në nivel vendor dhe kombëtar, dhe në këtë rast, edhe dëshirën e përgjithshme dhe të supozuar të njerëzve për të vizituar Shqipërinë në përgjithësi dhe Butrintin në veçanti.

Vlerësimi i këtij plani biznesi për rolin e Fondacionit të Ri në Sitin e Trashëgimisë Botërore të Butrintit është kryer nisur nga këndvështrimi i zhvillimit të një siti ekzistues fitimprurës dhe krijimit të një pakete punimesh të dorëzueshme, të arritshme, të menaxhueshme, realiste dhe të qëndrueshme në dobi të Zonës Arkeologjike, njerëzve që punojnë atje dhe atyre që jetojnë në zonën përreth, për një periudhë afatgjatë[1].

Ky këndvështrim nuk pasqyrohet vetëm në qasjen e rekomanduar 'të kujdesshme', 'të ruajtjes së identitetit të vendit' siç është advokuar prej shumë vitesh nga Fondacioni Butrinti[2] dhe mbështetur plotësisht nga ky Plan Biznesi, por pasqyrohet edhe në mënyrat e dhënies së rekomandimeve për ndërhyrjet në sit, zgjidhjet interpretuese, konservimin e rrënojave, vendosjen e çmimeve të hyrjes, punësimin e stafit dhe menaxhimin e vizitorëve.

Plani i Biznesit në këtë dokument mbulon shtatë vjet operim (2022-2028), si dhe një periudhë gjashtëmujore tranzitore nga muaji nëntor 2021 deri në prill 2022. Nevoja për periudhën tranzitore u shfaq si një modifikim i nevojshëm nga puna e programuar fillimisht në versionin e vitit 2019 të këtij relacioni për të marrë në konsideratë efektet e Covid-19.

Plani përcakton mënyrën e drejtimit dhe menaxhimit ditor të sitit, rekomandon investimet e reja kapitale, shpjegon përfshirjen e banorëve vendas, dhe merr në konsideratë angazhimin e tyre të plotë në Parkun Kombëtar për një periudhë afatgjatë.

Mund të parashikohen edhe shumë rezultate të tjera të pamatshme që mund të jenë njësoj të vlefshme, si: mirëqenia e ZonësA3 dhe Parkut Kombëtar përreth tij nëpërmjet largimit të mbetjeve plastike dhe të tjera, punësimit të banorëve vendas si udhërrëfyes, varkëtarë dhe zejtarë, dhe rritjes së të ardhurave të banorëve vendas nëpërmjet ngritjes së hoteleve, restoranteve, bareve dhe strukturave të ngjashme. Disa nga këto rezultate mund të rezultojnë mjaft të rëndësishme si për njerëzit e përfshirë edhe për mirëqenien afatgjatë të Zonës Arkeologjike në tërësi.

[1] Për qëllime të punimeve dhe për ta dalluar atë nga Fondacioni ekzistues Butrinti, titulli i punimeve ***Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit*** do të përdoret gjatë gjithë këtij Plani Biznesi. Jemi të ndërgjegjshëm se nevojitet një emër më i përshtatshëm të paktën për qëllime të njohjes dhe markës në aspektin afatgjatë.

[2] Fondacioni Butrinti u themelua në vitin 1993 nga Lord Rothschild dhe Lord Sainsbury i Preston Candover, të cilët vazhdojnë të kontribuojnë në mënyrë aktive. Fondacioni synon të konservojë, ruajë dhe zhvillojë sitin e Butrintit dhe ka qenë mjaft i dobishëm në ruajtjen e tij, si dhe në nxitjen e kërkimeve pas rënies së komunizmit në Shqipëri në vitin 1992.

Rezultatet parësore të Planit janë:

1. Në fund të vitit operacional 7, duke pasur parasysh periudhën tranzitore, siti do të 'konservohet plotësisht' sipas standardeve të përcaktuara në Planin e Menaxhimit të Integruar, do t'i nënshtrohet një sërë ndërhyrjesh të standardit ndërkombëtar, duke përfshirë një qendër të re vizitorësh, dhe do të jetë plotësisht i hapur për publikun me pagesë, i cili përllogaritet në rreth 295,000 vizitorë në vit, nga të cilët rreth 200,000 pritet të jenë shtetas të huaj
2. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të jetë plotësisht funksional për gjashtë vjet dhe nëntë muaj, duke marrë në konsideratë periudhën gjashtëmujore tranzitore, përpara se të marrë në kontroll sitin në fund të tremujorit të parë të Vitit 1
3. Nevojitet një investim total kapital prej 7.5 milionë USD, ku 39% e të cilit do të shpenzohet për konservimin e sitit dhe 61% për ndërtimin e strukturave të reja për vizitorët dhe stafin
4. Megjithëse investimi total i përshkruar më sipër ndryshon nga viti në vit, nevojitet një investim total kapital i akumuluar neto prej 7.5 milionë USD deri në Vitin 4
5. Falë këtij investimi do të krijohen interpretime dhe struktura të reja dhe të përmirësuara të standardeve ndërkombëtare në mbarë Qytetin Antik, duke përfshirë një qendër të re vizitorësh, rregullime të reja interpretuese, rregullime të reja të transportit, si dhe rregullime të reja të stafit lidhur me kushte më të mira punësimi
6. Projekti në tërësi gjeneron tepricë operative vjetore në Vitin 4 dhe tepricë të akumuluar në Vitin 7 kur ai operon me fitim prej afërsisht 1.5 milionë USD në vitin pasardhës
7. Të gjitha punimet e papërfunduara për konservimin e sitit do të jenë adresuar dhe buxheti për të gjitha punimet për mirëmbajtjen e vazhdueshme në të ardhmen do të jetë siguruar, duke garantuar në këtë mënyrë mirëqenien afatgjatë të rrënojave arkeologjike, që përbëjnë pasuritë parësore të sitit
8. Struktura e re e menaxhimit do të përfaqësohet në operacionet e sitit, të cilat do të mundësojnë marrjen e shpejtë të vendimeve në të ardhmen për menaxhimin e sitit dhe me njohuritë e duhura për forcat e tregut
9. Nëse dëshirohet, sigurimi i investimit në të ardhmen do të jetë më i lehtë nëpërmjet Fondacionit të Ri dhe investitorëve të tij partnerë, falë operimit të provueshëm fitimprurës së sitit
10. Zhvillimi dhe përdorimi i markës Butrinti duhet të ndiqet si një mundësi biznesi e veçantë por që lidhet me të për një periudhë afatgjatë, pasi mund të sjellë përfitime të mëdha ekonomike dhe për komunitetin
11. Tepricat vjetore nga operimi i Zonës A3 *mund* të përdoren si fonde të investimit fillestar për (a) mbarë Parkun Kombëtar të Butrintit dhe/ose (b) site të tjera të ngjashme në mbarë Shqipërinë: që nënkupton se modeli mund të miratohet dhe shfrytëzohet diku tjetër, në varësi të kushteve të tregut vendas.

Të gjitha zhvillimet e reja, të çfarëdolloj fushe apo shkalle, ofrojnë mundësi por mbartin edhe rreziqe. Rreziqet ndaj zhvillimit të suksesshëm afatgjatë të Butrintit ndahen në tre kategori: globale, kombëtare dhe vendore.

Rreziqet globale dhe kombëtare përfshijnë ato që vetë siti ka shumë pak mundësi të zbusë. Një rast ekstrem, siç do të ishte një ngjarje sizmike, për të cilat ka precedentë historikë dhe prova të qarta në Butrint, mund të ndryshojnë tërësisht strukturën e tij.

Rritjet e parashikuara në nivelin e Detit Jon, që lidhen me ngrohjen globale, me shumë gjasë mund të përmbytin sipërfaqe të mëdha të Qytetit Antik, duke përfshirë lagjen periferike romake në Fushën e Vrinës. Gjithashtu, ndryshime në udhëheqjen politike ose filozofike, vullnet dhe drejtim mund të sjellin pasojat e tyre.

Ndikimet e gjera të pandemisë Covid-19 dhe masat për ta përmbajtur atë, kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në të gjitha aspektet e jetës, duke përfshirë edhe industrinë e trashëgimisë. Pandemia ka ndikuar në çdo dimension të zinxhirit të vlerave të trashëgimisë kulturore, duke nisur nga kërkimi në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë, deri në ofrimin e trajnimit dhe edukimit. Në periudhën afatmesme, siguria dhe higjiena do të jenë shqetësimi kryesor për operatorët e trashëgimisë dhe vizitorët. Në planin afatgjatë, do të jetë e nevojshme të rishikohen rregullat e sigurisë në lidhje me hyrjen e publikut në sitet e trashëgimisë.

Rreziqet vendore, mbi të cilat Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit ka të paktën njëfarë ndikimi, kanë të bëjnë me ato që lidhen drejtpërdrejt me Zonën A3, operacionet e tij dhe ato të fqinjëve të tij në dhe përreth Butrintit. Në këtë aspekt, rreziqet grupohen rreth mospranimit të propozimeve të zhvillimit për aq sa:

1. Ka kundërshtim të planeve, veçanërisht për qendrën e propozuar të vizitorëve, për shkak se ato konsiderohen se kanë ndikim negativ për mënyrën aktuale të funksionimit të ekonomisë vendore, kryesisht të bujqësisë, mbarështimit të peshqve, transportit me lundër, etj.
2. UNESCO paraqet një opinion pjesërisht ose tërësisht negativ rreth propozimeve
3. Agjencitë e qeverisë qendrore (ose vendore) ose hedhin poshtë planet, ose nuk arrijnë marrëveshje për to
4. Kundërshtimi vjen nga një sërë akademikësh dhe organe të ndryshme ndërkombëtare

Këto rreziqe vendore të paktën mund të zbuten,madje dhe të kapërcehen nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, duke shpjeguar qartë se çfarë përpiqet të arrihet përmes ndërhyrjeve të propozuara dhe pse.

Prandaj, përpjekjet e tij lidhur me marrëdhëniet me publikun duhet të jenë të cilësisë më të lartë dhe të vijojnë për një periudhë afatgjatë.

Këto përpjekje të marrëdhënieve me publikun duhet të koordinohen si me Planin e Menaxhimit të Integruar për mbarë Parkun Kombëtar të Butrintit edhe me zhvillimin e markës Butrinti, ku të dyja këto ofrojnë ose mund të ofrojnë përfitime të mëdha për komunitetin vendas.

Nëse Butrinti aspiron të shndërrohet në model për pjesën tjetër të Shqipërisë, të gjithë Ballkanin dhe Mesdheun Lindor, ai duhet të përpiqet të përmirësojë integritetin e vendit, t'i njohë brezat e rinj me historinë, të angazhojë komunitetet vendore, të ruajë ndërthurjen e vendit antik me peizazhin modern në mënyra të tilla që na pasurojnë të gjithëve.

Për sa i përket risisë, ky Plan Biznesi synon të promovojë një ndërhyrje pozitive ndaj emetimit të dioksidit të karbonit (ose të paktën neutrale ndaj emetimit të dioksidit të karbonit) në Zonën A3 për një periudhë afatgjatë, nëpërmjet përdorimit të autobusëve dhe varkave ekologjike, pagesave të kostove për mbledhjen dhe riciklimin e mbetjeve plastike dhe të tjera, angazhimin e Grupit të ri Kërkimor të Butrintit dhe punësimin e banorëve vendas në konservimin, menaxhimin, zhvillimin dhe marrjen në dorëzim të Sitit të Trashëgimisë Botërore.

Shumë prej këtyre iniciativave janë risiprurëse. Ato janë propozuar për të nxitur të gjitha punimet, në mënyrë që Butrinti të shndërrohet në sitin arkeologjik më të mirëmenaxhuar në Mesdheun Lindor, një model për t'u ndjekur edhe nga site të tjera. Ky Plan Biznesi është dhe duhet të mbetet një dokument pune.

Megjithëse janë përcaktuar, parashtruar dhe diskutuar mënyrat, së bashku me implikimet financiare dhe risqet përkatëse, vendimet e marra për këtë Plan nga AADF-ja, qeveria dhe agjencitë e tjera përgjegjëse do të kenë doemos ndikime, disa të lehta dhe disa gjithëpërfshirëse, mbi propozimet që ky Plan bën dhe të ardhmen që ai parashikon.

Rrjedhimisht, duke qenë se fokusi i diskutimeve dhe projektit mund të ndryshojnë, nevojitet që të përshtaten politika dhe zbatimi (të cilat nuk mund të përcaktohen tani), në mënyrë që Plani i Biznesit dhe ndërhyrjet e rezultatet e tij të jenë gjithmonë në përputhje me realitetin e ndryshueshëm.

Ky Plan Biznesi ka treguar se *nuk ka problematika teknike të pakapërcyeshme* lidhur me zhvillimin e tij në dobi të Zonës A3.

Çështjet e pazgjidhura lidhur me zhvillimin e një projekti të suksesshëm janë ligjore ose politike, dhe fokusohen në:

1. Zgjidhjen e çështjes së pronësisë së tokës brenda Parkut Kombëtar, veçanërisht të zonës së propozuar për qendrën e re të vizitorëve. Prezumohet se këto çështje do të zgjidhen përpara nënshkrimit të Marrëveshjes së Menaxhimit.
2. Nevojën për një Komision më të fortë dhe të fuqizuar (në formën e një Autoriteti) që të mbikëqyrë menaxhimin e Sitit të Trashëgimisë Botërore *dhe* të mbarë Parkut Kombëtar, me qëllim mbështetjen e përpjekjeve brenda Zonës A3
3. Transferimin e fondit të rezervuar nga Ministria e Kulturës, te Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit në datën e transferimit të këtij fondi sipas Marrëveshjes së Administrimit, referuar ne vlerën 2.1 milionë USD[3] në këtë Plan Biznesi si vlerë indikative për efekte parashikimi, në Vitin 1 për punimet kryesore në konservimin e sitit. Ky kontribut siguron që projekti do të ruajë një fluks monetar pozitiv
4. Rregullimet specifike ligjore dhe menaxheriale për marrëveshjen ndërmjet Fondacionit të Ri dhe Qeverisë
5. Zgjidhjen e mospërputhjes së kufijve ndërmjet Përcaktimit të Zonave nga Ministria e Kulturës, AKZM-ja dhe UNESCO
6. Kapaciteti i Qeverisë për të dhënë në dorëzim Zonën A3, e cila do të përcaktohet në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit si një aset pa barrë, për t'i mundësuar Fondacionit të Ri të vijojë me planet e zhvillimit dhe strategjitë e tij të investimit

[3] Gjendja e llogarisë deri në tetor 2021.

1 Hyrje

Në tetor të vitit 2018, PRINCE+PEARCE Ltd (P+P), në bashkëpunim me Qendrën për Arkeologjinë e Aplikuar në Institutin e Arkeologjisë, University College London (UCL) dhe Trashëgiminë Kulturore pa Kufij, Shqipëri (CHwB), u kontraktua nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), për të kryer punë kërkimore dhe për të hartuar një Plan Menaxhimi të Integruar (PMI) për Sitin e Trashëgimisë Botërore të Butrintit (STB)[4]. Puna duhej përfunduar në maj të vitit 2019.

Një aspekt i këtij autorizimi ishte hartimi i një Plani Biznesi për operimin në të ardhmen të Zonës Arkeologjike A3, e cila do të menaxhohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, i propozuar për t'u ngritur nga Ministria e Kulturës dhe AADF-ja, në përputhje me Nenin 172 të Ligjit të ri për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë. E përcaktuar në Termat e Referencës (TeR) për punimet, Zona A3 (614.3 ha) paraqitet me ngjyrë vjollcë më poshtë. Plani fillestar i Biznesit u përfundua në maj 2019 siç ishte planifikuar. Ndërsa Marrëveshja e Menaxhimit midis Fondacionit të Ri për Menaxhimin e Butrintit dhe Qeverisë së Shqipërisë pritet të finalizohet dhe të paraqitet në Kuvend për miratim në vitin 2021; parashikimet fillestare të Planit të Biznesit janë rishikuar, duke reflektuar dhe marrë parasysh ndikimin e situatës aktuale nën masat globale të pandemisë.



Figura 1: Fokusi i Planit të Biznesit siç përcaktohet në TeR[5]

[4] Ekipi i konsulentëve i P+P përbëhej nga: Dr. David Prince (drejtues i ekipit), Simon Pearce (koordinator i projektit), Dr. Richard Hodges (përgjegjës për konservimin arkeologjik), Dr. Daniel Laven (përgjegjës për konservimin ekologjik dhe biodiversitetin), Oliver Gilkes (përgjegjës për turizmin dhe infrastrukturën), Dr. Gai Jorayev (përgjegjës për hartëzimin dixhital), Lejla Hadzic (përgjegjëse për arkitekturën e konservimit), Mirian Bllaci (përgjegjës për angazhimin dhe edukimin e komunitetit), dhe Dr. Sarah McCarthy (përgjegjëse për mbështetjen e kërkimit).

[5] Kjo hartë është veçse treguese. Një nga qëllimet e punës aktuale është të paraqesë një përvijim të saktë të të gjithë kufijve, dhe rrjedhimisht të zonave, si pjesë e PMI-së.

Ky Plan Biznesi është parashtruar në kontekstin e përmbledhjes së gjerë të punimeve, me qëllim hartimin e:

1. Një Plani Biznesi më vete për një periudhë shtatëvjeçare, për operimin e Zonës A3 i cili mbështetet në rekomandimet e PMI-së për operimin e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit. Plani i Biznesit duhet të përfshijë nevojat për staf, si dhe identifikimin e burimeve të mundshme të të ardhurave, siç janë mundësitë e zhvillimit të turizmit.
2. Hartimi i propozimeve për mundësi të zhvillimit ekonomik brenda sitit dhe në zonat përreth tij(në zonën e tij buferike), duke përfshirë aktivitete turistike dhe çlodhëse, që i përshtaten më së miri natyrës së sitit, Vlerës së tij të Jashtëzakonshme Universale (VJU), pozicionit të tij brenda Parkut Kombëtar dhe përcaktimit të tij si zonë Ramsar.

1.1 Parametrat

Të gjitha planet e biznesit janë hipotetike. Ato synojnë të bëjnë parashikime për sjelljen (financiare, ekonomike, shoqërore) në të ardhmen, ku në shumicën e rasteve, bazohen në informacion të pamjaftueshëm, të keqpërcaktuar dhe ndonjëherë të panjohur. Ato nevojiten për modelimin ose projektimin e këtij informacioni për shumë vite në të ardhmen. Gjithashtu, për shkak të nevojës, ato duhet të marrin në konsideratë prirjet ekonomike lidhur me luhatjet në nivel vendor dhe kombëtar, dhe në këtë rast, edhe dëshirën e përgjithshme dhe të supozuar të njerëzve për të vizituar Butrintin dhe Shqipërinë.

Plani i Biznesit në këtë dokument mbulon shtatë vjet operim (2022-2028), si dhe një periudhë gjashtëmujore tranzitore nga muaji nëntor 2021 deri në prill 2022. Nevoja për periudhën tranzitore u shfaq si një modifikim i nevojshëm nga puna e programuar fillimisht në versionin e vitit 2019 të këtij relacioni për të marrë në konsideratë efektet e Covid-19.

Plani përcakton mënyrën e drejtimit dhe menaxhimit ditor të sitit, rekomandon investimet e reja kapitale, shpjegon përfshirjen e banorëve vendas, dhe merr në konsideratë angazhimin e tyre të plotë në Parkun Kombëtar për një periudhë afatgjatë.

Mund të parashikohen edhe shumë rezultate të tjera të pamatshme që mund të jenë njësoj të vlefshme, si: mirëqenia e Zonës A3 dhe Parkut Kombëtar përreth tij nëpërmjet largimit të mbetjeve plastike dhe të tjera, punësimit të banorëve vendas si udhërrëfyes, varkëtarë dhe zejtarë, dhe rritjes së të ardhurave të banorëve vendas nëpërmjet ngritjes së hoteleve, restoranteve, bareve dhe strukturave të ngjashme. Disa nga këto rezultate mund të rezultojnë mjaft të rëndësishme si për njerëzit e përfshirë edhe për mirëqenien afatgjatë të Zonës Arkeologjike A3 në tërësi.

1.2 Konsultimi

Njësoj si të gjitha Planet e Biznesit, ky plan i detyrohet shumë kontributeve të shumë njerëzve. Gjithsej, mbi shtatëdhjetë e pesë persona ofruan kohën dhe përvojën e tyre, që nga Ministrat e Shtetit deri te prodhuesit e mandarinave në Fushën e Vrinës. Vetëm ky fakt, tregon interesin e gjithanshëm të banorëve vendas. Rëndësi të veçantë në hartimin e këtij Plani Biznesi ka pasur diskutimi me drejtoritë dhe ministritë e mëposhtme, për të cilat falënderohet:

1. Ministria e Kulturës
2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
5. Instituti i Monumenteve të Kulturës

6. Instituti i Arkeologjisë
7. Universiteti i Tiranës
8. AKZM – Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
9. AdZM – Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
10. Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit
11. Bashkitë e Sarandës, Konispolit dhe Finiqit
12. Përfaqësues vendorë në mbarë zonën e Butrintit.

1.3 Konteksti dhe qëllimi

Butrinti është një nga peizazhet botërore arkeologjike, kulturore dhe ekologjike më të jashtëzakonshme, siç dëshmohet nga përcaktimet e tij si Sit i Trashëgimisë Botërore (1992), si Park Kombëtar (2000) dhe si Zonë Ramsar (2002).

Përmendur për herë të parë në filozofinë perëndimore në poemën epike *Eneida* të Virgjilit, tashmë dihet se ai ka qenë i banuar për të paktën 12,000 vjet, ose për rreth 500 breza. Siti është një xhevahir i paçmueshëm i mozaikut të siteve arkeologjike të rëndësishme në nivel ndërkombëtar, i cili kontribuon në përcaktimin e historisë së Mesdheut dhe të botës perëndimore. Si i tillë, siti ka qenë për vite me radhë në fokus të një sërë studimesh arkeologjike, historike dhe ekologjike, të cilat kanë krijuar së bashku një literaturë të pasur, të besueshme dhe të konfirmuar nga studiues të tjerë për sitin dhe prapatokën e lidhur me të[6].

Qëllimi i këtij Plani Biznesi ***nuk*** është riinterpretimi i këtij informacioni për krijimin e një historie përfundimtare të sitit, nëse kjo do të ishte vërtetë e mundur. Gjithashtu, ai nuk synon të hartojë plane të detajuara për menaxhimin e konservimit, dhe as strategji ekologjike apo plane për interpretimin e sitit, Zonën e tij Buferike/Parkun Kombëtar apo për të gjithë Zonën Ramsar ku ai ndodhet.

Megjithatë, qëllimi i tij ***është*** marrja në konsideratë dhe dhënia e rekomandimeve për drejtimin, menaxhimin, punësimin, zhvillimin dhe kapitalin financiar për operimin e Zonës Arkeologjike A3 si një pasuri për t'u menaxhuar në vazhdimësi nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, dhe i cili në këtë mënyrë identifikon dhe mbulon nevojat e peizazhit vendor dhe banorëve të tij.

1.4 Përmbledhje e marrëdhënieve me mbarë Parkun Kombëtar

Për shkak të problematikave në mbarë Parkun Kombëtar lidhur me menaxhimin dhe mekanizmat e mbikëqyrjes dhe zhvillimit, që komplikohen edhe më shumë nga problematikat e pronësisë së tokës brenda Zonës A3 (Qyteti Antik, që do të shtjellohet në vijim), ky Plan Biznesi paraqet një *zgjidhje të pavarur* dhe të zbatueshme për drejtimin, menaxhimin dhe zhvillimin e Zonës A3.

1.5 Qasja dhe çështjet kyçe

Të idealizosh një sit si Butrinti nuk kërkon shumë mund. Ai është piktoresk në mënyrën më të përsosur, i pozicionuar në një peizazh madhështor natyror dhe detar, dhe plotësisht i aksesueshëm nga njeriu. Kjo e bën atë njëkohësisht tërheqës dhe të cenueshëm.

Për rrjedhojë, thelbi i çdo plani të suksesshëm biznesi është që siti të vazhdojë të jetë tërheqës, duke minimizuar në të njëjtën kohë edhe cenueshmërinë e tij.

[6] Falë publikimeve të Fondacionit Butrinti, asnjë sit arkeologjik në Ballkanin Perëndimor (përveç Kerosit në Greqi) nuk ka një regjistrim arkeologjik kaq të detajuar, duke përfshirë prapatokën e tij. Në vitin 2019 u botuan *Butrinti 5* (1 vëllim) dhe *Butrinti 6* (3 vëllime); në vitin 2020, Oxbow Books botoi *Butrinti 7* (një vëllim i vjetër në internet) për Kalivon dhe Çukën e Ajtoit, si dhe studime të tjera të shkurtra të prapatokës së Butrintit që priten të botohen në vitin 2020. Fondacioni Butrinti po punon edhe për një arkiv të ri dixhital.

Ky është çelësi i një qasjeje që është testuar në sesione diskutime dhe përcaktimi të vizionit me palë të shumta interesi (kombëtare, rajonale dhe vendore), gjatë punës sonë, si dhe me të gjithë anëtarët e ekipit të konsulentëve.

Të gjitha sitet historike, të çfarëdolloj madhësie apo natyre, përballen me problematika kontradiktore lidhur me aksesin dhe konservimin, veçanërisht kur fluksi i vizitorëve përqendrohet në pak muaj, siç është rasti i Butrintit. Ky problem është sa i thjeshtë, aq edhe i ndërlikuar: si të mbrojmë pasuritë kryesore të sitit, jo vetëm nga bota që ndryshon vrullshëm, por edhe nga vetë vizitorët.

Megjithëse problematikat e rritjes së nivelit të detit nga ndryshimet klimatike globale, krahas shqetësimeve për ndotjen detare me mbetje plastike, nuk janë objekt i qëllimit të këtij punimi, reagimet ndaj këtyre sfidave në nivel vendor duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të planit.

Ka ende debat ndërmjet ruajtjes së asaj që ekziston, që është e njohur, e pranuar dhe e kuptuar dhe për atë që mbetet akoma për t'u zbuluar, dhe nevojës për ta shfrytëzuar këtë burim për përfitime socio-ekonomike të vendasve dhe komuniteteve të tyre.

Një tjetër faktor, që vihet re në site të tjera të ngjashme përgjatë Mesdheut Lindor dhe gjetkë, është çështja e *konservimit* të asaj që ekziston … në gjendjen që është zbuluar … duke ndjekur një qasje ndërhyrëse 'rikonstruksioni' për monumentin dhe peizazhin e tij përreth. Kjo çështje kërkon studim të kujdesshëm dhe plane realiste, të zbatueshme dhe të qëndrueshme për të ardhmen.

Një plan biznesi që nuk merr në konsideratë të gjithë faktorët mund të çojë lehtësisht në konflikte, që mund të shoqërohen me humbjen e vlerave kulturore dhe identitetit, dobësimin ekonomik dhe shkatërrimin e monumentit dhe mjedisit të tij mbështetës. Këto rezultate janë parë edhe gjetkë,ndaj duhen shmangur në Butrint.

Shumica e Siteve të Trashëgimisë Botërore që janë aktualisht të rrezikuara nga çështje si lufta, trazirat apo konflikti civil, mirëmbajtja e pamjaftueshme ose e paplanifikuar dhe ndërhyrjet e papërshtatshme, të cilat i izolojnë banorët vendas nga toka e tyre dhe çojnë në shkatërrimin e mjedisit të sitit; shpesh, këta faktorë ndërthuren me mungesën e të menduarit strategjik dhe burimet e pamjaftueshme, si financiare ashtu edhe njerëzore.

Qasja jonë ndaj hartimit të Planit të Biznesit për sitin bazohet gjerësisht në të kuptuarit se pasuritë e trashëgimisë mund dhe duhet të jenë një faktor i rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit dhe prosperitetit, duke nxitur investimet dhe sipërmarrjen vendase.

Kjo kërkon që qasja të bëjë lidhjen e mbrojtjes afatgjatë të sitit dhe pasurive të tij kulturore dhe natyrore me një të ardhme dinamike, konkurruese dhe tërheqëse. Gjithashtu, kjo nënkupton që këto plane të kenë ndikim të gjerë, të jenë novatore dhe të guximshme në qasjen e tyre.

Prandaj, fokusi i këtij plani bie mbi gjetjen e ekuilibrit ndërmjet nevojave të dukshme të sitit, lidhur me konservimin e tij, dhe nevojave e aspiratave afatgjata të njerëzve që do të kujdesen për të.

Përfundimisht, dhe në mënyrë që Plani i Biznesit të funksionojë, nevojitet angazhimi i të gjitha palëve: komuniteteve vendase, turistëve, themeluesve, financuesve, organeve të reja drejtuese dhe agjencive qeveritare, të cilat janë ngarkuar me përgjegjësinë për të punuar bashkërisht me mirëkuptimin drejt arritjes së qëllimit të përbashkët, bazuar në mirëkuptimin reciprok.

1.6 Baza

Baza e këtij Plani Biznesi ka si shqetësim të përgjithshëm të tij konservimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të Sitit të Trashëgimisë Botërore të Butrintit, të përcaktuar nga UNESCO në listën e tij të vitit 1992, dhe të përditësuar në vitet 1999 dhe 2007. Në veçanti, Plani i Biznesit fokusohet në operimin dhe menaxhimin e Zonës A3, e përshkruar zakonisht si 'Zona Arkeologjike' (Figura 1).

Në këtë mënyrë, Plani i Biznesit duhet të jetë një model i drejtimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të siteve arkeologjike në Mesdheun Lindor dhe më gjerë. I parashtruar në partneritetet e fuqishme dhe efektive në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, ai do të synojë të vendosë standarde që do të ndiqen nga të tjerët në Shqipëri dhe gjetkë.

Si pjesë e tij, Butrinti duhet të aspirojë të shndërrohet në qendrën e ekselencës për trajnimin e drejtuesve dhe zhvillimin e komunitetit në çështjet e trashëgimisë dhe turizmit në Shqipëri dhe më gjerë. Për shembull, ai duhet të shndërrohet në qendrën e ofertës turistike në rajon, që do të përfshinte Sarandën, Gjirokastrën, Beratin dhe Epirin Grek. Në veçanti, grekët e shohin Butrintin si një magnet të fuqishëm për zhvillimin e turizmit në pjesën veriore të vendit të tyre.

Në këtë mënyrë, ky Plan Biznesi balancon kërkesat e konservimit me nevojën për të garantuar që ekonomia dhe banorët vendas të përfitojnë nga trashëgimia e tij unike, si historike edhe mjedisore, si vend i rëndësisë botërore.

Vetë statusi i Butrintit si Sit i Trashëgimisë Botërore do të përdoret për të mbështetur dhe përmirësuar mirëqenien e komunitetit vendor, nëpërmjet aktivitetit të mirëmenaxhuar të turizmit në sit dhe në prapatokën e tij.

Prandaj, objektivat parësore afatgjata të këtij Plani Biznesi janë:

1. Mbrojtja në vazhdimësi e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të vendit
2. Mundësimi dhe nxitja e aktiviteteve tërheqëse, konkurruese dhe të shumta për sitin dhe mjediset e tij përreth, të cilat janë në pajtim dhe nuk bien ndesh me sa më sipër
3. Menaxhimi dhe balancimi i përdorimeve dhe aktiviteteve të mundshme konfliktuale nëpërmjet vendimmarrjes, e cila i kushton rëndësinë më të madhe ruajtjes dhe mbrojtjes së sitit
4. Të qenit një forcë e zhvillimit të mirë në komunitetin vendas lidhur me mirëqenien dhe prosperitetin e tij afatgjatë, dhe marrja në konsideratë e opinioneve të shumta dhe të ndryshme të shprehura nga komuniteti
5. Njohja e faktit se nuk mund të imponohet një Plan Biznesi i qëndrueshëm dhe i suksesshëm; ai duhet të zhvillohet si rezultat i procesit të konsultimit dhe të mbështetet nga të gjitha palët e interesit

1.7 Mbulimi

Ky Plan Biznesi mbulon katër fusha kyçe:

1. Si do të qeveriset siti në periudhë afatgjatë: e shprehur nëpërmjet Fondacionit të ngritur, fushëveprimit të tij, aktiviteteve, anëtarësisë e kështu me radhë
2. Burimet financiare dhe të tjera (kapitali dhe të ardhurat) të nevojshme për zhvillimin e planit: duke përfshirë rekrutimin e stafit, menaxhimin ditor, kostot operacionale dhe kthimet
3. Mënyrat se si mund të përdoren pasuritë kulturore dhe natyrore të sitit në interesin më të mirë, duke ruajtur integritetin e tyre si burime të rëndësisë së njohur të jashtëzakonshme
4. Mënyrat se si Zona Buferike e sitit (në fakt i gjithë Parku Kombëtar i Butrintit) mund të vihet në dispozicion për investime nga palë të treta, sektori privat dhe palë të tjera për të mbështetur ekonominë vendase dhe punësimin, dhe për të ofruar përfitime shtesë në nivel vendor.

Kjo qasje kërkon përpunimin dhe nxjerrjen e të gjitha kontributeve dhe problematikave për hartimin e Planit të Biznesit.

Qasja është e dykahshme, si nga lart-poshtë, në kuptimin e njohjes së rrugëve më të rrahura dhe punës domethënëse të të tjerëve, duke përfshirë Fondacionin Butrinti, por po me aq rëndësi ka edhe qasja nga poshtë-lart, ku shumë banorë vendas, akademikë, arkeologë, vrojtues zogjsh, fermerë, peshkatarë,

tregtarë dhe të tjerë ndajnë këndvështrimet dhe opinionet e tyre për të ardhmen e Butrintit. Kjo qasje është rrënjosur në këtë punim.

1.8 Përvojat e shkuara dhe mësimet e nxjerra

Mënyra se si historia dhe arkeologjia shihen, komunikohen dhe mësohen janë pasqyrim thelbësor i mënyrës se si një komb e sheh veten, dhe se si popullsia lidhet me atë komb. Nëse arrijmë të kuptojmë se si një vend i përdor sitet e tij arkeologjike, atëherë do të kemi një udhëzues në lidhje me natyrën e vendit dhe aspiratat e popullit. Të dyja këto ndryshojnë në varësi të rrethanave politike.

Ky veçanërisht konteksti në Shqipëri, e rrjedhimisht në Butrint, sikundër e tregon historia e të qenit pjesë e Perandorisë Osmane (1479-1913), principatë dhe republikë (1914-1928), mbretëri (1928-1939), subjekt i pushtimit fashist (1939-1944), komunizëm (1944-1992) deri në një demokraci kapitaliste (1992 e në vijim).

Periudha midis luftërave

Historia e Butrintit si pasuri arkeologjike e menaxhuar fillon në vitet 1930. Misioni Arkeologjik Italian, në vitet ndërmjet luftërave, mori fonde për të investuar në sit si destinacion turistik. Kjo ishte qasje standarde, e ndjekur në shumë site arkeologjike dhe historike në Mesdheun e dominuar nga italianët, por pjesërisht ishte edhe justifikim për politikën e arkeologjisë gjeopolitike, që financohej kryesisht nga Ministria e Jashtme Italiane. Për rrjedhojë, u caktua një kujdestar dhe vizitorëve iu ofroheshin ture me anije ose nga ato anije që udhëtonin nga Korfuzi.

Midis viteve 1928 dhe 1936, arkeologu italian, Luigi Maria Ugolini, gërmoi në një pjesë të madhe të Zonës A3. Kjo për shkak të dëshirës së Musolinit për të shkrirë historinë e Italisë moderne me historinë e Romës perandorake, sikundër personifikohet me figura si Çezari dhe Augusti. Si rrjedhojë, puna e Ugolinit u përdor nga qeveria italiane për të promovuar rrënojat romake mbi ato helene[7], dhe u përdor gjerësisht për të justifikuar pushtimin italian të Shqipërisë në prill të vitit 1939: ajo që dikur ishte romake, tani është italiane.

Vitet1945-1992

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe largimit të forcave pushtuese, Shqipëria u zhvillua si një vend kryesisht Marksist-Leninist nën kontrollin e ish-udhëheqësit të luftës antifashiste, Enver Hoxha. Midis vitit 1945 dhe rënies së komunizmit në Shqipëri në vitin 1992, për Butrintin, bashkë me shumë site të tjera historike, arkeologë dhe historianë të arsimuar në Bashkimin Sovjetik bënë përpjekje për të treguar historinë se shqiptarët kishin jetuar dhe kishin mbrojtur tokën e tyre që nga kohët e lashta, si një mënyrë për të hedhur poshtë pretendimet nga vendet fqinje, si Greqia, Italia dhe (ish) Jugosllavia.

Në periudhën e pasluftës, Butrinti kishte nevojë për t'u rindërtuar, dhe sistemi italian u rivendos me efektshmëri. Në atë kohë, Butrinti mund të aksesohej nga uji, ndërsa nga toka, rruga ishte thjesht një shteg për mushkat dhe udhëtimi zgjaste tri orë nga Saranda. Në vitin 1952 u vendos një roje, i cili filloi të angazhonte grupe punëtorësh vendas për të pastruar bimësinë nga monumentet dhe për të sistemuar disi Kalanë në Akropol. Kjo punë praktikisht e restauroi pamjen italiane të sitit, sikundër qe parashtruar nga Ugolini dhe pasardhësit e tij, duke përfshirë të gjitha shtigjet nëpër pyll. Në vijim, ky sistem u vendos si itinerar standard për vizitorët, i cili ekziston edhe sot.

Vizita e Nikita Hrushovit në vitin 1959 u shoqërua me ndërtimin e rrugës së parë automobilistike që lidhte Sarandën dhe Qytetin Antik. Ajo mbeti rruga e vetme e aksesit deri në rindërtimin e saj në fund të viteve 1970, për arsye të vizitës së Enver Hoxhës. Kjo rrugë e ngushtë, me kthesa mbeti itinerari

[6] Hodges, R (2017) The Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the global heritage industry. Bloomsbury Academic, Londër. Në të vërtetë, puna e Ugolinit ishte thelbësore për krijimin e atraksionit të parë të trashëgimisë kulturore në Shqipëri.

kryesor i aksesit deri në vitin 2008, kur u ndërtua rruga e re, më e zgjeruar për të përballuar rritjen e madhe të volumit të trafikut, që në verë bëhet disa kilometra i gjatë.

Në vitet 1970, në Shqipëri filloi një nismë e re turistike, me shumë gjasa si rezultat i përkeqësimit të marrëdhënieve me Kinën (e angazhuar në shumë projekte infrastrukturore në vend asokohe, duke përfshirë edhe disa në Butrint), si dhe e nevojës për të gjetur burime të reja të ardhurash[8]. Kjo ishte periudha kur filluan të vinin vizitorë të huaj në Shqipëri gjatë sezonit zyrtar turistik, përkatësisht prill-tetor. Në atë kohë, turistët përzgjidheshin nëpërmjet operatorëve turistikë individualë të huaj, që vepronin si agjentë për organizatën *Albturist* me qendër në Tiranë dhe menaxhonin grupe të vogla të kontrolluara turistësh, dhe kontakti me shqiptarët ishte tejet i kufizuar. Krahas kësaj, filloi një projekt për ndërtim hotelesh, me rezultat ndërtimin e 11 hoteleve të reja për turistë, veçanërisht në Sarandë, ku për shembull, ngjitur me Hotelin e vjetër, Epirus Palace, u ngrit në mënyrë madhështore Hotel Butrinti, i cili u hap në vitin 1979.

Turistëve që vizitonin Butrintin përgjithësisht iu bënte përshtypje arkeologjia dhe mirëmenaxhimi i mjedisit rrethues. Në vitin 1978, u shtrua rruga nga Saranda dhe ferma shtetërore e frutave në Ksamil ishte plotësisht funksionale, sistemi i kullimit ofronte një peizazh të gjelbëruar dhe me lulëzim e me fruta të pjekura të stinës[9].

Turi në Butrint gjithnjë përfshinte një vizitë në muzeun e Kalasë së Akropolit. Fillimisht i rikonstruktuar nga italianët, ku në vitin 1940 kishte një oborr me skulptura dhe mozaikë dhe një dhomë e vogël me hapësira me objekte më të vogla. Hyrja për te muzeu kalonte direkt përmes portës së madhe veriperëndimore të kalasë. Muzeu u ri-hap zyrtarisht në vitin 1950, duke përfshirë oborrin dhe një pjesë të kullës.

Butrinti në vitin 1993

Me rënien e komunizmit në vitin 1992, për herë të parë në periudhën moderne, Butrinti u prek nga ndikimet perëndimore, duke përfshirë qasje ndaj arkeologjisë dhe konservimit.

Kur Fondacioni Butrinti filloi veprimtarinë e tij në vitin 1993, zon aishte një peizazh 'homerik' i pazhvilluar. Rruga nga Ksamili për në Sarandë nuk ishte ndërtuar ende deri tek hotel Butrinti. Në Butrint, nga kanali i Vivarit një lundër e vogël ndiqte itinerarin, me një kapacitet shumë më të vogël sesa ai i lundrës së sotme.

Asokohe, në sit ekzistonin dy lokale të vogla. Njëri gjendej në anë të Hotelit Livia që ndodhet sot dhe ishte një restorant i ndërtuar në anë të rrugës që do të përshkonin turistët gjatë viteve 1980. Tavolinat prej betoni mund të shihen ende. Një barakë dhe një kafene e vogël gjendeshin jashtë portës kryesore, poshtë zonës tashmë të rezervuar për vendparkim. Rrënojat e skelës mund të shihen edhe sot.

Elementi fizik më i dallueshëm kur i afroheshe hyrjes së sitit ishte gardhi prej betoni dhe porta që tregonin zonën e brendshme të ruajtur të sitit. Natyrisht, Butrinti i lashtë shtrihej përtej këtij kufiri, por ky gardh kishte pasur një ndikim, dhe ende ndikon fort në interpretimin e asaj çfarë përfaqësonte Butrintin, dhe në shumë mënyra ishte edhe metaforë për të gjitha vështirësitë që do të ndikonin përpjekjet për të krijuar një infrastrukturë moderne në mbarë Parkun.

Periudha e Fondacionit Butrinti

Objektivat e Fondacionit Butrinti ishin:

1. Realizimi i një hulumtimi arkeologjik interesant, novator dhe modern

[8] Hall (1984) *Albania and the Albanians*
[9] Dawson (1989) *Albania: Guide and Illustrated Journal*

2. Trajnimi i arkeologëve shqiptarë mbi teknikat arkeologjike moderne
3. Asistencë për konservimin e monumenteve të sitit
4. Asistencë për ngritjen dhe zhvillimin e një parku arkeologjik me një strukturë të modeluar sipas shembujve perëndimorë të kohës, që të vepronte si shtysë e rigjenerimit ekonomik vendas dhe model për zhvillime të ngjashme në vende të tjera.

Që në fillimet e veta, Fondacioni provoi të sillte ide dhe koncepte të reja në Shqipëri. Një nga qëllimet kryesore ishte zhvillimi i një projekti model madhor, që merrte përsipër përgjegjësinë e realizimit të projekteve kërkimore në fushat e konservimit, interpretimit dhe prezantimit. Burimet e disponueshme mundësonin qasjen me një *mënyrë* të caktuar për arritjen e këtij qëllimi. Megjithatë, drejtimi i veprimtarisë ishte hedhja poshtë e modelit të "gërmimit dhe lënies", që shpeshherë është një nga kritikat më të mëdha për ndërhyrjet arkeologjike të huaja në Mesdhe dhe gjetkë.

Pavarësisht qasjes pozitive dhe të përparuar, vitet e para të projektit të Fondacionit Butrinti u karakterizuan nga tensione midis Fondacionit dhe autoriteteve përgjegjëse vendase. Kjo ndodhi kryesisht me Institutin e Arkeologjisë, që asokohe ishte një organ kërkimor i pavarur, përgjegjës për arkeologjinë e nëndheshme. Ndërsa, monumentet ishin nën mbrojtjen e Institutit të Monumenteve Kulturore, në varësi të Ministrisë së Kulturës, dhe pylli menaxhohej nga Ministria e Mjedisit. Burimi i këtij tensioni ishte qasja kryesisht britanike e Fondacionit ndaj gërmimit, regjistrimit dhe konservimit që binin ndesh me atë shqiptare. Kjo nuk ishte befasuese, duke marrë parasysh metodën e izoluar me të cilën ishin aplikuar qasjet shqiptare ndaj arkeologjisë gjatë pesëdhjetë viteve të komunizmit. Përpos këtyre, tensioni lindi edhe së brendshmi, midis ministrive dhe drejtorive përgjegjëse në Shqipëri.

Megjithatë, marrëveshja e veçantë e bashkëpunimit anglo-shqiptar dha më në fund frytet e veta. Të dyja palët mësuan nga ky proces, dhe Fondacioni kuptoi se modeli perëndimor i zhvillimit dhe menaxhimit i orientuar nuk mund të përcillej pa modifikime[10]. Pikëpamja shqiptare për Butrintin dhe mjedisin dhe arkeologjinë e tij kishte baza të forta, ndërsa qasja britanike mund të konsiderohej se ishte tepër e fokusuar dhe specifike.

Shkurtimisht, Fondacioni Butrinti në një farë mënyre ra viktimë e paradoksit të përhershëm të projekteve të ndihmës: 'ku dëshira për të ndihmuar kthehet në nevojë për të kontrolluar'[11]. Përpjekja e Fondacionit për ngritjen e një strukture perëndimore mbi një mjedis të huaj do të haste padyshim pengesa. Projekti arriti ta realizonte premtimin e tij vetëm në fillim të shekullit 21 kur e kishte marrë këtë mësim.

Nuk ka shumë dyshime se në disa aspekte, projekti Fondacioni Butrinti qe i suksesshëm, pasi solli ide dhe koncepte të reja, që u pranuan në shkallë kombëtare, si dhe i bëri "vend" vetës me anë të punës kërkimore dhe asaj në terren[12].

Fakti se ekzistojnë të dhëna rreth Parkut Kombëtar të Butrintit është pjesërisht rezultat i drejtpërdrejtë i punës së Fondacionit. Me kalimin e viteve u krijua një arkivi madh, i cili është i disponueshëm në formën e botimeve, por edhe në formën e bazës së të dhënave, dhe mbulon shumë aspekte shkencore, duke filluar nga menaxhimi i ujit, jeta e egër, teknikat bujqësore, arkeologjia e deri te menaxhimi i vizitorëve. Për shembull, Fondacioni Butrinti ishte përgjegjës për kryerjen e një sërë ndërhyrjesh të regjistruara, cilësore dhe parimore, në të cilat mbështetet edhe ky Plan i Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar.

[10] Ky proces përfundoi duke u përqendruar në parimet më themelore, të cilat në Evropën Perëndimore do të ishin parë si të pavlera, por në kontekstin e Shqipërisë së asaj periudhe ishin ideale.

[11] Maren (2002) *The Road to Hell: The Ravaging Effects of Foreign Aid Projects*

[12] Hodges 2016 *The Archaeology of Mediterranean Placemaking*. Bloomsbury Academic.

Megjithatë, Fondacioni nuk ishte përgjegjës vetëm për punimet arkeologjike, por shqyrtoi dhe zbatoi një sërë programesh, trajnimesh dhe mundësish edukimi për mbarë Parkun Kombëtar. Këto mbeten shumë të rëndësishme edhe sot e kësaj dite.

Mësimet e nxjerra

Përvoja e Fondacionit Butrinti solli një sërë mësimesh të rëndësishme. Këto mësime mund të përmblidhen në katër fusha themelore, të renditura më poshtë sipas rëndësisë përkatëse.

1 Angazhimi i komunitetit

Dështimi kryesor i projektit të Fondacionit Butrinti ishte mungesa e integrimit me komunitetin. Në teori, qasja ndiqte rrjedhën nga poshtë-lart, por si pasojë e burokracive në të shkuarën, në praktikë interesat e autoriteteve të centralizuara shkonin përtej opinionit të vendasve. Gjatë hartimit të planit të parë të menaxhimit (2001-2005) për Butrintin, u mbajtën një sërë workshop-esh me palë vendore interesi.

Përgjithësisht, palët e vërteta të interesit nuk përfaqësoheshin plotësisht dhe shqetësimet e tyre pragmatiste dhe të ngutshme nuk adresoheshin asnjëherë[13]. Ndaj, ata nuk e kishin mundësinë të vilnin frytet nga ekzistenca e planit ose e Parkut.

Kjo çështje mbetet thelbësore për hartimin e strategjive mbi adresimin e rritjes së numrit të vizitorëve në Butrint. Tërheqja e vizitorëve në zonën më të gjerë të Parkut mund të realizohet vetëm në bashkëpunim me komunitetin.

Ndaj, thelbësor për suksesin e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit është komunikimi më i mirë me komunitetin. Duhet të ofrohen zgjidhje në nivel vendor, dhe jo të krijohen probleme, sidomos në kuptimin e hierarkikës së marrëdhënies. Për këtë qëllim, mund të nevojitet të bëhen kompromise, veçanërisht për të adresuar shqetësimet e mundshme të UNESCO-s, dhe sigurisht për të përmbushur nevojat e konservimit të arkeologjisë, të Qytetit Antik, të mbarë Parkut, si dhe të komunitetit vendas.

Angazhimi më proaktiv dhe efikase i komuniteteve vendase është një karakteristikë që duhet të ishte prioritizuar në planin fillestar të menaxhimit, si dhe nga stafi i parkut, të cilët nuk ishin të trajnuar për rolin e tyre. Një sërë takimesh të rregullta në fshatrat përreth me stafin e parkut dhe përfaqësues të institucioneve në Tiranë do të kishin krijuar ura komunikimi.

2 Trajnimi

Natyrisht, trajnimi i duhur dhe intensiv ka rëndësi madhore edhe për të gjithë stafin e parkut. Problemi më i madh që u konstatua në vitet 1990 ishte mungesa e përvojës, proaktivitetit, si dhe mendësisë së përbashkët nga i gjithë stafi i parkut. Ndonëse mund të jetë problematikë sistemike, ajo duhet të luftohet në të gjitha aspektet. Problemet nuk lindin vetëm kur merren vendime madhore, por janë të dukshme edhe në nivelet më të ulëta të vendimmarrjes, që vihet re nga shmangia e përgjegjësive dhe mbështetja tek autoriteti i centralizuar.

Regjimi i duhur për trajnimin mund të ndihmojë në luftimin e pasivitetit, dhe të gjithë punonjësit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit do të duhet ta plotësojnë këtë kusht për t'u punësuar. Trajnimi teknik do të rrisë nivelet e vetëbesimit. Dhënia e përgjegjësisë për vendimmarrje, veçanërisht në lidhje

[13]Natyrisht që ky është problem i përgjithshëm në mbarë botën kur merren parasysh organet ndërkombëtare, si parqet dhe rezervatet https://www.theguardian.com/environment/2009/apr/08/south-downs-national-park. Ndonëse njihen gjerësisht, këto problematika rrallëherë adresohen.

me shpenzimet për financimin e projektit, me mbështetjen e një ekipi të fuqishëm menaxhimi do të garantojë aftësinë për të kuptuar dhe për të realizuar menaxhimin e duhur.

Skema e mentorimit do ta plotësojë më së miri trajnimin bazë, e nevojshme gjatë periudhës tranzitore. Në këtë rast specialistët e huaj, të kontraktuar sipas nevojave, mund të ofrojnë përvojë dhe mbikëqyrje. Rreziku që duhet shmangur është të mbështetemi verbërisht të ndihma nga jashtë, në një kontekst ku e gjithë struktura e menaxhimit duhet të përbëhet nga shqiptarë, që punojnë dhe zhvillohen brenda një paradigme që e kanë ndërtuar vetë.

3 Konservimi

Struktura disi e paqartë e menaxhimit fillestar të Parkut ka qenë objekt diskutimi. Pavarësisht kësaj, ose mbase për shkak të saj, ndërhyrjet konservuese dhe restauruese nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit kanë qenë në një nivel minimal dhe këto ndërhyrje të lehta përfshinin menaxhimin e pyjeve dhe konservimin e disa ndërtesave. Projekte madhore të mëparshme kanë rindërtuar një pjesë të "*scenae frons*" (ndërtesë për skenën) të teatrit dhe Portën e Luanit, në vitet 1960 dhe 1970.

Këto punime kanë kërkuar ndërhyrje të mëdha inxhinierike, dhe gjatë kohës së Fondacionit Butrinti, është ushtruar trysni nga ana e qeverisë për të ndërmarrë projekte, veçanërisht në lidhje me konsolidimin e murit rrethues të qytetit, që ose ishin të panevojshme ose shumë të rënda. Ky ka qenë pjesërisht rezultat i disponueshmërisë së fondeve, ndaj Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit duhet të tregohet i kujdesshëm në këtë aspekt. Krahas kësaj, projektet kishin tendencën të trajtonin probleme të dukshme dhe me pak rëndësi (restaurimi i afreskut dhe elementeve të ngjashme), dhe shpërfillnin problemet e mëdha, si konsolidimi i murit rrethues të qytetit.

Tashmë është fare e qartë se qasja e "kujdesshme dhe minimale është e duhura për mirëmbajtjen e Qytetit Antik të Butrintit dhe monumenteve të tjera të shpërndara në Park. Por kjo nuk duhet të përbëjë pengesë për të ndërmarrë ndërhyrje të qëndrueshme në dy fusha:

1. Zona pyjore kërkon menaxhim proaktiv dhe të konsoliduar. Është e thjeshtë të hamendësohet se "pylli magjik" nuk duhet prekur, por sikundër tregon sëmundja e elmit holandez në Mbretërinë e Bashkuar dhe gjetkë, ajo mund të jetë po aq e dëmshme sa menaxhimi i tepërt. Pastrimi i rregullt i barit dhe shkurreve, mbajtja pastër e zonës rreth monumenteve dhe rritja e pyllit me një kurorë, kërkojnë veprime pozitive.
2. Ndonëse shumica e monumenteve brenda Zonës A3 kërkojnë pastrim bazë dhe konsolidimin e përshtatshëm, ekzistojnë disa probleme që kanë kosto të konsiderueshme dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

4 Kërkimi

Butrinti është një sit që ofron mundësi shumëdisiplinore. Për disa nga kërkimet kërkohen ndërhyrje minimale, ndërsa për disa të tjera kërkohen ndërhyrje më të thella.

Qasja perëndimore është në mbështetje të ndërhyrjeve minimaliste, dhe veçanërisht në fushën e arkeologjisë, është mbajtur një qëndrim që kundërshton çdo lloj ndërhyrjeje e cila nuk është e nevojshme për të shpëtuar objektin, pra ndërtesat dhe punimet e tjera zhvillimore. Megjithatë, ky skenar është i panjohur në traditën arkeologjike të Mesdheut.

Veçantia e Butrintit nuk është vetëm falë ndërthurjes së mjediseve njerëzore dhe natyrore ose vendndodhjes topografike, ndonëse këto janë elemente kyçe, por falë faktit që është vend ku ka shumë për të zbuluar, një qendër magjie që ngjall interes dhe ngre pyetje. Ky është element jetik i siteve të këtilla, pasi ato që zbulohen mund të transmetohen, duke e pasqyruar atë dhe duke ngjallur interesin

e publikut. Ndonëse të vogla, dhe siç rezultoi të gabuara, zbulimet nxisin shkrimin e artikujve për Sitin e Trashëgimisë Botërore[14].

Prandaj, rëndësia e Grupit Kërkimor të Butrintit dhe e veprimtarive të tij duhet të shihet si pjesë e pandashme e motorit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, që duhet të ketë një interes proaktiv për funksionimin, veprimtaritë, nxitjen e risive, projekteve të vyera dhe promovuese, si dhe bashkëpunimit në nivelin botëror.

Implikime më të gjera

Plani për Menaxhimin e Butrintit i viteve 2001-2005[15]parashikonte hartimin e një udhërrëfyesi për Butrintin. Përfundimet e tij kyçe ende vlejnë sot:

> *... zbatimi është kyç. Menaxhimi i Parkut Kombëtar të Butrintit duhet të ketë në dispozicion burimet dhe instrumentet ligjore për të përmbushur detyrat thelbësore. Këto detyra përfshijnë konservimin dhe përmirësimin e sitit të Butrintit, në mënyrë që të mbetet pjesë jetike e trashëgimisë së Shqipërisë dhe njëkohësisht të kthehet në burim për rigjenerimin ekonomik të rajonit.*

Parimet e konservimit, përmirësimit dhe zhvillimit të burimeve njihen dhe janë aplikuar tërësisht në këtë Plan Biznesi, dhe të gjitha ofrojnë bazën për zbatim të efektshëm.

Problematika me Butrintin nuk qëndron te mungesa e ideve parimore, pasi thuajse çdo material akademik apo raport i referohet atij, por është mungesa e menaxhimit të efektshëm, për t'i mundësuar Sitit dhe mbarë Parkut Kombëtar të funksionojë në mënyrë të efektshme dhe efikase.

Ky konstatim nuk është pasqyrim i punës së stafit, pasi të gjithë punonjësit dëshirojnë më të mirën për të. Siç e pohon edhe Hodges[16], ky është një reflektim i përgjegjësive të paqarta, mbase të nënfinancuara, por në thelb të mbivendosura të agjencive të përfshira në mirëqenien afatgjatë të Sitit, shoqëruar kjo me paqartësinë e përgjegjësive për mbikëqyrjen e Qytetit Antik dhe mbarë Parkut Kombëtar.

Idetë dhe nismat dashamirëse të ndërmarra nga Fondacioni Butrinti në vitin 1993 (dhe veçanërisht midis viteve 2000 dhe 2012) janë penguar nga mungesa e drejtimit të qartë dhe të përqendruar, dhe mbi të gjitha, nga mungesa e mekanizmave për ndërmarrjen dhe vijueshmërinë e ndërhyrjeve në mbarë Parkun, si në nivel kombëtar ashtu edhe atë vendor. Ndaj, problematika nuk lidhet me mungesën e ideve apo të vullnetit, por me menaxhimin dhe realizimin.

Sipas Hodges[17], dhe mbështetur në përvojën e tij të drejtpërdrejtë thuajse tridhjetë vjeçare me Zonën A3, Parkun Kombëtar dhe Shqipërinë, mësimet e nxjerra që duhen marrë parasysh në lidhje me qëndrueshmërinë janë si vijon:

1. Nevoja për një gjuhë të përbashkët dhe konsistente lidhur me konceptet e përbashkëta për konservimin e vendeve kulturore dhe natyrore, në mbarë vendin

[14] Një shembull është Guri i shahut, i gjetur në Butrint http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/2155916.stm

[15] Martin S (2001) Plani i Menaxhimit të Butrintit. Fondacioni Butrinti.

[16]Hodges, R (2017) The Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the global heritage industry. Bloomsbury Academic, Londër.

[17]Hodges, R (2017) The Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the global heritage industry. Bloomsbury Academic, Londër, duke përdorur punën e Linn J (2014): Koment: koncepte mbi arkeologjinë dhe zhvillimin ekonomik; Arkeologji Publike, 13: 85-90.

2. Njohja e implikimeve ekonomike [dhe sociale] të punës nga ana e arkeologëve [dhe specialistëve të tjerë]
3. Njohja e rolit të rëndësishëm që luajnë vlerat joekonomike në konservimin e pasurive kulturore [dhe natyrore], si dhe përshtatshmërisë së tyre afatgjatë në të mirë të njerëzimit
4. Nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj [realizimit] të të gjitha planeve të menaxhimit
5. Drejtuesit duhet të punojnë me efektshmëri në të gjitha nivelet, duke ofruar mundësi për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha aspektet e menaxhimit të trashëgimisë kulturore [dhe natyrore]
6. Krijimi dhe promovimi i markës [Butrinti] tek audienca të ndryshme [si brenda dhe jashtë sitit]
7. Investimi në mbështetje teknike që nevojitet për të realizuar [dhe vijuar me] raportim të saktë të elementeve arkeologjike [dhe natyrore] të Parkut
8. Investimi në konservimin me praktikat më të mira, duke përfshirë kthimin në gjendjen e mëparshme
9. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve në të gjitha aspektet e menaxhimit të trashëgimisë, duke përfshirë reklamimin, interpretimin, kërkimin e granteve dhe pjesëmarrjen e komunitetit.

Këto nuk janë thjesht mendime me vlerë: realizimi i tyre nëpërmjet këtij Plani Biznesi, së bashku me Planin e Menaxhimit të Integruar është jetësor për të garantuar mirëqenien e Zonës A3 dhe mbarë Parkut Kombëtar në planin afatgjatë.

Kur Hodges shkruante librin e tij, para tre apo katër vitesh, ende nuk kish lindur ideja që Shteti t'i kalonte menaxhimin e Zonës Arkeologjike A3 një Fondacioni të ri të sponsorizuar nga AADF-ja. Idetë e tij, që bazohen në përvojën e punës me Fondacionin "Butrinti" dhe agjencitë e qeverisë qendrore, kishin nevojë për një vend ku mund të mblidheshin, të riformoheshin dhe të ndërthureshin me mbështetje të fortë financiare dhe vendosmëri të përkushtuar drejt suksesit.

Tri parimet më të rëndësishme që rrjedhin nga kjo analizë janë:

1. Qëllimi kryesor duhet të jetë kryerja e ndërhyrjeve të lehta dhe ndjekja e qasjeve të kthyeshme të konservimit, që në çdo rast ruajnë identitetin e vendit përgjatë Zonës A3 dhe mbarë Parkut Kombëtar
2. Nxitja dhe mirëmbajtja e programeve të trajnimit për të gjitha veprimtaritë në lidhje me sitin, pa përjashtuar menaxhimin e trashëgimisë, reklamimin, interpretimin, kërkesa për grante, pjesëmarrjen e komunitetit dhe punimet për konservimin
3. Njohja e dobisë dhe vlerës së komuniteteve vendase në realizimin e synimeve të Parkut në planin afatgjatë. Mbështetja e tyre është jetike.

Mirëqenia e ardhshme e Parkut dhe e njerëzve që jetojnë aty dhe rreth tij janë të ndërlidhura: Parku ka nevojë për mbështetjen e të gjitha palëve për të lulëzuar, dhe nga ana tjetër, njerëzit duhet të përfitojnë nga zhvillimet në Park, të cilat duhet të jenë të dukshme.

1.9 Qasjet evoluese

Menaxhimi i trashëgimisë kulturore dhe siteve arkeologjike, si dhe mënyra si ato i prezantohen publikut, veçanërisht për Sitet e Trashëgimisë Botërore ka pësuar shumë ndryshime gjatë dy dekadave të fundit.

Nga një qasje kryesisht e orientuar nga konservimi ka ndryshuar në një qasje ku vlerat e shoqëruara me peizazhin, historinë kulturore, trashëgiminë jomateriale dhe jehonën vendase luajnë që të gjitha një rol në kontekstin e gjerë të çështjeve mjedisore dhe kuadrot planifikuese. Këto ndryshime kanë mundësuar krijimin e një grupi përfituesish dhe palësh interesi më të gjerë dhe më pak homogjen.

Për herë të parë, ndikimet në popullsinë vendase konsiderohen me të drejtë po aq të rëndësishme sa edhe ndikimet në vetë sitin historik.

Të gjitha planet e menaxhimit dhe biznesit kanë nevojë për orientim dhe mbështetje, për financime dhe elemente të tjera, dhe mënyra e zotërimit dhe realizimit është mjeti kryesor për garantimin e zbatimit dhe vijimësisë së këtyre planeve në terma afatgjatë. Prandaj, një integrimi tillë është një aspekt kyç i propozimeve për Butrintin.

Duke marrë parasysh sa më sipër, lind nevoja për një strukturë të re drejtimi dhe menaxhimi, të mbështetur nga rojtarë të sitit, ambientalistë dhe specialistë të komunitetit. Të gjithë këta persona janë në dispozicion dhe shumë prej tyre kanë dëshirë të angazhohen.

Edhe marrëveshjet e reja ndërmjet Fondacionit të Ri dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura kanë të njëjtën rëndësi; Butrinti mundet dhe duhet të jetë modeli që do të frymëzojë projekte të tjera të ngjashme. Ky duhet të jetë qëllimi dhe trashëgimia e tij për brezat e ardhshëm. Për ta siguruar një gjë të tillë, qeveria ka miratuar legjislacionin kombëtar përkatës.

1.10 Filozofia e zhvillimit

Qasja e ndjekur nga Fondacioni Butrinti për mirëmbajtjen dhe mbështetjen afatgjatë të sitit ka garantuar që "identiteti i vendit" *të shihet si përparësi absolute*.

Kjo qasje përshkruhet më në hollësi në librin e Richard Hodges,*The Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the Global Heritage Industry*[18]. Si Drejtori Shkencor i Fondacionit "Butrinti" ndërmjet viteve 1993 dhe 2012, idetë e tij kanë qenë udhëheqëse në përcaktimin e qasjes për menaxhimin dhe zhvillimin e sitit dhe si rrjedhojë dhe këtij Plani Biznesi.

Qasja e rekomanduar për të gjitha punimet (nga konservimi, te rinovimi e deri te ndërtimi nga e para) është një qasje minimale, me ndërhyrje të vogla në strukturë, dhe duke respektuar kuptimin e vendit. Çfarëdo lloj qasje tjetër jo vetëm që do të cenonte punën e shkëlqyer dhe novatore të Fondacionit Butrinti, por do të ishte një akt i papërligjshëm ndaj vetë strukturës dhe mirëqenies së një prej siteve më të rëndësishme historike në Mesdheun Lindor.

Ekzistojnë shumë shembuj të 'restaurimeve' dashamirëse, por tërësisht të papërshtatshme brenda dhe përreth siteve antike, qoftë në Mesdhe apo gjetkë. Dallimi kryesor qëndron në faktin që *konservimi* mbron strukturën e sitit për të mundësuar brezat e ardhshëm të shqyrtojnë çdo fazë të zhvillimit të një siti, ndërsa *restaurimi* e fikson monumentin në një datë të supozuar në të kaluarën, duke mos lejuar kërkimet dhe vrojtimet në të ardhmen. Fatkeqësisht, një rast i tillë ekziston në Butrint që nga fundi i vitit 2018. Ndërhyrje të tilla duhet të shmangen në të ardhmen.

Pikërisht duke theksuar këtë filozofi, Butrinti jo vetëm që duhet të dallohet, por edhe të shërbejë si model për site të tjera të ngjashme. Ai duhet të ruajë integritetin e vendit, të jetë burim informacioni për brezat e rinj, të angazhojë komunitetin vendas dhe duke vepruar kështu të ruajë atë ndërthurje të mrekullueshme të vendit antik me peizazhin modern që na pasurojnë të gjithë ne.

1.11 Parimet e planifikimit të punës

Më poshtë parashtrohet një analizë e problematikave që aktualisht po has Zona Arkeologjike A3, shoqëruar me implikimet lidhur me veprimtaritë që nevojiten dhe ndërhyrjet e kërkuara, të cilat të

[18]Hodges, R (2017) *The Archaeology of Mediterranean Placemaking*, Bloomsbury Academic, London

gjitha së bashku kanë një ndikim në mirëqenien financiare të sitit në terma afatgjatë, dhe adresohen në këtë Plan Biznesi. Këto problematika mund të grupohen në gjashtë lloje:

1. Drejtimi, menaxhimi i sitit dhe stafi
2. Vizitat, menaxhimi i vizitorëve dhe përvoja e vizitorëve
3. Konservimi dhe veprimtaritë parandaluese të mirëmbajtjes si për rrënojat arkeologjike ashtu edhe për sistemet natyrore që bashkekzistojnë me to
4. Zhvillimet dhe ndërhyrjet fizike që nevojiten për të garantuar mirëqenien afatgjatë të sitit
5. Përfitimet për komunitetin vendas në drejtim të mundësive ekonomike dhe tregtare
6. Vlerësime financiare dhe planifikimi financiar.



Figura 2: Analizë e problematikave

1.12 Pronësia mbi tokën, mbledhja, ofrimi dhe shërbimi

Ishte e nevojshme që në këtë Plan Biznesi të ngriheshin disa supozime në lidhje me disa problematika, ndër të cilat përfshihet edhe pronësia mbi tokën dhe aftësia e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, nëpërmjet AADF-së dhe Ministrisë së Kulturës, për të hedhur bazat e një plani (biznesi) zhvillimi, nëpërmjet marrjes së titujve së pronësisë mbi tokën.

Supozohet se të gjitha problematikat me pronësinë e tokës do të sheshohen nga vetë Ministria e Kulturës, me kostot e saj. Këto kosto paraqiten në Planin e Biznesit, me përjashtim të kostove ligjore në lidhje me mosmarrëveshje të mundshme mbi shpronësimin.

Por, ekziston një çështje tjetër,mjaft e rëndësishme, e cila duhet adresuar.

Aktualisht Zona A3 përfiton shërbime të dobëta. Për shembull, ajo mbështetet tek ujërat e ëmbla nga rrjeti i Hotel Livias, që ndodhet në afërsi (për të cilin paguan një shumë vjetore nominale) dhe përdor ujë të njelmët për tualetin, etj. Krahas kësaj, furnizimi me energji elektrike në Zonën A3 është i dobët.

Siti ka edhe lidhje interneti të paqëndrueshme saqë ndonjëherë stafi përdor lidhjen e internetit të Hotel Livias, edhe pse është kryer lidhja me fibra optike nga Ksamili.

Për më tepër, mbështetur në të dhënat dhe vëzhgimet e fundit, nuk ofrohet asnjë shërbim në sitin e propozuar për qendrën e re të vizitorëve.

Është e qartë se për menaxhimin e sitit me efektshmëri nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit , nevojitet lidhja e sitit me shërbimet kryesore (ujë, energji elektrike, kanalizime, internet) të siguruara nga qeveria shqiptare nëpërmjet institucioneve përgjegjëse përkatëse.

Këto shuma janë publikuar por nuk përfshihen në modelin financiar. Natyrisht që kërkohen diskutime të hollësishme me qeverinë, pasi shërbejnë për ndryshimin ose për përshtatjen e rrugës hyrëse nga Ksamili, në mënyrë që Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit të marrë përsipër menaxhimin e sitit (pra, të Zonës A3) në një gjendje që përmbush qëllimin për ta menaxhuar si një atraksion për vizitorët ndërkombëtarë dhe si një Sit të Trashëgimisë Botërore.

1.13 Situata aktuale

Si atraksion për vizitorët dhe falë përzierjes së pasurive arkeologjike dhe ekologjike, çka njihet në arenën ndërkombëtare, Butrinti e ka vendin e tij në spektrin e gjerë të destinacioneve ekoturistike, një nga përkufizimet e të cilave është "praktika e udhëtimit me ndikim të ulët dhe ndjeshmëri ndaj kulturës, ekologjisë, edukimit, në përfitim të komuniteteve vendase dhe vendeve pritëse"[19].

Ekoturizmi është shndërruar në një nga sektorët me rritjen më të shpejtë në industrinë e turizmit, me rritje vjetore prej 15–20% në mbarë botën deri sa ky progres u frenua nga Covid-19. Me shumë gjasa rritja do të rikthehet në ato nivele pasi pandemia të vihet nën kontroll, mundësisht brenda pesë viteve, për shkak të kërkesës së natyrshme[20].

Ndonëse, pa dyshim që në Butrint aspirohet kjo ofertë turistike për vizitorët, aktualisht një nga kërcënimet kryesore të ruajtjes së monumentit dhe mjedisit të Zonës Buferike dhe mbarë Parkut Kombëtar janë vetë vizitorët.

Mbështetur në biletat e shitura gjatë vitit 2019, Qytetin Antik e kanë vizituar rreth 236,000 persona. Mbipopullimi është një problematikë serioze për menaxhimin gjatë muajve të verës, përkatësisht në korrik, gusht, dhe shtator, që ndikon si në cilësinë e përvojës së vizitorëve ashtu edhe në gjendjen e rrënojave arkeologjike. Ky plan i përditësuar biznesi (shihni Seksionin 3) ka marrë parasysh efektet e Covid-19 duke hamendësuar se kur mund të rikuperohen këto shifra vizitorësh.

Megjithëse fushëveprimi i Planit të Biznesit kufizohet në Zonën A3, është e qartë se duhen marrë parasysh edhe ndërhyrjet jashtë kësaj zone që kanë ndikim mbi Zonën A3. Megjithatë, duhet nënvizuar se kufijtë aktualë të Zonës duhet të ripërcaktohen për të përfshirë informacionet e vrojtimit të fundit dhe për të përfaqësuar më saktë përgjegjësitë e synuara të menaxhimit. Informacioni i përftuar nga hartat dixhitale me referencë GIS i është paraqitur AADF-së si pjesë e procesit të planit të biznesit.

Sitet kyçe paraqiten në skemën e mëposhtme.

Aktualisht, shumica dërrmuese e turistëve ndërkombëtarë (numri i të cilëve që prej vitit 2014 është më i lartë sesa ai i vizitorëve vendas,si segmenti më i gjerë i tregut) transportohen nga Saranda në Butrint nga operatorët turistikë me autobusë (me 55 vende), që shpeshherë e kalojnë me vështirësi rrugën me kthesa pranë hyrjes së sitit, pranë vendkalimit të lundrës.

[19]Burimi: Honey M (1999) Ecotourism and Sustainable Development: Who Owns Paradise? Island Press.

[20]Është e qartë se shumë vende po gjejnë mënyra të ndryshme për të jetuar me Covid-19 në të ardhmen . (https://www.ibm.com/downloads/cas/M1JGA6ZD)



Figura 3: Skema e siteve kryesore të adresuara në Planin e Biznesit

Kufizimet ekzistuese që nuk i lejojnë autobusët të shkojnë më larg se vendparkimi i Hotel Livias shpeshherë shpërfillen, me qëllim që turistët të arrijnë menjëherë te porta e hyrjes përpara operatorëve të tjerë turistikë. Këta vizitorë mbase kalojnë 1-2 orë rreth rrënojave kryesore arkeologjike dhe më pas drejtohen për të drekuar te një restorant jashtë sitit. Përgjithësisht, atraksionet e Parkut Kombëtar shpërfillen ose anashkalohen nga operatorët turistikë, duke shpjerë drejt nënvlerësimit të ndjeshëm të turizmit të mundshëm të ecjes, vrojtimit të zogjve,çiklizmit dhe të tjera. Krahas kësaj, minimizohet edhe përfitimi i komuniteteve vendase, përveç rastit të një dyqani të vogël artizanësh në hyrje të sitit për të cilin i paguajnë Ministrisë së Kulturës një qira vjetore dhe taksat kombëtare dhe vendore.

Rruga hyrëse e re nga Ksamili për në lundrën në Kanalin e Vivarit në hyrjen aktuale të Sitit ka çuar në rritjen e trafikut të automjeteve nga dhe drejt fshatrave të Fushës së Vrinës. Kjo ka sjellë ngjeshje, ndotje akustike dhe atmosferike në hyrje, si dhe shqetësime të tjera në lidhje me shëndetin dhe sigurinë.

Për t'i adresuar këto problematika, rekomandohet që autobusët dhe makinat e vizitorëve të parkohen në vendparkimin ekzistues në krye të rrëpirës, rreth 1.5 km nga hyrja e Zonës Arkeologjike. Kjo vendndodhje ofron pamje panoramike nga fusha e Vrinës deri te kalaja e Ali Pashës në grykën e kanalit të Vivarit në perëndim dhe nga Qyteti Antik, në monumentin e Sitit të Trashëgimisë Botërore në lindje. Një qendër e re vizitorësh do të ofronte një sens të qartë të mbërritjes dhe mikpritjes në mjedisin për orientimin e vizitorëve, shitjen e biletave, interpretimin, pijet freskuese dhe shitjet.

Veç këtyre, do të zgjerohej oferta turistike e Parkut Kombëtar që aktualisht nuk po e realizon potencialin e plotë si destinacion për vizitorët.

Kjo qendër vizitorësh e re do të ofronte alternativën për të zbritur kodrën përgjatë trotuarit ekzistues të mbrojtur drejt hyrjes së sitit ose për t'u transportuar në çfarëdolloj drejtimi me anë të automjeteve "të gjelbra".

Problematika e banorëve vendas që përdorin lundrën për të hyrë në fshatrat e fushës së Vrinës duhet të merret parasysh dhe të adresohet me kushtin që aksesi duhet të vazhdojë, ndonëse qarkullimi

nërrugën që do lidhë qendrën e vizitorëve me hyrjen kryesore duhet të jetë i "qetë"për të zvogëluar problemet e mundshme kur vendasit dhe mijëra turistë janë në të njëjtën hapësirë.

Përcaktimi i orareve specifike të hyrjes *mund* të jetë i nevojshëm për të rregulluar fluksin e vizitorëve drejt dhe brenda Zonës Arkeologjike gjatë pikut, dhe si rrjedhojë do të duhet të ofrohen veprimtari dhe alternativa të tjera. Krahas strukturave të përvijuara më sipër, një përparësi tjetër e qendrës së vizitorëve në këtë vendndodhje është se ofron akses të menjëhershëm në shtigjet drejt Shtëpisë së Doganës në bregun përballë kalasë së Ali Pashës dhe rreth liqenit Alinura. Kjo zonë e Parkut Kombëtar ka disa nga peizazhet bregdetare më mahnitëse me pamje nga deti Jon në Korfuz dhe mundësi të shumta për ecje në natyrë dhe vrojtimin e zogjve, si dhe akses në sitet arkeologjike që datojnë pas periudhës -Klasike, veçanërisht në shpatet e Malit Sotira në perëndim.

Aktualisht numri i vizitorëve gjatë muajve të dimrit është tepër i ulët për të mbështetur disa nga veprimtaritë dhe ambientet e propozuara më sipër, dhe ndonëse Parku Kombëtar dhe Zona A3 do të jenë të hapur gjatë gjithë vitin, mund të nevojitet një ofertë fleksibël vizitorësh me bazë sezonale. Kjo është një praktikë shumë e përdorur në site të ngjashme në mbarë botën.

Rasti për t'iu ofruar vizitorëve mundësinë e transportit me varkë nga Shtëpia e Doganës në kalanë e Ali Pashës dhe më pas përgjatë Kanalit të Vivarit në Butrint duhet marrë parasysh me seriozitet. Për këtë do të nevojitet një flotë e vogël varkash elektrike të posaçme, që mund të operohen lehtësisht nga fshatarët e zonës gjatë stinë së verës dhe mund të kërkohen pagesa shtesë nga vizitorët.

Udhëtimet me varkë mund të ofrohen nga Zona Arkeologjike për në sitet e tjera me monumente ose restorantet buzë bregut të liqenit Butrinti, si Kalivo, Diaporit dhe Shtëpia e Midhjeve. Natyrisht që mund të lindin probleme me konservimin nga përdorimi i varkave, ndaj nevojitet monitorimi i përshtatshëm.

Ambientet e reja prezantuese dhe orientuese të ofruara në qendrën e vizitorëve do t'i mundësojë muzeut ekzistues në Kullën Veneciane mbi Akropol që të rizhvillohet dhe të riprezantohet për të ofruar orientime dhe interpretime më specifike të monumentit arkeologjik nëpërmjet një muzeu të riorganizuar duke përdorur artefaktet si burim parësor interpretimi [21].

Pengesat me rrotullim për kalimin e njerëzve në hyrjen e sitit duhet të menaxhohen nga stafi i sitit për t'iu ofruar vizitorëve ndihmën e nevojshme. Zyrat e stafit aktualisht gjenden në Kullën Veneciane pranë bregut. Ky akomodim është krejtësisht i papërshtatshëm, pasi nuk ka dritare dhe ka lagështirë, ndërkohë që hapësirat e reja për zyrat e stafit do të mundësohen nëpërmjet një shtese të posaçme në ambientet ekzistuese në hyrje në mënyrë që të ruhet prezenca e stafit në sit, krahas ambienteve të propozuara për qendrën e vizitorëve.

Caktimi i zyrave të stafit dhe vendndodhjes së tyre mundëson riprojektimin e hyrjes kryesore të sitit duke hequr portën e periudhës komuniste dhe duke i mirëpritur vizitorët në biletari dhe si rrjedhojë, edhe në sit.

Hotel Livia ofron ambiente kafeneje dhe restoranti në një kopsht të këndshëm me hije, që frekuentohet nga vizitorët. Hoteli ka edhe 12 dhoma që rezervohen në bazë sezoni. Ndërkohë që mund të mirëmbahet struktura e kateringut në katin e parë, kjo ndërtesë *mund* të shndërrohet në një qendër burimesh arsimore për grupet shkollore dhe studiues nga Grupi Kërkimor i Butrintit i propozuar bashkë me zyrat për stafin e sitit në katet e sipërme në planin afatgjatë.

Megjithatë, ky rekomandim është jashtë fushëveprimit të planit aktual të biznesit, ndaj hamendësohet se Hotel Livia do të vazhdojë të operojë po njësoj.

[21] Kjo mund të kërkojë shqyrtimin e artefakteve nën menaxhimin e Institutit të Arkeologjisë brenda parkut dhe si rrjedhojë ato mund të vendosen jashtë Zonës A3.

1.14 Roli dhe rëndësia e komuniteteve vendase

Edhe gjatë një vizite rastësore në Butrint vërehet se ndonëse Zona A3 është e mirëmenaxhuar dhe e mirëmbajtur, mjediset përreth nuk janë.

Shishet plastike dhe mbetje të tjera gjenden kudo... Kanali i Vivarit në thelb është shteg i hapur për mbetjet plastike dhe të llojeve të tjera. Asnjë metër katror i Fushës së Vrinës dhe mbarë peizazhit nuk ka mbetur pa një qese plastike, teneqe, paketë cigaresh apo mbështjellëse karamelesh.

Kjo duhet të ndryshojë. Mbase do të duhet një brez i tërë, por duhet të ndryshojë me patjetër, përndryshe e ardhmja e Butrintit mund të jetë shndërrimi në një Zonë Arkeologjike të paprekur dhe të mirëmenaxhuar, por e izoluar dhe e rrethuar nga neglizhimi dhe shkatërrimi me plastikë dhe me mosrespektim ndaj botës së egër.

Dhe nëse në Qytetin Antik *do të vinte* ndonjë vizitor, me kalimin e kohës numri i tyre do të binte. Të ardhurat do të binin, vendasit do të humbnin interesin dhe incentivat, stafi me përvojë mund të largohej, dhe vetë siti mund të përkeqësohej, madje duke vënë në pikëpyetje Statusin aktual të Sitit të Trashëgimisë Botërore[22].

Si menaxhues i përgjegjshëm i sitit, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit nuk mund ta lejojë këtë gjë.

Një zgjidhje mund të jetë angazhimi dhe motivimi i vendasve për të nxjerrë fitime financiare nga një operacion i përgjithshëm pastrimi që fillimisht mund të zgjasë 2-3 vjet. Përgjatë të gjithë Parkut Kombëtar, njerëzit duhet të shpërblehen për mbledhjen e mbetjeve plastike dhe mbetjeve të tjera joorganike dhe dërgimin e tyre në një ose disa pika qendrore për depozitim.

Duhen nxitur shkollat për t'u përfshirë, si dhe komunitetet dhe fshatrat vendase duhet të konkurrojnë për të mbledhur sa më shumë mbetje plastike. Duhet bërë çmos për ta zgjidhur këtë gjë.

Qëllimi është që agjencia drejtuese, në bashkëpunim me palë të treta për përpunimin e mbetjeve, t'i paguajnë komunitetet vendase për mbledhjen e plastikës dhe mbetjeve të tjera. Nuk synohet që Zona A3 të nxjerrë fitime financiare nga ky planifikim pasi kjo veprimtari nuk duhet të përqendrohet te kostot. Nëse nxirren, fitimet duhet të përdoren në përfitim të komunitetit vendas.

Parku Kombëtar i Butrintit, dhe Zona A3 brenda tij, do t'iu sjellë njerëzve mirëqenie dhe begati nëse kujdesen, e respektojnë dhe dëshirojnë më të mirën për të. Ndaj, nuk ka justifikim për fonde të pamjaftueshme dedikuar konservimit të të gjitha llojeve dhe për mungesën e stafit apo burimeve të tjera për ta realizuar këtë qëllim.

Komunitetet vendase janë kyçe për qëndrueshmërinë e Parkut Kombëtar, ndaj Zona A3 duhet të jetë pjesë integrale e menaxhimit të tij të suksesshëm. Kooperativat bujqësore në Fushën e Vrinës dhe peshkimi tregtar në Liqenin e Butrintit dhe Kanalin e Vivarit e kanë formësuar peizazhin gjatë mijëvjeçarëve, çka duhet të bëhet pjesë e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar në tërësi.

Krahas kësaj, Zona Buferike dhe mbarë Parku Kombëtar janë kyç për identitetin dhe Statusin e Trashëgimisë Botërore të Butrintit, ndaj dhe duhet ruajtur ekuilibri midis interesave të komuniteteve vendase dhe vendndodhjes së monumentit.

Në disa rrethana të caktuara, mund të jetë e nevojshme të kompensohen komunitetet për moszhvillimin për qëllime tregtare të hapësirave të reja, që cenojnë monumentin.

[22] UNESCO mund të heqë statusin e Trashëgimisë Botërore nëse vlerëson se siti ose Zona e tij Buferike po keqmenaxhohen ose keqzhvillohen. I tillë është rasti me STB Liverpul të MB-së (të cilit iu dha statusi STB në vitin 2004). Më 22 Qershor 2021, sipas gjykimit të tij, Komiteti i Trashëgimisë Botërore rekomandoi që ky status të hiqej për shkak se zhvillimet e reja në qytet kishin rezultuar në "përkeqësim serioz dhe humbje të pakthyeshme të karakterit"

Këto pagesa "mënjanë" janë të zakonta gjetkë, në rastet kur përfitimi i përgjithshëm i peizazhit tejkalon çdo shpërblim financiar individual ose të menjëhershëm.

Mekanizmat lehtësues, si panelet e arbitrimit dhe të tjera të ngjashme me to, nuk janë pjesë e fushëveprimit të këtij Plani Biznesi, por duhen marrë parasysh për Planin e Menaxhimit të Integruar.

1.15 Përmbledhja e ndërhyrjeve kapitale të propozuara

Në vijim mund të gjeni një përmbledhje të rekomandimeve në lidhje me ndërhyrjet kapitale:

1. Konservimi i të gjitha elementeve arkeologjike sipas standardeve të dakordësuara
2. Një qendër e re vizitorësh, e ndarë në faza, në vendparkimin mbi sit
3. Mjete transporti ekologjike
4. Varka për pasagjerët, platforma për zbritje dhe mole
5. Struktura të reja interpretimi të muzeut në Kalanë Veneciane
6. Hyrje e re në sit, zyra për stafin dhe gardh sigurie
7. Panele të reja interpretimi dhe burime të tjera në mbarë sitin, duke përfshirë Fortesën Trekëndore.

Këto ndërhyrje rekomandohen, sepse:

1. Janë në vetvete ndërhyrje të kujdesshme, si dhe respektojnë dhe përmirësojnë identitetin e vendit
2. Mund të ofrohen relativisht lehtë dhe shpejt, si dhe brenda buxheteve të miratuara
3. Nuk kërkojnë pushtet të pazakontë ose të jashtëzakonshëm për zbatimin e tyre.

Me qëllim realizimin e këtyre ndryshimeve, në Seksionin më poshtë paraqitet një strukturë e re drejtimi.

2 Drejtimi

2.1 Rregullimet aktuale të qeverisjes

Zona e shpallur si Sit i Trashëgimisë Botërore përfshin një sipërfaqe prej 2,500 hektarësh të Parkut Kombëtar; sipërfaqja e mbetur e Parkut Kombëtar të Butrintit shërben si zonë buferike për Sitin e Trashëgimisë Botërore. Organi kombëtar përgjegjës për raportimin lidhur me Sitet e Trashëgimisë Botërore pranë UNESCO-s është Ministria e Kulturës, nëpërmjet Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve, në Tiranë.

Në përputhje me Konventën e RAMSAR-it, Parku Kombëtar i Butrintit është shpallur si Ligatinë e Rëndësisë Ndërkombëtare. Ministria e Mjedisit është organi kombëtar përgjegjës për raportimin lidhur me sitet e shpallura nga RAMSAR-i, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare për Zonat e Mbrojtura.

Aktualisht, Parku Kombëtar i Butrintit drejtohet nga disa departamente qeveritare në varësi të Ministrisë së Kulturës. Konkretisht, ai drejtohet nga Bordi për Administrimin dhe Koordinimin e Butrintit dhe Zyra e Administrimit dhe Koordinimit, që u themeluan në vitin 1998; Bordi i ngarkuar me kompetenca për zhvillimin strategjik të zonës, ndërsa zyra e ngarkuar me funksione administrative për Zonën A3[23]. Këto organe përfshijnë përfaqësues të institucioneve qendrore të mjedisit, turizmit, zhvillimit urban dhe trashëgimisë kulturore.

Në vitin 2000, zona arkeologjike prej 2,500 hektarësh u shpall Park Kombëtar i mbrojtur nga Shteti.[24] Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit është autoriteti përgjegjës për administrimin e kësaj sipërfaqeje.

Në vitin 2002, Kompleksi Ligatinor Butrinti prej 13,500 hektarësh u shpall zonë e mbrojtur natyrore, dhe u përfshi në listën e Ligatinave të Rëndësisë Ndërkombëtare, sipas Konventës së RAMSAR-it.[25] Ky vendim specifikon një sipërfaqe arkeologjike prej 408 hektarësh. Për sa i përket organeve të qeverisjes, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Bujqësisë, është përgjegjëse për menaxhimin e zonës dhe zbatimin e planit të saj të menaxhimit.

Megjithatë, Rregullorja për funksionimin e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit[26] i referohet ushtrimit të juridksionit të kësaj Zyre në një zonë prej 2,500 hektarësh dhe nuk është përditësuar me zgjerimin e kufijve të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe përgjegjësive të Zyrës. E njëjta gjë ndodhi edhe me aktet ligjore në lidhje me Bordin e Butrintit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave i vitit 2005[27], i ndryshuar, parashikon kufijtë aktualë të Parkut Kombëtar të Butrintit. Ai e përcakton sipërfaqen prej 9,424.4 hektarësh të Kompleksit Ligatinor të Butrintit si park kombëtar dhe e ia delegon përgjegjësinë e menaxhimit Ministrisë së Kulturës, përmes Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit për Zonën A3 (614.3 hektarë). Krahas këtyre, ai përcakton edhe përgjegjësinë e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, së bashku me Komitetin e Menaxhimit të Parkut (i themeluar sipas legjislacionit për Zonat e Mbrojtura) dhe institucionet e tjera të specializuara, për menaxhimin e përgjithshëm të Parkut dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planit të tij të menaxhimit. Komiteti i menaxhimit i Parkut Kombëtar të Butrintit nuk u themelua sipas ligjit të mëparshëm për zonat e mbrojtura.

[23]Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 450, datë 01.07.1998, i ndryshuar.
[24]Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 82, datë 02.03.2000.
[25]Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 531, datë 31.10.2002.
[26]Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 857, datë 19.12.2003.
[27]Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 693, datë 10.11.2005, i ndryshuar.

Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM) e themeluar në vitin 2015[28],është përgjegjëse për mbrojtjen e pasurive natyrore brenda zonave të mbrojtura. Komitetet e Menaxhimit për zonat e mbrojtura janë ngritur për të mbikëqyrur zbatimin e planeve të menaxhimit.

Duke marrë parasysh ndryshimet e sipërfaqes dhe zonës së Parkut Kombëtar të Butrintit, kuadri ligjor mund të interpretohet në dy mënyra, për sa i përket zgjerimit gjeografik dhe shtimit të kompetencave të Bordit të Butrintit dhe institucioneve të tjera, duke qenë se disa akte ligjore kontradiktore janë në fuqi. Në praktikë, Bordi i Butrintit merr vendime strategjike në lidhje me zhvillimin e Sitit të Trashëgimisë Botërore, të cilat zbatohen nga Zyra e Administrimit dhe Koordinimit, ndërsa Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura është përgjegjëse dhe konsultohet rregullisht me Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit për çdo problematike që lidhet me bimësinë dhe çështje të tjera mjedisore.

Ajo që ka nevojë Butrinti është një forum i qartë, i mirëformuluar, i *përkushtuar dhe i besueshëm*, ku të zhvillohen debate për sipërfaqen brenda Parkut dhe përreth tij, me fuqi të mjaftueshme për të ndikuar në vendimmarrje dhe në mirëqenien e ardhshme të Parkut, duke e parë atë si detyrën e tij prioritare. Ky forum duhet të marrë parasysh edhe pikëpamjet e banorëve vendas, të shprehura nëpërmjet përfaqësuesve të bashkive të tyre dhe organeve të tjera vendore.

Komiteti i Parkut Kombëtar të Butrintit është themeluar rishtas pikërisht për këtë qëllim. Megjithatë, anëtarësia mbetet ende për t'u përcaktuar në mënyrë më të qartë, pasi jemi ende në fillesat e këtij procesi, por ka të ngjarë që të favorizohen institucionet e nivelit kombëtar, me përjashtim të Fondacionit të Ri, i cili mund të ngarkohet me drejtimin, të paktën në vitet e para, për të mbështetur aplikimet pranë UNESCO-s, por pa kufizuar në to.

Pra, ndërkohë që kapaciteti e secilës prej palëve për të ndikuar dhe udhëzuar politikat, nëpërmjet të drejtës së votës, është një çështje e hapur për diskutim, është e qartë se Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të gëzojë avantazhe të rëndësishme nga mirëqenia financiare e Parkut, duke qenë se do bëjë investimin kryesor për Zonën A3, pavarësisht financimeve shtesë të çfarëdo lloji që mund t'i vërë në përdorim për aktivitete të tjera në mbarë Parkun.

Emërtimi i organizatës nën shqyrtim/të propozuar si 'komitet' ose 'autoritet' është më pak i rëndësishëm se kapaciteti e saj: (a) për të përcaktuar politika dhe standarde për të gjitha operacionet në Parkun Kombëtar, dhe (b) për të vepruar si burim Planifikimi dhe si Autoriteti i të gjitha zhvillimeve të ardhshme.

Në këtë kuptim, ajo është ndryshe nga komiteti ekzistues i menaxhimit, që "ka rol mbikëqyrës, me veprimtari jo menaxhuese ... i ngritur në nivelin rajonal''[29].

[28] Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 04.02.2015, i ndryshuar.
[29]Vendim i Këshillit të Ministrave i Republikës së Shqipërisë Nr. 593 (9 tetor 2018) "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura".



Figura 4: Zona A3 në kontekst

[Kufijtë e sitit të trashëgimisë botërore paraqiten në ngjyrë kafe; Zona A3 në ngjyrë të gjelbër të çelët; parku kombëtar në ngjyrë të gjelbër. Ky plan biznesi përqendrohet në Zonën A3].

2.2 Implikimet e ligjit të ri për trashëgiminë kulturore

Ligji i ri për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë Nr.27/ 2018 parashikon dy modele për administrimin e pasurive të trashëgimisë kulturore: (a) administrim i drejtpërdrejtë nëpërmjet agjencive qeveritare, dhe (b) administrim indirekt.

Që prej përditësimit të këtij Plani Biznesi, është krijuar një fondacion i posaçëm për menaxhimin e sitit të Butrintit, me emrin Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Nga të gjithë faktorët që shpien drejt mirëqenies afatgjatë të një vendi, veçanërisht të një vendi antik dhe të dashur, gjëja më e rëndësishme është instrumenti me të cilin qeveriset, menaxhohet e rrjedhimisht mbrohet.

Nga kjo rrjedh çdo gjë tjetër: investime në kapital, punësimi i stafit të pajisur me aftësitë e duhura dhe të mirëtrajnuar, motivimi i popullsisë vendase, vullneti i mirë politik, si dhe ruajtja e vetë peizazhit.

Pa qeverisjen e efektshme dhe të mirëdrejtuar që synon ruajtjen afatgjatë të pasurive të sitit, çdo gjë tjetër është në rrezik: mund të neglizhohet monumenti, mund të realizohen ndërhyrje të pamenduara, mund të lindë një qëndrim indiferent, i cili përqendrohet në fitime afatshkurtra kundrejt atyre afatgjata.

Sitet si Butrinti janë gjithnjë në qendër të vëmendjes. Ndonëse ndodhen në një vend, në një shtet, në një rajon të caktuar, rëndësia e tyre i kapërcen të gjitha këto. Këto site kanë rëndësi ndërkombëtare dhe duhet të mbrohen në përjetësi që të përfitojnë të gjithë. Ndaj, menaxherët e këtij siti kanë detyrim ndaj komunitetit botëror.

Por njëkohësisht, këto site janë të brishta. Ndryshimi i vullnetit, ndërrimi i qeverisë, ndryshimi i qëndrimit mund të shpien drejt braktisjes së tyre, madje në disa raste shumë shpejt. Kemi shembuj të shumtë si Siria, Irani, Iraku, Lindja e Mesme dhe Afganistani.

Kjo theksohet edhe më shumë në Butrint duke qenë se baza kërkimore e dokumentuar arkeologjike (dhe të tjera) është kaq e madhe dhe e njohur në arenën ndërkombëtare, sa që humbja e tij do të ishte e pamatshme. Prandaj, drejtimi i duhur, i qëndrueshëm dhe afatgjatë i sitit ka rëndësi absolute.

2.3 Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

Duke marrë në konsideratë të gjithë këta faktorë, u krijua një **organizate të re**, për të menaxhuar Zonën A3. Kjo organizatë e re u krijua me një synim të ri afatgjatë dhe mund të njihet si 'Fondacion', me statusin "jofitimprurës", sipas Ligjit Shqiptar. Ligji i ri për trashëgiminë kulturore dhe muzetë parashikon krijimin e një organizate të tillë[30]. Fondacioni është themeluar dhe regjistruar në përputhje me ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar dhe ligjin nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". Fondacioni është i organizuar dhe vepron në përputhje me këto akte ligjore dhe rregulloret e brendshme ose udhëzimet e miratuara nga Bordi i Drejtorëve. Organi më i lartë vendimmarrës i Fondacionit është Bordi i Drejtorëve, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët emërohen për një mandat 2 (dy) vjeçar dhe mund të riemërohen për një numër të pakufizuar mandatesh.

Kështu, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të funksionojë nëpërmjet Bordit të tij të Drejtorëve me qëllim ofrimin e një përvoje të qëndrueshme, edukuese dhe të kënaqshme për vizitorët e Butrintit, duke garantuar që sipërmarrjet dhe komunitetet vendase të bashkëjetojnë, duke pasur përfitim reciprok. Ky është qëllimi i tyre i vetëm jofitimprurës: të gjitha konsideratat e tjera janë dytësore. Në këtë përpjekje, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, në fillim do të mbështetet nga tre Ministri dhe nga Grupi Kërkimor i Butrintit, i propozuar rishtas (për të cilin do të gjeni më tepër informacion në vijim). Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit mund të pranojë mbështetje dhe financime nga truste, fondacione, individë, shoqëri të tjera private, etj., për llogari të tij dhe pa mbështetjen e organeve të tjera, atje ku gjykohet më e arsyeshme dhe e përshtatshme, sigurisht në përputhje me legjislacionin

[30]Ligji Nr. 27/2018: Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë

shqiptar dhe parimet etike, sipas të cilave do të operojë fondacioni, si një organ i pavarur, me qëllimin e sigurimit të mirëqenies afatgjatë të sitit.



Figura5: Fondacioni i Ri (Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit) - përshtatjet kryesore

2.4 Fluksi i fondeve dhe përgjegjësia për sitin

Ekipi i menaxhimit bën parashikimet operacionale, me miratim të Drejtuesit të tij (për të cilin do të gjeni më tepër informacion në vijim), për një plan biznesi shtatëvjeçar, të përditësuar në baza vjetore. Si rrjedhojë, organizimi financiar në aspektin e fluksit të fondeve kapitale dhe të të ardhurave mund të përmblidhet si vijon:



Figura6: Fluksi kryesor i fondeve kapitale dhe të ardhurave

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, nëpërmjet Bordit të tij, është ngritur me fonde nga AADF-ja dhe Ministria e Kulturës, dhe do të veprojë në emër të Qeverisë Shqiptare. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit mund të pranojë fonde nga palë të treta për punimet kapitale dhe operacionale, si: truste, fonde universitare, fonde private e të tjera si këto. Fondacioni do të mbështesë Grupin e ardhshëm Kërkimor të Butrintit dhe do të alokojë fonde për funksionimin e Ekipit të Menaxhimit të Sitit, duke e pasur si qëllimin e tij prioritar.

Si rrjedhojë, një nga detyrat kyçe të Bordit të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit është sigurimi i financimeve nga burime të ndryshme (si për projektet kapitale, ashtu edhe mbështetjes së të ardhurave), në mënyrë që të zbutet rreziku nga investimi afatgjatë. Kjo është praktikë e zakonshme e Fondacioneve të tjera kudo në botë, veçanërisht në ato që kanë nevojë për financime dhe mbështetje të jashtme për projektet e konservimit, siç është rasti i Butrintit. Kështu, Fondacioni do të ofrojë kapitalin për funksionimin e Zonës A3 dhe për aktivitetet në Zonën Buferike të sitit, që janë ende për t'u përcaktuar.

Siti, nga ana tjetër, i kthen Fondacionit tepricën nga veprimtaritë e tij, dhe ky i fundit duhet t'i investojë përsëri për mirëmbajtjen dhe funksionimin e sitit, si edhe për punimet e parashikuara në Zonën Buferike, nëse është e nevojshme.

Sipas këtij propozimi, pasuritë, menaxhimi dhe përgjegjësia operacionale e sitit janë ndarë ndërmjet organizatave të duhura përgjegjëse.

Aspektet kyçe të këtij rregullimi, janë si vijon:

1. Qeveria Shqiptare gëzon pronësinë e të gjitha pasurive të sitit për përfitime publike
2. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit investon për kërkesat operacionale dhe kapitale të sitit, ndoshta në partneritet me palë të treta të jashtme, si të gjykohet e arsyeshme
3. Siti ia kthen tepricën nga veprimtaritë tregtare Bordit të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, për riinvestim në Zonën A3 dhe, nëse ka vullnet, edhe në Zonën Buferike, sipas përcaktimit në marrëveshjen e Bashkëpunimit nënshkruar nga AADF-ja dhe Ministria e Kulturës
4. Duke qenë fondacion jofitimprurës me synim të vetëm menaxhimin e Zonës A3, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit nuk do të bëjë shpërndarjen e dividendit dhe as nuk do t'u japë rroga anëtarëve të bordit,
5. Bordi i Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit do të punësojë një Drejtor për Sitin, i cili do të ngarkohet me detyrën për të zhvilluar të gjitha operacionet e sitit, me anë të një plani menaxhimi dhe investimi shtatëvjeçar, të përditësuar në baza vjetore, me miratim të Bordit dhe financim të Fondacionit.



Figura 7: Ofrimi dhe përgjegjësia e përgjithshme

3 Plani i Biznesit

Projektimi i operacioneve të çfarëdolloj biznesi, për trashëgiminë apo fushë tjetër, që mbulon një periudhe shtatëvjeçare është shumë i vështirë.

Duhen marrë parasysh, ndër të tjera:

1. Qëndrueshmëria e vendit pritës, qeverisë dhe ekonomisë së tij
2. Prirjet ekonomike botërore, duke përfshirë tregjet financiare, paqëndrueshmërinë e tyre dhe strategjitë për rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë
3. Ndryshimet që janë jashtë kontrollit të çdo vendi: ndryshime politike, siç është shembulli i Brexit në Mbretërinë e Bashkuar, dhe ndryshime madhore në botë, si ngrohja globale
4. Kursi i këmbimit midis monedhave botërore
5. Aftësia dhe dëshira e vazhdueshme që njerëzit të udhëtojnë për qëllime turizmi, pavarësisht frikës apo perceptimit të çështjeve të sigurisë nga terrorizmi (ose mungesa e tij)
6. "Vlera e parasë" e konceptuar në një treg turistik global.

Asnjë projekt i turizmit të trashëgimisë nuk mund të jetë i izoluar, pasi duhet të dallojë dhe t'iu përgjigjet ndryshimeve dhe tendencave të mëdha në shkallë botërore.

3.1 Ngritja, roli dhe ndikimi i turizmit ndërkombëtar

Përpara Covid-19, turizmi ishte një nga sektorët më të mëdhenj, me rritjen më të shpejtë në ekonominë botërore, duke gjeneruar më shumë se 7.5 trilionë dollarë amerikanë në vit dhe duke mbështetur rreth 10% të profesioneve në ekonominë botërore[31]. Në vitet përpara pandemisë, turizmi ishte përgjegjës për lëvizjen më të madhe të njerëzve në mbarë rruzullin.

Në përpjekje për të zbutur efektet e pandemisë, thuajse çdo vend ndërmori masa tejet kufizuese. Kufijtë u mbyllën, linjat ajrore ndaluan së fluturuari, udhëtimet brenda vendit u kufizuan dhe u vendosën karantinat, ku në disa vende u vendosën edhe orët policore [32]. Për herë të parë në historinë e saj, shumica e ekonomisë botërore u vendos në një gjendje recesioni të krijuar nga qeveria. Trilionë dollarë të mbështetur nga qeveritë u shpenzuan për të mbajtur likuide ekonomitë.

Organizatat e trashëgimisë kulturore, si pjesë e industrisë së turizmit, ishin ndër më të goditurat, pasi ato: (a) janë ndër vendet ku distanca fizike, dhe si rrjedhojë siguria publike janë më të vështira për t'u ruajtur, së bashku me faktin se (b) ato në thelb kanë nevojë për praninë dhe xhiron e një numri të madh vizitorësh për të mbështetur dhe ruajtur modelet e tyre të biznesit. Kjo ka prekur edhe udhëtimet ndërkombëtare, veçanërisht udhëtimet ajrore; hotelet dhe anijet kroçere; kafenetë, baret, lokalet, restorantet dhe klubet e natës; teatrot, kinematë dhe hapësira të tjera shfaqjesh.

Kështu, çdo model biznesi i bazuar në ofrimin e shërbimeve ballë për ballë dhe / ose për një numër të madh përdoruesish (vizitorësh) u gjend përballë problemeve afatgjata dhe, në shumë raste, përballë krizave afatshkurtra.

Sipas OBT-së mbërritjet turistike ndërkombëtare ranë me 83% në tremujorin e parë të 2021-shit pasi kufizimet në udhëtim mbetën në fuqi në mbarë botën. Sidoqoftë, Indeksi i Besimit të OBT-së tregon shenja të një rritjeje të ngadaltë të besimit[33].

[31] Këshilli Botëror i Turizmit dhe Udhëtimeve. (2018). *Raporti vjetor për kërkimin e ndikimit ekonomik.*

[32] https://www.independent.co.uk/news/at-a-glance-europes-coronavirus-curfews-and-lockdowns-curfew-curfews-countries-coronavirus-patchwork-b1787264.html

[33] https://www.unwto.org/news/tourist-numbers-down-83-but-confidence-slowly-rising

Midis periudhës janar dhe mars 2021, destinacionet në mbarë botën mirëpritën 180 milionë më pak turistë ndërkombëtarë krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Azia dhe Paqësori vazhduan të vuanin nivelet më të ulëta të aktivitetit me një rënie prej 94% të turistëve ndërkombëtarë gjatë periudhës tre-mujore. Evropa regjistroi rënien e dytë më të madhe me -83%, e ndjekur nga Afrika (-81%), Lindja e Mesme (-78%) dhe Amerika (-71%). Kjo i mbivendoset rënies prej 73% të mbërritjeve turistike ndërkombëtare në mbarë botën e regjistruar në vitin 2020, duke e bërë atë vitin më të keq të regjistruar për sektorin.

Shumë ekspertë[34] nuk shohin një kthim në nivelet e turizmit ndërkombëtar të vitit 2019 të paktën deri në vitin 2024. Shumëçka do të varet nga ritmet e vaksinimit dhe nëse shfaqet ndonjë variant rezistent ndaj vaksinës në muajt dhe vitet e ardhshme që do të ndikojë negativisht tek ato vende që kanë një nivel të lartë të vaksinimit, po ato vende (perëndimore) që kontribuojnë në shumicën dërrmuese të turistëve jashtë vendit, veçanërisht në sitet arkeologjike në Mesdhe.

Në periudhën pas pandemisë, arritja e niveleve të turizmit të 2019-s do të sjellë kosto afatgjata. Me rreth 1.5 miliardë turistë që udhëtojnë në mbarë botën çdo vit, konsumi i burimeve natyrore, veçanërisht i energjisë dhe i ujit, do të shtojë kërkesat për burimet e shumë vendeve, veçanërisht të vendeve më pak të pasura që po përjetojnë rritjen e aktivitetit turistik, pasi turistët kërkojnë destinacione të reja, përfshirë dhe Shqipërinë.

Në fakt, duke prezumuar kthimin në "normalitet" [35], brenda pak viteve do të ketë rreth 1.5 miliardë turistë në vit të cilët do të kenë një ndikim madhor mbi atë që quhet “ekologjia e turizmit”[36].

Nga kjo pikëpamje, turistët dhe strukturat turistike veprojnë si organizma që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin fizik, duke krijuar një sistem dinamik dhe kompleks. Turistët dhe strukturat turistike nuk janë shtesa të mjedisit, por pjesë thelbësore e tij. Janë aktorë, jo spektatorë.

Sipas kësaj pikëpamjeje, çdo ngjarje e re në ekosistem do të ketë ndikim mbi pjesën tjetër të sistemit, duke e ndryshuar gjendjen e ekuilibrit. Ekuilibri,ashtu si në natyrë, arrihet nëpërmjet përshtatjes ekologjike... në këtë rast, ose nëpërmjet një ndryshimi (përshtatjeje) të produktit turistik, mjedisit fizik, tregut, ose të trijave... ose nuk arrihet ekuilibri i duhur,duke shpjerë drejt zhdukjes së sistemit dhe zëvendësimit nga një tjetër.

Ndjekja e kësaj pikëpamjeje ka implikime të thella për turizmin e qëndrueshëm për të gjithë, duke përfshirë Shqipërinë në përgjithësi dhe Butrintin në veçanti.

Një pjesë e madhe e rritjes vjetore të turizmit e parashikuar për vitin 2030 (duke supozuar që nivelet përpara vitit 2019 do të arrihen deri në vitin 2024) pritet të vijë nga ekonomitë në rritje (dhe të mëdha) të Kinës dhe Indisë, duke krijuar një ekologji turizmi të ndryshme nga ajo që ekziston tani dhe që aktualisht furnizohet nga ekonomitë e BE-së, MB-së, SHBA-së, Japonisë, Australisë dhe Kanadasë.

Njohja dhe përshtatja ndaj kësaj tendence është sfidë kyçe ndaj ofruesve turistikë, menaxherëve dhe politikëbërësve në të ardhmen. Përgjigjja e tyre do të përcaktojë mirëqenien e trashëgimive natyrore dhe kulturore të botës, që nxisin dhe mbështesin shumicën dërrmuese të kërkesës turistike.

---

[34] https://www.mckinsey.com/industries/healthcare-systems-and-services/our-insights/when-will-the-covid-19-pandemic-end#

[35] Nuk ka ndonjë mendim të dakordësuar se si do të jetë 'normaliteti i ri', por, me shumë gjasa do të përfshijë menaxhimin e të jetuarit me Covid-19 për vite me radhë, pasi një numër ekspertësh tashmë sugjerojnë se sëmundja do të bëhet endemike.

[36] Prince, D R., (2013). Evolving ecology: the tourism potential of the Drinos Valley, Albania; Trashëgimi Kulturore pa Kufij, Gjirokastër.

3.2 Roli i politikave turistike në promovimin e qëndrueshmërisë

Përgjatë viteve, duke përfshirë edhe ato gjatë pandemisë, një kohë e konsiderueshme, përpjekje të mëdha, grante kërkimore, konferenca dhe takime të liderëve botërorë janë përqendruar në idenë dhe idealin e promovimit të projekteve dhe programeve të turizmit të qëndrueshëm.

Nuk ka dyshim që kur turizmi mbështetet mbi parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, të paktën në teori, mund të lehtësojë rritjen gjithëpërfshirëse, të ofrojë mundësi për zhvillimin ekonomik vendas, mund të reduktojë ndarjen që ndjehet shpesh midis zonave rurale dhe urbane, dhe të promovojë integrimin social.

Krahas kësaj, mund të ndihmojë me ndërgjegjësimin e problematikave mjedisore dhe kulturore, të financojë pjesërisht mbrojtjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe të kontribuojë në ruajtjen e diversitetit biologjik. Bota është zotuar të zbatojë Axhendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm me 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të miratuara nga Shtetet Anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në shtator 2015[37]. Megjithatë, situata e pazakontë e krijuar nga Covid-19, në fillim të vitit 2020, po ndikon në këtë angazhim dhe po minon qasjen e përgjithshme ndaj përshtatshmërisë duke ngadalësuar procesin drejt realizmit të 17 OZHQ-ve dhe duke ndryshuar trajektoren e zhvillimit. Qëllimi kryesor "për të mos lërë askënd pas" kërcënohet nga pabarazitë aktuale në rritje. Ndërsa sfidat e shumëfishuara globale, tronditjet ekonomike dhe financiare në lidhje me Covid-19 e bëjnë edhe më të vështirë financimin e qëndrueshmërisë.

Organizata si Banka Botërore dhe BE-ja përfshihen ndjeshëm në promovime të tilla, duke qenë se e njohin rëndësinë e turizmit të qëndrueshëm, të mirëmenaxhuar për të ardhmen e shumë vendeve, veçanërisht të vendeve më të vogla, që po zhvillojnë ofertat e tyre turistike, si në rastin e Shqipërisë.

Pavarësisht mundësive të shumta dhe të qarta të paraqitura nga ky sektor vazhdimisht në rritje, turizmi përballet me një sërë sfidash që vijnë nga fakti se është një veprimtari e copëzuar, me shumë nivele, shpeshherë me objektiva të politikave konkurruese, si në nivelin kombëtar edhe në atë ndërkombëtar.

Krahas kësaj, turizmi preket dhe nga faktorë të tjerë, mbi të cilët ka pak ose aspak kontroll, si: ndryshimi klimatk, ndotja e detit nga mbetjet plastike, kushtet makroekonomike (luhatja e kursit të këmbimit, kostoja e karburantit, veçanërisht naftës dhe karburantit për mjetet fluturuese), politikat botërore në ndryshim, si dhe perceptimi i vetë turistëve mbi rrezikun dhe sigurinë personale.

Kësaj i shtohen edhe shërbimet turistike që po zhvillohen me shpejtësi, veçanërisht për t'iu përgjigjur digjitalizimit të ekonomisë botërore, përdorimit të teknologjisë së përparuar dhe zhvillimit të sektorëve të specializuar, si ekoturizmi, turizmi i ngadaltë dhe turizmi i aventurës. Të gjithë bashkë, këta faktorë nënvizojnë kompleksitetin e "ekologjisë turistike" dhe nevojën për politika kuptimplota, që synojnë orientimin dhe drejtimin e këtij sektori në një të ardhme më të qëndrueshme.

Si rrjedhojë, politikat e formuluara për të rritur mirëqenien e një vendi ose destinacioni, njerëzve dhe ekologjisë së tij duhet të arrijnë të përballojnë trysninë në ndryshim. Për këtë shkak, politikat e turizmit të qëndrueshëm duhet të jenë të një niveli të lartë dhe të dallojnë nga strategjitë (kombëtare dhe ndërkombëtare), që zhvillohen nga to për të bërë ndryshime në terren.

Krahas kësaj, duhet të jenë në gjendje t'iu përgjigjen shpejt rrethanave në ndryshim: mbase një perspektivë që arrihet më lehtë nga organizatat private, si Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, dhe jo nga drejtoritë dhe ministritë, kudo që të ndodhen.

[37] https://www.un.org/sustainabledevelopment/development-agenda/

Në vitin 2013, duke njohur ndikimin negativ që turizmi, veçanërisht ai me paketa, kishte mbi disa pjesë të botës, Organizata Botërore e Turizmit (OBT) e Kombeve të Bashkuara reagoi me një fushatë për "t'i lejuar udhëtarët të dinë se si mund të përfitojnë nga njerëzit dhe vendet që vizitojnë".

Fushata mbulonte katër moto: (a) bli produkte vendase, (b) respekto kulturën vendase, (c) kurse energji, dhe (d) mbro trashëgiminë.

Ndonëse të lavdërueshme, të gjitha këto moto ngrenë pikëpyetje: (a) kush po ble produktet vendase... linja ajrore, operatori turistik, zinxhiri i hoteleve?; (b) a po respektohet kultura vendase si kulturë indigjene?; (c) mbërritja në destinacion kërkon shumë energji (pjesa më e madhe e të cilës është e parinovueshme), njësoj si teknologjitë digjitale në destinacion; (d) edhe qëndrimi në një vend mund të ndihmojë në shkatërrimin e tij... zhvillimi i infrastrukturës, qendra e re e vizitorëve, tërheqja e vendit, të gjitha mund të shpien drejt shkatërrimit.

Këto konsiderata kanë rëndësi madhore për Butrintin, e rrjedhimisht edhe për Planin e Biznesit.

Politikat afatgjata që përqendrohen në promovimin e punësimit cilësor dhe hapjes së vendeve të punës, zhvillimin e aftësive, sipërmarrje, novacionin, investimet e efektshme, dhe zhvillimin e integruar, janë kyçe për rritjen gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të turizmit. Kjo rritje do të përfillë ndikimin mjedisor, social dhe ekonomik aktual dhe të ardhshëm, si dhe adreson nevojat e vizitorëve, industrisë, mjedisit dhe komuniteteve pritëse.

Pronarët dhe menaxherët e sitit, duke përfshirë edhe ata të Butrintit, duhet të përpiqen që të zhvillojnë më tej politikat koherente dhe të integruara të turizmit, që pasqyrojnë rrethanat e siteve individuale dhe komuniteteve vendase në kërkim të qëllimeve të përbashkëta, duke përfshirë klientë cilësorë, përvoja turistike të sigurta dhe të besueshme, rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë (veçanërisht te NVM-të), si dhe mbrojtjen, menaxhimin dhe përmirësimin e peizazheve kulturore dhe fizike.

Realizimi i këtyre politikave kërkon mbështetje ndërsektoriale nga disa agjenci dhe ndërmarrje, të përfshira në promovimin dhe ofrimin e shërbimeve turistike, duke përfshirë sektorin publik (shtetëror, rajonal dhe vendas), shoqëritë private, sektorin jofitimprurës, institucionet kërkimore dhe arsimore, dhe nismat e komunitetit. Identifikimi dhe koordinimi i roleve të këtyre organizatave duhet të jetë në qendër të vëmendjes së politikave nëse synohet shmangia e nismave kundërproduktive.

Kjo është një arsye përse Autoriteti i propozuar i Parkut Kombëtar do të jetë i rëndësishëm për mirëqenien e Parkut në planin afatgjatë dhe përse Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit është *thelbësor* për Zonën A3.

3.3 Bota në vitin 2030

Ndërsa Covid-19 padyshim ka pasur një efekt ndërprerës afatshkurtër në ekonominë botërore, mbetet i vlefshëm një këndvështrim për vitin 2030. Për më tepër, ekzistojnë çështje thelbësore themelore dhe të qëndrueshme të zhvillimit që aktualisht po adresohen nga shumica e vendeve (të udhëhequra nga G7 dhe G20) që do të jenë më të rëndësishme në terma afatgjatë; ku më e madhja është ajo e ndryshimit të klimës. Pa dyshim që bizneset (veçanërisht ato që lidhen me turizmin, duke përfshirë linjat ajrore dhe operatorët e kroçerave, kjo e fundit veçanërisht e rëndësishme për Butrintin) do të përpiqen të kthehen në nivelet para pandemisë sa më shpejt që të jetë e mundur pasi modelet e tyre të biznesit, kthimet e investimeve dhe përkrahja e bankës dhe aksionarëve mbështetet në to. Megjithatë, për qëllimet e këtij plani biznesi do të ishte e matur të supozohet se ekonomia botërore nuk do të funksionojë në nivelet para-Covid-19 ndoshta deri në tremujorin e parë të vitit 2024.

Kur Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm e UNESCO-s të arrijë vitin 2030 (dy vite pas mbulimit të planit të biznesit), me shumë gjasa bota do të ketë ndryshuar. Sipas disa parashikimeve (p.sh. nga Organizata Botërore e Turizmit e Kombeve të Bashkuara), mund të vlejnë pikat e mëposhtme[38] pasi shumë biznese (dhe qeveri) kanë rivlerësuar operimet e tyre në kontekstin e Covid-19 dhe janë në proces të kalimit në një formë "normaliteti të ri", ku pjesa më e madhe po përshtatin akoma dhe më shumë teknologjitë online dhe punën në distancë:

1. Shumica e produkteve do të bëhen shërbime. Përse të blesh një makinë, kur mund ta marrësh me qira?
2. Çmimi i karbonit do të rritet në mbarë botën. Lëndët djegëse po shterojnë dhe nëse nuk gjenden alternativa më të përballueshme, udhëtimet ndërkombëtare (fluturimet e gjata) mund të pakësohen ose kostoja e biletës së avionit mund të rritet ndjeshëm.
3. Bota digjitale plotësisht ndërvepruese do të jetë reale:përse të shkosh në Butrint kur mund ta përjetosh në shtëpi nëpërmjet një platforme virtuale?
4. Pas rënies së mbizotërimit ekonomik të SHBA-së, do të kemi një kthim të konceptit të shtetit komb. Kjo mund të ketë implikime të mëdha për traktatet ndërkombëtare dhe zgjidhjet botërore të problemeve botërore, veçanërisht me mbizotërimin në rritje të shoqërive botërore online (sidomos media dhe rrjetet sociale, si Facebook, Instagram dhe Twitter).
5. Dy të tretat e njerëzve në botë do të jetojnë në qytete, dhe numri total i popullsisë do të arrijë 11 miliardë gjatë 50 vjetëve të ardhshëm, çka është një shifër e lartë. Afërsisht dy të tretat e tyre do të jetojnë në varfëri.
6. Pas vitit 2024, India do të ketë popullsinë më të madhe në botë, duke ia kaluar Kinës.
7. Akujt në Arktik mund të jenë veç një kujtim, ndërsa në Antarktidë do të ngelen vetëm gjurmët.
8. Për këtë shkak, niveli i detit do të vazhdojë të rritet si pasojë e ngrohjes globale[39]. Sipas përllogaritjeve të Kombeve të Bashkuara, në Butrint niveli i detit do të rritet me rreth 0.7 m deri në vitin 2040 dhe mbase po aq (1.2 m) deri në vitin 2060[40].

3.4 Përballja me ndryshimin

Ndonëse këta faktorë botërorë shkojnë përtej ndikimit të drejtpërdrejtë të menaxhimit të sitit në Butrint, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit duhet të reagojë ndaj tyre duke qenë se do marrë sitin përsipër.

Nëse niveli i detit *do të rritet* me1 metër gjatë 30-40 vjetëve të ardhshme, një pjesë e madhe e Zonës A3 që vizitohet aktualisht do të mbetet nën ujë, përgjithmonë. Mbrojtja e sitit nëpërmjet një sërë projektesh inxhinierike madhore do të ishte një përgjigje e pamenduar pasi problemi kryesor me Butrintin nuk është përmbytja, sa ç'është rritja e ujërave sipërfaqësore duke qenë se një pjesë e madhe e Qytetit Antik gjendet mbi tokën e rivendosur gjatë periudhës romake. Qasja e ndërhyrjes së lehtë e advokuar në këtë Plan Biznesi kërkon studime, gërmime, regjistrime, botime, konservim dhe shpërndarje të sa më shumë informacioneve përpara se të ndodhë e pashmangshmja.

Ky është një nga rolet kyçe të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, pra maksimizimi i mbledhjes dhe shpërndarjes së informacioneve cilësore, kërkimore tek akademikët, turistët dhe të tjerë para se këto informacione të humbasin ose të bëhen të vështira për t'u mbledhur. Ndaj, më poshtë parashtrohet roli i propozuar i Grupit Kërkimor të Butrintit.

[38] Kombet e Bashkuara. (2013). *Raport vjetor*.

[39] https://climate.nasa.gov/effects/

[40] UNESCO (2018) *Mediterranean UNESCO World Heritage at risk from coastal flooding and erosion due to sea-level rise* Nature Communications

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit duhet të përgatitet për më të keqen për të mirën e sitit.

3.5 Supozime dhe pozicioni ekzistues

Gjatë hartimit të këtij Plani Biznesi për zhvillimin e Zonës A3 ishte e nevojshme që të bëheshin disa supozime lidhur me stafin e nevojshëm për të ofruar veprimtaritë e rinovuara dhe rijetësuara të sitit, buxhetet e disponueshme, mënyrën se si do të ofrohen punimet kapitale të ndryshme, dhe kur do të kryhen këto punime.

Të gjitha sitet historike janë të cenueshme. Ato janë të cenueshme nga përdorimi i tepërt i vizitorëve, nga mungesa e vëmendjes nga ana e qeverisë, nga rreziku i vjedhjes, nga shfrytëzimi i bandave kriminale dhe më keq akoma, nga mungesa e interesit.

Kjo e fundit është një shqetësim në Butrint. Nëse siti nuk ka asnjë domethënie për vendasit, nuk iu jep asgjë në këmbim dhe, në fakt, shihet si një kënd lojërash për vizitorët nga Perëndimi, atëherë për çfarë iu shërben?; si mund të përfitojnë ata, përse duhet që të ndihmojnë në ruajtjen e tij?

Thelbi duhet të qëndrojë te fitimi ekonomik ... për sa i përket individit, komunitetit, shoqërisë.

Duhet të gjenden mekanizma jo vetëm në Zonën A3, por në të gjithë Parkun Kombëtar, në mënyrë që vendasit ta shohin Butrintin dhe peizazhin përreth tij si një mundësi në planin afatgjatë. Këto çështje trajtohen në tërësinë e tyre në Planin e Menaxhimit të Integruar për mbarë Parkun, një dokument i përgatitur nga P+P si dokument i lidhur me planin e biznesit.

Nga informacionet e disponueshme[41] mund të pohohet se operimi aktual i sitit ka rënë në mënyrë të ndjeshme për shkak të pandemisë, në përputhje me tendencën botërore gjatë vitit 2020, me një rënie prej 86% krahasuar me vitin 2019:

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Të ardhurat (mijë USD)	339	388	471	485	541	777	919	127
Shpenzimet (mijë USD)	158	174	407	187	341	152	227	304
Tepricat (mijë USD)	**181**	**214**	**64**	**298**	**200**	**625**	**692**	**-177**

Figura 8: Kthimet kryesore të operimit për vitin 2013-2020 (për detaje shihni Shtojcën A)

Shpenzimet e përgjithshme për sitin (nga tabela e mësipërme) shkojnë mesatarisht 243.000 USD në vit, ku përfshihen tre kategoritë e mëdha:stafi i sitit, të mira dhe shërbime, dhe shpenzime kapitale, duke përfshirë punimet për konservimin e sitit. Megjithatë, së fundmi punimet për konservimin janë pezulluar ose kanë qenë minimale për shkak të mungesës së lejeve të përshtatshme të dhëna nga qeveria. Ky ishte rasti për çdo vit, përveç vitit 2015 dhe deri diku për vitin 2017.

Në Shtojcën A gjendet analiza e plotë e shpenzimeve dhe e të ardhurave aktuale në Zonën A3, të administruara nga qeveria. Këto shifra, që janë përdorur si baza fillestare për parashikimet e reja financiare, tregojnë se ekziston një akumulim i konsiderueshëm i punimeve të papërfunduara të konservimit (vërtet jetësore për sitin), gjë që trajtohet edhe në këtë Plan Biznesi, e treguar nga shifra prej rreth 2.1 milionë USD (rreshti i shumës së tepricave në Figurën 8 më sipër) nga fonde të pashfrytëzuara, të mbajtura zyrtarisht nga Ministria e Kulturës dhe të alokuara posaçërisht për ndërhyrje të pamiratuara ende për konservimin e sitit.

Për më tepër, nëse çështja e konservimit të sitit *nuk trajtohet si çështje emergjente*, struktura e Zonës A3 do të vihet më shumë në rrezik, duke çuar në rënien e numrit të vizitorëve dhe si rrjedhojë, në uljen e të ardhurave.

[41] Të dhëna të ofruara nga Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit Shqipëri, qershor 2021

Ky aspekt thelbësor trajtohet në seksione të tjera të këtij Plani që pranon se nevojitet një kapital i konsiderueshëm, i cili është rekomanduar dhe përfshirë në këtë Plan Biznesi.

Prandaj, duke u bazuar te Figura 8, për shtatë vitet e fundit (nga viti 2013-2019) Siti ka gjeneruar tepricë (fitim) mesatarisht prej 325.000 USD në vit, duke përjashtuar vitin 2020, ku vitet kryesore janë 2018 dhe 2019.

Kjo nënkupton se shteti ka akumuluar një tepricë prej 2.1 milionë USD që prej vitit 2013, që *mund* të shpenzohej për konservime thelbësore të sitit.

Në modelin financiar bazë (Figura 10), shifra 2.1 milionë USD, 'pagesë nga qeveria'/ QSH, (rreshti 44) shfaqet si e ardhur nga projekti në pjesën e alokuar për shpenzimet e punimeve të konservimit të sitit (rreshti 2 dhe 17). Figura 10 tregon shumën totale që duhet të përftohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit si një shumë totale në Vitin 1.

Ndërsa kjo pa dyshim do të jetë një çështje debati midis Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit dhe Qeverisë, kjo do të thotë që, me këto para, baza e projektit (Figura 10, rreshti 47) është gjithnjë pozitive. Nëse kjo shumë paguhet në një hark kohor prej tre ose katër vitesh, ajo ndikon vetëm në fluksin e parasë, që mund të mbështetet nëpërmjet fondeve të AADF-së, dhe nuk ka asnjë efekt në buxhetet e përgjithshme.

Transferimi i realiteteve ligjore të operimit të sitit nga qeveria qendrore te Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të marrë kohë, po ashtu si dhe kryerja e ndërhyrjeve të reja fizike, veçanërisht qendra e re e propozuar për vizitorët, rregullimet në hyrjen e sitit dhe punimet urgjente për konservimin e sitit, në pjesën më të madhe të Zonës A3. Kjo krijon një periudhë tranzitore.

Prandaj, sugjerohet një periudhë tranzitore e menaxhimit gjashtë mujore duke nisur nga miratimi i Marrëveshjes së Menaxhimit deri në dorëzimin përfundimtar dhe marrjen nën kontrollin e plotë menaxherial të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit.

Kjo është periudha kyçe e zhvillimit dhe e mirëqenies së ardhshme të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, si rrjedhojë edhe e sitit në tërësi. Mbi të gjitha, kjo kërkon një qëndrim të fokusuar dhe ambicioz nga anëtarët e bordit themelues të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, i mbështetur nga palë të treta, sipas nevojës.

Gjatë kësaj periudhe tranzitore do të jetë *thelbësore* që Zona A3 të qëndrojë e hapur për publikun (për sa kohë që nuk ka kufizime për shkak të Covid-19), për të mbajtur të gjallë ndërgjegjësimin e tij, veçanërisht ndërgjegjësimin ndërkombëtar, duke pranuar se në disa raste mund të jetë e nevojshme që pjesë të ndryshme të sitit të mbyllen për arsye sigurie, veçanërisht kur ka zhvillime apo ndërhyrje fizike, siç ndodh tanimë herë pas here. Periudha tranzitore mbulon studime dhe operacione të tjera mbështetëse për të mundësuar marrjen e kontrollit të sitit nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit në mënyrë të menjëhershme dhe në dijeni të plotë të rrethanave mbizotëruese, me kujdesin e duhur, konsideratat e projektimit për qendrën e re të vizitorëve dhe ndërhyrjet e tjera të nevojshme në sit që i nevojiten Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit për të mbajtur, shtuar dhe ruajtur të ardhurat operacionale.

Gjatë kësaj periudhe tranzitore, investimi i kapitalit kryesor dhe aspektet e të ardhurave të modelit të biznesit do të funksionojnë krah për krah, të cilat janë parashtruar në modelin financiar bazë shoqërues, të paraqitur në Figurën 10.

Aktivitetet e para lidhen me proceset ligjore, të nevojshme për transferimin e sitit nga Shteti te Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Këto aktivitete janë në vetvete komplekse dhe me një fushë të gjerë veprimi.

Punime të tjera përfshijnë studimet dhe angazhimet e tjera të nevojshme në rast se Zona A3 do të mbajë Statusin e Jashtëzakonshëm Universal të UNESCO-s, gjatë periudhës tranzitore dhe pas saj, që sigurisht është thelbësore për mirëqenien e ardhshme të sitit në tërësi.

Prandaj, sugjerohet që të kryhen një sërë studimesh, vrojtimesh e të tjera si këto, thelbësore dhe të nevojshme për përcaktimin e vlerës dhe menaxhimin e sitit në termin afatgjatë, dhe për t'i ofruar stafit të ri të sitit një inventar të detajuar me veprimet që do të ndërmerren dhe me informacione të ndryshme.

Punimet në terren janë gjithashtu të përcaktuara dhe mbulojnë punimet e reja kryesore që nevojiten për të kuptuar potencialin e sitit gjatë kohëzgjatjes së këtij Plani Biznesi. Ato mbulojnë nevojën për një qendër të re vizitorësh, zyra të reja për stafin dhe ndryshimet në hyrjen e sitit, muze të ri të pasur me objekte në Kalanë Veneciane, ndërhyrje të reja në sit dhe riinterpetim të Fortesës Trekëndore.

Çështja thelbësore është se aspektet kryesore të projektimit të punimeve për këto ndërhyrje duhet të fillojnë sa më shpejt që të shihet e arsyeshme, në mënyrë që të ketë kohë të mjaftueshme për kryerjen e punimeve fillestare të sitit deri në fund të periudhës tranzitore dhe për marrjen në kontroll të parashikuar nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit në të njëjtën datë, me të gjithë stafin e duhur të angazhuar.

Fazat/produktet kyçe, që mund të konsiderohen si piketa janë:

Data Efektive e Marrëveshjes së Administrimit	Fillimi i periudhës tranzitore
Periudha Tranzitore	Fillimi i projektimit të punimeve për qendrën e re të vizitorëve dhe ndërhyrje të reja në sit
	Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit fillon me rekrutimin e stafit
	Kryerja e studimeve për mirëmenaxhimin e sitit
	Punësimi i të gjithë stafit të ri të sitit
Transferimi i Administrimit	Funksionimi i plotë i sitit nën menaxhimin e ri të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit

Figura 9: Fazat kyçe për produktet

3.6 Modeli financiar bazë

Në Figurën 10 (më poshtë), rreshtat 2 deri në 26 tregojnë shpenzimin e pritshëm vjetor për zërat kapitalë dhe të të ardhurave, të administruar nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Elementet kapitale shfaqen në rreshtat 2 deri në 13; *shpenzimet e të ardhurave* në rreshtat 14 deri në 26.

Rreshtat 27 dhe 28 i përmbledhin të dyja elementet.

Rreshtat 31 deri në 39 tregojnë të ardhurat vjetore.

Rreshtat 40 dhe 41 përmbledhin transaksionet vjetore dhe tregojnë investimin e përgjithshëm që do realizohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Shumica e rreshtave kanë një nën-aktivitet që lidhet me to, të cilat përshkruhen në seksionet më poshtë.

Plani i Biznesit parashikon një kthim vjetor prej 0.5% të të ardhurave totale në vitin e parë të operimit, 1% në vitin e dytë, 1.5% në vitin e tretë dhe 2% çdo vit në vijim si kontribut ne Fondin Kombëtar për Ruajtjen e Pasurisë Kulturore.

Periudha	Periudha Tranzitore		Operimii ri						
Buxheti i përgjithshëm operacional strategjik (mijë USD)		V1	V2	V3	V4	V5	V6	V7	Totalet
Zërat e kapitalizuar									
Punimet e konservimit, përfshirë edhe mbylljen e punimeve të prapambetura		231	346	346	346	462	462	462	2,655
Qendra e re e vizitorëve dhe punimet përkatëse	100	173	1,350	1,000					2,623
Hyrja e re në sit, zyrat e stafit, rrethimi i sigurisë dhe shtigje të reja		273							273
Shërbimi i ri muzeal në Kalanë Veneciane		545							545
Interpretimi i ri në Fortesën Trekëndore		136							136
Interpretim i ri në mbarë sitin		159							159
Varkat e vizitorëve, platformat lundruese, skelat dhe automjetet elektrike					159				159
Kostoja e automjeteve 4x4 dhe varkave të rojtarëve					71				71
Kostoja e autobusëve të vizitorëve					109	109			218
Nëntotali i rreshtave 2-12	100	1,518	1,696	1,346	685	571	462	462	6,840
ADD: Kontingjenca 10%	10	152	170	135	69	57	46	46	684
Totalet	**110**	**1,669**	**1,866**	**1,481**	**754**	**628**	**508**	**508**	**7,524**
Zërat operacionalë									
Mirëmbajtja vjetore e sitit dhe buxheti i monitorimit		87	73	73	73	73	73	73	525
Studime dhe konsulenca të specializuara	100	614	123	64	64	64	64	64	1,155
Grupi Kërkimor i Butrintit		0	59	105	59	105	59	105	491
Marka, marketingu dhe promovimi		90	85	70	60	60	50	40	455
Operacionet jashtë sitit		127	127	127	127	127	127	127	891
Stafi i sitit	70	286	317	397	496	551	551	551	3,218
Furnizime dhe shërbime të kontraktuara	35	267	420	447	470	475	475	475	3,017
Grante			50	50	50	50	50	50	300
Kontribut në Projekte të tjera Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore		23	20	40	54	60	74	74	345
Nëntotali i rreshtave 17-24	205	1,494	1,274	1,372	1,453	1,564	1,523	1,558	10,443
ADD: Kontingjenca 10%	21	149	127	137	145	156	152	156	1,044
Totalet	226	1,644	1,401	1,509	1,598	1,721	1,675	1,714	**11,487**
Shuma e zërave të mësipërm	**336**	**3,313**	**3,267**	**2,990**	**2,352**	**2,349**	**2,183**	**2,222**	**19,011**
Buxheti kumulativ	**336**	**3,649**	**6,916**	**9,906**	**12,258**	**14,607**	**16,789**	**19,011**	

Mbledhje: punime kapitale (rreshti 13)								40%	**7,524**
Mbledhje: kostot e të ardhurave (rreshti 26)								60%	**11,487**
Zërat e të ardhurave	**tranzitore**	**Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Totalet**
Vizitorët në vit (mijë)		78	109	175	262	294	296	296	
Çmimi mesatar i biletës (USD) (@ 75% e çmimit për të rritur)		6	8	8	9	9	11	11	
Faturat hyrëse		468	819	1,441	2,359	2,642	3,335	3,335	14,399
Mbledhja e fondeve			50	50	50	50	50	50	300
Të ardhura nga transporti me varka					17	26	29	30	103
Të ardhura nga shitjet me pakicë dhe shërbimi i kateringut (neto)					262	294	296	296	1,149
Të ardhura vjetore	**-**	**468**	**869**	**1,491**	**2,688**	**3,012**	**3,711**	**3,711**	15,951
Të ardhura kumulative	**-**	**468**	**1,337**	**2,828**	**5,517**	**8,528**	**12,239**	**15,951**	
Kthimi vjetor i investimit	**(336)**	**(2,845)**	**(2,398)**	**(1,499)**	**336**	**663**	**1,528**	**1,489**	**(3,061)**
Ndaj, duhen investime shtesë gjatë kësaj periudhe	**(336)**	**(3,181)**	**(5,579)**	**(7,078)**	**(6,741)**	**(6,078)**	**(4,550)**	**(3,061)**	
Fitimi vjetor V7+									**1,489**
Kontributi i AADF-së (QV e re+ Konserv. + invest. kapitale)	639	2,100	1,100	1,152					4,990
Kontributi i QSH (Konserv.+ investime të tjera kapitale)		2,100							2,100
Kontributi total nga QSH dhe AADF	**639**	**4,200**	1,100	1,152	**-**	**-**	**-**	**-**	**7,090**
Rezultati neto i fluksit monetar	**303**	**1,355**	**(1,298)**	**(347)**	**336**	**663**	**1,528**	**1,489**	**4,029**
Rezultati neto kumulativ	**303**	**1,658**	**359**	**12**	**349**	**1,012**	**2,540**	**4,029**	

Shënim: të gjitha zërat nuk e përfshijnë TVSH-në dhe inflacionin; të gjitha qelizat janë në mijë USD, vetëm nëse përcaktohet ndryshe.

Figura 10: Modeli financiar bazë

Modeli tregon se, duke filluar nga Viti 7 e më pas, projekti do të gjenerojë një tepricë prej afërsisht 1.5 milionë USD në vit.

Parashikohet se fondet e akumuluara do të përdoren nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit për të paktën (a) vazhdimësinë e punimeve thelbësore për konservimin e sitit, (b) përditësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe shërbimeve të sitit (automjetet, varkat, etj.), (c) ofrimin e fondeve dhe burimeve për aktivitetet në komunitet dhe (d) ndërhyrjet e mëtejshme në Zonën A3 dhe në mbarë Parkun Kombëtar, siç rekomandohet në seksionet e tjera të këtij Plani Biznesi.

3.7 Punimet për konservimin e sitit (rreshtat 2 dhe 15)

Qasja e rekomanduar për konservimin e Zonës A3 duhet të synojë ruajtjen e sa më shumë informacioneve, në formë fizike të gërmuar më parë, për brezat e ardhshëm, ndërkohë që ruhet "identiteti i vendit" si një monument unik.

Gjatë përdorimit të kësaj qasjeje, ekipi P+P u drejtua nga pjesëtarë të ekipit konsultues, veçanërisht nga Richard Hodges dhe Oliver Gilkes, të cilët kanë një përvojë të gjatë me gërmimet dhe punimet brenda dhe rreth Butrintit, mbi rreth tridhjetë vitet e fundit, po ashtu nga profesionistë të tjerë të trashëgimisë, duke përfshirë arkitekten për konservimin, Lejla Hadzic.

Qasja e rekomanduar për të gjitha punimet (nga konservimi, te rinovimi e deri te ndërtimi nga e para) është një qasje minimale, me ndërhyrje të vogla në strukturë, dhe duke respektuar kuptimin e vendit. Çfarëdo lloj qasje tjetër jo vetëm që do të cenonte punën e shkëlqyer dhe novatore të Fondacionit Butrinti, por do të ishte një akt i papërligjshëm ndaj vetë strukturës dhe mirëqenies së një prej siteve më të rëndësishme në Shqipëri dhe në të tërë Mesdheun.

Kanë lindur debate në lidhje me përkufizimet e "restaurimit" dhe "konservimit", të cilat janë kyçe për të ardhmen e Butrintit. Zgjidhja e këtij debati është thelbësore për të ardhmen e Butrintit, dhe përtej tij.

Dallimi kryesor qëndron në faktin që *konservimi* mbron strukturën e sitit për të mundësuar brezat e ardhshëm të vrojtojnë çdo fazë të zhvillimit të sitit, ndërsa *restaurimi* e fikson monumentin në një datë të supozuar në të kaluarën, duke mos mundësuar kërkimet dhe vrojtimet në të ardhmen.

Restaurimi për një periudhë të caktuar është tërësisht i përshtatshëm për prezantimet e realitetit virtual dhe modelet e ndërtimit me inteligjencë artificiale, duke qenë se mund të kuptohen lehtësisht, të vlerësohen nga vizitorët, të riprodhohen për periudha të ndryshme historike dhe të aksesohen nga formate të ndryshme nëpërmjet rrjeteve sociale dhe platformave të tjera dixhitale. Pra,meqenëse janë virtuale, këto modele nuk e prekin dhe nuk e dëmtojnë në asnjë mënyrë strukturën kryesore të sitit: praktikat e konservimit e ruajnë strukturën për brezat e ardhshëm.

Butrinti duhet të jetë i veçantë. Nëse synohet të bëhet model për pjesën tjetër të Shqipërisë, Ballkanin dhe Mesdheun lindor, Butrinti duhet të përpiqet të mirëmbajë integritetin e vendit, t'iu drejtohet brezave të ardhshëm, të angazhojë komunitetet vendase, të ruajë përzierjen e vendit antik dhe peizazhit modern në mënyra që na pasurojnë të gjithëve.

Pas së gjithash, asgjë nuk krahasohet me të qenit i pranishëm fizikisht: të shohësh, të përjetosh, të ndjesh mënyrën se si kanë evoluar peizazhet kulturore dhe natyrore dhe se si janë ndërthurur për të krijuar panoramën që shihet sot e kësaj dite.

Për këtë arsye, qasja e rekomanduar e këtyre punimeve është planifikimi dhe prioritizimi i monumenteve pa mure rrethuese, vetë muret, sitet jashtë mureve, mozaikët dhe sipërfaqet e pikturuara dhe të suvatuara.

Qasja e ndjekur nga Fondacioni Butrinti për mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të sitit është qasja që tregon se identiteti i vendit ruhet *si një përparësi absolute* përgjatë të gjitha punimeve të ardhshme. Kjo është pranuar si mënyra *de facto* për të ecur përpara, në të kundërt sitit do t'i zvogëlohej rëndësia.

Çmimet dhe kostot për të gjitha vëllimet lidhur me nevojat totale të investimit në konservim janë të bazuara tek Udhëzuesi Shtetëror për restaurimin dhe janë përgatitur në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

Për qartësim, çmimi i çdo njësie i përdorur në përllogaritje përfshin punën, taksën, dhe të gjitha kostot përkatëse. Megjithatë, duke qenë se nuk janë zhvilluar projekte të detajuara konservimi hartuar për secilin nga monumentet/muret/mozaikët/afresket, ne kemi rritur paksa çmimin për njësi, për të mundësuar përfshirjen e ndërhyrjeve të ndryshme shtesë pasi të jenë zhvilluar propozime të plota për konservimin e çdo monumenti/muri/mozaiku/afresku.

Përveç kësaj, buxheti i detajuar bazohet mbi konsiderata realiste dhe të detajuara për zonën, vëllimet dhe ndërhyrjet dhe jep rezultate të parashikuara, që nuk përbëjnë shqetësim për punimet e konservimit dhe mirëmbajtjes.

Gjatë kohëzgjatjes së këtij Plani Biznesi, modeli financiar parashikon një ndërhyrje prej 2.92 milionë USD për punimet me kapital të konservimit (duke përfshirë të gjitha punimet kryesore/të shtyra dhe kontigjencën prej 10%) dhe 0.58 milionë USD shtesë (duke përfshirë kontigjencën prej 10%) për mirëmbajtjen e vazhdueshme të strukturës së rrënojave historike: në total 3.94 milionë USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%).

Kostoja e konservimit (rreshti 2) përfshin një shumë prej 132.000 USD (duke përfshirë një kontigjencë prej 10%) për sigurimin e ndriçimit dhe CCTV-së në të gjithë pjesën e Qytetit Antik të Zonës A3 dhe qendrën e re të vizitorëve. Shuma përfshihet në kostot e përcaktuara në Shtojcën C të Planit të Menaxhimit të Integruar, pasi instalimi i tij do të kërkojë një qasje të bazuar në konservim për vendet dhe metodat specifike. Kostoja gjithashtu përfshin tarifat për studimet e nevojshme të projektimit.

Për sa i përket shpenzimeve kapitale kjo përkthehet në 43% të të gjitha fondeve të alokuara për punimet kapitale, të përcaktuara në Planin e Biznesit dhe është pasqyrim i (a) rëndësisë së këtyre punimeve nga ana e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit dhe (b) mungesës së investimeve nga Ministria e Kulturës gjatë viteve të fundit për këto ndërhyrje thelbësore.

Është përcaktuar që Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit të investojë mesatarisht në vit rreth 404.000 USD duke nisur nga Viti 2 e më tej për ndërhyrje të reja konservimi, po ashtu dhe 75.000 USD shtesë në vit për mirëmbajtjen e përgjithshme të strukturës arkeologjike. Sipas të gjitha standardeve,kjo përfaqëson një angazhim serioz dhe të vazhdueshëm nga ana e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit për mirëqenien thelbësore të Zonës Arkeologjike.



Kostot e konservimit

Ndërhyrjet kapitale Mirëmbajtja vjetore

Figura 11: Krahasimi ndërmjet punimeve kapitale dhe punimeve të të ardhurave për konservimin e sitit (duke përfshirë kontigjencën prej 10%)

Shpenzimet e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit fillojnë në Vitin 1, pas periudhës tranzitore, gjatë marrjes së përgjegjësive menaxheriale dhe fillojnë me një investim 1.27 milionë USD për katër vitet e para për punimet kapitale të konservimit të sitit (Viti 1-4).

3.8 Gërmimet e reja arkeologjike

Gërmimet e vazhdueshme dhe të fokusuara kërkimore janë jetësore për çdo sit arkeologjik, duke përfshirë dhe Butrintin.

Për shkak të statusit ndërkombëtar të Butrintit, këto punime duhet të programohen në mënyrë profesionale me qëllime të qarta kërkimore, të ndërmerren duke u bazuar te standardet më të mira ndërkombëtare, të regjistruara dhe të publikuara në revistat akademike, dhe duhet ta lënë sitin në një gjendje konservimi të qëndrueshme dhe të përmirësuar.

Ndërkohë që Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do t'i nxisë këto kërkime nga universitete të mirëbesuara dhe organizata dhe ekspertë të tjerë, ai pret dhe i paraprin faktit se çdo financim do të bazohet te projektet dhe do të financohet nga të tjerët, duke përfshirë financimin për konservimin pas gërmimeve, kurimin e artefakteve, publikimin dhe të gjitha shpenzimet ndihmëse (duke përfshirë zëvendësimin e stafit të sitit në bazë projekti, nëse shihet e arsyeshme dhe e nevojshme).

Duke qenë se roli i Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit është që të menaxhojë burimet e sitit, dhe të mos veprojë si një ekspert në këtë aspekt, Fondacioni do të mbështetet tek Instituti i Arkeologjisë dhe te Grupi Kërkimor i Butrintit për të propozuar dhe rekomanduar një sërë gërmimesh të planifikuara

gjatë shtatë viteve të para të këtij Plani Biznesi, pasi ka të ngjarë që siti të marrë disa propozime për gërmime gjatë kësaj periudhe[42].

Siç u shpreh edhe më sipër, kostot e të gjitha këtyre punimeve nuk përfshihen në bilanc, për sa i përket Planit aktual të Biznesit. Megjithatë, çfarë do lloj kërkimi (arkeologjik, biodiversiteti, komunitar etj.) do të mbështetet nëpërmjet aplikimeve për grante nën drejtimin e Grupit Kërkimor të Butrintit.

3.9 Qendra e re për vizitorët (rreshti 3)

Shumë Site të Trashëgimisë Botërore i konsiderojnë qendrat e vizitorëve si një mjet për të përmirësuar dhe menaxhuar përvojën gjatë vizitës dhe për të gjeneruar të ardhura. Shembujt më të fundit tregojnë struktura moderne të posaçme të ndërtuara posaçërisht ose që ndodhen brenda zonës kryesore të Sitit të Trashëgimisë Botërore, ose rreth Zonës Buferike, ndaj duhet të jenë në përputhje me parashikimet e rrepta për Planifikimin, veçanërisht me përfshirjen e UNESCO-s[43].

Qëllimi fillestar i këtij Plani Biznesi ka qenë promovimi dhe zhvillimi i një konkursi ndërkombëtar arkitekturor për një qendër të re vizitorësh në Butrint, e cila do të ndërtohet si një godinë dykatëshe prej 700 m^2 (kati përdhe dhe kati i parë) me një planimetri (sipërfaqja totale e brendshme; SBB) prej 350 m^2.

Kjo është plotësisht në përputhje me vendparkimin prej 1,640 m^2 në krye të skarpatit (Figura 12) dhe do të ofrojë hapësirë të mjaftueshme për një numër të caktuar autobusësh dhe makinash, që mund të parkohen dhe të manovrojnë pa pasur nevojë për zgjerim të sipërfaqes ekzistuese.

Askujt nuk i intereson që të krijohen radhë të gjata. Për këtë arsye, si pjesë e fazës tranzitore, janë propozuar dhe kostuar studime të transportit dhe lëvizjes/menaxhimit të vizitorëve, në mënyrë që të mund të kryhet konfigurimi përfundimtar i të gjitha rregullimeve të hyrjes, duke përfshirë ato përmes qendrës së propozuar të vizitorëve, përmes automjeteve private, dhe autobusëve.

Përcaktimi i problemeve dhe të drejtave të pronësisë së tokës i takon Shtetit. Për shkak të mosmarrëveshjes së vazhdueshme, që lidhet me pronësinë e tokës, nuk ekziston asnjë titull i qartë pronësie për sipërfaqen prej 1.640 m^2 të vendparkimit për makinat. Duke marrë në konsideratë rrethanat dhe rëndësinë e ndërtimit të qendrës së vizitorëve në këtë zonë, për zbatimin e Planit të Biznesit, është e nevojshme që *qeveria të ndërmarrë hapat e duhur* për të garantuar që toka të përdoret në të mirë të Butrintit.

Në rast se vendimi i gjykatës e njeh titullin e pronësisë së kësaj toke për pronarët privatë, supozohet se qeveria do t'i kompensojë me përpikëri pronarët për vlerën e pronës së paluajtshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Pra, në këtë rast kostot e shpronësimit përllogariten si më poshtë, duke u bazuar te vlera e pronës së paluajtshme, e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 89, të datës 3 shkurt 2016, për këtë sipërfaqe. Për më tepër, përmenden edhe kostot për lidhjen e sitit me shërbimet kryesore.

[42] Për shembull, aktualisht ekziston një propozim nga Universiteti i Notre Damit, nën mbikëqyrjen e Dr. David Hernandez, për të ndërmarrë një projekt thelbësor për sitin e Forumit Roman gjatë vitit 2019.

[43] Për shembull, qendra e re e vizitorëve në Stounhexh ndodhet brenda Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe ishte objekt i debateve shumëvjeçare midis palëve të interesit dhe agjencive ligjzbatuese. Qendra e vizitorëve në Giant's Causeway, Sit i Trashëgimisë Botërore në Irlandën e Veriut, i hapur në vitin 2013, është një homolog i denjë i Butrintit, nëse krahasojmë vendndodhjen bregdetare shkëmbore dhe përshtatjes së projektimit me topografinë e sitit.



Figura 12: Vendet kryesore të përmendura në tekst

Shpronësimi i truallit të qendrës së vizitorëve dhe kostot e infrastrukturës mbështetëse	mijë USD
Shpronësimi (nëse do të ketë)	40
Kanalizimet	900
Elektriciteti dhe Interneti	120
Totali	**1.060**

Figura 13: Kostot e përllogaritura për shpronësimin dhe infrastrukturën e sipërfaqes së qendrës së propozuar të vizitorëve (rreshtat 11 dhe 12 referuar Figurës 10).

Supozohet se qendra e vizitorëve do të ndërtohet si një fazë e vetme zhvillimore gjatë dy viteve që përfshin të gjitha aspektet nga kërkimi, fizibiliteti, projektimi, ndërtimi dhe rregullimet.

Kostot e ndërtimit për ndërtesa të këtij lloji në Jug të Shqipërisë nuk janë të lehta për t'u vlerësuar.

Kërkimet në vend sugjerojnë kostot e përgjithshme, duke përfshirë studimet e fizibilitetit, projektimin, rregullimet dhe ndërtimin brenda shifrës prej 2.9 milionë USD[44], ku shuma përfshin një kontigjencë prej 10%.

[44] Për më tepër, është bërë krahasimi i detajuar me një qendër të ngjashme (dhe të njohur) për vizitorët në Mbretërinë e Bashkuar, duke u bazuar te kontrata me një pagesë në Juglindje të Anglisë, që arriti raportin 3.700 USD/m^2 te çmimet e T1 për vitin 2019. U përjashtuan kostot e përgatitjes së sitit, punimeve të jashtme dhe shërbimeve të ardhshme. Gjithashtu, u përjashtuan edhe tarifat për profesionistët, TVSH-ja dhe kostot e paparashikuara për sitin. Si rrjedhojë, jemi besimplotë se 2.9 milionë USD, të përfshirë në këtë Plan Biznesi (duke përfshirë kontigjencën prej 10%) është një shifër tërësisht e nevojshme, së bashku me faktin se punimet do të kryhen në Shqipëri, duke përdorur materialet vendase, aty ku është e mundur. Ky raport përfshin përshtatjet e përgjithshme, përveç interpretimit, që llogaritet në një pjesë tjetër në këtë Plan Biznesi.



Figura 14: Komponentët e propozuar për qendrën e re të vizitorëve

Monitorimi arkeologjik për çdo mbetje arkeologjike është qartësisht thelbësor gjatë punimeve fizike të zhvillimit, kostoja e të cilit duhet të mbartet nga projektuesi, siç ndodh kudo tjetër.

Si rrjedhojë, për këtë zhvillim të propozuar parashikohet buxheti i përgjithshëm prej 2.9 milionë USD, (duke përfshirë kontigjencën prej 10%), për të përfshirë ndërtimin, furnizimin, shërbimet, dhe tarifat e projektimit.

Përveç rritjes së konsiderueshme të profilit turistik të Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe Parkut Kombëtar, qendra e re e vizitorëve në Butrint do të mundësojë:

1. Rregullimin e fluksit së vizitorëve në Zonën A3, sidomos gjatë muajve të verës
2. Politikat e reja të biletave dhe disponimi i zyrave për stafin administrativ
3. Përmirësimi i përvojës së vizitorëve dhe i lokaleve
4. Orientime, interpretime dhe informacione që i përshtaten Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe Parkut Kombëtar
5. Mjete të qëndrueshme për aksesin dhe transporti deri në hyrjen (e re) të sitit, në këmbë ose me transport të qëndrueshëm
6. Reduktimi i ndjeshëm i dërgesave në strukturat aktuale të Akropolit
7. Ofrimi i lehtësimeve të reja interpretative dhe edukative në Kalanë Veneciane në Akropol
8. Përmirësimi i ndjeshëm i mundësive të shitjes me pakicë, duke përfshirë edhe mundësi për artizanët vendas
9. Aksesi në zona bregdetare dhe ligatinore të Parkut për ecje në natyrë, vrojtim zogjsh, vozitje, etj.

Më poshtë mund të gjeni një plan fillestar të akomodimit:

Sipërfaqja	m^2
Hyrja/Biletaria	78
Hapësira orientimi	60
Lokal	90
Kuzhina	35
Ekspozita/Interpretimi	160
Tualetet	56
Ndërmarrje/Shërbime	20
Shitje me pakicë/Artizanët	52
Monitor me informacione/hapësira edukative	54
Mobiliet/ Magazinimi i pajisjeve	25
Zyra e administratorit/ Magazina	30
Zyrat e stafit	40
Totali	**700**

Figura 15: Qendra e vizitorëve: axhenda fillestare e akomodimit, vlerësuar në dy fazatë barabarta

Qendra e vizitorëve është pikënisja e vizitës për në Qytetin Antik dhe vepron si portë hyrëse për aktivitete të ndryshme shtesë dhe mundësi komerciale, si pranë Qytetit Antik ashtu edhe përreth:



Figura 16: Mundësitë që paraqiten në mbarë sitin dhe itineraret e transportit

3.10 Akomodimi i stafit, strukturat në hyrje dhe rrethimi i sitit (rreshti 4)

Duhet të merret në shqyrtim aksesi i sitit, duke përfshirë hyrjen kryesore të sitit dhe gardhin ekzistues rrethues, që duhet të përmirësohen me një skemë të re sinjalizuese sipas markës së Butrintit, që do të krijohet.

Akomodimi aktual i stafit të sitit në hyrje është tërësisht i papërshtatshëm. Nuk ka hapësirë mjaftueshëm për të punuar, aksesi në internet nuk është i mirë dhe nuk ka salla takimesh, nuk ka hapësirë për magazinimin e pajisjeve dhe as akses direkt në tualete. Këto shqetësime duhet të adresohen si prioritete, për të mirën e stafit dhe sitit në tërësi.

Një shtesë e ambientit ekzistues të biletarisë në hyrje të sitit, me një sipërfaqe dhe vëllim sa struktura aktuale (pra do të krijohet një sipërfaqe totale prej rreth 175 m^2), do të ofronte një sipërfaqe të bollshme, për stafin bashkë me një kuzhinë të vogël dhe tualet. Nëse ndërtohet me materialet e duhura dhe çati të ngritur, ndërhyrja që do bëhet do të ketë ndikim minimal në arkeologji[45].

Për punimet në Vitin 1 është parashikuar buxheti prej 300.000 USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%), me idenë se shuma do të mbulojë edhe përmirësimin e shtigjeve të rrezikshme, të pambuluara diku tjetër, dhe do të përballet me çdo çështje të papritura sigurie, për sa i përket rrethimit të sitit, pranë hyrjes kryesore, dhe me përmirësimin e sipërfaqes së vendparkimit të makinave, pranë lundrës.

Rekomandohet që planimetria e sigurisë/rrethimit të jenë në përputhje me atë të vjetrën, sa mund të jetë e mundur, me qëllim shmangien e shqetësimeve të mundshme arkeologjike. Elementet e rrethimit prej betoni të periudhës komuniste duhet të ruhen për qëllime interpretimi dhe historie.

Vendparkimi ekzistues i makinave në hyrjen kryesore, pranë lundrës, do të përdoret si pikë kthimi për autobusët elektrikë dhe si pikë ankorimi për varkat. Gjithashtu, është e mundur që me menaxhimin e kujdesshëm të trafikut, siti mund të përdoret edhe si sipërfaqe për artizanët, siç ndodh në shumë site arkeologjike, duke përfshirë Pompein dhe Herkulaneumin. Po ashtu, në vendparkimin e makinave ekspozohen rrënoja arkeologjike, të cilat duhet të interpretohen. Kostoja e këtyre punimeve me ndërhyrje të lehta përfshihet në planin e biznesit, nëpërmjet kostove kapitale për ankorimin dhe të përmirësimit të sipërfaqes hyrëse në përgjithësi.

Këto kosto mund të përllogariten si:

Aksesi në sit	mijë USD
Shtesë e re te ndërtesa në hyrje (1)	210
Përmirësimi i shtigjeve (2)	25
Rrethimi	45
Përmirësimi i sipërfaqes ekzistuese për vendparkimin e makinave	20
Totali (duke përfshirë kontigjencën prej 10%)	**300**

(1) Totali, duke përfshirë mobilimin me 1200 USD/m2

(2) Nuk mbulohet nga punimet e konservimit

Figura 17: Kosto të aksesit në sit

3.11 Interpretim i ri në Kalanë Veneciane (rreshti 5)

Propozimet e mëparshme për qendrën e re të vizitorëve përfshinin ambiente për një ekspozite dhe muze të ri, si pjesë e shërbimit të orientimit të vizitorëve në sit. Kjo përfshinte riekspozimin e artefakteve që tani janë të ekspozuara në Kalanë Veneciane bashkë me materiale të tjera që ruhen në Universitetin e Tiranës dhe gjetkë.

Prandaj, rekomandohet që muzeu ekzistues në Kalanë Veneciane t'i nënshtrohet rinovimit dhe ekspozimit.

[45]Kërkimet tregojnë se kjo zonë është kënetore dhe përbëhet nga material pas gërmimit të Ugolinit në vitet 1920 dhe 1930. Ndërkohë që nevojitet dhe rekomandohet të bëhet kujdes, nëpërmjet vëzhgimit arkeologjik, është arritur në përfundimin që kjo ndërhyrje në sit është plotësisht e përshtatshme.

Kjo mbështetet nga dëshmi historike të besueshme, si përdorimi i ndërtesave nga Ugolini në vitet 1930, dhe e mira do të ishte që të pasonte turet me udhërrëfyes.

Siti gjithashtu ofron pamje spektakolare të Kanalit të Vivarit, sitit të kolonisë romake në fushën e Vrinës, të fshatrave përreth dhe peizazhit të tyre historik. Akropoli ofron tualete (për t'u freskuar) dhe një lokal të vogël, aktualisht i menaxhuar privatisht.

Si në sit ashtu edhe gjetkë, ka një sërë materialesh për konkurse ndërkombëtare, me qëllim transmetimin e historinë e sitit nëpërmjet artefakteve dhe dëshmive të tjera të lidhura me të.

Duhet të mirëpriten edhe qasje të reja për interpretim dhe nuk ka arsye përse ky program të mos prekë edhe Zonën A3 në tërësi.

Një buxhet i konsiderueshëm (600.000 USD, duke përfshirë kontigjencën prej 10%) është hequr mënjanë për këtë aspekt, që përputhet me normat ndërkombëtare për mbulimin me USD/ m^2, për një muze të standardeve ndërkombëtare brenda një mjedisi historik. Kjo shumë përfshin edhe punimet për rinovimin e tualeteve dhe sipërfaqeve të tjera, po ashtu dhe ofrimin e sipërfaqeve të përkohshme dhe me strehë gjatë muajve të verës, së bashku me përditësimin e dyqaneve arkeologjike të vitit 2006, të themeluara nga Fondacioni Butrinti. Në total, buxheti prej 600.000 USD, duke përfshirë të gjitha tarifat dhe produktet, mbulon mbi 400/m^2, në një raport prej 1.500 USD/m^2.

Një çështje tjetër për t'u marrë në konsideratë është transferimi i artefakteve aktualisht nën menaxhimin e Institutit të Arkeologjisë brenda parkut, të vendosura kryesisht në Kalanë Veneciane. Disa prej tyre do të përdoren si pjesë e ekspozitës së re në Kala, disa të tjera mbase në Fortesën Trekëndore, dhe disa në qendrën e re të vizitorëve të propozuar. Nëse do të kërkohej një vend për shtesë për ruajtjen e tyre, mbase mund të përdoret një ndërtesë tjetër në qytetin e Sarandës. Buxhetet në lidhje me këtë përfshihen në buxhetet individuale për ndërhyrjet e ndryshme kapitale.

Kafeneja e vogël pranë Kalasë Veneciane drejtohet nga një palë e tretë, me marrëveshje qiraje me Ministrinë e Kulturës. Ky ambient duhet të ruhet dhe të vendoset nën menaxhimin e Sitit. Megjithatë, marrëveshja e qirasë duhet të rishikohet në aspektin e rregullave të reja të ofruara nga kuadri ligjor i trashëgimisë kulturore dhe të miratohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Aktualisht, të ardhurat nga ky burim *përjashtohen* nga Plani i Biznesit.

3.12 Interpretim i ri i Fortesës Trekëndore (rreshti 6)

Fortesa Trekëndore është një nga objektet historike më të dukshme dhe madhështore në Butrint, aktualisht e mbyllur për publikun dhe rrjedhimisht nuk ka shumë interpretime.

Fortesa është vendi ideal për të interpretuar rolin dhe ndikimin e venecianëve në Butrint (bashkë me të edhe arkeologjinë pas-klasike në përgjithësi), ku, për ta vizituar udhëtohet me lundër përmes Kanalit të Vivarit.

Vetë Fortesa ka nevojë për konservim dhe këto punime janë përfshirë te ndërhyrjet në rreshtin 2 të Planit të Biznesit.

Gjithashtu, ajo ka një oborr të brendshëm mjaft të madh për komunitetin dhe kryerjen e veprimtarive të tjera, disa prej të cilave zhvillohen momentalisht (për shembull, gjatë kohës së vjeljes).

Në Planin e Biznesit janë hequr mënjanë 150.000 USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%) për interpretimin e Fortesës Trekëndore, shifër shumë më e lartë sesa ajo për punimet për konservimin e sitit. Nëse parashikohet që interpretimi i sitit në tërësi do të lihet si kontratë më vete, atëherë mund të jepet një përllogaritje tjetër.

Megjithatë, do të ishte me vend që të ruhej shuma prej 150.000 USD, duke marrë në konsideratë se strategjitë e detajuara të interpretimit nuk janë hartuar ende. Siti ofron hapësira të brendshme rreth 350m^2 brenda një hapësirë të mbrojtur prej rreth 1.400 m^2.

3.13 Hotel Livia

Hotel Livia është ndërtesa më e madhe jo historike dhe me akses të plotë kudo në Qytetin Antik. Ai është ndërtuar pjesërisht mbi varrezat romake 1C, duke shkatërruar kështu një pjesë të konsiderueshme .

Hoteli ofron ambiente kafeneje dhe restoranti në një kopsht të këndshëm me hije, që frekuentohet nga vizitorët. Hoteli ka edhe 12 dhoma që rezervohen në bazë sezoni. Ndërkohë që mund të mirëmbahet struktura e kateringut në katin e parë, kjo ndërtesë *mund* të shndërrohet në një qendër burimesh arsimore për grupet shkollore dhe studiues nga Grupi Kërkimor i Butrintit i propozuar bashkë me zyrat për stafin e sitit në katet e sipërme në planin afatgjatë.

Nga ana tjetër, hoteli mund të bëhet pjesë e sitit nën pronësinë dhe menaxhimin e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, si një hotel me funksionim të plotë, të ardhurat e të cilit do të ndihmojnë në mirëmbajtjen e Zonës A3. Kjo ka ndodhur edhe në raste të tjera, duke përfshirë projektet në të cilat kanë punuar P+P.

Rekomandohet që Hotel Livia *duhet* të blihet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit dhe të bëhet pjesë e menaxhimit të Zonës A3, sa më shpejt që të jetë e mundur. Megjithatë, për sa i përket Planit aktual të Biznesit, *nuk është bërë asnjë supozim për të ardhmen e tij*.

3.14 Shtëpia e Doganës

Kompleksi i ndërtesave brenda dhe rreth Shtëpisë së Doganës në brigjet e Kanalit të Vivarit përballë Kalasë së Ali Pashës, tregon elemente të shkëlqyer të arkitekturës mbrojtëse të periudhës Komuniste, duke nisur nga platformat e artilerive deri te bunkerët e vegjël. Shtëpia e Doganës, ndërtuar mbi themelet e një vile romake buzë detit, ofron pamje spektakolare nga Kanali i Vivarit, Gjiri i Butrintit dhe Deti Jon.

Jo më larg se 1.5 km nga qendra e propozuar e vizitorëve, që mund të aksesohet nga automjete 4x4, siti mund të shndërrohet për akomodim hoteli. Mund të jetë propozim interesant, për nga pikëpamja e vendit dhe domethënies së tij.

Duke qenë se siti është teknikisht jashtë Zonës A3 (fokusi i Planit të Biznesit), ai duhet të merret në konsideratë si një *opsion* për Fondacionin e Menaxhimit të Butrintit, pasi kthimet në atë hotel, me restorante dhe shërbime të tjera, mund të jenë thelbësore dhe do të garantonin një të ardhme të qëndrueshme për sitin, nën menaxhimin e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit.

Ashtu si me Hotel Livian, *ky sugjerim nuk është përfshirë në parashikimet financiare*, duke qenë se nuk ka asnjë model, apo program, për investimin kapital për Shtëpinë e Doganës. Megjithatë, kjo mbetet një mundësi që duhet zbuluar edhe më tej, që sugjerohet të kryhet gjatë periudhës tranzitore.

3.15 Interpretimi i ri i sitit (rreshti 7)

Zbatimi i programit të zhvillimit paraqet mundësinë për të rishikuar interpretimin ekzistues të sitit në tërësi.

Kjo mund të bëhet ose nëpërmjet angazhimit të rojtarëve të trajnuar dhe/ose nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne. Përdorimi i mjeteve teknologjike është më i pëlqyer, dhe në këtë kuadër duhet

të ndërmerret një studim i veçantë për të mbikëqyrur interpretimin e sitit me anë të mjeteve digjitale, mbase nëpërmjet platformave në telefona inteligjentë,, në gjuhë të ndryshme.

Studimi duhet të kryhet përpara hapjes së qendrës së re të vizitorëve si pjesë e periudhës tranzitore, për një ofertë më të gjerë interpretimi, që do të fillojë me t'u hapur qendra e re e vizitorëve. Cilado metodë të zgjidhet, duhet të jetë e matur dhe e kthyeshme, si dhe t'i shtojë vlera sistemit ekzistues informues me panele interpretimi, që përdoren aktualisht.

Për kërkimet, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e këtyre punimeve parashikohet një buxhet prej 175.000 USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%).

Megjithatë, nëse ky buxhet do të alokohej brenda periudhës së riekspozimit të muzeut në Kalanë Veneciane dhe në Fortesën Trekëndore me anë të një pakete të vetme interpretimi të punimeve në të gjithë sitin, atëherë do të gjeneroheshin më tepër të ardhura. Por, buxheti aktual duhet të mbahet në këtë fazë.

3.16 Buxheti i interpretimit i të gjithë sitit

Modeli financiar bazë tregon se buxhetet për interpretimin e sitit (ndryshe nga ato për qendrën e re të vizitorëve) janë të shpërndara në tre elemente kryesore: (a) Kalaja Veneciane, (b) Fortesa Trekëndore dhe (c) në mbarë sitin. Në total, këto përfshijnë një investim kapital total prej 925.000 USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%) ose mbi 11% të të gjithë investimit kapital.

3.17 Varkat e pasagjerëve, platformat lundruese dhe vendparkimi i makinave në hyrje (rreshti 8)

Mënyra nëpërmjet së cilës qendra e vizitorëve do të mundësojë menaxhimin e vizitave në sit, krijon një sërë mundësish për vendasit dhe komunitetet e tyre për të përfituar me anë të shërbimit të transportit ndërmjet qendrës së vizitorëve, Qytetit Antik dhe zonave të tjera të Parkut Kombëtar.

Dy mënyra kryesore janë të disponueshme: (a) përdorimi i autobusëve ekologjikë drejt dhe nga qendra e re e vizitorëve në portën e hyrjes; dhe (b) përdorimi i varkave elektrike nga disa pikënisje në Zonën A3 drejt vendeve më të largëta në liqenin e Butrintit, si Diaporiti, Kalaja e Ali Pashës dhe kudo tjetër.

Sipas Planit të Biznesit, infrastruktura e nevojshme për të dyja veprimtaritë do të sigurohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, pasi nuk mund të priten investime të tilla nga vendasit. Nga ana tjetër, të gjithë operatorët e shërbimit të transportit (tokësor dhe ujor) do të duhet të licencohen, t'u nënshtrohen inspektimeve të rregullta dhe do t'u kërkohet të promovojnë "markën Butrinti", për t'u dalluar si operatorë të besueshëm.

Ka të ngjarë që kjo të marrë pak kohë për t'u zbatuar, veçanërisht në aspektin e Planifikimit dhe aksesit në Liqenin e Butrintit, nëpërmjet rrjetave ekzistuese të peshkimit përballë Qytetit Antik. Punimet duhet të përfshijnë edhe rimodelimin e vendparkimit të makinave në hyrjen kryesore të sitit, pranë lundrës.

Modeli financiar tregon se kthimet e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit gjatë një viti të qëndrueshëm nuk do të jenë më shumë se 31.000 USD, duke supozuar se 10% e të gjitha faturave do t'i paguhen Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit dhe 90% do të mbahen nga operatorët, të cilëve do t'u kërkohet që të mirëmbajnë varkat, sipas standardeve të vendosura nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit nëpërmjet marrëveshjes së licensimit. Duke qenë se operatorët e autobusëve paguhen për punën e tyre, kthimet në modelin financiar janë neto.

Gjatë shtatë viteve të këtij plani biznesi, një kthim modest i tillë mbulon koston e investimit kapital prej 175.000 USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%).

Investimi kapital është ndarë në këtë mënyrë:

Zërat	mijë USD
Varkat për pasagjerë	75
Platformat dhe infrastruktura që lidhet me to	50
Vendparkimi i makinave	50
Totali	**175**

Figura 18: Varkat e pasagjerëve, platformat lundruese dhe vendparkimi i makinave

Vini re se këto janë buxhete dhe janë subjekt i projektimit të detajuar dhe studimeve të fizibilitetit.

Parashikohet se rreth 90% e vizitorëve do të përdorin autobusët për transportin vajtje-ardhje nga Qyteti Antik. Kjo nënkupton se ky lloj transporti do të përdoret nga 236.000 vizitorë në Vitin 4, me 5.865 udhëtime me autobus dhe mesatarisht 40 persona për udhëtim ose 17 udhëtime në ditë. Pa dyshim, këto udhëtime do të rriten në mënyrë të konsiderueshme gjatë muajve të verës. Për shembull, nëse kapaciteti do të ishte për 12 udhëtime, duke përdorur dy autobusë për 8 orë = 72 x 40 = rreth 4.000 vizitorë në ditë ose 120.000 vizitorë në muaj gjatë muajve me më shumë fluks, çka është më shumë se e përshtatshme, duke pasur parasysh numrin e parashikuar të vizitorëve (siç tregohet më vonë në këtë plan biznesi).

Por, kjo është më shumë sesa një kthim monetar; zotësia e banorëve vendas për të shfaqur aftësitë e tyre me mjetet ujore, angazhimi i drejtpërdrejtë me vizitorët dhe fitimi i parave janë tërësisht pozitive për Sitin në tërësi dhe kontribuon së tepërmi në ngritjen e kapaciteteve në komunitet. Në skemën e madhe të kthimeve të projektuara vjetore të Butrintit, shumica e kthimit, ndërkohë që është minimale për këtë aktivitet, i shtohet (a) punësimit të banorëve vendas dhe (b) kënaqësisë së vizitorëve, që mund të kthehen ose i nxisin të tjerët që ta vizitojnë sitin, duke qenë se aksesi nëpërmjet ujit për në Zonën Arkeologjike është një përvojë krejtësisht e re. Për më tepër, reflekton mënyrën se si është aksesuar qyteti thuajse gjatë të gjithë historisë së tij.

Por, kuptohet se ndërtimi i një skele për ankorimin e mjeteve ujore do të ishte subjekt i ligjit. Në këtë aspekt, propozimet parashikojnë konsultime me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Gjithashtu, mund të nevojitet edhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor. Një tjetër çështje është licensimi formal i këtyre aktiviteteve nga qeveria.

3.18 Mjetet e transportit të sitit (rreshti 9)

Shuma kapitale prej 71.000 USD (ose 78.000 USD kur shtohet kontigjenca prej 10%) është për blerjen e dy automjeteve 4x4 dhe dy varkave elektrike, për përdorim nga rojtarët e sitit dhe pjesëtarët e tjerë të stafit[46].

3.19 Studimet e specializuara dhe konsultimet (rreshti 16)

Nuk ka dyshim se, veçanërisht gjatë periudhës tranzitore në Vitin 1, po ashtu dhe gjatë pjesës tjetër të Planit, duhen realizuar një sërë studimesh dhe përpjekjesh kërkimore të fokusuara për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Zonës A3 në termin afatgjatë, aq më pak për të përcaktuar rreziqet e përgjithshme që do të ndërmerren nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Këto përfshijnë, në renditje krejtësisht rastësore:

[46] Shembujt tipikë të automjeteve janë Toyota Hilux (37.000 USD) ose Mitsubishi Pajero (25.000 USD).Varkat me motorë elektrikë, bateri të përfshira (për dy persona dhe hapësirë për mjete, etj.) kushtojnë mesatarisht 2.500 USD.

1. Një studim hidrologjik mbi të gjithë vijën ujëndarëse të Parkut Kombëtar, për të informuar veprimet e përshtatshme për zbutjen e efekteve të rritjes së horizonteve ujëmbajtëse
2. Mbështetje të plotë gjatë periudhës tranzitore
3. Menaxhim i trafikut dhe studimeve të transportit, veçanërisht në lidhje me përdorimin e lundrës dhe efektshmërinë e transportit alternativ dhe të qëndrueshëm për vizitorët
4. Menaxhim i vizitorëve dhe anketime për nivelin e kënaqshmërisë së tyre, jetësore për një menaxhim të suksesshëm afatgjatë të sitit
5. Ofrim i trajnimit të detajuar dhe planeve për angazhimin komunitar për banorët vendas dhe të tjera si këto, në disa disiplina që lidhen me sitin
6. Plan biodiversiteti/ekologjik për Zonën A3 dhe Zonën Buferike, me monitorim vjetor
7. Plane për menaxhimin e shëndetit, sigurisë dhe fatkeqësive dhe përditësimi i tyre, veçanërisht në lidhje me rrezikun ndaj zjarrit dhe evakuimin emergjent të vizitorëve, stafit dhe artefakteve të lëvizshme, arkivave dhe dokumenteve të tjera.
8. Për më tepër, propozohet një periudhë mentorimi gjatë periudhës tranzitore, për të mundësuar përshtatjen e stafit me sitin, si dhe
9. Hartimi i një plani interpretimi për mbarë Parkun dhe për infrastrukturën e turizmit, rekomandimet e të cilit ka shumë të ngjarë që të zbatohen nga të tjerë.

Studimet e specializuara, konsultimet dhe monitorimi (mijë USD)	6m	V1	V2	V3	V4	V5	V6	V7	Totalet
Hidrologjike		45	25	10	10	10	10	10	120
Mbështetja për periudhën tranzitore	110	390							500
Menaxhimi i trafikut dhe transporti		30	10	10	10	10	10	10	90
Studimet dhe vrojtimet për menaxhimin e numrit të vizitorëve		20	10	10	10	10	10	10	80
Plani interpretues për mbarë parkun dhe infrastrukturën e turizmit		50	50						100
Plani për trajnimin		40	10	10	10	10	10	10	100
Plani i angazhimit të komunitetit		40	10	10	10	10	10	10	100
Plani ekologjik		40	10	10	10	10	10	10	100
Plani për shëndetin dhe sigurinë/plani për fatkeqësitë		20	10	10	10	10	10	10	80
Totalet	110	675	135	70	70	70	70	70	1270

Figura 19: Studimet e specializuara, konsultimet dhe monitorimi (duke përfshirë kontigjencën prej 10%)

Mbetet për t'u diskutuar nëse kostot e plota të këtyre aktiviteteve duhet të kryhen vetëm nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit apo nëse duhet të kontribuojnë edhe tre ministritë kryesore: Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Duke qenë se këto punime janë shumë të rëndësishme për Zonën A3, rekomandohet që, së paku gjatë dy viteve të para, kostot të mbulohen nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, pasi rezultatet do të jenë me përfitim të drejtpërdrejtë për të.

3.20 Grupi Kërkimor i Butrintit (rreshti 17)

Sitet e Trashëgimisë Botërore mund të përdoren si: (a) vende argëtimi dhe kënaqësie, (b) burime punësimi për komunitetet vendase, (c) rezervate për speciet e cenueshme, dhe (d) fokus për punën kërkimore. Fakti që ato *janë* Site të Trashëgimisë Botërore i dallon nga peizazhet e tjera dhe sugjeron se janë të denja për një studim të thelluar dhe për kërkim të vazhdueshëm në termin afatgjatë.

Butrinti është vërtet piktoresk. Ai nuk është vetëm i pasur në rrënojat arkeologjike, por përfaqëson një nga zonat arkeologjike më domethënëse dhe të shumëllojshme në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, ai është një peizazh që po formësohet: aktivitetet e fermerëve, peshkatarëve dhe të tjerëve kanë kontribuar për qindra vite me radhë në krijimin e vendit që shohim ditët e sotme. Ai është edhe një

peizazh në zhvillim: metodat e reja të blegtorisë dhe peshkimit, rrugët e reja, akomodimet e reja dhe infrastruktura e re janë duke u zhvilluar brenda dhe rreth Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe brenda Zonës së tij Buferike.

Tanimë ekziston një mundësi për krijimin e një grupi akademikësh dhe të tjerë, nga një sërë fushash dhe specialitetesh, që mund ta përdorin Parkun Kombëtar të Butrintit dhe Zonën A3 si zonë kërkimore dhe të japin kontributin e tyre në fushën kërkimore që është krijuar në sajë të mbështetjes së Fondacionit Butrinti dhe të të tjerëve, si pjesë e zbatimit të Planit të Menaxhimit të Integruar (ku Plani i Biznesit është dokument i lidhur). Si rrjedhojë, grupi kërkimor do të veprojë në cilësinë e një grupi akademik këshillues, nën krijimin dhe menaxhimin e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit.

Grupi Kërkimor i Butrintit mund të mbulojë shumë fusha akademike me kalimin e kohës, por disiplinat fillestare mund të përfshijnë arkeologjinë, historinë, gjeologjinë, hidrologjinë, ekonominë, inxhinierinë strukturore, ekologjinë, bujqësinë, historinë shoqërore dhe menaxhimin e trashëgimisë dhe vizitorëve.

Grupi duhet të drejtohet dhe të menaxhohet nga shqiptarë, dhe të ofrojë raportet e tij dhe rezultatet e tjera në të mirë të vendit në tërësi dhe, nëpërmjet kësaj, në të mirë të komunitetit ndërkombëtar.

Megjithatë, është thelbësore që Grupi të mos jetë i përfshirë vetëm me arkeologjinë, pasi ekzistojnë edhe çështje e disiplina të tjera që mund të përfitojnë nga ky kërkim. Gjithashtu, Grupit do t'i duhen terma të qarta të referencës për të garantuar ruajtjen e përhapjes së disiplinave. Kjo gjë do të vendoset gjatë periudhës tranzitore.

Roli i Grupit, i cili mbështetet financiarisht nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, është që të inkurajojë dhe të mbikëqyrë kërkimin dhe trajnimin në fushat e tij lëndore nga stafi profesionist, studentët dhe të tjerë në Shqipëri, në mënyrë që, me kalimin e viteve, të krijohet një bazë të dhënash e vlefshme dhe e besueshme me informacion kërkimor të cilësisë së lartë, nga ku mund të përcaktohen trendet dhe, nëse është e nevojshme, ndërhyrjet e rekomanduara në fushat kërkimore të Grupit. Kjo punë ka përfundime të rëndësishme për aspektet monitoruese të Planit të Menaxhimit të Integruar që zbatohet për të gjithë Parkun Kombëtar.

Asnjë Sit tjetër i Trashëgimisë Botërore nuk ka një Grup Kërkimor të lidhur me të formalisht, prandaj ky propozim përfaqëson një zhvillim novator në të mirë të instituteve, universiteteve, stafit, studentëve pjesëmarrës, dhe ç'është më e rëndësishmja, për vetë sitin.

Për lehtësimin e këtij procesi propozohet që Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit ta mbështesë financiarisht krijimin e Grupit dhe ta mirëmbajë gjatë shtatë viteve fillestare të Planit të Biznesit.

Fondet do të mund të jenë të vlefshme për (a) ripagimin e shpenzimeve për krijimin, menaxhimin dhe zhvillimin e Grupit, (b) bursat për studentët e masterit që e përdorin Butrintin si fokus i kërkimit të tyre (ndoshta, deri në dhjetë bursa në vit), (c) fondet për publikimin e punimeve kërkimore dhe raporteve të tjera, dhe (d) konferencën, që do të mbahet një herë në dy vjet, për çështjet që lidhen me Butrintin, në të gjitha disiplinat e mbuluara nga Grupi.

Me zhvillimin e Grupit mund të merret në konsideratë prania e disa personave mbikëqyrës në zyrat brenda Parkut Kombëtar të Butrintit. Për ta lehtësuar këtë proces, është propozuar një buxhet vjetor mesatar prej 77.000 USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%), si kontribut fillestar për Grupin Kërkimor nga ana e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, duke mbuluar pikat (a) deri në (d) të sipërpërmendura.

Grupi Kërkimor i Butrintit	V1	V2	V3	V 4	V 5	V6	V7	Totalet
Shpenzimet e menaxhimit	-	10	10	10	10	10	10	60
Studentët me bursa	-	15	15	15	15	15	15	90
Grantet për kërkimin	-	30	30	30	30	30	30	180
Publikimet	-	10	10	10	10	10	10	60
Bienalja e Butrintit	-	-	50	-	50	-	50	150
Totalet (USD)	-	65	115	65	115	65	115	540
Mesatarja për një periudhë shtatëvjeçare								**77**

Figura 20: Grupi Kërkimor i Butrintit (duke përfshirë kontigjencën prej 10%)

Aktualisht, parashikohet që ky buxhet *përjashton* fondet për gërmimet arkeologjike në Butrint, duke qenë se ato mund të financohen nga burime të tjera; si rrjedhojë, duke pasqyruar edhe qëllimin e Grupit për ta zgjeruar kërkimin edhe në disiplina të tjera përkatëse. Sa për sqarim, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të sigurojë të gjithë financimin për punën kërkimore në sit nëpërmjet Grupit Kërkimor të Butrintit.

3.21 Zhvillimi i markës, marketingu dhe promovimi (rreshti 18)

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit duhet të ketë një buxhet për fushatën e zhvillimit të markës, marketingun dhe marrëdhëniet me publikun, për të garantuar transferimin pa pengesa, nga gjendja aktuale në gjendjen e re, dhe rritjen e numrit të vizitorëve pas pandemisë, po ashtu dhe fondet për promovimin e sitit, veçanërisht nëpërmjet medias dixhitale dhe një rrjeti të ri të pavarur në internet.

Si rrjedhojë, është alokuar një buxhet për shtatë vitet e para të punës së Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, mesatarisht mbi 71.000 USD në vit (duke përfshirë kontigjencën prej 10%), ku 99.000 USD janë alokuar për periudhën tranzitore dhe Vitin 1 (të gjitha duke përfshirë kontigjencën prej 10%). Gjithashtu, këto shifra *përfshijnë* koston e krijimit dhe ruajtjes së një rrjeti të fuqishëm në internet, që mund të përdoret edhe për të ruajtur dhe ekspozuar materiale arkivore nga siti, disa aktualisht të mbajtura nga Fondacioni Butrinti, subjekt i marrëveshjes ndërmjet palëve.

Buxheti për marketingun dhe marrëdhëniet me publikun përfshin mbulim falas dhe të pakufizuar të internetit në të gjithë Zonën A3, për të mundësuar shkarkime të materialeve të ndryshme nëpërmjet telefonave inteligjentë, etj., për të ndihmuar në interpretimin dhe orientimin e objekteve. Përditësimet përfshihen në koston vjetore të sipërpërmendur; kostot e vendosjes së rrjetit përfshihen në shifrën fillestare prej 99.000 USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%).

Gjithashtu, parashikohet që kjo kosto të mbulojë më shumë se sa thjesht promovimin e sitit. Ekziston mundësia e prezantimit të *Markës së Butrintit* në të gjithë Parkun Kombëtar, për t'i shtuar vlerat prodhimit të butakëve (veçanërisht midhjeve), agrumeve dhe prodhimeve të tjera vendase. Të ardhurat nga fushatat e bazuara te markat mund të jenë të larta, por në të njëjtën kohë edhe risqet. Si rrjedhojë, të ardhurat nga shitja e prodhimeve të Parkut nuk përfshihen si zëra të ardhurash. Rekomandohet një studim i veçantë, që ka si rezultat caktimin e një përfaqësuesi për marrëdhëniet me publikun/këshilluesi marketingu me lidhje ndërkombëtare, për të zhvilluar markën. Për këtë qëllim, është alokuar buxheti prej 500.000 USD (duke përfshirë kontigjencën prej 10%) gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të këtij Plani Biznesi. Njëra nga detyrat kyçe gjatë periudhës tranzitore është caktimi i një firme të tillë.

3.22 Operimet jashtë sitit (rreshti 19)

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të vërë në dispozicion kosto shtesë, duke përfshirë shpenzimet për anëtarët e Bordit dhe angazhimin e stafit (financat dhe ekonomia qendrore), që nuk kanë lidhje me asnjë ndërhyrje të drejtpërdrejtë fizike brenda sitit.

Operimet jashtë sitit (mijë USD)	6 m	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Totali
Shpenzimet e Bordit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit		50	50	50	50	50	50	50	350
Stafi mbështetës *	-	90	90	90	90	90	90	90	630
Totali	**-**	**140**	**140**	**140**	**140**	**140**	**140**	**140**	**980**
* 5 punonjës me kohë të plotë, duke përfshirë ekspertët ligjorë, llogaritarët, BNj dhe administratën e përgjithshme									

Figura 21: Shpenzimet jashtë sitit (duke përfshirë kontigjencën prej 10%).

3.23 Stafi i Sitit (rreshti 20)

Momentalisht, siti operon me 14 punonjës me kohë të plotë, e gjithë puna e tyre ka një kosto vjetore prej afërsisht 88 mijë USD. Përgjatë viteve të fundit, kostoja është mbajtur në këto vlera.

Nga opinionet e marra gjatë punës kërkimore për këtë plan biznesi mund të themi se ky numër stafi nuk është i mjaftueshëm, dhe kjo do të thotë që siti në tërësi mund të jetë potencialisht i cenueshëm për shkak të mungesës së stafit (dhe fondeve), për të bërë ndërhyrjet e duhura lidhur me mirëmbajtjen dhe ruajtjen, duke mos përmendur mënyrën sesi mirëpriten dhe akomodohen vizitorët në sit.

Nëse synohet që Butrinti të ketë një pozicion të konsoliduar si një prej siteve arkeologjike më të mrekullueshëm në botë, atëherë kjo situatë duhet të ndryshojë.

Si me çdo organizatë në çdo vend të botës, çelësi i një biznesi dhe operacioni të qëndrueshëm dhe të suksesshëm është staf i motivuar, i dedikuar dhe i angazhuar, kjo vlen për çdo sektor, por në veçanti për ato të cilat kanë kontakt të përditshëm me publikun. Pavarësisht kësaj, siti, natyrisht, do të vazhdojë të ketë vizitorë për një kohë të gjatë në të ardhmen, sidomos udhëtarët njëditorë.

Për ta çuar sitin në fazën tjetër dhe për të garantuar zhvillimin e tij në lidhje me zonën më të gjerë të Parkut Kombëtar, kërkohet një ndryshim i qasjes së menaxhimit, sjelljes dhe shtim i ndjeshëm i stafit. Në fund të fundit, siti synon arritjen e objektivave dhe qëllimeve më të dobishme.

Ndonëse drejtori i ri i sitit sigurisht do të ketë pikëpamjet e veta, struktura e propozuar për stafin, e paraqitur më poshtë, është e projektuar për të mbuluar njëherazi një sërë çështjesh dhe për të ofruar një rikonceptim tërësisht të ndryshëm të asaj që po zbatohet aktualisht.



Figura 22: Stafi i Sitit dhe kontraktorët e pavarur (kutia rozë)

Sipas këtij plani të ri të propozuar, Drejtori i Sitit, që i përgjigjet Bordit të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit për të gjitha çështjet duke përfshirë ide të reja, zhvillime, dhe përhapjen e markës, mbështetet nga dy Zëvendës Drejtorë: njëri përgjegjës për menaxhimin e pasurive dhe tjetri për menaxhimin e sitit. Për rrjedhojë, do të krijohet një ekip drejtues menaxhimi prej tre vetash. Personi Drejtues i Angazhimit të Komunitetit duhet të jetë një arkeolog shumë i kualifikuar.

Dallimi kryesor midis zëvendës drejtorëve është se i pari merret me pasuritë dhe burimet historike në dispozicion të sitit dhe vepron në mënyra të atilla që t'i ruajë dhe përforcojë ato, ndërsa i dyti merr në konsideratë mënyrën me të cilën këto burime mund të shfrytëzohen për përfitimin financiar të sitit me anë të, për shembull, shitjes me pakicë dhe restoranteve, biletarisë dhe menaxhimit të transportit për sitin.

Praktikisht, i pari merret me pikëpamjen e brendshme, ndërsa, i dyti me atë të jashtmen. Ky është një dallim që bëhet edhe në shumë site të trashëgimisë në vende të tjera; MB dhe SHBA ofrojnë shumë shembuj të tillë. Roli i drejtorit është të përfaqësojë institucionin kudo dhe kurdo që të jetë e nevojshme: në TV, përpara qeverisë, në konferenca ndërkombëtare e të ngjashme si këto. Këta të tre (drejtori i sitit dhe dy zëvendës drejtorët) bashkërisht formojnë bërthamën e ekipit të menaxhimit që i përcjell bordit idetë e tij (nëpërmjet drejtorit të sitit) dhe më pas stafit të sitit, nëpërmjet menaxherëve të tyre të linjës, të cilat janë pesë.

Arkeologjia dhe Angazhimi i Komunitetit	Arkeologu kryesor, konservimi, mjedisi, turet, punonjësit kyç
Konservimi Arkeologjik	Monitorimi i konservimit, planifikimi i konservimit, mbikëqyrja e punimeve të konservimit në terren, gjenerimi i materialeve interpretative
Ekologjia dhe Mjedisi	Monitorimi i konservimit, planifikimi i konservimit, mbikëqyrja e punimeve të konservimit në terren, gjenerimi i materialeve interpretative

Shërbime për Vizitorët	Pjesa e Hyrjes për në sit përfshin rojtarët e sitit, shitjen me pakicë dhe shërbimin e kateringut, rezervimet online, guida nga vetë stafi, media dixhitale, monitorimi i vizitorëve
Menaxhimi i Ambienteve	Administrimi i sitit, biletaria, siguria, transporti, pastrimi dhe mbetjet, IT dhe sistemet e internetit, mirëmbajtja e përgjithshme e sitit

Figura 23: Menaxherët e linjës - rolet dhe përgjegjësitë

Përveç cilësive kyçe të mësipërme, për sa u përket kualifikimeve dhe aftësive të përgjithshme, Drejtori i Sitit duhet të ketë kualifikim në nivel doktorature ose një titull të barabartë me të në një fushë të ngjashme (jo domosdoshmërisht në arkeologji) dhe të ketë përvojë të drejtpërdrejtë në menaxhimin e atyre siteve që janë të paktën të një rëndësie kombëtare (preferohet në nivel ndërkombëtar). Ai/ajo duhet të jetë i aftë të përfaqësojë si sitin ashtu edhe Fondacionin e Menaxhimit të Butrintit në konferenca ndërkombëtare dhe në aktivitete të ngjashme si këto, dhe, mundësisht, të dalë lirshëm në median kombëtare dhe atë ndërkombëtare dhe të adresojë publikun si në shqip ashtu edhe në anglisht. Modeli i biznesit synon të joshë një kandidat me përvojë ndërkombëtare dhe shumë të kualifikuar.

Të dy Zëvendës Drejtorët duhet të kenë kualifikim të nivelit MA/MSc (ose i barasvlershëm) në fusha të ngjashme, të jenë të aftë të përfaqësojnë sitin në mungesë të Drejtorit, dhe të kenë aftësi për të menaxhuar stafin e nivelit të mesëm. Të dy duhet të flasin rrjedhshëm shqip dhe anglisht.

Menaxherët e linjës duhet të kenë kualifikim të nivelit BA/BSc ose të barasvlershëm, të kenë aftësinë të angazhohen në struktura si të nivelit të lartë ashtu edhe atë të ulët për sa i përket menaxhimit dhe motivimit të stafit të sitit në gjitha fushat e veprimit të tyre.

Në shumë mënyra, këta Menaxherë të Linjës përbëjnë stafin kyç të sitit që do të sigurojnë operimin me efikasitet të plotë të sitit, ofrojnë një përvojë të çmuar për vizitorët dhe siti të funksionojë më së miri si në syrin e publikut ashtu edhe së brendshmi. Kualifikimet kyçe për të gjithë stafin drejtues përfshijnë aftësinë për të motivuar të tjerët dhe për të qenë të përqendruar në përmbushjen e detyrave.

Këto pesë fusha konsiderohen si të domosdoshme për mirëqenien dhe menaxhimin e sitit në të ardhmen pasi ato (a) mbulojnë të gjitha fushat operacionale të propozuara, (b) theksojnë rëndësinë e secilës dhe (c) veprojnë si organe trajnimi e rekrutimi për stafin e ardhshëm.

Secili nga menaxherët e linjës, të cilët së bashku përfaqësojnë ekipet e menaxhimit të sitit dhe pasurive, ka stafin përkatës nën përgjegjësinë e tij. Struktura e plotë e stafit e përmendur më sipër paraqitet në tabelën më poshtë.

Kjo tabelë tregon nevojën për staf plotësues prej 44 vetash me kohë të plotë në momentin që siti do të jetë plotësisht operacional sipas kushteve të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit dhe duke punuar me kapacitet të plotë për sa i përket numrit të vizitorëve; kjo shifër përbën një trefishim i numrit aktual prej 14 duke u rritur gradualisht deri në Vitin 5, dhe ka për qëllim që siti të jetë i hapur gjatë gjithë vitit. Padyshim që në praktikë, këta 44 punonjës me kohë të plotë mund të mos caktohen në mënyrë të barabartë gjatë të gjithë vitit, por ky është një element në varësi të menaxhimit ditor të sitit nga ana e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit.

Kjo është plotësisht në përputhje me vizionin e sitit, me mënyrën se si ofrohen shërbimet, dhe me mënyrën se si do të ruhet siti në të ardhmen.

Gjatë periudhës tranzitore dhe nga pranimi zyrtar i sitit nga ana a e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit në fillim të Vitit 1, numri i stafit parashikohet të rritet si më poshtë:

Viti	PT*	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7
Numri i stafit (kohë të plotë)	5	22	24	31	38	44	44	44
Rritja vjetore (kohë të plotë)		8	2	6	8	6	0	0
* periudha tranzitore								

Figura 24: Rritja e parashikuar për stafin me kohë të plotë

Një ndryshim i tillë tërësor i strukturës drejtuese, së bashku me themelimin e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, krijon mundësinë për të rishikuar punësimin dhe angazhimin e çdo punonjësi aktual, nëse është e mundur, me kushte të reja ligjore sipas Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit. Kjo është një praktikë e zakonshme në vende si MB dhe vende të tjera, dhe natyrisht, një praktikë e zakonshme në Shqipëri, në raste ku përgjegjësia e menaxhimit transferohet nga një organizatë në tjetrën. Nëse situata është e atillë, atëherë të gjitha të drejtat e punonjësve transferohen, përveç se në raste kur të dyja palët kanë rënë dakord për një marrëveshje alternative. Zgjidhja e sugjeruar është zbatimi i rregullimeve të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, duke pasur parasysh që i gjithë stafi duhet të ketë kualifikimin e përshtatshëm për të plotësuar kërkesat e Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit.

A	B	C	D
Stafi (mijë USD)	**# punonjësve me kohë të plotë**	**USD pp pa**	**USD total**
Drejtori i sitit	1	85.0	85.0
Zëvendës drejtori – menaxhimi i pasurive	1	45.0	45.0
Zëvendës drejtori – menaxhimi i sitit	1	45.0	45.0
Drejtues –arkeologji dhe angazhimi në komunitet	1	25.0	25.0
Drejtues – konservimi arkeologjik	1	25.0	25.0
Drejtues – ekologjia dhe mjedisi	1	25.0	25.0
Drejtues – shërbime për vizitorët	1	25.0	25.0
Drejtues – menaxhimi i ambienteve	1	25.0	25.0
Konservimi dhe mirëmbajtja e sitit (MIP)	10	9.0	90.0
Pjesa e hyrjes për në sit/biletari/mirëseardhja (MIS)	6	9.0	54.0
Guidat/rojtarët e sitit (MIS)	6	9.0	54.0
Dyqanet dhe lokalet (MIS)	8	9.0	72.0
Pastrimi i dedikuar dhe shëndeti dhe siguria (MIS)	6	6.0	36.0
Stafi total	**44**		**606**
Menaxhimi i nivelit të lartë	3		
Menaxherët e linjës	5		
Menaxhimi i Integruar i Pasurive (MIP)	10		
Menaxhimi i Integruar i Sitit (MIS)	26		

Figura 25: Pagat e sugjeruara për stafin

Pavarësisht se parashikohet se stafi do të rekrutohet nga zona të ndryshme, shumicës do tu kërkohet të jetojnë në zonën përreth (mbase në një rreze prej 25 km nga siti) pasi lidhjet me vendin dhe vendasit janë thelbësore, duke pasur parasysh mënyrat se si janë planifikuar të zhvillohen Zona A3 dhe mbarë Parku Kombëtar bashkërisht në vitet në vazhdim.

Në përmbledhje (Figura 24), Menaxhimi i nivelit të lartë ka tre pozicione, 5 Menaxherë të Linjës, Ekipi i Menaxhimit të Integruar të Pasurive (MIP) prej dhjetë vetash dhe Ekipi i Menaxhimit të Integruar të Sitit (MIS) prej 26 vetash, duke reflektuar kështu aspiratat largpamëse të sitit.

Duke qenë se Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të themelohet në formën e një organizate jofitimprurëse,ai mund të vendosë çfarëdolloj sistemi pagash që gjykon si të përshtatshme. Kjo liri është e rëndësishme për të tërhequr, motivuar dhe mbajtur stafin e duhur.

Kështu, kolona C (lart) paraqet strukturën e re të pagave për të gjithë stafin me kohë të plotë. Këto shifra përfaqësojnë pagat bruto dhe nuk kanë lidhje me nivelin e pagave aktuale në sit për arsyet e lartpërmendura.

Sidoqoftë, rekomandohet një rritje e pagës vjetore. Kjo politikë propozohet pikërisht për të tërhequr staf të ri, të kualifikuar dhe për t'i motivuar e mbajtur ndërkohë që siti zhvillohet dhe Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit përfundon punimet kapitale dhe merr nën kontroll të plotë menaxhimin e përditshëm të sitit.

Në total, kjo strukturë e re, nëse zbatohet plotësisht (kolona D), paraqet një kërkesë vjetore (pa inflacion) prej 606 mijë USD (duke përfshirë një kontigjencë prej 10%), e vlerësuar për një staf me 44 veta me kohë të plotë dhe pagë mesatare prej 14 mijë USD. Kjo mesatare, e cila është rreth 50% më shumë se mesatarja e pagave aktuale të sitit, është tërësisht e përshtatshme për ndryshimet e reja dhe do të jetë një shtysë e madhe për të tërhequr stafin e duhur.

Modeli financiar bazë (figura 10, rreshti 20) tregon totalin prej 606 mijë USD që do të arrihet në Vitin 5. Kjo pasqyron efektin që mbart ndërtimi i qendrës së re për vizitorët dhe punimet e tjera kapitale nuk do të kenë përfunduar deri nga Viti 3 dhe 4.

Përveç kësaj, duhet theksuar se edhe luhatjet sezonale duhet të merren parasysh, por duhet përmendur se kjo është tepër e detajuar për analizën aktuale, veçanërisht duke qenë se shuma e përgjithshme e pagave kundrejt totalit të shpenzimeve është relativisht e ulët. I takon Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit dhe drejtorit të saj të zgjidhë rotacionin e stafit e çështje të ngjashme si këto.

3.24 Furnizime dhe shërbime të kontraktuara (reshti 21)

Stafi drejtues i sitit (drejtori, zëvendës drejtorët dhe menaxherët e linjës) do të jetë përgjegjës për përshtatjen, caktimin dhe menaxhimin e një sërë shërbimesh të kontraktuara të sitit dhe operacione të tjera mbështetëse në tre fusha kryesore:

1. Konservimi i sitit – shërbime arkeologjike dhe ekologjike (shtjellohet në një pjesë tjetër në këtë raport)
2. Operacionet në sit - përfshihen furnizime për zyrën, materiale pastrimi, broshura për vizitorët në gjuhë të ndryshme, pagesa e qirasë, biletaria elektronike, energjia elektike, karburanti, sigurimet, mirëmbajtja e IT-së, transporti vajtje-ardhje për te qendra e vizitorëve, e kështu me radhë.
3. Siguria në sit (shihni më poshtë)

Sipas menaxhimit ekzistues, për vitin 2018 dhe 2019, këto shpenzime shkonin përafërsisht 185 mijë USD dhe 180 mijë USD përkatësisht për pikat (1) dhe (2),dhe siguria e sitit (3) e paguar drejtpërsëdrejti nga qeveria qendrore si pjesë gjithëpërfshirëse e ndërtesave në nivel qeverie dhe me kontratë për sigurinë e sitit me një vlerë prej 110 mijë USD në vit. (I referohet Shtojca A).

Duke e lënë mënjanë konservimin e sitit (1) pasi kjo çështje shtjellohet më me detaje në Shtojcën C të Planit të Menaxhimit të Integruar, buxheti vjetor për operacionet në sit (rreshti 17 në modelin bazë) është llogaritur si vijon:

Furnizime dhe shërbime të kontraktuara (1)	6 muaj	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Totaleet
Shërbimet (energjia elektrike, uji, internet etj.)		25	25	25	30	30	30	30	195
Shpenzimet e përgjithshme të zyrës, duke përfshirë printimin dhe uniformat		20	25	30	35	40	40	40	230
Herbicide		12	12	12	12	12	12	12	84
Të gjitha kostot e transportit dhe shërbimet (2)		30	40	45	50	50	50	50	315
Udhëtimi i stafit dhe shpenzimet buxhetore (përfshirë jashtë shtetit) (3)		15	25	35	40	40	40	40	235
Mirëmbajtje e përgjithshme e sitit		20	30	35	40	40	40	40	245
Mirëmbajtje dhe zëvendësim i tabelave interpretative (4)			60	60	60	60	60	60	360
Siguria në sit (5)		110	110	110	110	110	110	110	770
Pastrimi i sitit dhe godinave		25	30	35	35	35	35	35	230

Fond amortizimi për mirëmbajtjen e godinave (6)			80	80	80	80	80	80	480
Prime të sigurimit (7)		25	25	25	25	25	25	25	175
Procedura të brendshme të operimit	35								
Auditim		12	12	12	12	12	12	12	84
Totalet	35	294	462	492	517	522	522	522	3319
Më pak: kontigjencë prej 10%		27	42	45	47	47	47	47	302
Net (transferimi për te modeli bazë)	**35**	**267**	**420**	**447**	**470**	**475**	**475**	**475**	**3017**
Shënime:									
(1) duke përjashtuar kostot e konservimit									
(2) duke përfshirë transportin për vizitorët									
(3) Pasqyron rolin më ndërveprues të drejtorit të ri dhe stafit drejtues (15 % të kostos së stafit)									
(4) Investim kapital 1.2 m USD me 6%/vit									
(5) Sipas kontratës aktuale e shtuar për më shumë vizitorë									
(6) Investim 4m USD me 2%/vit									
(7) Për të gjitha rreziqet që lidhen me sitin									

Figura 26: Përllogaritje të furnizimeve dhe shërbimeve të kontraktuara

Këto shifra:

1. Bazohen në vitet e mëparshme për të gjithë aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me konservimin nga kostot vjetore aktuale që prej vitit 2013, të rritura në atë mënyrë që të pasqyrohen operacionet e planifikuara në sit (referojuni shtojcës A)
2. Pasqyrojnë shtimin e përgjithshëm të aktivitetit në sit në lidhje me funksionimin e qendrës së re për vizitorët dhe rritjen e parashikuar dhe të pritshme të numrit të vizitorëve; prandaj parashikohet pastrim, mirëmbajtje e sitit dhe shërbime të ngjashme shtesë.
3. Sigurojnë buxhet për përditësim, riparim e kështu me radhë si për ndërhyrjet e fundit që janë kryer në ndërtesa ashtu edhe për interpretimin e sitit nga Viti 3 e në vijim
4. Pasqyrojnë rregullimet e propozuara lidhur me udhëtimin për në sit me anë të mjeteve elektrike/të gjelbra (autobusë dhe anije) dhe mirëmbajtja e tyre vjetore, shërbimet, shpenzime për karburant etj.
5. Përfshijnë një shumë vjetore për sigurimin e përgjegjësisë publike dhe sigurimin e përgjithshëm të ndërtesave (shënim: kjo varet nga lloji dhe shtrirja e mbulimit që mund t'i nevojitet Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit, dhe prandaj kjo shumë duhet të shihet si një përllogaritje e buxhetit)
6. Përfshijnë aktivitete shtesë siç janë shitja me pakicë dhe shërbimi i kateringut.

Për më tepër, megjithëse kostoja nga të ardhurat për të pasur autobusë për transportin e vizitorëve është pjesë e këtij rreshti, kostoja e përllogaritur e blerjes së tyre (kapital) jepet në rreshtin 10, edhe pse ato mund të merren me qira, në vend që të blihen. Sipas kësaj, automjete të vogla tip furgonash në gjendje për të akomoduar rreth 20 persona për udhëtim, maksimumi gjashtë mjete që operojnë në një kohë të caktuar gjatë muajve të verës (piku) [47] do të ishin të përshtatshme, duke marrë parasysh që do të realizohet një studim i detajuar i kërkesave të sitit në lidhje me transportin gjatë periudhës tranzitore. Ndryshe, mund të përdoren edhe mjete me kapacitet më të madh. Ky duhet të jetë një nga aspektet e studimit lidhur me transportin që rekomandohet në një pjesë tjetër të këtij Plani. Por duke marrë parasysh që të gjithë prodhuesit e makinave në botë ose po prodhojnë, ose janë në fazën kërkimore, për mjetet e gjelbra, kostoja për njësi do të ulet ndjeshëm në vitet e ardhshme[48]. Për më

[47] Çdo udhëtim nuk do të zgjasë më shumë se pesëmbëdhjetë minuta, duke përfshirë hipjen dhe zbritjen

[48] Një mjet i tillë është Emoss MB-16, i cili është elektrik (ose hibrid), me dysheme të ulët, me hyrje për karrige me rrota dhe plotësisht i konfigurueshëm (duke përfshirë audion), minibus 16-vendësh që përshkon 200 km me një karikim dhe përllogaritet se kursen 50% në krahasim me një mjet standard nafte ose benzine për sa i takon shpenzimeve operacionale. Në varësi të tarifave të flotës, çdo njësi mund të blihet për 25 mijë USD deri në 30 mijë USD, në varësi të opsioneve. Një shumë prej 240 mijë USD (duke përfshirë një kontigjencë prej 10%) është përfshirë në modelin kryesor financiar që parashikon 8 mjete me një kosto mesatare prej 30 mijë USD.

tepër, qeveria shqiptare, nëpërmjet kryetarit të bashkisë Tiranë, ka pranuar se këto mjete vërtet do të jenë zhvillimi i të ardhshmes[49].

3.25 Grante (rreshti 22)

Është parashikuar një shumë totale prej 300.000 USD për grante që do t'i jepen komunitetit vendas dhe grupeve të tjera. Kjo kosto kompensohet nga një shumë e ngjashme të ardhurash (rreshti 35) mbi bazën se kjo kosto do të ndahet me të tjerë.

3.26 Përmbledhje – kosto (nga rreshti 27 deri te 30)

Fluksi monetar kombinohet në të tillë mënyrë që sugjeron një shpenzim total prej rreth 18.33 milionë USD të ndara me 38%: 62%, përkatësisht, për punime kapitale dhe kostot e të ardhurave.

Kjo pasqyrohet më poshtë. Të gjitha qelizat janë në 000 (mijë) USD, vetëm në rastet kur përcaktohet ndryshe.

Përmbledhjet e Investimeve	6 muaj	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Totalet
Të gjitha investimet/shpenzimet	336	3313	3267	2990	2352	2349	2183	2222	**19,011**
Investimet/shpenzimet e akumuluara	336	3649	6916	9906	12258	14607	16789	**19011**	
Mbledhje: Punime kapitale (rreshti 13)								40%	**7524**
Mbledhje: Kostot e të ardhurave (rreshti 26)								60%	**11487**

Figura 27: Përmbledhjet e investimit (duke përfshirë një kontingjencë prej 10%)

3.27 Vizitorët dhe ndikimi i tyre (nga rreshti 31 deri te 39)

Gjatë vitit 2021, u zbatuan këto tarifa për një vizitë në Butrint. Ka pasur një riorganizim, një harmonizim dhe një rritje të ndjeshme krahasuar me tarifat e zbatuara në vitin 2017, të cilat kishin çmime preferenciale për shqiptarët

Përbërja e grupit	USD
0-12 vjeç (falas)	0,00
Biletë e reduktuar -50%	4,70
Bileta për fëmijë 12-18 vjeç dhe studentë	2,80
Biletë grup +12	7,50
Biletë individi për turistët vendas dhe të huaj	9,35
Mesatarja: bazuar në shifrat e vizitorëve për 2021	**6,09**

Figura 28: Tarifat aktuale (2021) për hyrje në Butrint

3.28 Sitet për krahasim

Përgjatë Mesdheut ekzistojnë një sërë sitesh arkeologjike, të cilat, përgjithësisht, përshkojnë historinë e njerëzimit nga Epoka e Bronzit (ose më herët) deri në kohët e sotme, ku shumica përqendrohen në vendbanimet Greke dhe Romake, siç është dhe rasti i Butrintit. Një pjesë e këtyre siteve është e hapur për publikun dhe janë kthyer në pika të rëndësishme turistike.

Shumë prej tyre kanë rëndësi botërore, një pjesë e mirë janë Site të Trashëgimisë Botërore, dhe disa syresh njihen nga të gjithë – Akropoli, Olimpia, Delfi, Pompei, Petra, Koloseu, Troja. Secila prej këtyre siteve aksesohet nga publiku kundrejt një tarife. Tabela e mëposhtme tregon tarifat e hyrjes për të rritur.

[49] 'Tirana teston autobusë elektrikë pas prezantimit të taksive elektrike' - Balkan Green Energy News, 31 Tetor 2017.

Mesatarja e siteve për krahasim (Knosos, Pompei, Efesi) është rreth 12,00 USD për një vizitë për të rritur në krahasim me tarifën 6 USD që paguhet aktualisht në Butrint.

Siti	Vendi	Çmimi për të rritur USD
Knosos	Kretë	11,50
Pafos	Qipro	3,00
Akropoli, Athinë	Greqi	35,00
Vergina	Greqi	16,00
Delfi	Greqi	14,00
Olimpia	Greqi	14,00
Korinth	Greqi	9,00
Kepi i Sunionit	Greqi	9,00
Mikenë	Greqi	14,00
Pompei	Itali	15,00
Herkulanum	Itali	13,00
Koloseu, Forumi, Palatina; Romë	Itali	15,00
Vila Romana del Casale	Itali	12,00
Petra	Jordani	70,00
Tarraco	Spanjë	4,00
Merida	Spanjë	14,00
Troja	Turqi	5,00
Efes	Turqi	11,00
Mesatarja (duke përjashtuar Petrën)		**12,00**

Figura 29: Çmimet krahasuese - çmimet e hyrjes për të rritur në USD

Në Vitin 7, tarifa për hyrjen për të rritur parashikohet të jetë 15,00 USD, duke gjeneruar një çmim hyrjeje mesatar prej 11,25 USD, sikundër pasqyrohet në modelin financiar bazë (Figura 10, rreshti 34).

Rritja në Vitin 2 duhet të shoqërohet me një shpjegim brenda në sit, ku të shpjegohen ndryshimet e reja dhe përfitimet afatgjata që do të ketë për sitin dhe vizitorët.

Duke u bazuar në përvoja të mëparshme, një informacion i tillë është i rëndësishëm kur ka zhvillime në sit për një kohë të gjatë dhe në disa zona.

3.29 Numri i vizitorëve

Prej shekujsh, Butrinti ishte i panjohur për botën. Pavarësisht punës pioniere arkeologjike të Ugolinit në vitet 1920 dhe 1930, Butrinti filloi të njihej ndërkombëtarisht vetëm pas rënies së komunizmit në vitin 1992 dhe nëpërmjet punës së Fondacionit Butrinti nga viti 1994 e më tej.

Prej disa qindra vizitorëve në vitin 1998, të paktën 280.000 njerëz vizituan Butrintin në vitin 2019. Megjithatë, gjatë vitit 2020, për shkak të Covid-19 shifrat e reja tregojnë se vetëm 34,000 persona vizituan sitin. Padyshim që efekti i Covid-19 është pasqyruar në rakordimin e rritjes së numrit të vizitorëve që kur plani origjinal i biznesit u prodhua në fund të vitit 2018 / fillim të vitit 2019.

Parashikimi i numrave gjatë një pandemie është shumë problematik dhe me shumë gjasa mund të përmbajë gabime. Prandaj, është marrë një qasje konservatore në lidhje me rritjen e mundshme të numrit të vizitorëve nga shifra bazë prej 34,000 në vitin 2020, duke marrë parasysh dy faktorë kryesorë: (a) një kthim gradual në një formë të "normalitetit" deri në vitin 2024/2025 bazuar në efektshmërinë dhe shpërndarjen e vaksinave kundër çdo varianti të ri të shfaqur dhe (b) gatishmërinë dhe aftësinë e njerëzve për të udhëtuar jashtë vendit për pushime të theksuara nga disponueshmëria e paketave të pushimeve, dhe linjave të kroçerave etj. për t'i ofruar ato.

Kështu, është bërë një përllogaritje e matur në lidhje me rritjen e mundshme të numrit të vizitorëve nga koha e shkrimit (korrik 2021) deri në fund të periudhës së planifikimit të biznesit (2028). Tashmë parashikohet se niveli i vizitorëve i përllogaritur fillimisht për vitin 2019, do të arrihet brenda ose rreth Vitit 4.



Rritja e parashikuar e numrit të vizitorëve
Periudha 6-mujore tranzitore
Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit merr kontrollin
Rritje graduale me heqjen e kufizimeve për shkak të Covid-19 në mbarë botën
Punimet kryesore kapitale në sit të përfunduara
Shifrat rikthehen në përllogaritjet përpara Covid-19 pas pesë vitesh

Figura 30: Rritja e parashikuar e numrit të vizitorëve 2022-2028 (Viti operacional 1 deri në 7)

Duke supozuar se kjo do të arrihet në Vitin 4, turistë (vizitorë të huaj) mund të ndahen në dy grupe kryesore:

Turistë që kalojnë natën:

- Individë dhe turistë të huaj që vijnë me paketa turistike, pjesë e vizitave turistike dhe të trashëgimisë kulturore, të cilët kalojnë natën në Sarandë, me qëllim që të vizitojnë Parkun Arkeologjik të Butrintit dhe atraksione të tjera rreth Sarandës, duke përfshirë dhe monumentin natyror të Syrit të Kaltër;
- Turistë që vijnë me anije kroçera duke u ankoruar në Sarandë, dhe që kalojnë një ose dy net në anije, të cilët përveç vizitës në Butrint dhe në Syrin e Kaltër, mund të vizitojnë Gjirokastrën në ditën e dytë dhe më pas të kthehen në anijen e tyre.

Vizitorë ditorë:

- Me paketë, turistë të huaj në ture brenda ditës që vijnë nga Korfuzi me qëllim që të vizitojnë Butrintin dhe atraksione të tjera në Sarandë;

- Turistë të anijeve kroçera që ankorohen në Sarandë me qëllim që të vizitojnë Butrintin dhe atraksione të tjera në Sarandë, si dhe Syrin e Kaltër;
- Vizitorë ditorë individualë (që qëndrojnë në destinacione të afërta bregdetare në rivierën shqiptare) që vizitojnë Butrintin dhe ndoshta, Syrin e Kaltër.

Këto shifra ndikojnë në mënyrën se si do të zhvillohet dhe menaxhohet Zona A3, në veçanti lidhur me mbarë Parkun Kombëtar, gjë që pasqyrohet në Planin e Menaxhimit të Integruar, një dokument i lidhur me këtë Plan Biznesi.

3.30 Të ardhurat nga vizitorët dhe të tjerët (rreshtat 32-38)

Në terma financiarë, tabela e mëposhtme tregon rritjen e numrit të vizitorëve nga viti i pandemisë (2020) dhe me 2019-n si vit reference, duke marrë parasysh rritjen e pritshme graduale pas pandemisë nga 78.000 (Viti 1) në mbi 296.000 në Vitin 6 (shihni Figurën 29). Kjo rritje mbështetet në qasjen e trendit botëror në rimëkëmbjen pas pandemisë dhe masave që mund të ndërmerren për udhëtimin ndërkombëtar. Roli i operatorëve të mëdhenj turistikë, sidomos të atyre që operojnë në Korfuz, është arsyeja kryesore përse nevojiten plane të menaxhimit të vizitorëve të shoqëruara me strategji të forta marketingu.

Një përgjigje është rritja e çmimit të hyrjes nga një mesatare prej 6,00 USD (Viti 1, kur Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit të marrë kontrollin e sitit) në 11,25 USD (Viti 6) kur të ngrihen struktura të reja. Një tjetër është të përdoret operimi i qendrës së vizitorëve për të menaxhuar xhiron e sitit dhe kështu të parandalojë dëmtimet nga vizitorët.

Zërat e të ardhurave	6 muaj	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Totalet
Vizitorë në vit (000)		78	109	175	262	294	296	296	
Çmimi mesatar i hyrjes (USD) (@75% të çmimit të biletës për të rritur)		6	8	8	9	9	11	11	
Faturat e hyrjes		468	819	1441	2359	2642	3335	3335	14399
Mbledhje fondesh			50	50	50	50	50	50	300
Të ardhurat nga transporti me varka dhe autobusë					17	26	29	30	100
Të ardhura (neto) nga shitja me pakicë dhe kateringu					262	294	296	296	1149
Të ardhura vjetore	-	468	869	1491	2688	3012	3711	3711	15951
Të ardhura kumulative	-	468	1337	2828	5517	8528	12239	15951	

Figura 31: Përmbledhja e të ardhurave

Për më tepër, çmimet e hyrjes mund të konsiderohen dhe si baza nga e cila, me kalimin e kohës, mund të krijohet një strukturë më e detajuar e çmimeve.

Për shembull, njerëzit (kryesisht vendasit) që dëshirojnë të vizitojnë sitin më shumë se një herë në vit mund të nxiten që të blejnë një biletë sezonale me çmime preferenciale dhe të vizitojnë jashtë sezonit turistik. Ndoshta, kjo mund të kthehet në një skemë anëtarësimi (e tillë si 'Miqtë e Butrintit') , e cila mund të bëhet baza e një skeme anëtarësimi më të gjerë që mbulon parqe kombëtare dhe site të tjera të rëndësishme në Shqipëri – ndoshta pararendëse e një "Fondi Kombëtar" shqiptar duke u bazuar në modele të njohura në Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të tjera.

Struktura e çmimeve mund të përmirësohet më tej duke përdorur një faqe interneti kushtuar shitjeve online, dhe duke siguruar kështu çmimet e hyrjes përpara vizitës. Një faqe e tillë interneti mund të përdoret dhe për shitjen e mallrave online dhe mundësi të tjera të shitjes me pakicë. Ky aspekt duhet studiuar më tej dhe për këtë janë parashikuar fonde në modelin bazë si pjesë e "markës, marketingut dhe promovimit", me një buxhet total prej 500.000 USD për menaxhimin e modelit të biznesit.

Tabela tregon se të ardhurat neto nga shitjet dhe shërbimi i kateringut do të rriten në mënyrë të ndjeshme dhe kthimi mesatar neto do të jetë 1 USD për vizitor. Kjo nënkupton se të gjitha shërbimet dhe ambientet do të jenë të vetëmenaxhuara, duke pasqyruar nevojën për rritjen e stafit me kohë të plotë. Nuk tregohet asnjë e ardhur në Vitin 1 dhe 3 nga këto burime pasi investimi për qendrën e re të vizitorëve (tashmë i planifikuar si një zhvillim me një fazë të vetme) pritet të përfundojë në Vitin 3, ndërsa investimi për varkat parashikohet për Vitin 4.

Gjithashtu, pasqyrohen dhe shuma neto të vogla nga të ardhurat e transportit me varka dhe autobusë nëpërmjet marrëveshjeve të licencimit me furnizues vendas nga Viti 4 dhe më tej. Një nga arsyet është se akoma nuk janë kryer bisedat me këta furnizues, ndaj dhe marrëveshjet specifike për këto shërbime mbeten pa u eksploruar. Gjithsesi, ato përfaqësojnë një mënyrë të rëndësishme se si komunitetet mund të angazhohen me projektin. Ky aspekt duhet të përbëjë një prioritet për Fondacionin e Menaxhimit të Butrintit.

Modeli financiar bazë (Figura 10, rreshti 44) tregon edhe një të ardhur prej 2.1 milionë USD nga qeveria qendrore për punimet e konservimit, sipas përcaktimit në Marrëveshjen e Bashkëpunimit lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe AADF-së. Kjo është shuma që duhet të transferohet nga qeveria në Fondacionin e Menaxhimit të Butrintit dhe e cila është përfshirë si e ardhur pasi kuptohet se, për shkak se mungojnë shpenzime për punime të rëndësishme konservimi gjatë një kohe të gjatë, Ministria e Kulturës ka vënë në dispozicion këtë shumë për të paguar për punime të rëndësishme në terren.

Këshillohet që Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit të kërkojë me ngulm këto shuma kur të nevojiten në përputhje me programin e detajuar të punimeve të konservimit.

3.31 Burime të tjera të ardhurash – mbledhja e fondeve, sponsorizime dhe dhënie me qira e sitit

Modeli financiar i prezantuar në këtë Plan, është, sipas mendimit tonë, *thelbësisht konservativ*, pasi ai nuk përfshin, për shembull, mundësi për tarifa ndihmëse brenda sitit, të cilat mund të jenë më vete për galerinë e muzeut në qendrën e vizitorëve, një tarifë për akses në interpretimin e ri të Kullës Veneciane, dhe më vete, për Fortesën Trekëndore, ose dhënien me qira të materialeve dixhitale për përkthim, siç ndodh dhe në vende të tjera. Këto janë çështje që i përkasin Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit dhe drejtuesve të tij.

Në vitet e para, rekomandohet që siti të ketë një tarifë të vetme për hyrjen në të gjitha ambientet dhe të monitorojë nga afër përdorimin e tyre nga vizitorët.

Fonde kapitale më të konsiderueshme dhe investime të tjera, për shembull, nga Banka Botërore[50], BE-ja dhe nga organizata të tjera të mëdha dhe kombëtare *nuk janë përfshirë*, edhe pse kjo mund të jetë shumë e realizueshme.

Pra, burimi i të ardhurave sipas modelit është minimumi që mund të pritet të marrë siti në varësi të nivelit të shfrytëzimit të vizitorëve dhe mënyrës së parashikimit të menaxhimit të sitit.

Kjo analizë nuk përfshin të ardhura jashtë sitit nga përdorimi i Markës Butrinti me prodhime dhe produkte që lidhen me historinë e gjatë të sitit: si për shembull, midhje, peshk, mandarina, dhe fruta të tjera, si dhe potencialin për verën e Butrintit.

Sipas rekomandimit, roli dhe përdorimi i *Markës Butrinti* në këto mënyra duhet të jetë një çështje më vete për t'u marrë në konsideratë, në veçanti lidhur me të mirat dhe shërbimet e disponueshme në mbarë Parkun Kombëtar, dhe mënyrat në të cilat marka mund të përdoret për të shtuar vlerën furnizuesve vendas si në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për më tepër, mund të përdoret siti për aktivitete të tilla si: aktivitete *son-et-lumière* (tinguj dhe ndriçimi), shfaqje në teatër të hapur (mundësisht me një temë greko-romake), shkolla vere, gërmime trajnimi, festivale letrare, koncerte (*Pink Floyd në Pompei*), sete filmash (*Petra dhe'Indiana Jones'*), rikrijimin e një ngjarjeje historike, fundjava kulinarie, degustim vere ... lista kufizohet vetëm nga imagjinata e atyre të përfshirë.

Gjithsesi, ndërkohë që të gjitha më sipër janë mjaft emocionuese dhe do të ofrojnë një përvojë të këndshme, ato *nuk mund dhe nuk duhen* përdorur si mbështetje e çështjes shumë të rëndësishme dhe afatgjatë të konservimit dhe mirëqenies së Butrintit[51].

Ato janë thjesht shtesa; mënyra për të gjeneruar të ardhura shtesë me risk shumë të ulët *duke marrë parasysh që risku mbartet nga të tjerët dhe siti kompensohet për çdo dëm apo degradim.*

Në fund të fundit, Butrinti në thelb është një park kulturor dhe peizazh natyror i një rëndësie ndërkombëtare: nuk është një park argëtimi.

Firma e marrëdhënieve me publikun që do të caktohet për të promovuar dhe ruajtur Markën Butrinti duhet të ngarkohet me ofrimin e këtyre shërbimeve (në rastin më të keq) pa kosto për Fondacionin e Menaxhimit të Butrintit, dhe në rastin më të mirë, të ofrojë një përfitim pa risk.

Do të ishte *tejet e pamatur*, gjithsesi, të përfshihen shuma të tilla në këtë Plan Biznesi, i cili, para së gjithash, është një strategji investimi që bazohet në risk të ulët dhe fitim të menaxhueshëm, sikundër

[50] Për shembull, është mbajtur një takim paraprak me Bankën Botërore në zyrat e saj në Tiranë.

[51] Për shembull, një analizë e burimeve të të ardhurave nga Pyetësori më i fundit i Ciklit Periodik të UNESCO-s sipas *Konventës së Trashëgimisë Botërore* (2018) sugjeron *se* të ardhurat neto nga dhënia me qira e sitit dhe pagesa të tjera tregtare, të tilla si leje dhe koncesione janë më pak se 2% e të gjithë të ardhurave.

duhet të jetë në përputhje me një Fondacion Bamirës që ruan një nga vendet kulturore më të rëndësishme në botë.

3.32 Të ardhura nga qeveria

Fondet e kërkuara nga qeveria tregohen më poshtë në lidhje me ato që do të investohen nga AADF dhe organizatat e saj partnere.

Financime kapitale	milionë USD	%
AADF-ja dhe organizatat e saj partnere	**4.99**	**70%**
Qeveria e Shqipërisë	**2.10**	**30%**
Duke përfshirë:		
Fonde të Qeverisë: për punime konservimi dhe investime të tjera	2.10	
Totali	**7.09**	

Figura 32: Fondet e kërkuara nga Qeveria dhe AADF-ja

4 Përmbledhje dhe ndjeshmëri

Vlerësimi i këtij plani biznesi lidhur me rolin e Fondacionit të Ri në Sitin e Trashëgimisë Botërore të Butrintit është bërë nga këndvështrimi i zhvillimit të një siti ekzistues fitimprurës dhe krijimit të një pakete punimesh të dorëzueshme, të arritshme, të menaxhueshme, realiste dhe të qëndrueshme në dobi të Zonës Arkeologjike të Parkut Kombëtar të Butrintit, njerëzve që punojnë atje dhe atyre që jetojnë në zonën përreth, për një periudhë afatgjatë.

Ky këndvështrim nuk pasqyrohet vetëm në qasjen e rekomanduar 'të kujdesshme', 'të ruajtjes së identitetit të vendit' siç është advokuar prej shumë vitesh nga Fondacioni Butrinti dhe mbështetur nga P+P, por pasqyrohet edhe në mënyrat e dhënies së rekomandimeve për ndërhyrjet në sit, zgjidhjet interpretuese, konservimin e rrënojave, vendosjen e çmimeve të hyrjes, punësimin e stafit dhe menaxhimin e vizitorëve.

Do të ishte e lehtë të spekulohej me këtë, ku të sugjeroheshin tarifa hyrjesh dy herë ose tre herë më të larta nga niveli i propozuar, për të pasur kthim trefish ose katërfish nga shitjet dhe shërbimi i kateringut, të fryhej së tepërmi prezantimi i shërbimeve dixhitale dhe të tjera, ose të përfshiheshin strukturat që nuk janë ende pjesë e menaxhimit, të tilla si përfshirja e Hotelit Livia dhe Shtëpisë së Doganës.

Ky plan biznesi ka zgjedhur që të mos bëj asnjë prej këtyre, por ka ofruar një qasje të matur dhe të kujdesshme për të ardhmen e Zonës A3, e cila po rimëkëmbet nga pandemia Covid-19 nën një menaxhim të ri gjatë viteve të ardhshme.

1	**Financat bazë gjatë shtatë viteve të para të operimit**	**milionë USD**
2	Investimi kapital	7.52
3	Shpenzimet e të ardhurave	11.49
4	Totali	19.01
5	Kthimi gjatë periudhës (të ardhurat totale të gjeneruara)	15.95
6		
7	**Viti i stabilizuar (Viti 7+)**	
8	Vizitorët në vit (mijë)	300
9	Të ardhurat vjetore të gjeneruara	3.70
10	Shpenzimi vjetor	2.22
11	Teprica vjetore	1.49

Figura 33: Përmbledhjet financiare bazë (duke përfshirë një kontigjencë prej 10%)

Tabela e përmbledhjes më sipër tregon një investim total të parashikuar (kapitali dhe të ardhurat) në 19.01 milionë USD (rreshti 4, duke përfshirë një kontigjencë prej 10%) dhe një kthim total prej 15.95 milionë USD.

Zërit të kthimit duhet t'i shtohen edhe investimet totale të AADF-së dhe Qeverisë prej 7.1 milionë USD duke gjeneruar një periudhë të kthimit të parave prej plus 4 milionë USD (baras me 15.95 m + 7.1 m - 19.01 m). Modeli financiar bazë (referuar Figurës 10, rreshti 47).

Pasi të jenë kryer investimet kapitale dhe siti të operojë në një vit të qëndrueshëm, teprica vjetore parashikohet në 1.5 milionë USD në vit.

4.1 Profile të përgjithshme të performancës

Figura e mëposhtme tregon që biznesi kthen një fitim operues.

Investimet kryesore kapitale (vija blu) ndodh në Vitin 1 deri në Vitin 3. Investimi kapital i vazhdueshëm për konservimin e sitit përbën shpenzimin më të madh kapital pas Viteve 2-3 dhe 7-8.



- Investime kapitale - Kosto operacionale - Të ardhura - Kthimet

Figura 34: Profilet e performancës

Të ardhurat vjetore (vija gri) rritet nga Viti 3 e më pas si pasojë e hapjes së qendrës së vizitorëve me shërbimet katering dhe të shitjes, numrit të rritur të vizitorëve dhe faktit që çmimet e hyrjes janë rritur në terma realë.

Kostot operacionale (vija kaf) rriten në Vitin 2 kur Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit të marrë përgjegjësinë operacionale të sitit, por mbetet relativisht e sheshtë pas asaj meqenëse rritja e të ardhurave (vija gri) nuk varet drejtpërsëdrejti në shpenzimet operacionale, por në faktorët e sipërpërmendur.

Nga Viti 7 e më pas, parashikohet një fitim operacional pa asnjë borxh prej rreth 1.5 milionë USD.

Në gjithë këtë është supozuar që investime dhe kthime të tilla janë bazuar në mirëkuptimin që Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të jetë një institucion më vete që nga krijimi dhe si rrjedhojë nuk do të përfitojë nga asnjë fond kapital mbështetës nga palë të treta me përjashtim të AADF-së, vetëm sa i përket punimeve të konservimit të sitit nga qeveria qendrore.

Edhe në këtë nivel, është e qartë se meqenëse siti ishte fitimprurës gjatë vitit 2019 dhe pa dyshim që do të rikthehet në të njëjtën gjendje gjatë viteve të ardhme, risku për partnerët themelues është i ulët, sidomos pasi investimet e sugjeruara më sipër do të heqin punimet e prapambetura të konservimit dhe do të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme përvojën e vizitorëve.

4.2 Ndjeshmëria

Mund të zbatohen një sërë analizash ndjeshmërie të modelit bazë.

Në shembullin e mëposhtëm (Figura 33) tregohet ndikimi i rritjes së të gjitha kostove me 15%, ndërkohë që në të njëjtën kohë ulen të gjitha të ardhurat me 15%.

Sipas kësaj qasjeje ekstreme, pasi ka shumë pak gjasa që të gjitha shifrat të kenë një marzh të përbashkët gabimi prej 30%, do të duheshin mbase dy vite më shumë (në Vitin 6 dhe jo në Vitin 2) për të prodhuar një suficit të akumuluar vjetor, i matur për të gjitha investimet kapitale.

Kjo mund të konsiderohet si skenari më i keq i mundshëm.

Gjithsesi, tregon se modeli i përgjithshëm është mjaft i fortë për të përfshirë edhe një faktor gabimi prej 30% dhe sërish të gjenerojë mbi dyfishin e suficitit vjetor me atë që fiton siti tani, duke përfshirë edhe faktin që kohët e fundit nuk janë ndërmarrë punime kapitale thelbësore.

Sigurisht, ndjeshmëria kryesore, mbi të cilën siti (dhe Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit) ka shumë pak ose aspak kontroll, është mënyra se si bota do të rikuperojë efektet e Covid-19.



Figura 35: Vlerësim i gjerë i ndjeshmërisë

4.3 Tregues të përzgjedhur të performancës

Rezultati i operimit të biznesit mund të vlerësohet me një sërë mënyrash, kryesisht ose nëpërmjet (a) raporteve ose treguesve financiarë të vetëgjeneruara (të tilla si kthimi mbi investimin dhe raporti i

borxhit mbi kapitalin), ose (b) treguesit e referuar nga jashtë, si xhiroja për vizitor, kënaqshmëria e vizitorëve, koha e kaluar në sit dhe të tjera, si dhe tregues më të gjerë që burojnë nga indeksi i qëndrueshmërisë së UNESCO-s dhe të ngjashme.

E para kërkon më shumë informacion se sa është përfshirë (ose mund të përfshihet) në këtë Plan Biznesi, pasi lidhet me mënyrën specifike se si do të ngrihet Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, tatimi i tij[52] dhe marrëdhënie të tjera me qeverinë shqiptare, dhe numrin e partnerëve themelues të përfshirë si në fillim dhe gjatë zhvillimit të projektit. TKP të tilla krijohen vetë kur projekti të nisë dhe të zhvillohet.

Treguesit e fundit janë më të drejtpërdrejtë pasi ata mund të krahasohen, për shembull, me operimin e Fondacionit të Ri në një vit të funksionimit të plotë (Viti 7) me një vit të ndërmjetëm (Viti 4) dhe viti i fundit për të cilin ka shifra të disponueshme për operimin ekzistues të sitit (2018). Më poshtë tregohet një përzgjedhje.

Kur të konsiderohet kjo tabelë, duhet të kihet parasysh se kostot e Fondacionit të Ri përfshijnë si elementet e kapitalit dhe të të ardhurave *të plota.*

Ndërkohë që kjo do të ishte ideale në rastin e operimit aktual (2018) për të bërë një krahasim ballë për ballë, fakti që në sit nuk janë ndërmarrë punime kapitale (veçanërisht punime kapitale konservimi) këto vitet e fundit nënkupton se një krahasim i drejtpërdrejtë duhet të interpretohet me shumë kujdes.

Gjithsesi, treguesit për xhirot vjetore bazuar në të ardhura ofrojnë rezultate të qarta: siti operon në një nivel shumë më të lartë të tepricave kur kryhen punime kapitale fillestare gjatë periudhës dyvjeçare tranzitore dhe gjeneron teprica të konsiderueshme nga Viti 6 e më pas.

	Treguesit e performancës*	2018 **	Viti 4	Viti 7
2	Stafi i punësuar (me kohë të plotë)	14	44	44
3	Buxheti për stafin (mijë USD)	88	397	496
4	Buxheti mesatar për stafin (mijë USD)	6.29	9.01	11.27
5	Rritje në buxhetin për stafin (faktor)	1.00	1.43	1.43
6	Numri i vizitorëve (mijë)	200	148	300
7	Koha e përllogaritur e qëndrimit të vizitorëve në sit (mesatarisht në minuta)	90	120	180
8	Rritje në kohën e përllogaritur të qëndrimit të vizitorëve në sit (faktor)	1.00	1.33	2.00
9	Rritje e numrit të vizitorëve (faktor)	1.00	0.74	1.50
10	Të ardhurat totale (mijë USD)	900	1269	3700
11	Të ardhura/vizitor (USD)	4.50	8.59	12.33
12	Rritje në të ardhura/vizitor (faktor)	1.00	1.91	2.74
13	Kostot totale (mijë USD)	450	2847	2174
14	Kostot/vizitor (USD)	2.25	19.26	7.25
15	Të ardhura/staf (mijë USD)	64.29	28.85	84.08
16	Rritje në të ardhura/staf (faktor)	1.00	0.45	1.31
17	Marzhi vjetor i operimit (mijë USD)	450	-1577	1525
18	Marzhi vjetor i operimit /vizitor (USD)	2.25	-10.67	5.08
19	Rritje në marzhin vjetor të operimit /vizitor (faktor)	1.00	-4.74	2.26
20	* përfshini zërat kapitalë dhe të të ardhurave sipas rastit			
21	** bazuar në përllogaritjet më të mira			

Figura 36: Treguesit e përzgjedhur të performancës

[52] Ligji i Ri për trashëgiminë kulturore parashikon një regjim të ri taksash për fondacionet kushtuar saj dhe si rrjedhojë Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit do të jetë e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat, TVSH-ja dhe taksa importi dhe dogane.

4.4 Konsiderata përmbledhëse

Bashkimi i gjithë këtyre shifrave dhe përshkrimet e tyre nënkuptojnë si më poshtë vijon:

1. Në fund të Vitit 7 operacional, duke pasur parasysh periudhën tranzitore, siti do të 'konservohet plotësisht' sipas standardeve të përcaktuara në Planin e Menaxhimit të Integruar, do t'i nënshtrohet një sërë ndërhyrjesh të nivelit ndërkombëtar, duke përfshirë një qendër të re vizitorësh, dhe do të jetë plotësisht i hapur për publikun me pagesë, i cili përllogaritet në rreth 300.000 vizitorë në vit, nga të cilët rreth 200.000 do të jenë shtetas të huaj;
2. Fondacioni i Menaxhimit të Butrinti do të jetë plotësisht operacional për shtatë vjet, duke marrë në konsideratë periudhën gjashtëmujore tranzitore, përpara së cilës ai merr në kontroll sitin në fillim të Vitit 1;
3. Nevojitet një investim kapital total prej 7.52 milionë USD, nga të cilat 39% do të shpenzohen për konservimin e sitit dhe 61% për ndërtimin e strukturave të reja për vizitorët dhe stafin;
4. Ndërkohë që investimi i përgjithshëm i përshkruar më sipër ndryshon nga viti në vit, nevojitet një investim total i akumuluar prej 5.13 milionë USD në Vitin 3, që përkon me investimet kryesore;
5. Falë këtij investimi do të krijohen interpretime dhe struktura të reja të standardeve ndërkombëtare në të gjithë Zonën A3 duke përfshirë një qendër të re vizitorësh, rregullime të reja interpretuese, rregullime të reja të transportit, si dhe rregullime të reja të stafit lidhur me kushte më të mira punësimi;
6. Projekti në tërësi gjeneron suficit operativ vjetor në Vitin 3 dhe suficit të akumuluar në Vitin 7 ku ai operon me fitim prej afërsisht 1.5 milionë USD në vitin pasardhës;
7. Të gjitha punimet e prapambetura për konservimin e sitit do të jenë adresuar dhe të gjitha punimet për mirëmbajtjen e vazhdueshme në të ardhmen do të jenë siguruar, duke garantuar në këtë mënyrë mirëqenien afatgjatë të rrënojave arkeologjike, që përbëjnë pasuritë parësore të sitit;
8. Struktura e re e menaxhimit do të përfaqësohet në operacionet e sitit, të cilat do të mundësojnë marrjen e shpejtë të vendimeve në të ardhmen për menaxhimin e sitit dhe me njohuritë e duhura për forcat e tregut;
9. Nëse dëshirohet, sigurimi i investimit në të ardhmen do të jetë më i lehtë nëpërmjet Fondacionit të Ri dhe investitorëve të tij partnerë, falë operimit të provueshëm fitimprurës së sitit;
10. Zhvillimi dhe përdorimi i markës Butrinti duhet të ndiqet si një mundësi biznesi e veçantë por që lidhet me të për një periudhë afatgjatë, pasi mund të sjellë përfitime të mëdha ekonomike dhe për komunitetin;
11. Tepricat vjetore nga operimi i Qytetit Antik *mund* të përdoren si fonde të investimit fillestar për (a) mbarë Parkun Kombëtar të Butrintit dhe/ose (b) site të tjera të ngjashme në mbarë Shqipërinë: që nënkupton se modeli mund të miratohet dhe shfrytëzohet diku tjetër, në varësi të kushteve të tregut vendas.

4.5 Përmbledhja e investimit kapital

Sipas projektit, nevojitet një investim kapital prej rreth 7.09 milionë USD.

Burimet e këtyre fondeve parashikohen të jenë:

Financime kapitale	milionë USD	%
AADF-ja dhe organizatat e saj partnere	**4.99**	**70%**
Qeveria e Shqipërisë	**2.10**	**30%**
Duke përfshirë:		
Fonde të Qeverisë për punime konservimi dhe investime të tjera	2.10	
Totali	**7.09**	

Figura 37: Përmbledhja e investimit kapital

Ju lutem vëreni se këto shuma supozojnë se investimi që do të ofrohet nga AADF-ja dhe partnerët e saj, në veçanti, *përjashton*:

1. Kosto shtesë të blerjes së tokës dhe kostot e tjera ligjore lidhur me to që nuk përmenden më sipër
2. Infrastrukturë shtesë dhe kosto shërbimi për dhe brenda Zonës A3 në të gjitha aspektet, duke përfshirë aspektet ligjore, projektuese, miratime ligjore, aspekte përgatitore dhe ndërtimi, duke përfshirë, por jo e kufizuar në një monitorim arkeologjik dhe autorizimi, disa prej të cilave llogariten në këtë Plan Biznesi, por për shkak të natyrës së tyre (të tilla si punime të mëdha infrastrukture) nuk mund të llogariten.

Gjithashtu, ju lutem vëreni se 4.99 milionë USD nga AADF-ja dhe partnerët e saj *nuk është ajo çka nevojitet në terma monetarë me ecurinë e projektit* pasi ata do të kenë përfitimet e të ardhurave nga siti kur Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit të marrë kontrollin.

5 Risku dhe menaxhimi i riskut

Të gjitha zhvillimet e reja, të çdo lloj fushe dhe shkalle, ofrojnë mundësi por mbartin edhe risqe.

E pazakontë për një projekt kulturor apo trashëgimie, në këtë rast, risqet *nuk janë tërësisht financiare*: rasti i biznesit është i shëndoshë dhe i bazuar në precedentë sipas njëzet e pesë viteve të fundit dhe i cili kërkon financimin e projektit për të siguruar zhvillimin dhe mirëqenien e tij të ardhshëm, pavarësisht problematikave të shkaktuara nga Covid-19.

Pra, nëse sigurohen financat, modeli do të funksionojë.

Faktorët e riskut ndaj zhvillimit të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të Butrintit ndahen në tri kategori: globalë, kombëtarë dhe vendorë.

A Risqet globale përfshijnë ato risqe për të cilat siti ka shumë pak gjasa që t'i zbusë. Për shembull, lëkundjet e forta sizmike, të cilat kanë ndodhur edhe më parë, duke lënë gjurmët e tyre në Zonën A3, mund ta ndryshojnë rrënjësisht strukturën e tij.

Sipas parashikimeve, ka shumë gjasa që të rritet niveli i Detit Jon, për shkak të ngrohjes globale, dhe nëse ndodhë, do të përmbysë sipërfaqe të mëdha të Zonës A3, duke përfshirë periferinë Romake, siç konstatohet edhe në një raport të fundit në revistën shkencore *Nature*[53].

B Risqet kombëtare janë ato risqe, te të cilat siti ka shumë pak gjasa që të ndikojë, duke qenë se ato përfshijnë politikën e vendit, ndryshimet në lidershipin politik, filozofi, vullnet apo udhëheqësit, të cilat mund të kenë pasojat e tyre në Parkun Kombëtar.

Destabilizimi politik në rajon, për të cilin ekziston një shembull jo i shumë viteve më parë, si edhe ndonjë manifestim terrorist, mund të rezultojë në rënie të shpejtë dhe të qëndrueshme të numrit të vizitorëve të huaj, siç ka ndodhur edhe në vende të tjera të Mesdheut, veçanërisht në Egjipt, gjatë viteve të fundit.

C Risqet vendore kanë të bëjnë me risqet e lidhura drejtpërdrejt me sitin, funksionimin e tij dhe atë të zonave të tjera pranë dhe rreth Butrintit.

Në këtë aspekt, risqet lidhen me mospranimin e rekomandimeve dhe propozimeve për zhvillimin, të cilat përfshijnë:

1. Mungesa e kapacitetit për të zgjeruar sitin përmes qendrës së re të vizitorëve, për shkak të pretendimeve mbi pronësinë e tokës, po ashtu dhe të zonave të tjera brenda Zonës A3
2. Refuzimi i Ministrisë së Kulturës për alokimin e fondeve, për punimet e mbartura të konservimit të sitit
3. Kundërshtimi i planeve të zhvillimit, veçanërisht për qendrën e re të vizitorëve, sepse shihen si plane me impakt negativ te mënyra se si funksionon aktualisht ekonomia vendase, ku përfshihet: blegtoria, akuakultura, lundra, etj.
4. Agjencitë qeveritare qendrore (ose vendore) ose i refuzojnë planet, ose nuk arrijnë një marrëveshje për to
5. Kundërshtimi vjen nga një sërë organesh dhe institucionesh akademike ndërkombëtare.

Këto risqe vendore, nëse nuk mund të adresohen, të paktën mund të zbuten, nga drejtuesit, duke përcaktuar qartësisht se çfarë po përpiqen të arrijë me ndërhyrjet e propozuara, dhe arsyen përkatëse.

[53]Reimann, L, Athanasios, T V, Brown S, Hinkel J, Tol R S J (2018) Mediterranean UNESCO World Heritage at risk from coastal flooding and erosion due to sea-level rise. (Trashëgimia Botërore e UNESCO-s në Mesdhe rrezikon përmbytjen dhe erozionin për shkak të rritjes së nivelit te detit.) *Nature* 16 tetor 2018

Prandaj, përpjekjet e PR-it duhet të jenë shumë cilësore dhe afatgjata.Kjo përpjekje duhet të koordinohet me Planin e Menaxhimit të Integruar dhe zhvillimin e "markës" së Butrintit, të cilat kanë potencialin të ofrojë përfitime domethënëse për komunitetin vendas.

5.1 Risqe politike dhe të tjera

Për aq sa mund të vlerësohet nga jashtë, këto risqe *nuk* kanë të bëjnë me performancën e Zonës A3 dhe aftësisë së saj për të gjeneruar të ardhura në afate të shkurtra, të mesme dhe të gjata siç pasqyrohet në këtë Plan Biznesi. Me shumë gjasa, siti do të vazhdojë të ketë një tepricë monetare (fitim) për arsyen e thjeshtë se, pasi të ketë kaluar pandemia e Covid-19, mbi 200,000 njerëz në vit do të zgjedhin të vizitojnë atë.

Risqetkryesore politike lidhen me aftësinë dhe vullnetin e AADF-së dhe partnerëve të saj të mundshëm për të dorëzuar në kohë një propozim plotësisht të financuar për të çuar përpara Sitin në bashkëpunim, dhe përmes negociatave, me Qeverinë Shqiptare.

Nëse marrëveshje të tilla *nuk mund* të arrihen, Siti, me shumë gjasa, do të vazhdojë në të njëjtën mënyrë.

Nëse, për çfarëdolloj arsye, do të kishte një vonesë (si në rastin e Covid-19), mendimi i P+P është se kjo *nuk duhet të devijojë* përgatitjen e Zonës A3, për transferimin te Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit deri në fund të vitit 2021, *nëse* ekziston vullneti si nga qeveria, ashtu dhe AADF-ja për ta dorëzuar atë dhe duke supozuar se çështjet lidhur me pronësinë e tokës të jenë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme.

Kjo, pasi ekziston një nevojë e qartë për të zhvilluar planet nëpërmjet periudhës tranzitore dje studimet shoqëruese, në veçanti për qendrën e re të vizitorëve, aksesin në sit dhe menaxhimin e ri, dhe akomodimet e stafit si një çështje disi urgjente, pasi kjo me patjetër do të kërkojë kohë për t'u projektuar dhe zbatuar, duke pasur parasysh natyrën dhe rëndësinë e sitit dhe numrin e madh të organizatave, agjencive dhe ministrive të përfshira.

Ky Plan Biznesi bazohet në premisën se mund të arrihet, në mënyrë të qetë dhe në kohë, një punë e ardhshme dhe marrëdhënie afatgjatë midis AADF-së dhe organizatave partnere të saj dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Sidoqoftë, marrja e ideve nga ky Plan dhe arritja e një marrëveshje zyrtare ndërmjet palëve lidhur me to, mbart risqe lidhur me disa faktorë kyçë.

Pa një renditje të caktuar, këta janë:

1. Parashikimi i një strukture të vazhdueshme të tërheqjes së parave bazuar në projekt (kryesisht, një linjë krediti) nga AADF-ja dhe partnerët e saj, e matur për shtatë vjet, për arsyet e sipërpërmendura;
2. Mungesa e vendimmarrjes nga palët e përfshira;
3. Pamundësia e palëve të përfshira për të kuptuar dhe ndarë riskun dhe kështu për të arritur një marrëveshje;
4. Nxitja e Ministrive të ndryshme për të mbështetur propozimet si zgjidhjen më të mundshme, të efektshme dhe plotësisht të financuar për menaxhimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Zonës A3 për mirëqenien afatgjatë si dhe përftimet shtesë për të gjithë Parkun Kombëtar;
5. Kostot, përgjegjësitë dhe risqet duhet të shpjegohen, dhe ku është e mundur, të ndahen bashkë;
6. Vendimmarrja nga ana e qeverisë për të vazhduar me projektin, plotësisht ose pjesërisht, së bashku me AADF-në si i vetmi partner strategjik (deri më sot) me fondet e disponueshme për të ndikuar në ndërhyrjet e nevojshme dhe për të siguruar mirëqenien e ardhshme të Sitit.

5.2 Risku i forcave madhore dhe katastrofave

Çështja e forcës madhore përgjithësisht përjashtohet nga planifikimi i menaxhimit të riskut, pasi trajtohet si risk që mund të sigurohet, nga pronari i tokës, menaxheri, ose të dyve së bashku. Kjo vlen dhe për Butrintin.

Pronësia e pasurive kulturore dhe natyrore të sitit do të mbetet e Qeverisë së Shqipërisë dhe, me shumë mundësi, nuk do ta sigurojë atë nga rreziqet e forcës madhore, pasi mendohet se mund të mbulohet kostoja e çdo dëmi nga katastrofat natyrore që mund të ndodhin, për shembull, si një zjarr katastrofik, (si ngjarja e fundit e Notrë Damit në Paris), luftë, revolucion, tërmet, epidemi (si p.sh. Covid-19) dhe përmbytje.

Në fakt, qeveritë (duke përfshirë dhe Qeverinë e Shqipërisë) vetësigurojnë, pasi primi për sigurimin ndaj shkatërrimit të pasurive kulturore dhe natyrore të një vendi do të arrinte një shifër astronomike. Megjithatë, ka dyshime nëse *ndonjë* kompani sigurimi do ta merrte përsipër këtë rrezik ose nëse ka kapacitetin financiar për ta marrë nën sigurim. Në Mbretërinë e Bashkuar, kjo qasje njihet si 'Sigurimi i Dëmshpërblimit të Qeverisë', sipas të cilës qeveria pranon se sigurimi është qeveria burimi i fundit i financimeve ndaj këtyre risqeve. Për sa i përket Fondacionit të Ri, kur të marrë kontrollin e Butrintit, ai *mund* të dëshirojë që të sigurohet ndaj, për shembull, humbjeve të fitimeve, prishjen e pasurive të sapo ndërtuara (si qendra e vizitorëve), shlyerjen e borxhit dhe rifitimin e kostove fikse të vazhdueshme. Këto janë të gjitha çështje operacionale lidhur me biznesin, ndaj, do të jetë në dorë të Fondacionit të Ri, duke u këshilluar me konsulentët e tij ligjorë dhe profesionistë të tjerë, për të vlerësuar këto risqe dhe për të marrë një vendim biznesi nëse ia vlen të ketë një policë sigurimi.

Ky Plan Biznesi përfshin një analizë ndjeshmërie me një variacion prej 30% (+15% shpenzime/-15% të ardhura) në modelin bazë, i cili shfaq një kontigjencë prej 10%, gjë që jep një shkallë të lartë konfidence se Plani do t'i arrijë këta parametra.

Por, nëse ndodh ndonjë ngjarje katastrofike (e tillë si një tërmet, pandemi ose një sulm terrorist) që e destabilizon të gjithë tregun e turistëve në Shqipëri, atëherë, është e qartë se Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të duhet të vepronte menjëherë duke hequr nga puna staf jo-kryesor (i orientuar ndaj vizitorëve) dhe të reduktojë operimin për të ruajtur integritetin e sitit dhe pasurive të tij arkeologjike dhe natyrore.

Kontingjenca të tilla duhet të përfshihen në marrëveshje(t) që do bëhen midis AADF-së/Fondacionit të Ri dhe qeverisë.

Do të ndihmonte edhe përdorimi i një sigurimi për humbjet e fitimeve/ndërprerjeve të biznesit. Një sigurim i tillë do të nevojitej për të mbuluar humbje operacionale të demonstrueshme dhe nuk do të mbulonte pasurinë fizike kryesor (Zonën A3), pasi ai do të mbetej në pronësi të shtetit. Një përllogaritje e kësaj është përfshirë në këtë Plan.

Të gjitha ndërhyrjet e sapondërtuara (qendra e vizitorëve, zyrat e stafit, përshtatja e muzeut në Kullën Veneciane, etj.) *duhet* të mbulohen me garanci ose nga furnizuesit ose kontraktuesit për të siguruar që artikulli i përfunduar të jetë i përshtatshëm për qëllimin, të mos ketë të meta dhe të jetë në përputhje me të gjithë rregullat dhe përcaktimet ligjore.

Zakonisht, nuk ka afate fikse për kohëzgjatjen e garancive të tilla, pasi ato janë krejtësisht të varura në natyrën specifike të shërbimit dhe marrëveshjes midis palëve kontraktuese. Mund të kërkohet këshillë nga ekspertët ligjorë të Fondacionit të Ri, kur të caktohen.

6 Ndikimi ekonomik

6.1 Parime

Ekonomitë ekzistojnë në shkallë. Ato mund të vlerësohen në nivel kombëtar, ndërkombëtar, rajonal ose vendor, dhe të gjitha janë njëkohësisht të pranishme. Matja e ndikimit të tyre është vërtet problematike, veçanërisht në nivel vendor. Gjithsesi, Banka Botërore, BE-ja, themeluesit privatë, organizata bamirësie dhe të ngjashme i konsiderojnë vlerësime të tilla si një përpjekje e vlefshme pasi, shpesh ato mbështesin vendimet për investim.

Edhe në ekonomitë që bazohen në ekspertizën e të dhënave, studimet e ndikimit ekonomik shihen me një farë skepticizmi[54]. Përfundimet e tyre shpesh shprehen në terma të punëve me kohë të plotë të krijuara dhe të ruajtura, pra, pjesërisht duke pasqyruar shqetësimet kryesore të qeverisë ose shoqërisë sponsorizuese që propozon zhvillimin, së bashku me nevojën për të shpjeguar rezultatet e ndërhyrjes financiare në një nivel që është lehtësisht i kuptueshëm.

Natyrisht që ndikimi ekonomik është një indeks shumë i gjerë dhe nuk përfshin rezultate më të detajuara, të tilla si indekset e mirëqenies së përgjithshme, lumturisë[55] ose kohezionit social. Sidoqoftë, mbetet një masë e njohur në mbarë botën. Duke pasur këtë parasysh, për sa i përket ndërhyrjeve kulturore ose të trashëgimisë, të gjitha bizneset, veprimet e qeverisë, aktivitetet bamirëse dhe sjelljet individuale ndikojnë në ekonomi në gjashtë mënyra 'teorikisht' të matshme:

1. Shpenzimi kapital
2. Stafi i punësuar drejtpërdrejtë
3. Koeficienti i punësimit
4. Shpenzime biznesi
5. Shpenzime shtesë për vizitorët dhe përdoruesit
6. Tatimi dhe transferimi në fonde rajonale, qendrore ose në grup.

Zëri	Shpjegim
Shpenzimi kapital	Do të krijohen vende pune gjatë fazës së ndërtimit, rregullimeve të brendshme dhe komisionimit të projektit. Ndërkohë që, në fakt, këto do të jenë vetë të përkohshme, është e mundur të shprehen në ekuivalentë të punës me kohë të plotë duke përdorur parametra vendorë për të vlerësuar peshën aritmetike ndërmjet punëve afatshkurtra dhe ekuivalentëve të tyre me kohë të plotë.
Stafi i punësuar drejtpërdrejtë	Siti do të punësojë staf me kohë të plotë, të pjesshme dhe sipas nevojave
Koeficienti i punësimit	Shpenzimet e stafit të sitit për të mira, shërbime dhe të ngjashme në ekonominë vendore do të mbështesë vende pune shtesë, dhe si rrjedhojë do të sjellë më shumë vende pune duke krijuar një efekt zinxhir të paevitueshëm.
Shpenzimi i projektit	Siti do të shpenzojë para për mallra dhe shërbime të cilat do të sjellin krijimin e vendeve të punës për shkak të efektit zinxhir
Shpenzimet e vizitorëve jashtë sitit	Vizitorët do të shpenzojnë para larg sitit. Kjo do të krijojë dhe do të ruajë një grup tjetër vendesh pune pasi do të ndikojë ekonominë
Tatimi	Ky varet në politikat e qeverisë dhe forma e organizatës

[54]Për një kritikë shihni Hansen, T. B. (1995) 'Measuring the value of Culture', në International Journal of Cultural Policy, Vol.1, Nr.2, 309-322. Ky artikull mund të ketë më shumë se njëzet vjet që është shkruar, por gjetjet e tij vlejnë edhe sot

[55]Shihni, për shembull, *The World Happiness Report*; një publikim vjetor i Rrjetit të Zgjidhjeve për një Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-së. NB: Në mars 2019, Finlanda u rendit vendi më i lumtur në botë, ndërsa Republika e Burundit u rendit vendi më pak i lumtur.

Ndikimi ekonomik nuk është një shkencë ekzakte. Vërtet, përveç se në rastin teorik të një komuniteti ishullor të izoluar, thuajse pa asnjë lidhje të jashtme[56], vlerësimi i ndikimit ekonomik është mjaft i vështirë pasi ndikimi varet në sasinë e prurjeve nga siti, rajoni dhe vendi; për shembull, kur dhe si paguajnë vizitorët për vizitën e tyre, ku qëndrojnë, ku hanë, si arrijnë aty? Kush paguan taksën?

Për shembull, një anije kroçera që ankorohet në Korfuz dhe që dërgon vizitorë në Butrint (pjesa më e madhe e 200.000 vizitorëve të huaj në vit të regjistruar në sit për vitin 2018 vijnë nga Korfuzi) me shumë siguri kanë pronësi jashtë vendit, ofrojnë ushqime dhe pije në anije, do të jenë furnizuar me karburant jashtë Shqipërisë, udhërrëfyesit turistikë do të jenë paguar kryesisht nga shoqëri joshqiptare (evropiane ose të tjera) përpara vizitës, dhe do të kenë rënë dakord me furnizuesit vendas (shqiptarë) të transportit.

Konsorciumi që zotëron anijen do të paguajë taksa në ndonjë vend tjetër, nëse i paguan ato[57]. Asnjë përveç pronarëve aktualë të anijeve kroçera (dhe ndoshta në një mënyrë modeste, firma vendase të transportit) nuk fitojnë shumë me marrëveshjet aktuale, që paraqet potencialin për fitime më të ulëta për Butrintin.

6.2 Butrint

Duhet të gjenden potenciale dhe marrëveshje të tjera fitimi në Butrint duke u bazuar në tregun e anijeve kroçera, dhe këtë duhet ta bëjë Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Një udhëtim dhjetë ditor me anije në Mesdheun lindor, i rezervuar online, për shembull, nga Parisi, mund të kushtojë deri në 4.500 USD për person, nga të cilat Butrinti, i përmendur thuajse në të gjitha itineraret nëpërmjet Korfuzit, nuk merr pothuaj asgjë, vetëm çmimin e hyrjes.

Emri i Butrintit, Marka e tij, dhe vendi i tij në botë, vlejnë shumë më tepër se kaq.

Sigurisht, çdo gjë varet se si Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të trajtojë dhe zhvillojë modelin financiar për Butrintin në të ardhmen.

Një model i mirë referimi, për qëllime të menaxhimit dhe rrjedhimisht të ndikimit, është Pompei i cili aktualisht po përballet me numrin e madh të vizitorëve në sit, ku një grup në veçanti përbën më shumë problem:

> *Turistët e anijeve kroçera po i prishin rrënojat e Pompeit. Në veçanti, shkallët e hyrjes në Tempullin e Apollonit janë shkatërruar nga fluksi i turistëve. Turistët e anijeve kroçera kanë një kohë të kufizuar, ndaj, ata gjithnjë përqendrohen në të njëjtën rrugë.*[58]

Lagi sugjeron të devijojë turistët nga Pompei, duke i drejtuar në site të tjera arkeologjike të mahnitshme aty pranë (si Herkulaneum dhe Villa Poppea (Oplontis)[59], të cilat janë po aq madhështore, por më pak të frekuentuara.

---

[56]Ishulli i Pashkëve është një shembull. I tërë ishulli është Sit i Trashëgimisë Botërore dhe përfshin dhe një Park Kombëtar. I aneksuar nga Kili në vitin 1888 dhe tani si pjesë e qeverisjes së Rajonit të Valparaisos, 7.500 banorët e tij presin 100.000 turistë në vit, aq sa tashmë po vendosin kufizime në sit (*The Independent* 30 korrik 2018)

[57]Tre operatorët më të mëdhenj të anijeve kroçera janë Carnival Corporation, Royal Caribbean dhe Norwegian Cruise Liner Holdings, të cilët pavarësisht vendit të origjinës, të gjithë lundrojnë me flamuj të ndryshëm sipas lehtësirave, ku flamuri i Panamasë është më popullori.

[58]Adele Lagi, Mbikëqyrëse në Pompeii; UNESCO, nga punimet e konferencës për 'I Love Pompeii' (2016).

[59]Të dhënat sugjerojnë që ishte në zotërim të Perandorit Neron (mbretëroi 54-68) dhe mendohet që është përdorur nga gruaja e tij e dytë (Poppaea Sabina) si rezidenca e saj dytësore kur ishte larg Romës.

Në këtë Plan Biznesi rekomandohet ideja e shpërndarjes së ngarkesës së vizitorëve nga Qyteti Antik i Butrintit drejt rrënojave dhe atraksioneve të tjera në mbarë Parkun Kombëtar. Një lëvizje e tillë ka ndikime pozitive dhe në xhiron ekonomike që do të sjellë ky Plan Biznesi.

Për shembull, përgjysmimi i numrit të vizitorëve të parashikuar në Vitin 7 (rreth 150,000 në vit) ku secili të paguajë tre ose katër herë më shumë për vizitë do të ishte në dobi të sitit në tre mënyra:

1. Duke gjeneruar më tepër para nëpërmjet shumës së hyrjes
2. Duke pakësuar dëmin në infrastrukturën fizike të sitit për shkak të përdorimit të tepërt nga vizitorët
3. Do ta bënte Butrintin një atraksion elitar 'që duhet vizituar me patjetër', ku mund të parashikohen dhe rritje të mëtejshme të çmimeve, si dhe shpenzime shtesë.

Si përfundim, do të kufizonte numrin e vizitorëve tek ata që mund të paguajnë dhe si rrjedhojë do ndikonin dhe faktorët socialë dhe arsimorë.

Këta janë vetëm disa nga shembujt e çështjeve shumë urgjente, të cilat duhet të adresojë Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit dhe drejtori i tij i ri si dhe ekipi drejtues i menaxhimit ... si e sheh veten Butrinti si atraksion turistik në konkurrim me shumë atraksione të tjera në Mesdheun Lindor? A mund të marrë një komision nga operatorë e anijeve kroçera përpara vizitës së tyre?

6.3 Rezultati

Nëse duhet të ngremë supozime bazuar në njohuritë ekzistuese, atëherë mund të kryhet një përllogaritje shumë e përgjithshme në terma të vendeve të punës ekuivalente më kohë të plotë dhe të *hamendësohet* se:

Zëri	Përllogaritje e përafërt
Shpenzimi kapital	Çdo 50.000 USD nga shpenzimet kapitale gjeneron 1 vend pune me kohë të plotë e matur për 10 vjet = 7.5 milionë USD/50.000 USD/10 = 15 (rreth 20)[60]
Stafi i punësuar drejtpërdrejtë	Sipas planit të biznesit = 44 (neto = 30, pasi 14 janë aktualisht të punësuar)
Koeficienti i punësimit	Shpenzimet e stafit të sitit për të mira, shërbime dhe të ngjashme në ekonominë vendore do të mbështesin vende të tjera pune, dhe si rrjedhojë do të sjellin më shumë vende pune duke krijuar një efekt zinxhir të paevitueshëm = 44* 0.3= 15 (neto 8)
Shpenzimi i projektit	Siti do të shpenzojë para për të mira dhe shërbime të cilat do të sjellin krijimin e vendeve të punës për shkak të efektit zinxhir = shpenzimi vjetor i projektit * 15% / 50.000 USD = 33.
Shpenzimet e vizitorëve jashtë sitit	Vizitorët do të shpenzojnë para larg sitit. Kjo do të krijojë dhe do të ruajë një grup tjetër vendesh pune pasi do të ndikojë në ekonomi. Kjo është shumë e vështirë të përllogaritet. 200.000 vizitorë të huaj që paguajnë 10 USD do të thotë 200K * USD 10 *0.1=200. Meqenëse këto ndodhin tani, ato duhet të ulen me (rreth) 90% = 20 të tjerë
Tatimi	Kjo varet tërësisht në politikat e qeverisë, ndaj dhe nuk janë bërë supozime.

Ky vlerësim sugjeron se Zona A3, nën Fondacionin e Ri, do të mund të mbështesë, minimalisht 111 *vende të reja pune me kohë të plotë* brenda dhe përreth sitit (20+30+8+33+20) për një periudhë afatgjatë.

[60]Burimi: Banka Botërore; botime të ndryshme bazuar në Shqipëri, me interpretimin e autorit.

Kjo nuk është diçka e vogël.

Mund të jetë më shumë ose më pak, mund të parashikohen diku ndërmjet 95 dhe125 punonjës me kohë të plotë. Çfarë është e rëndësishme, kjo është *pozitive*: do të ketë *shumë* vende pune me kohë të plotë në zonën vendase se ç'ka tani si pasojë e ndërhyrjeve të Fondacionit të Ri. Maksimizimi i këtij përfitimi do të jetë në dorë të Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit.

6.4 Përfitimet shtesë

Për më tepër, shumë prej tyre do të jenë punë të kualifikuara pasi lidhen me konservimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të Qytetit Antik, dhe si rrjedhojë do të krijojnë aftësi që transferohen në pjesë të tjera të ekonomisë shqiptare.

Kjo ishte një ambicie e Fondacionit Butrinti, e cila duhet të njihet dhe të pasqyrohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Kjo analizë e përgjithshme sugjeron se çelësi për ndikimin e përgjithshëm ekonomik të Butrintit nuk është ajo çfarë ndodh në vetë sitin: është përqendrimi i shpenzimeve jashtë sitit brenda mbarë Parkut Kombëtar që është kyçe, përndryshe do të shpërndahet në pjesën tjetër të Shqipërisë, apo në Korfuz, siç ndodh tani.

Për më tepër, kjo nuk llogarit prezantimin e Markës Butrinti: një funksion kyç i Fondacionit të Ri.

Gjithashtu, fakti që Butrinti *po zhvillohet* (dhe do të shihet zhvillimi) do të ketë ndikime pozitive, kolaterale në ekonominë mbështetëse nëpërmjet çmimeve të shtëpive, tarifave të mbledhura, e me radhë, duke parashikuar se shuma të tilla mund të merren nga qeveria.

Pra, ndërhyrjet e propozuara në këtë Plan Biznesi për Butrintin janë *tërësisht pozitive* në terma ekonomike.

Se si këto do të konkretizohen varen nga puna, përfshirja dhe synimet e Fondacionit të ri, dhe kjo është në dorë të Bordit të Ri dhe stafit drejtues që do të punësojë ai.

7 Hapat e mëtejshëm

Ky Plan Biznesi ka treguar se nuk ekzistojnë problematika teknike të pakapërcyeshme lidhur me zhvillimin e tij në dobi të Zonës A3.

7.1 Çështjet kyçe për t'u zgjidhur

Çështjet e pazgjidhura lidhur me zhvillimin e një projekti të suksesshëm janë *ligjore* ose *politike*, dhe përqendrohen në:

- Zgjidhjen e çështjes së pronësisë së tokës brenda Parkut Kombëtar, veçanërisht të vendit të propozuar për qendrën e re të vizitorëve
- Nevojën për një Autoritet të ri që të mbikëqyrë menaxhimin e Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe të mbarë Parkut Kombëtar, me qëllim mbështetjen e punës brenda Zonës A3
- Transferimin e 2.1 milionë USD, që mbahen nga Ministria e Kulturës, te Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit për punimet kryesore të konservimit të sitit
- Marrëveshjet specifike ligjore dhe menaxheriale midis Fondacionit të Ri dhe Qeverisë
- Zgjidhjen e mospërputhjes së kufijve midis Përcaktimit të Zonave nga Ministria e Kulturës, AKZM-ja dhe UNESCO
- Pamundësinë e qeverisë për të vënë në dispozicion Zonën A3 (mbetet për t'u përcaktuar në ligj) si një pasuri pa barrë, për t'i mundësuar Fondacionit të Ri që të vijojë me planet e zhvillimit dhe strategjitë e investimit
- Pranimin dhe miratimin nga ana e qeverisë të Planit të Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar në tërësi.

7.2 Rruga përpara

Në pritje për miratim dhe zgjidhje e vazhdueshme të çështjeve të mësipërme, nevojiten veprimet në vijim për sa i përket këtij Plani Biznesi gjatë vitit të parë, e përkufizuar si Periudha Tranzitore:

1. Fillimi i procesit të ngritjes së Fondacionit të Ri, me të gjitha rregullimet përkatëse ligjore, kushtetuese dhe financiare, duke bashkëpunuar me qeverinë në të gjitha aspektet, duke përfshirë edhe çështjet e përvetësimit të tokës
2. Fillimi i të gjitha punimeve lidhur me periudhën tranzitore; kjo është veçanërisht e rëndësishme për punimet e konservimit të sitit, të cilat nuk mund të menaxhohen nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, deri sa ky i fundit të marrë përsipër kontrollin e menaxhimit të sitit
3. Fillimi i aktivizimit të rolit të anëtarëve të autorizuar të bordit (nëse nevojitet) gjatë periudhës tranzitore, në mënyrë që të ruhet shtysa e projektit.

Duke supozuar se 1-3 janë në proces, të realizohen sa më poshtë vijon:

4. Kryerja e një studimi fizibiliteti dhe projektimi fillestar për fazën 1 të qendrës së vizitorëve
5. Bashkëpunim me UNESCO-n dhe agjenci të tjera (lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, nëse është e nevojshme) për krijimin e një qendre të re vizitorësh, e cila do të ndërtohet në dy faza, në vendndodhjen e rekomanduar, si dhe për aspekte të tjera të projektit
6. Hartimi dhe përgatitja e udhëzimeve dhe fillimi i zhvillimit të studimeve të mëposhtme të specializuara:
    - Studim hidrologjik mbi të gjithë vijën ujëndarëse të Parkut Kombëtar, për të informuar veprimet e përshtatshme për zbutjen e efekteve të rritjes së horizonteve ujëmbajtëse

- Menaxhimi/mentorimi i mbështetjes për periudhën tranzitore në tërësi, për t'i mundësuar stafit sistemimin e plotë në sit
- Hartimi i një plani infrastrukturor interpretues dhe turistik për mbarë Parkun, rekomandimet e të cilit do të zbatohen, me shumë gjasë, nga palë të tjera
- Studime për menaxhimin e qarkullimit dhe transportit, veçanërisht lidhur me përdorimin e tragetit dhe efikasitetin e transportit alternativ, të përshtatshëm për vizitorët
- Vrojtime për menaxhimin dhe kënaqshmërinë e vizitorëve, që janë edhe çelësi i menaxhimit të suksesshëm afatgjatë të sitit
- Hartimi i planeve të detajuara për trajnimin dhe angazhimin e komunitetit për vendasit dhe të tjerë, në një sërë disiplinash të lidhura me sitin
- Plan biodiversiteti/ekologjik për Zonën A3 dhe Zonën Buferike me monitorim vjetor
- Plane për menaxhimin e shëndetit, sigurisë dhe fatkeqësive, si dhe përditësimi i tyre, veçanërisht lidhur me rrezikun nga zjarri dhe në raste emergjence evakuimin e vizitorëve, stafit dhe artefakteve të lëvizshme, arkivave dhe dokumenteve të tjera.

7. Hartimi dhe përgatitja e udhëzimeve, si dhe fillimi i kryerjes së projektimeve për interpretimin e Sitit, duke përfshirë muzeun e ri në Kalanë Veneciane, Kalanë Trekëndore dhe sitin në tërësi, varkat për transportimin e pasagjerëve, mjetet ekologjike të transportit etj. (të konsiderohen ose si paketë punimesh, ose në seri)

8. Vijueshmëria e angazhimit të palëve vendase të interesit për të dhënë sugjerimet e tyre, teksa u shpjegoni mundësitë për tregti, që do t'iu ofrohen falë zhvillimeve të propozuara, duke siguruar kështu mbështetjen e tyre, e cila do të jetë jetike në plan afatgjatë

9. Marrja në konsideratë e Markës që do t'i ofrojë Butrinti brezave të ardhshëm, së bashku me mënyrat se si kjo markë do të pasqyrohet dhe konsolidohet si në Zonën A3, ashtu edhe në mbarë Parkun Kombëtar, si Zonën e tij Buferike

10. Marrja në konsideratë e implikimeve për të gjithë stafin ekzistues të sitit dhe mirëqenien e tyre në të ardhmen, si dhe punësimin e personave të rinj, duke përfshirë përshkrime të detajuara të pozicioneve të punës dhe kushteve të shërbimit, si dhe intervistimi dhe fillimi i përzgjedhjes së kandidatëve, siç gjykohet e përshtatshme.

Shumë prej këtyre veprimeve mund, dhe duhet, të ndërmerren paralelisht.

Shtojca A Përmbledhje financiare e Zonës A3: 2013-2020

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të të ardhurave dhe shpenzimeve për Zonën A3 duke nisur nga viti 2013 dhe duke përfshirë vitin 2020. Të gjitha qelizat janë në USD.

	2013		2014		2015		2016		2017		2018		2019		2020	
	Shpenzimet e financuara nga shteti		**Shpenzimet e financuara nga shteti**		**Shpenzimet e financuara nga shteti**		**Shpenzimet e financuara nga shteti**		**Shpenzimet e financuara nga shteti**		**Shpenzimet e financuara nga shteti**		**Shpenzimet e financuara nga shteti**		**Shpenzimet e financuara nga shteti**	
Pagat* Financuar nga shteti (neto)	63,623		64,042		59,545		56,344		68,639		78,327		65,984		69,406	
Pagat* taksa; Fondi i pensionit	10,604		10,649		10,153		7,018		11,383		13,071		13,198		13,634	
TOTAL	74,227		74,690		69,698		63,362		80,022		91,398		79,181		83,040	
	Shpenzimet e financuara nga të ardhurat e veta		Shpenzimet e financuara nga të ardhurat e veta		Shpenzimet e financuara nga të ardhurat e veta		Shpenzimet e financuara nga të ardhurat e veta		Shpenzimet e financuara nga të ardhurat e veta		Shpenzimet e financuara nga të ardhurat e veta		Shpenzimet e financuara nga të ardhurat e veta		Shpenzimet e financuara nga të ardhurat e veta	
Stafi sezonal (pagesat)	13,344		12,855		5,556		5,935		8,784		7,993		8,197		9,597	
Shpenzimet e zyrës	4,862		4,168		5,533		5,990		8,976		9,466		5,935		11,935	
Materiale specifike (uniforma, herbicide, printim biletash, broshura	10,635		7,468		13,749		17,215		22,181		23,519		23,283		18,006	
Shërbimet (energjia elektrike, interneti etj.)	7,726		15,512		15,822		12,169		18,552		16,759		15,140		21,757	
Siguria	55,186		64,662		68,097		67,196		75,416		71,779		90,343		91,615	
Transportation costs	2,972		3,448		5,833		7,790		8,834		9,954		9,971		9,217	
Shpenzimet e transportit, udhëtimit	97		2,056		249		1,033		1,076		658		1,410		2,858	
Kosto të tjera operative (TVSH, shërbime dhe materiale të tjera)	40,798		48,863		2,228		2,043		18,022		1,540		12,533		14,443	
Kostot e mirëmbajtjes	7,781		6,923		20,967		8,356		8,886		10,353		9,228		22,068	
Qira zyrash									2,108							
Projekte/studime/faqe interneti	3,363		756		4,942				113,532							
Investimet	3,993		7,210		23,115		32,410		7,594				50,280		8,081	
Kostot e ruajtjes (konservimit)					228,900		17,879		46,626							
Kostot e bashkëpunimit në projekte					11,979		9,451								1,045	
TOTAL	**150,757**		**173,920**		**406,970**		**187,468**		**340,585**		**152,022**		**226,322**		**210,622**	
	Të Ardhurat		**Të Ardhurat**		**Të Ardhurat**		**Të Ardhurat**		**Të Ardhurat**		**Të Ardhurat**		**Të Ardhurat**		**Të Ardhurat**	
	ZAKPB (90%)	SHTETI(10%)	ZAKPB (90%)	SHTETI(10%)	ZAKPB (90%)	SHTETI(10%)	ZAKPB (90%)	SHTETI(10%)	ZAKPB (90%)	SHTETI(10%)	ZAKPB (90%)	SHTETI(10%)	ZAKPB (90%)	SHTETI(10%)	ZAKPB (90%)	SHTETI(10%)
Të ardhura nga biletat	304,062	33,785	348,521	38,725	420,765	46,752	435,208	48,356	485,784	53,976	695,705	77,301	827,194	91,910	102,821	11,425
Të ardhura nga publikimet	129	14														
Të ardhura nga sponsorizimet	1,010		934		1,043								139,595	15,511		
Shërbime konsulence			182	20	503	56	194	22	34	4	551	61	303	34		
Të ardhurat nga qiratë					1,788	199	1,131	126	902	100	2,820	313	1,770	197	89	10
Të ardhura të tjera					349	39									15	2
TOTAL	**305,201**	**33,799**	**349,637**	**38,745**	**424,448**	**47,045**	**436,532**	**48,504**	**486,720**	**54,080**	**699,076**	**77,675**	**968,861**	**107,651**	**102,926**	**11,436**

FONDACIONI PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT

- dhe -

MINISTRIA E KULTURËS E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- dhe -

INSTITUTI I ARKEOLOGJISË

PROTOKOLL BASHKËPUNIMI

TIRANË, SHQIPËRI 16 / 11 /2021

KY PROTOKOLL BASHKËPUNIMI lidhet

NDËRMJET:

(1) **FONDACIONIT PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT**, me seli në adresën Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Ndërtesa 6, Hyrja 11, Apartamenti 21, 1019, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga përfaqësuar nga Z. Martin Mata dhe Z. Aleksandër Sarapuli, sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve nr. 3, datë 08.10.2021 ("**Fondacioni**"), dhe

(2) **MINISTRISË SË KULTURËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, me seli në adresën rruga "Aleksandër Moisiu", ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Znj. Elva Margariti, Ministre e Kulturës (**"Ministria"**); dhe

(3) **INSTITUTIT TË ARKEOLOGJISË,** me seli në adresën sheshi "Nënë Tereza", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Institutit të Arkeologjisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Znj. Belisa Muka ("**IA**")

DUKE QENË SE:

A IA, i krijuar në 1991 në vazhdën e Muzeut Arkeologjik Etnografik, është një institucion kërkimor shkencor, pjesë e Albanologjike, me objekt veprimtarie hulumtimet arkeologjike në të cilët përfshihen midis të tjerave, gërmimet arkeologjike, monitorimet arkeologjike, sondazhet arkeologjike dhe vëzhgimet arkeologjike;

B Nga krijimi i tij, IA ka luajtur një rol të rëndësishëm në arkeologjinë institucionale në Shqipëri, duke rritur ndjeshëm dinamikën dhe shtrirjen gjeografike të kërkimeve arkeologjike në lidhje me periudha të ndryshme historike si periudha e vonë antike dhe ajo mesjetare, në bashkëpunim me universitete te mirënjohura europiane dhe amerikane duke marre eksperiencat më të mira në qendra të rëndësishme arkeologjike, përfshirë Parkun Kombëtar të Butrintit (sikurse është përkufizuar më poshtë);

C IA ka kryer ndër vite kërkime dhe studimet të vyera në një sërë monumentesh të Parkut Kombëtar të Butrintit të periudhës paleobizantine si Baptister, Trikonkë, Bazilikën e Madhe, muret rrethuese, si dhe hulumtimet në zonat përreth, përfshirë Vrinën, kompleksin e vilave romake dhe manastirin paleokristian të Diaporit etj., duke luajtur një rol të rëndësishëm në njohjen dhe zhvillimin sa më të gjerë të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe vlerave të tij arkeologjike dhe kulturore.

D Në përputhje me Marrëveshjen e Administrimit (sikurse është përkufizuar më poshtë) të lidhur midis Ministrisë dhe Fondacionit, ky i fundit është personi juridik i ngarkuar me administrimin indirekt të Pasurisë Kulturore (sikurse është përkufizuar më poshtë), e cila përfshin një nga zonat arkeologjike më të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë dhe që luan një rol kryesor në hulumtimet dhe zbulimet arkeologjike të IA;

E Ministria, IA dhe Fondacioni njohin rëndësinë e gërmimeve dhe hulumtimeve arkeologjike në zbulimin dhe rritjen e vlerave të trashëgimisë kulturore në zonën e Pasurisë Kulturore dhe rrjedhimisht Fondacioni mbështet IA në kryerjen e aktiviteteve të hulumtimit arkeologjik dhe IA pranon se hulumtimet arkeologjike përbëjnë një nga aktivitetet e shumta të nevojshme për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Pasurisë Kulturore.

ËSHTË RËNË DAKORD:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Termat e mëposhtëm dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet përkatëse si më poshtë:

"Data e Transferimit" nënkupton datën në të cilën Fondacioni merr në dorëzim Pasurinë Kulturore nga Ministria;

"Fondacion" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Marrëveshje;

"IA" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Marrëveshje;

"IKTK" nënkupton Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore;

"KKTKM" nënkupton Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;

"Hulumtime Arkeologjike" nënkupton vlerësimin e potencialit arkeologjik, vëzhgimi sipërfaqësor (sipas nocionit klasik, si dhe metodave të reja për vëzhgimin arkeologjik, si p.sh. studimet, gërmimet arkeologjike dhe me gjeoradar etj.), sondazhet arkeologjike, gërmimi arkeologjik, monitorimi, konservimi, administrimi arkeologjik, si dhe përpilimi i dokumentacionit të nxjerrë prej kësaj veprimtarie, raporteve paraprake dhe përfundimtare, deri në botimin e rezultateve;

"Legjislacioni i Zbatueshëm" nënkupton, në lidhje me çdo Palë, çdo akt detyrues ndërkombëtar, çdo dispozitë kushtetuese, ligj, statut, rregull, rregullore, urdhëresë, traktat, urdhër, dekret, vendim, certifikatë, akt, regjistrim, licencë, franchisë, leje, autorizim, udhëzim, miratim qeveritar, pëlqim ose kërkesë të një autoriteti kompetent që ka juridiksion mbi Palën ose pronën e saj, të zbatueshëm sipas ligjit apo statutit, duke përfshirë interpretimin dhe administrimin e saj nga autoriteti kompetent;

"Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" nënkupton Ligjin nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë";

"Marrëveshja e Administrimit" nënkupton marrëveshjen e administrimit të lidhur midis Fondacioni dhe Ministrisë, me anë të të cilës Fondacioni ngarkohet me administrimin indirekt të Pasurisë Kulturore;

"Ministria" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse të kësaj Marrëveshje;

"Palë" nënkupton, sipas rastit, Ministrinë, Fondacioni ose IA; së bashku **"Palët"**;

"Parku Kombëtar i Butrintit" nënkupton territorin natyror dhe arkeologjik i përcaktuar si park Kombëtar sipas VKM 693;

"Pasuri Kulturore" nënkupton Pasurinë Kulturore të Paluajtshme që ndodhet në Parkun Kombëtar të Butrintit, në administrim të Ministrisë, sipas përkufizimit të dhënë në Marrëveshjen e Administrimit.

"Person i Lidhur" nënkupton çdo person fizik ose juridik, nëpunës, bashkëpunëtor, nënkontraktor, studiues, konsulent, bashkëkontraktor, i cili është i lidhur me një Palë nëpërmjet një marrëdhënie punësimi ose marrëdhënie kontraktore;

"Protokoll Bashkëpunimi" nënkupton këtë protokoll bashkëpunimi të nënshkruar nga Fondacioni dhe IA;

"ZAKPKB" nënkupton Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar Butrint;

1.2 Çdo fjalë me gërma kapitale që nuk është e përkufizuar këtu, do të ketë të njëjtin kuptim si në Marrëveshjen e Administrimit.

2. HYRJA NË FUQI, AFATI

2.1 Ky Protokoll Bashkëpunimi hyn në fuqi në Datën e Transferimit dhe do të jetë i vlefshëm deri në mbarimin e afatit ose zgjidhjen e parakohshme të Marrëveshjes së Administrimit.

3. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

3.1 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, nenin 4 dhe nenin 3.2 të Protokollit të Bashkëpunimit, IA dhe çdo Person i Lidhur me të, ka të drejtën:

(a) e hyrjes dhe qarkullimit në territorin e Pasurisë Kulturore gjatë ditëve të pushimit ose të festave zyrtare dhe/ose jashtë orareve të hapjes së Pasurisë Kulturore për publikun, pa u penguar nga drejtuesit dhe stafi i Fondacionit me kusht që të njoftojë me shkrim Fondacionin të paktën 5 ditë pune përpara;

(b) e kryerjes së Hulumtimeve Arkeologjike sipas projektit të miratuar në KKTKM në nëtokën ose nën ujë në territorin e Pasurisë Kulturore duke përfshirë por pa u kufizuar në ndërhyrjen e plotë nëpërmjet mënyrës frontale të avancimit (open area excavation), zgjerimit të sipërfaqes së gërmimit të mëparshëm, ose nëpërmjet parcelimit (copëzimit) të sipërfaqes arkeologjike, vlerësimin e potencialit arkeologjik, vëzhgimin sipërfaqësor (përfshirë gërmimet, përdorimin e radarit), sondazhin arkeologjik, monitorimin arkeologjik dhe përpilimin e dokumentacionit përkatës. Para fillimit të kryerjes së Hulumtimeve Arkeologjike, IA duhet të rrethojë zonën ku kryhen Hulumtimet Arkeologjike dhe të vendosë sinjalistikën e nevojshme për të siguruar sigurinë dhe shëndetin e arkeologëve dhe të vizitorëve.

(c) depozitimit të gjetjeve arkeologjike në një ambient të vënë në dispozicion nga Fondacioni, të përshtatshëm, të mbuluar dhe të ruajtur, deri në mbarimin e projektit të Hulumtimit Arkeologjik.

3.2 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Fondacioni:

(a) lejon dhe mundëson hyrjen e IA dhe të çdo Personi të Lidhur me të, në përputhje me nenin 4 dhe me kusht që IA dhe çdo Person i Lidhur me të të respektojnë rregulloret dhe protokollet e brendshme të Fondacionit, përshirë ato për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë;

(b) mund të kërkojë shtyrjen ose ndryshimin e programit të Hulumtimeve Arkeologjike nëse:

(i) periudha e përzgjedhur për kryerjen e Hulumtimeve Arkeologjike përkon me periudhën e përzgjedhur paraprakisht nga Fondacioni për organizimin dhe zhvillimin e një ngjarjeje kulturore apo ndonjë veprimtarie tjetër; dhe

(ii) kryerja e Hulumtimeve Arkeologjike prek zonën ose monumentin në të cilin Fondacioni ka planifikuar paraprakisht të kryejë ngjarjen kulturore apo shqetëson kryerjen e veprimtarisë së Fondacionit.

Palët do të bisedojnë në mirëbesim për të mundësuar kryerjen e Hulumtimeve Arkeologjike dhe minimizimin e shqetësimeve që Hulumtimet Arkeologjike mund të sjellin në aktivitetet e Fondacionit.

(c) do të marrë masat e nevojshme për rrethimin, sinjalizimin e zonës ku kryhen Hulumtimet Arkeologjike për të siguruar sigurinë e shëndetit të vizitorëve;

(d) përveç shenjave të tjera dalluese, do të mbajë të ngritur flamurin zyrtar shqiptar në territorin e Pasurisë Kulturore;

(e) ka të drejtën e marrjes së masave shtesë për rrethimin, sinjalizimin e zonës ku kryhen Hulumtimet Arkeologjike, nëse marrja e këtyre masave është parashikuar në protokollet dhe rregulloret e brendshme të Fondacionit për ruajtjen e sigurisë dhe shëndetin brenda Pasurisë Kulturore.

4. NJOFTIMI PARAPRAK I PROJEKTEVE

4.1 IA do të njoftojë me shkrim Fondacionin për çdo projekt Hulumtimi Arkeologjik që ka marrë aprovimin e KKTKM dhe IKTK të paktën 60 ditë përpara datës së parashikuar për fillimin e projektit të Hulumtimeve Arkeologjike, duke përfshirë në njoftim projektin e plotë të miratuar. Në rast se data e fillimit të projektit të Hulumtimeve Arkeologjike është më e afërt se 60 ditë nga data e marrjes së aprovimeve, IA do të njoftojë Fondacionin të paktën 30 ditë përpara datës së parashikuar për fillimin e projektit të Hulumtimeve Arkeologjike, pavarësisht nëse projekti nuk është miratuar ende nga KKTKM dhe IKTK.

4.2 Çdo njoftim apo komunikim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Protokoll Bashkëpunimi duhet të kryhet në formë të shkruar, dhe konsiderohet i dorëzuar nëse dorëzohet personalisht, me postë rekomande të parapaguar, me korrier në adresën e Palës tjetër e cila jepet më poshtë, me faks (me marrje të konfirmimit të transmetimit) në numrin e faksit të Palës tjetër, ose postë elektronike në adresën e marrësit ose (sipas rastit), me kusht që, nëse nuk është dhënë adresë postare apo poste elektronike dhe/ose numri faks për marrjen e njoftimeve, këto njoftime nuk do të dorëzohen nëpërmjet këtyre mënyrave të komunikimit.

4.3 Adresat e Palëve për njoftim do të jenë ato të dhëna më poshtë, ose një adresë tjetër që secila Palë mund t'ia njoftojë me shkrim Palës tjetër për këtë qëllim.

(a) Për Fondacionin

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Kullat Binjake, Ndërtesa 6, Hyrja 11, Apartamenti 21

Tiranë, Shqipëri

[EMAIL]

(b) Për Ministrinë

Rruga "Aleksandër Moisiu"

Ish Kinostudio "Shqipëria e Re"

Tiranë, Shqipëri

[EMAIL]

(c) Për Institutin e Arkeologjisë

Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri

[EMAIL]

4.4 Një njoftim do të konsiderohet se është marrë:

(a) Në momentin e marrjes, nëse dorëzohet personalisht;

(b) Në Ditën e tretë të Punës pas datës së postimit nëse dërgohet me postë rekomande të parapaguar;

(c) Pas marrjes së konfirmimit të dorëzimit nëse dërgohet me transmetim faksimil;

(d) Në rastin e dërgesës me postë elektronike, në momentin e mbërritjes në serverin e marrësit dhe nëse dërguesi nuk merr mesazh që ka ndodhur gabim.

4.5 Çdo njoftim që konsiderohet si i marrë në një ditë që nuk është Ditë Pune, apo pas orës 17:00 në një Ditë Pune, do të konsiderohet se është marrë në orën 09:00 në Ditën e nesërme të Punës.

4.6 Të gjitha njoftimet, korrespondencat ose komunikimet e tjera ndërmjet Fondacionit dhe IA në lidhje me këtë Protokoll Bashkëpunimi do të jenë në gjuhën shqipe.

5. MBËSHTETJA FINANCIARE E PROJEKTEVE TË IA-S

5.1 Në përputhje me Marrëveshjen e Administrimit dhe në bazë të buxhetit vjetor të miratuar nga bordi i drejtorëve të Fondacionit, Fondacioni do të ofrojë mbështetje financiare për projektet e Hulumtive Arkeologjike të IA që do të zhvillohen në zonën e Pasurisë Kulturore përmes procedurave të grantit që do të ofrohen nga Fondacioni përmes Butrint Research Group, deri në vlerën e miratuar nga Bordi i Drejtorëve të Fondacionit.

5.2 IA do t'i dorëzojë drejtorit ekzekutiv të Fondacionit, brenda datës 30 nëntor/31 dhjetor të secilit vit një listë e cila përmban të gjitha projektet e Hulumtive Arkeologjike që IA parashikon të ndërmarrë në zonën arkeologjike të Pasurisë Kulturore në vitin pasardhës, përfshirë projektet e Hulumtimeve Arkeologjike të përcaktuar nga IA si të një rëndësie të veçantë.

5.3 Në përputhje me nenin 5.1 të këtij Protokolli Bashkëpunimi, Fondacioni do të ofrojë një mbështjetje financiare mbi të paktën një prej projekteve të Hulumtimeve Arkeologjike të rëndësisë të veçantë të propozuar nga IA deri në vlerën e miratuar nga bordi i drejtorëve të Fondacionit.

5.4 Në kuadër të mbështetjes financiare të ofruar nga Fondacioni për projektet e Hulumtimeve Arkeologjike, Fondacioni do t'i japë prioritet IA dhe projekteve të prezantuar nga arkeologë shqiptarë.

6. PËRCAKTIMI I AMBIENTEVE

6.1 Fondacioni do të sigurojë një ambient të përshtatshëm në territorin e Pasurisë Kulturore të kushtuar ekskluzivisht për ekspozimin e përkohshëm të gjetjeve arkeologjike dhe historisë së gërmimeve në Parkun Kombëtar të Butrintit, në formën e një pavijoni të dedikuar në qendrën e vizitorëve.

6.2 Fondacioni do të sigurojë një ambient të përshtatshëm në territorin e Pasurisë Kulturore për kryerjen e aktiviteteve restauruese dhe/ose kërkimore nga IA dhe/ose Persona të Lidhur me të. Ky ambient do të jetë i pajisur me infrastrukturën e nevojshme për të mundësuar kryerjen e

aktiviteteve të lidhura me Hulumtimet Arkeologjike.

6.3 Në përputhje me nenin 6.4, IA do t'i kalojë Ministrisë administrimin e çdo aseti të paluajtshëm që IA administron në territorin e Pasurisë Kulturore, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave. Në përputhje me Marrëveshjen e Administrimit, Ministria do t'ia kalojë administrimin e këtyre aseteve Fondacionit.

6.4 Ministria do të sigurojë, me shpenzimet e veta, një ambient të përshtatshëm në qytetin e Sarandës për të mundësuar depozitimin dhe ruajtjen e fondit arkeologjik i cili do të zhvendoset si rrjedhojë e kalimit të administrimit të ambienteve në të cilët ruhen, në përputhje me nenin 6.3 të këtij Protokolli Bashkëpunimi. Ministria do të bashkëpunojë ngushtësisht me IA në përzgjedhjen e ambientit sipas kësaj pike, i cili duhet të respektojë kriteret minimale dhe udhëzimet e IA për ruajtjen dhe depozitimin e fondit arkeologjik.

6.5 Fondacioni do të kontribuojë financiarisht deri në vlerën USD 35,000 (pa TVSH) (i) për restaurimin e ambientit të siguruar nga Ministria sipas nenit 6.4, dhe/ose (ii) për zhvendosjen e fondit arkeologjik nga ambientet e liruara nga IA sipas nenit 6.3 drejt ambientit të siguruar nga Ministria sipas nenit 6.4. Këto fonde do të menaxhohen nga vetë Fondacioni sipas procedurave të tij të brendshme.

6.6 Në rast mospërmbushje nga ana e Fondacionit e detyrimeve të saj sipas neneve 6.1, 6.2 dhe 6.5, IA ka të drejtën të kërkojë kthimin e aseteve të përmendura në pikën 6.3 në administrimin e IA.

7. KONSULTIMI I IA

7.1 Fondacioni njeh dhe vlerëson kontributin e IA në kryerjen e studimeve dhe kërkimeve shkencore në fushën e arkeologjisë.

7.2 Fondacioni angazhohet se do të konsultohet rregullisht me IA për çdo çështje që prek Pasurinë Kulturore dhe që i përket fushës së arkeologjisë. Konsultimi sipas këtij neni mund të kryhet nëpërmjet komunikimit me shkrim, mbajtjes së takimeve periodike ose vizitave në terren nga ana e IA.

7.3 IA angazhohet t'i ofrojë Fondacionit konsulencë dhe *know-how* në çdo mënyrë që është e nevojshme për mirëadministrimin e Pasurisë Kulturore dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

8. PJESËMARRJA NË GRUPIN KËRKIMOR

8.1 Fondacioni do të emërojë në grupin kërkimor të Butrintit të paktën 1 studiues të propozuar nga IA.

8.2 IA do t'i propozojë Fondacionit emërimin në grupin kërkimor të Butrintit të kandidatëve me eksperiencë të gjatë dhe me reputacion në kryerjen e kërkimeve dhe studimeve arkeologjike.

9. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

9.1 Palët do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur me mirëbesim çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga apo lidhet me këtë Protokoll Bashkëpunimi. Pala që ngre pretendimin mbi mosmarrëveshjen njofton fillimisht përfaqësuesin ligjor të Palës tjetër. Palët do të takohen në mirëbesim brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve Pune që nga data e parashtrimit të mosmarrëveshjes për të zgjidhur mosmarrëveshjen.

9.2 Në rast të mos arritjes së një zgjidhjeje sipas pikës 9.1 më lartë, Palët do të referojnë të gjitha mosmarrëveshjet në një proces ndërmjetësimi si një kusht paraprak për çdo procedurë tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Për ndërmjetësimin sipas kësaj pike, Palët do t'i drejtohen

ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

9.3 Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 30 Ditëve Pune sipas nenit 9.2 më lartë, Palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

*****

[pjesa e mbetur lënë qëllimisht bosh]

FAQJA E NËNSHKRIMIT

PËR FONDACIONIN PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT

PËRFAQËSUES TË AUTORIZUAR

Z. Martin Mata Z. Aleksandër Sarapuli

PËR MINISTRINË E KULTURËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

MINISTRI

Znj. Elva Margariti

PËR INSTITUTIN E ARKEOLOGJISË

DREJTORE

Znj. Belisa Muka

LIGJ
Nr. 53/2022

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, për:

a) organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, në vijim "Autoriteti";

b) procedurat për refuzimin, pezullimin dhe revokimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe certifikatave, legjislacionin e aplikueshëm në rastin e ankimimit të vendimeve të Autoritetit;

c) llojet e tarifave për shërbimet që ofron, mënyrën e llogaritjes së tyre, mënyrën e administrimit të të ardhurave të realizuara prej tyre, si dhe rastet e përjashtimeve nga zbatimi i rregullave në fuqi dhe masat për ruajtjen e nivelit të sigurisë në këto raste.

Neni 2
Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Autoriteti, si Autoritet Mbikëqyrës Kombëtar, ka në fushën e tij të veprimtarisë rregullimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil, në zbatim të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë.

KREU II
STATUSI, ORGANET DREJTUESE DHE STRUKTURA E AUTORITETIT

Neni 3
Statusi i Autoritetit

Autoriteti është person juridik publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, veprimtaria e të cilit është nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror, në vijim "ministri".

Neni 4
Organet drejtuese të Autoritetit

Organet drejtuese të Autoritetit janë këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv.

Neni 5
Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Autoritetit.

2. Këshilli drejtues është organ kolegjial, i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë, nga të cilët dy specialistë të fushës së transportit ajror, dy specialistë të fushës së financës dhe një specialist i fushës ligjore, të cilët duhet të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë.

3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues emërohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 6
Kompetencat e këshillit drejtues

Këshilli drejtues ka këto kompetenca:

a) miraton programet e zhvillimit të Autoritetit në përputhje me strategjinë e aviacionit civil;

b) propozon te ministri strukturën organizative të Autoritetit, e cila miratohet me urdhër të Kryeministrit;

c) miraton metodologjinë për përcaktimin e masës së trajtimeve të tjera financiare ose jofinanciare të administratës së Autoritetit, duke marrë në konsideratë kushtet e tregut, përvojat e autoriteteve të tjera që kryejnë aktivitet rregullator dhe nevojat e institucionit sipas legjislacionit në fuqi;

ç) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, ku parashikohen funksionet specifike dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe të sektorëve, sipas kritereve të përcaktuara, si dhe masat disiplinore që merren në raste shkeljeje nga punonjësit e Autoritetit, struktura përgjegjëse për marrjen e tyre, rastet/arsyet specifike për të cilat lind e drejta për vendosjen e secilës masë disiplinore përkatëse, si dhe procedura konkrete që ndiqet për vendosjen e tyre;

d) miraton programin financiar të Autoritetit e ndryshimet dhe mbikëqyr realizimin e tij;

dh) miraton rregullat për metodologjinë e përllogaritjes së tarifave dhe llojet e tarifave për shërbimet që kryhen nga Autoriteti;

e) propozon te ministri masën e tarifave që do të zbatohen nga Autoriteti sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon çështjet e transportit dhe të ministrit të financave;

ë) propozon te ministri kandidatët për t'u emëruar drejtorë ekzekutivë, si dhe propozon shkarkimin e tyre;

f) i siguron drejtorit ekzekutiv udhëzime për veprimtarinë;

g) miraton planin e veprimit, raportin vjetor dhe raporte të tjera të Autoritetit;

gj)mbikëqyr punën e drejtorit ekzekutiv në drejtimin e Autoritetit;

h) miraton pagat, si dhe nivelet e pagave të punonjësve të Autoritetit brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, si dhe shtesat e shpërblimet profesionale të punonjësve, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri;

i) miraton shpërblimet dhe masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri;

j) merr vendime për çështje të tjera në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

Neni 7
Kriteret e emërimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues

Për t'u emëruar kryetar ose anëtar i këshillit drejtues, personat duhet të plotësojnë këto kritere:

a) të kenë shtetësi shqiptare;

b) të kenë diplomë të nivelit "Master shkencor" apo "Master profesional", sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

c) të kenë përvojë të paktën 5 vjet në administratën publike, sektorin privat ose në institucionet shkencore arsimore;

ç) të jenë me integritet moral dhe profesional;

d) të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 5 vjetëve të fundit;

dh) të mos jenë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;

e) ndaj tyre të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos kenë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 8
Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues

1. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të këshillit drejtues është 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Kur mandati i kryetarit ose i anëtarit përfundon, ata qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e kryetarit ose të anëtarit të ri.

3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit mund të jenë të punësuar me kohë të plotë në detyra të tjera, por nuk mund të jenë anëtarë të më shumë se një këshilli drejtues apo të një organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.

Neni 9
Shpërblimet e këshillit drejtues

Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues shpërblehen në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

Neni 10
Lirimi nga detyra e kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues

1. Lirimi nga detyra e kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues përpara përfundimit të mandatit bëhet, kur:

a) jep dorëheqjen;

b) bëhet fizikisht i paaftë për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar për më shumë se 3 muaj;

c) kur mungon pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;

ç) i shkakton për shkak të paaftësisë profesionale ose të neglizhencës dëm Autoritetit apo imazhit të këtij Autoriteti;

d) vepron gjatë ushtrimit të funksioneve në kundërshtim me interesat e Autoritetit;

dh) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;

e) humbet apo lë shtetësinë shqiptare;

ë) del ne pension.

2. Propozimi për lirimin nga detyra të anëtarit të këshillit drejtues i paraqitet ministrit nga vetë këshilli apo nga institucione të tjera publike, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të Autoritetit, shoqëruar edhe me arsyet e provat për të cilat kërkohet ky lirim.

3. Ministri, në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe të marrjes së vendimit.

4. Kur ndonjëri prej anëtarëve të këshillit drejtues lirohet nga detyra përpara përfundimit të mandatit, anëtari tjetër emërohet sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për emërimin e anëtarëve të këtij këshilli për një mandat 4-vjeçar (katërvjeçar).

Neni 11
Mbledhjet e këshillit drejtues

1. Mbledhjet e këshillit drejtues thirren me nismën e kryetarit, me kërkesën e secilit prej anëtarëve ose me kërkesë të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit, si dhe me kërkesë të ministrit. Këshilli drejtues mblidhet të paktën një herë në dy muaj për të diskutuar e vendosur për rendin e ditës.

2. Mbledhjet e këshillit drejtues drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve, i autorizuar prej tij.

3. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë. Vendimet e këshillit drejtues merren me shumicë të thjeshtë. Në votim nuk lejohet abstenimi.

4. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, ndërsa vendimet e këshillit drejtues nënshkruhen nga kryetari.

Neni 12
Transparenca në veprimtarinë e Autoritetit

1. Këshilli drejtues miraton rregulloren për procedurat e vënies në dispozicion të publikut të dokumentacionit që disponon, si dhe afatet e kushtet për mbajtjen e kopjeve të njësuara të këtij dokumentacioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për informimin publik.

2. Çdo vendim i këshillit drejtues publikohet në faqen e internetit të Autoritetit.

Neni 13
Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv është titullari i Autoritetit, i cili emërohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

2. Drejtori ekzekutiv nuk mund të jetë anëtar i këshillit drejtues.

3. Drejtori ekzekutiv merr pjesë në mbledhjet e këshillit drejtues pa të drejtë vote.

Neni 14
Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv ka këto përgjegjësi e detyra:

a) është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së Autoritetit;

b) paraqet për miratim në këshillin drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit;

c) paraqet për miratim në këshillin drejtues programin ekonomiko-financiar të Autoritetit dhe çdo ndryshim të tij;

ç) paraqet për miratim në këshillin drejtues vlerat e tarifave që do të zbatohen për të gjitha autorizimet, certifikimet dhe licencat që lëshon ky Autoritet;

d) përfaqëson Autoritetin në marrëdhëniet me të tretët;

dh) ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrat për të siguruar plotësimin e detyrimeve, që i janë ngarkuar Autoritetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe nënshkruan të gjitha autorizimet, lejet, licencat e kategorizimet;

e) miraton programet e trajnimit dhe të kualifikimeve të stafit të Autoritetit, për të cilat informon këshillin drejtues. Në rast nevoje, kontrakton ekspertë të jashtëm të fushës së aviacionit civil;

ë) miraton manuale dhe/ose procedura me karakter tekniko-operacional;

f) në fund të çdo tremujori, drejtori ekzekutiv i paraqet këshillit drejtues një raport për veprimtarinë e tij gjatë tremujorit; pasqyrat përkatëse për realizimin e treguesve financiarë të të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planifikimit; një raport të hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, për rastet e refuzimit të licencave, për të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të tjera si nga operatorët, ashtu dhe nga konsumatorët që i janë paraqitur Autoritetit.

Neni 15
Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv

Kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv janë:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë diplomë të nivelit "Master shkencor" apo "Master profesional" sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

c) të ketë përvojë, të paktën 5 vjet, në aviacionin civil;

ç) të ketë integritet moral dhe profesional;

d) të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 5 viteve të fundit;

dh) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;

e) të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 16
Lirimi nga detyra i drejtorit ekzekutiv

Ministri i propozon Kryeministrit lirimin nga detyra të drejtorit ekzekutiv, në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) bëhet fizikisht i paaftë për më shumë se 3 muaj për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar;

c) për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës i shkakton dëm Autoritetit ose imazhit të institucionit;

ç) vepron gjatë ushtrimit të funksioneve në kundërshtim me interesat e Autoritetit;

d) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;

dh) humbet apo lë shtetësinë shqiptare;

e) kur mbush moshën për pension.

KREU III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Neni 17
Organizimi dhe detyrimet

1. Struktura dhe organika e Autoritetit miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit pas konsultimit paraprak me institucionin përgjegjës për strukturat dhe organikat e institucioneve të administratës shtetërore.

2. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Autoritetit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

3. Rekrutimi i punonjësve të Autoritetit bëhet në bazë të kërkesave dhe përshkrimeve të punës për çdo pozicion, të miratuara nga këshilli drejtues dhe të përcaktuara në rregulloren e brendshme. Procedurat e rekrutimit duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për funksionimin e administratës.

4. Punonjësit e Autoritetit, që mbajnë pozicione të lidhura me funksione specifike dhe që kanë akses në zonat me siguri të kufizuar, i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës sipas përcaktimeve të Kodit Ajror.

5. Punonjësit e Autoritetit, që administrojnë dokumentacion apo të dhëna që parashikohen në legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar, u nënshtrohen parashikimeve ligjore të këtij të fundit.

Neni 18
Të ardhurat e Autoritetit

1. Të ardhurat realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtaritë që kryen Autoriteti, të cilat llogariten në bazë të kostos kur është e aplikueshme dhe në bazë të metodologjisë së përcaktuar në nenin 6, shkronja "dh", të këtij ligji.

2. Të ardhurat e Autoritetit përfshijnë:

a) të ardhurat nga tarifat e rrugës (*en-route*), të cilat mblidhen dhe faturohen nga Eurokontrolli, në

zbatim të marrëveshjes së përbashkët të lidhur për tarifat e rrugës (*en-route*);

b) të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, e cila merret nëpërmjet aeroportit;

c) të ardhurat nga autorizimet, licencimet dhe certifikimet e parashikuara në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë;

ç) të ardhurat nga sanksionet, në zbatim të legjislacionit për aviacionit civil;

d) të ardhura të tjera të lejuara, si: grantet, fondi rezervë dhe huat.

3. Pasqyrat financiare të të ardhurave dhe të shpenzimeve hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, trajtime financiare dhe jofinanciare, shpenzime operative dhe investime të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit, për të krijuar dhe mbajtur fondin e rezervës, si dhe për pagesat e kontributeve, që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të aviacionit civil, si dhe shpenzime të tjera të nevojshme. Trajtimet financiare përfshijnë mbulimin e shpenzimeve të kryera në përmbushje të detyrës, pagesat për trajnimet profesionale, për sigurimin e jetës dhe shëndetit dhe të tjera të ngjashme.

Autoriteti mund të krijojë një plan të pensionit profesional për punonjësit e tij. Përcaktimet e akteve nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë nen, nuk zbatohen për Autoritetin.

5. Autoriteti, për përdorimin e fondeve të veta, zbaton dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimet publike.

Neni 19
Buxheti

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.

2. Drejtori ekzekutiv paraqet për miratim në këshillin drejtues propozimin e detajuar të programit financiar për vitin pasardhës, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit përkatës.

3. Veprimtaria e Autoritetit financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai.

Të ardhurat e vitit 2021, të papërdorura nga Autoriteti, do të jenë pjesë e buxhetit të Autoritetit.

Në vitet në vazhdim, të ardhurat e realizuara e të papërdorura deri në fund të vitit mbarten dhe reflektohen në nivelin e shpenzimeve të vitit vijues dhe në fondin rezervë.

4. Fondi rezervë, për qëllime të këtij ligji, nënkupton fondin në të cilin alokohen të ardhura të papërdorura në vitin ushtrimor dhe të mbartura në vitin pasardhës, të cilat përdoren për rastet e financimit të shpenzimeve dhe/ose investimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së programit ekonomik dhe në rastet e mosrealizimit të të ardhurave për shkaqe të paparashikuara. Fondi duhet të plotësohet gradualisht dhe brenda 5 vjetëve duhet të arrijë nivelin mesatar të gjashtëmujorëve të dytë të buxhetit të Autoritetit të tre vjetëve të fundit. Me arritjen e këtij niveli, teprica e të ardhurave derdhet çdo vit në buxhetin e shtetit.

Neni 20
Kontabiliteti

1. Autoriteti mban regjistrat kontabël në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kontabël të zbatueshme.

2. Regjistrat kontabël duhet të pasqyrojnë me saktësi, në çdo kohë, gjendjen financiare të Autoritetit.

3. Autoriteti përgatit pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së vet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas certifikimit nga audituesi ligjor.

Neni 21
Raportimi dhe kontrolli

1. Brenda muajit prill të vitit pasardhës, Autoriteti i paraqet ministrit:

a) një raport vjetor për veprimtarinë e tij, përfshirë të gjitha vendimet e marra nga këshilli drejtues;

b) pasqyrat financiare vjetore;

c) një raport për realizimin e planit të të ardhurave e të shpenzimeve;

ç) një raport për vendimet e marra për licencat e dhëna, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, për rastet e refuzimit të licencave apo për kërkesat e tjera, që i janë paraqitur Autoritetit, si dhe për të dhënat e regjistrave dhe rezultatin e inspektimeve të subjekteve të mbikëqyrura.

2. Autoriteti i paraqet në çdo kohë ministrit, me kërkesë të tij, çdo informacion, raportim dhe të

dhëna të tjera, që vlerësohen të nevojshme për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të transportit ajror.

KREU IV
KODI ETIK, PROFESIONALIZMI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 22
Kodi etik dhe profesionalizmi

1. Anëtarët e këshillit drejtues, drejtori ekzekutiv dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë zbatojnë kodin e etikës dhe standardet profesionale të miratuara nga këshilli drejtues.

2. Kur vërehen shkelje të kodit të etikës ose mungesë profesionalizmi, merren masa disiplinore deri në lirimin ose largimin nga detyra.

Neni 23
Konfidencialiteti

1. Të dhënat për veprimtarinë e subjekteve, që operojnë në fushën e aviacionit civil, të cilat i vihen në dispozicion Autoritetit, klasifikohen "konfidenciale" nëse përhapja e tyre cenon interesat tregtarë ose reputacionin e subjektit.

2. Nuk janë "konfidenciale" të dhënat tregtare të siguruara nga subjektet, detyrimi për botimin e të cilave është parashikuar nga ky ligj apo nga ligje të tjera.

3. Anëtarët e këshillit drejtues, drejtori ekzekutiv dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t'i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë të dhënat "konfidenciale".

4. Çdo informacion tjetër për të cilin punonjësit e Autoritetit kanë dijeni për shkak të funksionit dhe detyrave që kryejnë, duhet të administrohet prej tyre në përputhje me rregullat e brendshme dhe hierarkinë e raportimit në Autoritet.

5. Për rastet kur vërtetohen shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë nen, merren masa administrative deri në lirimin nga detyra të anëtarit të këshillit drejtues ose largimin nga detyra të punonjësit të Autoritetit.

6. Detyrimi për konfidencialitetin dhe mospërhapjen e të dhënave shtrihet për punonjësit e Autoritetit dhe anëtarët e këshillit drejtues për një periudhë 2-vjeçare pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

KREU V
KOMPETENCA E AUTORITETIT GJATË USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE MBIKËQYRËSE

Neni 24
Marrja e masave administrative ndaj subjekteve të treta

1. Drejtori ekzekutiv merr vendime për:

a) parandalimin apo ndërprerjen e veprimeve, që përbëjnë shkelje të Kodit Ajror dhe të akteve ligjore të dala në zbatim të tij;

b) parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit;

c) shmangien e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit.

2. Drejtori ekzekutiv ka autoritet për të vendosur në mënyrë të menjëhershme kufizime të përkohshme ose të përhershme në operim dhe/ose masa administrative te një subjekt i certifikuar apo i licencuar nga Autoriteti në rastin e konstatimit të mospërputhshmërisë me kërkesat e certifikimit dhe/ose licencimit, ose në rastin e një problemi të pazgjidhur të sigurisë në aviacion.

Procedura për evidentimin dhe ndjekjen e mospërputhshmërisë në rastet e konstatuara më sipër miratohet nga ministri

3. Në vendimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni përcaktohen:

a) veprimet që duhet të kryejnë subjektet për të parandaluar dëmin apo për të korrigjuar gjendjen;

b) afatet për kryerjen e ndryshimeve apo për korrigjimin e veprimeve;

c) detyrimin për ndryshimin e administratorëve ose të drejtuesve në rastet kur veprimet bien në kundërshtim me ligjin.

4. Autoriteti, në përputhje me parashikimet e nenit 160 të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, mund të zbatojë masë administrative, vënien e gjobave.

Neni 25
Ankimi ndaj vendimeve të Autoritetit

1. Kundër vendimit të Autoritetit mund të bëhet ankim te ministri brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi. Me kalimin e 30 (tridhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës te ministri, ankuesi mund të bëjë ankim sipas

parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

2. Në rast të pranimit të ankimit nga ministri dhe vendimmarrjes së tij, Autoriteti detyrohet të zbatojë dispozitivin e vendimmarrjes së ministrit.

3. Për trajtimin e ankesave zbatohen procedurat e Kodit të Procedurave Administrative.

4. Ankimimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të autoritetit, përveç kur Gjykata vendos ndryshe.

Neni 26
Përjashtimet

1. Autoriteti ka të drejtë të bëjë përjashtime nga zbatimi i rregullave në fuqi në rastet kur parashikohen në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, të cilat lejojnë përjashtimet, me kusht që pas një vlerësimi të arrihet në konkluzionin që mospërputhshmëria dhe masat e marra do të garantojnë nivel të pranueshëm sigurie.

2. Drejtori ekzekutiv propozon te ministri udhëzimin për procedurën e aplikimit të përjashtimeve.

Neni 27
Licencat, lejet dhe certifikatat

1. Në ushtrimin e kompetencave të tij në lidhje me lejet, licencat dhe certifikimet, Autoriteti zbaton krahas legjislacionit të fushës, edhe legjislacionin në fuqi për licencimin.

2. Autoriteti ngarkohet të hartojë procedurat e detajuara, që do të zbatohen për dhënie, refuzim, pezullim apo revokim të çdo lejeje, certifikatë apo licence të parashikuar në Kodin Ajror dhe legjislacionin në fuqi

Neni 28
Inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil

1. Pajisja e inspektorëve të Autoritetit me kredenciale kryhet sipas rregullave të miratuara nga ministri.

2. Në zbatim të rregullave të miratuara nga ministri, drejtori ekzekutiv mund të pajisë inspektorët me kredenciale për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse, duke iu dhënë atyre:

a) të drejtën e pakufizuar të hyrjes në avion, në lehtësirat e aviacionit dhe në dokumentacionin përkatës, siç kërkohet për ushtrimin e funksioneve të tyre;

b) të drejtën për të kryer auditime të sigurisë së aviacionit, periodike ose të rastësishme, inspektime dhe testime te sipërmarrjet apo subjektet, objekt mbikëqyrjeje, certifikimi dhe licencimi të Autoritetit, sipas parashikimeve të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) të drejtën për të mos i lejuar çdo personi që të ushtrojë të drejtat e një licence të aviacionit, certifikate të aviacionit ose dokumenti tjetër, kur ka dyshime të arsyeshme. Kjo e drejtë ushtrohet menjëherë ose nëpërmjet një procesi të përcaktuar, që duhet të aplikohet brenda një kohe të arsyeshme në përputhje me rregulloren e miratuar nga drejtori ekzekutiv.

3. Në kuptim të këtij neni, termi "kredencial" nënkupton llojin e kualifikimit të veçantë në lidhje me kompetencat e Autoritetit, i cili i jep mbajtësit të saj disa të drejta të caktuara dhe detyrime në përputhje me Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 29
Dispozitë kalimtare

Anëtarët e zgjedhur të këshillit drejtues dhe drejtori ekzekutiv do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe drejtorit të ri.

Neni 30
Shfuqizime

1. Ligji nr. 10 233, datë 11.2.2010, "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore në fuqi, të cilat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në daljen e akteve nënligjore në përputhje me Kodin Ajror.

Neni 31
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 16.6.2022.

VENDIM
Nr. 61/2022

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 703, DATË 20.6.2022, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 50/2022, 'PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ADMINISTRIMIN E NËNZONAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE PEIZAZHIT KULTUROR, PJESË E PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT, NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS DHE FONDACIONIT PËR MENAXHIMIN E BUTRINTIT'"

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 703, datë 20.6.2022, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 50/2022, 'Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit'".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.7.2022.

VENDIM
Nr. 62/2022

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E ZËVENDËS-KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 13 835, datë 26.7.2022, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13 835, datë 26.7.2022, për shkarkimin e zotit Arben Ahmetaj nga detyra e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 28.7.2022.

VENDIM
Nr. 63/2022

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË SHTETIT DHE KRYENEGOCIATORIT

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 13 836, datë 26.7.2022, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13 836, datë 26.7.2022, për

emërimin e zonjës Majlinda Dhuka në detyrën e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 28.7.2022.

VENDIM
Nr. 64/2022

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZËVENDËS-KRYEMINISTRIT

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 13 837, datë 26.7.2022, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13 837, datë 26.7.2022, për emërimin e zonjës Belinda Balluku, ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, edhe në detyrën e zëvendëskryeministrit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 28.7.2022.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke nënvizuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor,

Vlerëson:

Procesin e kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë;

Punën e kryer për hartën e re gjyqësore në bashkëpunim mes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e propozimit të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave sipas parashikimeve të nenit 13 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", duke konstatuar se procesi ka marrë shumë kohë dhe se miratimi i hartës së re gjyqësore përveçse është një detyrim ligjor, përbën një hap të rëndësishëm për mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor.

Punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për hartimin dhe miratimin e një serie aktesh nënligjore normative dhe rregullatore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera të reformës në drejtësi, si dhe rëndësinë e përmbylljes së paketës së plotë të këtyre akteve sa më parë.

Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të

rivlerësimit kalimtar dhe rëndësinë e kryerjes së këtij procesi në një kohë sa më të arsyeshme.

Analizat e kryera për shumë aspekte të sistemit gjyqësor referuar edhe standardeve të Komisionit Evropian për Eficiencën e Drejtësisë (CEPEJ), mbarëvajtjen e punës në gjykata dhe masat e marra në këtë drejtim.

Punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor në propozimin dhe administrimin e buxhetit të vet dhe të gjykatave në përputhje me nevojat përkatëse.

Kontributin e dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor përmes opinioneve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimin e tij.

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2021, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

Zhvillimin e 100 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 607 vendimeve për vitin 2021.

Plotësimin e Gjykatës së Lartë me 9 anëtarë dhe hapjen e garës për të gjitha vendet e mbetura vakante përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratëve gjyqtarëve.

Finalizimin e propozimit të përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë të hartës së re gjyqësore dhe organizimin e konsultimeve publike me palët e interesuara.

Vijimin e zbatimit të reformës së administratës civile gjyqësore nëpërmjet rekrutimit dhe shpërndarjes së 86 nëpunësve gjyqësorë në gjykata, përfundimit të verifikimit të kritereve ligjore, pasurisë dhe integritetit për 2/3 e kancelarëve në detyrë, si dhe verifikimit dhe pranimit në shërbim civil gjyqësor të 17 punonjësve, nga të cilët 7 këshilltarëve ligjorë pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë dhe 10 ndihmësligjorë në gjykatat e apeleve.

Përcaktimin e numrit të kuotave në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2021-2022, plotësimin me 35 kandidatë për magjistratë në profilin gjyqtar dhe 20 kandidatë në profilin këshilltarë dhe ndihmësligjorë, për të cilët u krye edhe verifikimi i kritereve formale-ligjore, pasurisë dhe figurës për 26 kandidatë.

Vijimin e bashkëpunimit të ngushtë me organet e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve nëpërmjet depozitimit pranë KPK-së të 70 raporteve të analizimit të aftësive profesionale të shoqëruara me 350 dosje gjyqësore për 70 subjekte (gjyqtarë) të rivlerësimit kalimtar.

Ushtrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, me qëllim vetëpastrimin e sistemit gjyqësor nëpërmjet zhvillimit të 10 procedimeve disiplinore.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, trajtimin e 744 kërkesave duke caktuar 920 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme ose 5% më shumë se vitin e shkuar, si dhe përfshirë në skemë delegimi 14 gjyqtarë dhe transferuar me pëlqim 10 të tjerë.

Vazhdimin e plotësimit të paketës së akteve dhe vlerësimin etik-profesional të gjyqtarëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nëpërmjet hartimit dhe miratimit të 72 raporteve të vlerësimit (36 për periudhën e vlerësimit 2013-2016 dhe 36 për periudhën e vlerësimit viti 2019).

Përfundimin e vlerësimit për 36 gjyqtarë, duke trajtuar me prioritet kandidatët të cilët janë në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, gjykatat e posaçme dhe gjykatat e apeleve, me qëllim funksionalizimin apo ruajtjen e funksionalitetit të tyre.

Shqyrtimin e 100 ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit, nga 121 ankime të regjistruara në total, për të cilat Këshilli ka vendosur refuzimin e tyre si të pabazuar.

Marrjen e masave për përmirësimin e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve (ICMIS), me shtimin në këtë version të 37 zhvillimeve të reja, dhe duke iu përgjigjur me mbështetje teknike 667 kërkesave të gjykatave nga i gjithë vendi.

Trajtimin e 55 kërkesave në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit.

Përditësimin me informacion të faqes zyrtare të internetit me materialet dhe vendimmarrjet e Këshillit.

Hartimin dhe miratimin e rregulloreve për shqyrtimin e praktikave korruptive në KLGJ, hetimin administrativ të sinjalizimit, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ruajtjen e konfidencialitetit, në funksion të angazhimit të Këshillit për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në institucion.

Vijimin e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm duke zhvilluar një sërë aktivitetesh,

takimesh, konferencash dhe trajnimesh me institucionet vendase, ndërkombëtare, shoqërinë civile etj.

Zhvillimin e trajnimeve në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, ASPA-n, projektet e asistencës së huaj etj., të punonjësve të institucionit, punonjësve të gjykatave dhe gjyqtarëve.

Hartimin e Planit të dytë Strategjik për periudhën 2022-2024, i cili i është nënshtruar një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimesh.

KLGJ-ja ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Këshillin e Lartë Gjyqësor:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin

Gjyqësor, me qëllim mirëfunksionimin e sistemit në kuadër të parimit të funksionalitetit.

2. T'i kushtojë rëndësi informimit të publikut për qasjen në drejtësi dhe mbarëvajtjes së

marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun.

3. Të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi.

4. Të informojë, sa herë kërkohet, Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin gjyqësor duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Lartë.

2. Të vijojë me ritme të shpejta procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Të ndjekë dhe të informojë periodikisht Kuvendin e Shqipërisë për ecurinë dhe problematikat në implementimin e hartës së re gjyqësore.

4. Të vijojë me intensitet puna për rritjen e eficiencës së administrimit të gjykatave sipas përcaktimeve të nenit 89 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

5. Të vijojë me përparësi zbatimin e procesit të vlerësimit etik-profesional të gjyqtarëve në përputhje me skemën e re të vlerësimit.

6. Të bashkëpunohet me organet e tjera të drejtësisë për nevojat e aksesit në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, për aq sa është e mundur, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe mundësitë teknike.

7. Me qëllim përmbushjen e përcaktimeve ligjore, të organizohen takime të përbashkëta periodike me Këshillin e Lartë të Prokurorisë duke e vendosur theksin në unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjeve.

8. Të përshpejtojë ritmet e punës për vlerësimin vjetor të performancës së personelit të administratës së gjykatës.

9. Të përmbyllë miratimin e të gjitha akteve nënligjore që përcaktohen në ligjet e reformës në drejtësi.

10. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje.

11. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe specifikimeve të nenit 87 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të mbajë dhe të artikulojë publikisht qëndrimet përkatëse kur gjykohet se pavarësia e pushtetit gjyqësor është cenuar.

12. Të intensifikojë veprimtarinë në përmbushje të përcaktimeve për qasjen në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës të organizojnë trajnime për anëtarët e Këshillit, gjyqtarët, për mediet, administratën e Këshillit dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në këto aktivitete.

13. Të vijojë me dhënien e opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 187 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Miratuar më datë 14.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë;

Duke nënvizuar rëndësinë e funksioneve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vendosjen e masave disiplinore, si dhe pezullimin e prokurorëve të të gjitha niveleve;

Duke mbajtur në konsideratë rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në mbikëqyrjen e respektimit të standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë në vendosjen e masave disiplinore dhe procedimeve të tjera sipas përcaktimeve ligjore në funksion të rritjes së efikasitetit funksional për të dyja institucionet,

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit të prokurorisë;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat për funksionimin eficient të sistemit të prokurorisë,

Vlerëson:

Punën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për hartimin dhe miratimin e standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së prokurorit.

Veprimtarinë e Këshillit për plotësimin e vakumeve të krijuara në sistemin e drejtimit të prokurorive si pasojë e shkarkimit të drejtuesve të prokurorive gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Punën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për rregullimin e disa aspekteve të veprimtarisë së prokurorëve nëpërmjet miratimit të rregulloreve të ndryshme dhe vendimeve përkatëse.

Punën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar dhe rëndësinë e kryerjes së këtij procesi në një kohë sa më të arsyeshme.

Kontributin e dhënë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë nëpërmjet opinioneve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimin e tij.

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2021, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

Zhvillimin e 39 seancave plenare dhe miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë".

Miratimin e 25 pozicioneve për prokurorë për t'u pranuar në programin fillestar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2021–2022.

Verifikimin e pasurisë dhe figurës së 23 kandidatëve për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Miratimin e 21 vendimeve të propozuara nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, në ushtrim të kompetencave të veta.

Përgatitjen dhe miratimin në seancë plenare të 52 raporteve për subjekte magjistratë (prokurorë), që janë vënë në dispozicion të KPK-së dhe ONM-së.

Verifikimin e pasurisë dhe figurës, si dhe plotësimit të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga ligji për 4 kancelarë në detyrë nga 4 në total.

Përfundimin e procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës për 24 kandidatë për drejtues prokurorish të juridiksionit të përgjithshëm.

Miratimin e 253 vendimeve të propozuara nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në ushtrim të kompetencave të veta.

Përmbylljen e 3 procedurave disiplinore nga Komisioni Disiplinor të propozuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Përgatitjen e regjistrit disiplinor sipas përcaktimeve të nenit 150, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Dhënien e kontributit në hartimin dhe dërgimin e kontributit të katërt të raportit të Komisionit

Evropian për Shqipërinë për vitin 2021 në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e përfaqësuesit si pjesë të kapitullit 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore".

Raportimin në mënyrë të detajuar për punën e Këshillit në Nënkomitetin e Stabilizim-Asociimit për kapitullin 23 mbajtur gjatë vitit 2021.

Bashkëpunimin me ministrin e Brendshëm dhe me ministrin e Drejtësisë për miratimin e udhëzimeve të përbashkëta për kushtet, rregullat, procedurat dhe mënyrat e zbatimit të programit të mbrojtjes, kriteret dhe procedurat për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit për programin e mbrojtjes, për rregullat dhe procedurat e zbatimit të programit të mbrojtjes së bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe për rregullat e hollësishme, për detyrat, përgjegjësitë, format dhe procedurat e bashkërendimit e të informimit ndërmjet institucioneve.

Zhvillimin e mbledhjes së parë të përbashkët me KLGJ-në në datën 29.12.2021, me synim koordinimin më mirë të punës në çështje me interes të përbashkët dhe me ndjeshmëri për publikun dhe medien sipas përcaktimeve të nenit 170, të ligjit nr. 115/2016.

Nga 11 rekomandime të lëna në rezolutën e vitit paraardhës për Këshillin, rezulton se 7 rekomandime nuk janë përmbushur ose janë përmbushur pjesërisht.

Këshilli ka emëruar vetëm 4 prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke mos përmbushur plotësisht rekomandimin e Kuvendit në rezolutën për vitin 2021 ku theksohet plotësimi i të gjitha vendeve të lira në këtë prokurori.

Nuk është përmbushur rekomandimi i Kuvendit për vitin 2021 për miratimin e Rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe ligjeve të tjera të reformës në drejtësi, akt që është miratuar në vitin 2022, dhe si pasojë Këshilli nuk ka plan vjetor të miratuar për vlerësimin etik e profesional të prokurorëve.

Janë ende pa miratuar disa akte nënligjore të rëndësishme, si: rregullorja "Për komandimin e magjistratit në një institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë"; rregullorja "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë pranë gjykatave të Apelit të juridiksionit të përgjithshëm"; rregullorja "Për vlerësimin e punës së prokurorëve"; rregullorja "Për mënyrën e caktimit të kompensimit financiar që përfitojnë prokurorët në skemën e delegimit, që delegohen, transferohen përkohësisht ose caktohen përkohësisht" etj.

Rekomandimi i Kuvendit për nxitjen e bashkëpunimit të Këshillit me Prokurorin e Përgjithshëm me qëllim ndjekjen e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve nuk ka gjetur zbatim gjatë vitit 2021.

KLP-ja ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin e prokurorisë, veçanërisht në reduktimin e emërimeve të përkohshme.

2. Të bëjë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e problematikave apo kapërcimin e sfidave që vijnë nga vakancat e krijuara në sistem në kuadër të parimit të funksionalitetit dhe mirëfunksionimit të sistemit prokurorial.

3. Të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi.

4. Të vazhdojë t'i kushtojë rëndësi komunikimit me publikun për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

5. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin e prokurorisë duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 i rekomandon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

1. Të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm me qëllim ndjekjen e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve dhe të angazhohet për rezultate konkrete në këtë drejtim.

2. Të vijojë procedurat për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme

kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për të bërë të mundur sa më shpejt plotësimin e vendeve të lira në këtë institucion në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 6, datë 28.1.2021.

3. Të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore sipas përcaktimeve në ligjet e reformës së drejtësisë, si dhe hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për nëpunësit e tjerë civilë të prokurorisë.

4. Të përgatisë dhe të miratojë programin e përvitshëm për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të prokurorëve dhe fillimin e procesit të vlerësimit menjëherë. Këshilli të paraqesë një raport të detajuar për zbatimin e këtij rekomandimi brenda muajit shtator 2022.

5. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve të nenit 170 të ligjit nr. 115/2016 të organizohen takime të përbashkëta mbi baza periodike me Këshillin e Lartë Gjyqësor duke vendosur theksin në unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjeve dhe forcimin e bashkëpunimit institucional.

6. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje.

7. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe specifikimeve të nenit 185 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të mbajë dhe të artikulojë publikisht qëndrimet përkatëse për të garantuar pacenueshmërinë dhe mosndikueshmërinë në ushtrimin e funksioneve ligjore të prokurorëve.

8. Të forcohet bashkëpunimi institucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kapërcimit të sfidave që krijohen nga vendet e lira në sistem.

9. Të intensifikojë bashkëveprimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorët, duke pasur prioritet subjektet në proces rivlerësimi.

10. Të ndjekë dhe të konsiderojë me përparësi angazhimet, detyrimet ligjore dhe funksionale që burojnë nga procesi i zbatimit të hartës gjyqësore.

11. Me qëllim rritjen e mëtejshëm të transparencës së Këshillit, të publikohen në kohë vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve plenare dhe Komisioneve të Përhershme sipas përcaktimeve të neneve 167 dhe 168 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, si dhe të përpunohet informacioni ndaj publikut në mënyrë sa më të unifikuar dhe të kuptueshme në faqen zyrtare të institucionit.

12. Të plotësojë pa vonesa rekomandimet për Këshillin në progresraportin e Bashkimit Europian të vitit 2021, si dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga procesi i integrimit me Bashkimin Europian të Shqipërisë.

13. Të vijojë dhënien e opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 187 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Miratuar në datën 14.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj;

Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë për gjendjen e kriminalitetit, zbatimin e rekomandimeve parësore të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;

Duke mbajtur parasysh rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe legjislacionit përkatës;

Duke ritheksuar detyrimin e prokurorisë për të siguruar një procedim të drejtë, të barabartë, të rregullt ligjor për të mbrojtur liritë personale dhe të drejtat e njeriut, për të mbrojtur e për të forcuar

rendin juridik dhe për të zbatuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi;

Duke ritheksuar përgjegjësitë e prokurorisë në zbatimin me sukses të reformës në drejtësinë penale;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në luftën kundër pastrimit të parave të korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit;

Duke ritheksuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm me organet ekzekutive ligjzbatuese, Kuvendin e Shqipërisë, organet e tjera homologe vendase ose të huaja dhe organizatat e asistencës dhe ndihmës në raport me prokurorinë;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave, si bazë e nevojshme për të analizuar kriminalitetin, format dhe prirjet e tij, si dhe bazë shkencore për të hartuar, zbatuar, ndryshuar dhe vlerësuar politikën penale dhe efektivitetin e institucioneve të drejtësisë penale;

Duke vlerësuar kontributin e dhënë mes opinioneve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimin e tij;

Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në përmbushjen e detyrimeve, në kuadër të integrimit evropian;

Duke mbajtur parasysh rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë të datës 14.6.2021,

Bazuar në analizën e të dhënave për kriminalitetin në vend gjatë vitit 2021, të referuara në raportin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm, Kuvendi i Shqipërisë konstaton, se:

Koeficienti i kriminalitetit, sipas procedimeve penale të regjistruara, është 1002 për 100.000 banorë, ndërsa në vitin 2020 koeficienti i kriminalitetit ka qenë 979.

Grupet e veprave penale, që zënë një përqindje më të madhe në numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara, sipas strukturës së Kodit Penal, gjatë vitit 2021 janë: veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike (28.88%), vjedhja e pasurisë (27,86%), pasuar nga veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës (6.90%).

Grupet e tjera të veprave penale, që zënë një përqindje më të vogël në numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara, sipas strukturës së Kodit Penal, janë: krimet kundër rendit kushtetues (0,01%), krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi (0,02%), veprat me qëllime terroriste (0,03%), krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi (0,04%) etj.

Për sa i përket gjinisë së të pandehurve, nga numri i përgjithshëm i të pandehurve rezulton se 9.33% janë femra dhe 90,67% meshkuj. Në vitin 2020 raporti i të pandehurve sipas gjinisë ishte 97,86% meshkuj dhe 2,14% femra.

Çështjet e përfunduara rezultojnë me një ulje prej 1,84% në krahasim me vitin 2020.

Çështjet e dërguara në gjykatë rezultojnë me një rritje prej 5,25% në krahasim me vitin 2020.

Çështjet e pushuara rezultojnë me një ulje prej 1,82% në krahasim me vitin 2020.

Çështjet e pezulluara rezultojnë me një ulje prej 7,84% në krahasim me vitin 2020.

Numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur me 7,3% krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vitit u dërguan në gjykatë për pushim 4686 çështje ose me rritje 0,83% krahasuar me vitin 2020, prej të cilave 34,07% janë pushuar për mungesë fakti.

Prokuroria ka shpallur në kërkim ndërkombëtar 172 shtetas shqiptarë apo të huaj dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e 133 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar. Prokuroria e Përgjithshme ka trajtuar 1254 kërkesa të ndryshme të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja.

Janë ekzekutuar 1534 vendime për përgjime të autorizuara nga gjykata në hetimet paraprake, të zbatuara për 655 procedime penale. Është mundësuar interceptimi për 3412 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

Nga të dhënat e depozituara rezulton se janë filluar kryesisht 125 procedime penale ose me rritje 104,91% të numrit të procedimeve të filluara kryesisht krahasuar me vitin 2020 që ishte 61 procedime.

Numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe të kallëzuara është 47512, nga të cilat vetëm 125 janë vepra penale të filluara kryesisht nga Prokurori ose rreth 0,3% e numrit të përgjithshëm.

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi:

Zbatimin e rezolutës së Kuvendit të datës 14.6.2021, "Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020", në përmbushje të detyrimit të parashikuar në lidhjen 3, pika 5, të

vendimit të Kuvendit nr. 49/2017, "Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj";

Zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave "Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021", të miratuara në zbatim të nenit 103, pika 3, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";

Raportin e Ministrisë së Drejtësisë për mënyrën e zbatimit nga organi i prokurorisë së rekomandimeve prioritare të dhëna nga Këshilli i Ministrave në luftën kundër kriminalitetit, në zbatim të nenit 103, pika 5, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Bazuar në analizën e raportit të Prokurorit të Përgjithshëm, të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe në raportimin e ministrit të Drejtësisë për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021, Kuvendi konstaton, se:

Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzime për zbatimin nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm të rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021, si dhe për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzime të përgjithshme dhe planet e veprimit për të unifikuar veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrjes së zbatimit tyre me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit.

Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të vijimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, ka lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë "Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkeljet individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm".

Bashkëpunimi midis organit të prokurorisë dhe institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese është rritur.

Prokuroria e Përgjithshme ka intensifikuar marrëdhëniet me Komisionin e Policisë Gjyqësore nëpërmjet bashkëpunimit për caktimin e numrit të përgjithshëm të oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Policisë Gjyqësore në prokuroritë e të gjitha niveleve të juridiksionit të përgjithshëm.

Prokuroria e Përgjithshme ka organizuar trajnime të përbashkëta në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës për hetimet financiare, evazionin fiskal dhe krimin kibernetik.

Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, si: trajnime, *workshop*-e dhe kurse për rritjen e kapaciteteve profesionale në fushat prioritare, në kuadër të projektit PROCEEDS-2 të Këshillit të Evropës dhe në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit miratuar mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe prezencës së OSBE-së, me fokus "Veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri".

Me gjithë arritjet për vitin 2021, vijon të mbetet i ulët roli proaktiv i prokurorit për çështje të filluara kryesisht, veçanërisht në lidhje me veprat penale kundër korrupsionit.

Lidhur me veprën penale të dhunës në familje, vihet re rritje e numrit të çështjeve të regjistruara, por sipas raportit të Ministrisë së Drejtësisë duhet punuar në drejtim të ashpërsimit të politikës penale nga gjykatat.

Vlerësohet analiza e veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal e kryer nga Prokurori i Përgjithshëm në raportin e paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë, në veçanti politika penale dhe siguria publike, si dhe të dhënat për viktimat dhe kostot e shpenzimeve procedurale në fazën e hetimeve.

Prokurori i Përgjithshëm, sipas nenit 38, pika 1, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka përgjegjësi për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë, por mjetet shtrënguese ligjore për ushtrimin e këtyre përgjegjësive janë të kufizuara, ndaj Prokurori i Përgjithshëm ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë.

Bazuar sa më sipër, për vitin 2022, Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme:

1. Të vijojë rritja e rolit proaktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të

hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, duke zbatuar standardet më të mira në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut në procedimet penale, të drejtat për proces të rregullt, të parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit dhe parimit të proporcionalitetit, parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Të nxisë prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore për të pasur më shumë fokus, përgjegjshmëri, hetime kryesisht dhe proaktive për veprat penale në fushën e korrupsionit, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit, për aq sa është e mundur, duke vlerësuar me prioritet efektivitetin e strukturave të ngritura për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e pastrimit të parave, të lidhura me to.

3. Të vijojë punën për konsolidimin e pavarësisë institucionale dhe funksionale të institucionit të prokurorisë dhe veçanërisht pavarësinë e prokurorëve në procesin e hetimit dhe vendimmarrjes në çështjet përkatëse duke konsideruar tejet të rëndësishme, gjithashtu, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimit.

4. Të punojë për forcimin e mekanizmave për rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së brendshme të oficerëve të Policisë Gjyqësore, për eficiencën dhe efikasitetin e punës, pa cenuar procesin e rregullt ligjor gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, si dhe të vijojë nxitja e prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe të evidentohen rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore.

5. Të merren masa për rritjen e cilësisë së hetimeve për veprat penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve, si dhe të vijojë mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm në këtë drejtim, përfshirë edhe aspekte të krijimit të statistikave të reja dhe raportimit periodik të të dhënave të sakta statistikore.

6. Të merren masa efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi.

7. Të vijojë puna për vlerësimin e kapaciteteve profesionale, teknologjike dhe marrjen e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në bashkëpunim me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Të konsolidohet metodologjia dhe transparenca në hedhjen e shortit elektronik për ndarjen e çështjeve, si dhe të vijojë puna e nisur për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse.

9. Të vijohet me përmirësimin më tej të eficiencës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshje dy ose shumëpalëshe, si dhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës së Prokurorit ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, veçanërisht për rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e veprimtarisë kriminale brenda dhe jashtë vendit.

10. Të vijojë rritja e bashkërendimit dhe koordinimit me Komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të Policisë Gjyqësore në strukturat përkatëse të shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore, me synim rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e hetimeve në drejtimet prioritare të luftës kundër kriminalitetit në zbatim të Kodit të Procedurës Penale.

11. Të vijojë fuqizimi i bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre "Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" dhe të vijohet roli proaktiv i Prokurorit të Përgjithshëm në bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të adresuar problematikat e moszbatimeve të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga drejtues të prokurorive.

12. Të vijojë fuqizimi i bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare

në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore.

13. Të vijojë puna e nisur për forcimin e kapaciteteve profesionale në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe veprave penale në fushën e zgjedhjeve të lira, fushën e narkotikëve, veçanërisht sa i përket prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, si dhe hetimin e veprave penale që lidhen me zhvillimin e paligjshëm të lojërave të fatit, nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese, në bashkëpunim edhe me misionet e projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë.

14. Të vijojë puna e nisur për përditësimin e manualit për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve në kuadrin e projektit FIIAPP.

15. Të angazhohet në procesin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, duke synuar garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, me theks të veçantë tek e drejta e aksesit në drejtësi.

16. Së bashku me strukturat përgjegjëse shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe asistencën e nevojshme ndërkombëtare të kontribuojë në krijimin e një qasje të integruar të politikës penale në luftën kundër kriminalitetit si një nevojë tashmë imediate e shoqërisë sonë, me fokus parandalimin e kriminalitetit tek të miturit dhe të rinjtë.

17. Të vijojë përpjekjet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit me Bashkimin Evropian referuar rekomandimeve të lëna në progresraportin e datës 19.10.2021.

Miratuar në datën 14.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2021

Në Kuvendin e Shqipërisë është paraqitur raporti "Mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2021" bazuar në përcaktimet e neneve 104 dhe 105, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Në raportin "Mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2021" janë paraqitur treguesit e punës, gjendja e kriminalitetit sipas juridiksionit përkatës dhe veprimtaria e realizuar në zbatim të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2021:

Vlerëson rolin e Prokurorisë së Posaçme në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë.

Vlerëson ngarkesën që Prokuroria e Posaçme dhe BKH-ja kanë mbajtur gjatë vitit 2021, rezultatet pozitive të evidentuara në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe fillimin e mirë për hetimin e disa çështjeve të cilat lidhen me korrupsionin.

Vlerëson rezultatet pozitive në luftën kundër krimit organizuar dhe rritjen e besimit të homologëve ndërkombëtarë te SPAK-u.

Vlerëson rritjen e vlerës së aseteve të konfiskuara që gjatë vitit 2021 arriti 70 milionë euro, si dhe rritjen e numrit të çështjeve që janë përfunduar me vendime dënimi në fushën e pastrimit të parave dhe rritjen e konfiskimeve të aseteve kriminale në procesin penal.

Konsideron shumë të rëndësishëm plotësimin e të gjithë strukturës së SPAK-ut me prokurorë sipas numrit të miratuar me vendimin e Kuvendit, ashtu

si edhe plotësimin e strukturës së BKH-së me numrin e hetuesve të përcaktuar dhe strukturën mbështetëse të Policisë Gjyqësore sipas detyrimit të përcaktuar në ligjin përkatës.

Rithekson nevojën e krijimit të një sistemi "historik" për menaxhimin e çështjeve, e cila do t'u japë më shumë mundësi institucioneve për të pasur transparencë dhe pavarësi në trajtimin e çështjeve.

Shpreh shqetësimin lidhur me gjetjet e prezantuara në një sërë raportesh të organizmave ndërkombëtarë, por edhe atyre vendorë, veçanërisht nga progresraporti i KE-së për vitin 2021 në të cilat theksohet se, pavarësisht se janë bërë hapa pozitivë, mbetet ende shumë për të bërë sidomos nga strukturat e specializuara të sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit në nivelet e zyrtarëve të lartë.

Vlerëson se Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë pasur mbështetje aktive me burime buxhetore e njerëzore, në trajtimin me paga dhe përfitime të tjera financiare shtesë dhe me instrumente ligjore shtesë në funksion të rritjes së efiçencës së tyre dhe çmon se kjo mbështetje ka rritur pritshmërinë e taksapaguesve shqiptarë për një ritëm më të shpejtë në rezultate më domethënëse në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivelet e larta në veçanti, pavarësisht kohës dhe personave të përfshira në to, si kusht thelbësor për të forcuar më tej besimin e publikut te drejtësia.

Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2021 konstaton se:

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka miratuar 691 urdhra në funksion të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Gjatë vitit 2021 është realizuar përzgjedhja e 32 kandidatëve hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit.

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 2021 ka përfunduar raportet e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës për 37 subjekte dhe vazhdojnë verifikimet edhe për 133 subjekte.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ka ndërtuar një infrastrukturë moderne sipas parametrave të standardizuar teknikë, si dhe sisteme kontrolli dhe sigurie për të garantuar sigurinë e institucionit. Gjithashtu, është realizuar aksesi dhe përdorimi për qëllime hetimi i 9 databazave, ndërsa për 8 databaza të tjera puna është në proces.

Është realizuar regjistri elektronik dhe manual për çdo të dënuar duke shënuar të dhënat kryesore dhe Regjistri i Konfiskimeve, sipas vendimeve të gjykatës dhe emrave të të dënuarve, ku përcaktohet informacioni i konfiskimit të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe vlerat monetare përkatëse.

Është realizuar regjistri elektronik dhe manual për personat e vendosur në regjim të posaçëm.

Është hetuar një numër i konsiderueshëm i procedimeve penale (gjithsej 715), ku janë përfunduar hetimet për 226 procedime penale me 332 persona nën hetim (për 48 procedime penale janë paraqitur kërkesa për gjykim).

Gjatë vitit 2021 janë transferuar për efekt të juridiksionit 35 procedime penale me 21 të pandehur nën hetim në fushën e antikorrupsionit.

Nga 519 persona nën hetim, janë përfunduar hetimet për 332 persona nën hetim/të pandehur, që i korrespondon rreth 64% e numrit total të personave në hetim.

Prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e 128 çështjeve penale themeli, me 418 persona të akuzuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në gjykimin e 4 çështjeve penale në Gjykatën e Lartë, si dhe kanë marrë pjesë në 2 raste në Gjykatën Kushtetuese.

Janë ekzekutuar 77 vendime gjykate të formës së prerë, nga këto 36 vendime kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës të Parë dhe janë dënuar 171 të pandehur.

Është konfiskuar pasuria në proces penal për 41 vendime penale dhe janë nxjerrë urdhrat e prokurorit për ekzekutimin e vendimeve penale për 171 të dënuar, duke krijuar praktikat përkatëse në bashkëpunim me prokurorët e çështjeve.

Është përdorur metoda e përgjimit për 129 procedime penale me një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin e mëparshëm.

Janë ekzekutuar në interes të procedimeve penale nën hetim 411 autorizime të Prokurorit për lejim përgjimi, 1204 vendime të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, 224 vendime lejim përgjimi,

400 vendime vleftësimi dhe 580 vendime zgjatjeje për afatin e lejimit të përgjimit.

Për veprat penale nën hetim, janë interceptuar rreth 1500 subjekte, 1957 pajisje fundore, ku është rezultuar në ndalimin e rreth 179 personave të dyshuar për kryerje të veprave penale.

Janë paraqitur pranë sektorit të ekspertizës 118 vendime ekspertimi.

Janë trajtuar 91 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja dhe janë ekzekutuar 41 letërporosi dhe ndodhen në proces ekzekutimi 50 letërporosi të drejtuara nga autoritetet gjyqësore të huaja për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë.

Janë ngritur 10 skuadra të përbashkëta hetimore me strukturat homologe të Republikës së Italisë.

Janë kryer bashkëpunime me projekte të asistencës së huaj në funksion të punës së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Shorti i çështjeve në Prokurorinë e Posaçme hidhet manualisht sipas përcaktimeve të nenit 15, pika 2, germa "b" të ligjit nr. 95/2016; nuk është plotësuar ende numri i hetuesve i parashikuar në strukturën e BKH-së; nuk ka përfunduar procesi i ngritjes së shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë BKH-së; është ngritur ekspertiza digjitale, por duhen plotësuar me ekspertë kontabël sektorët e ekspertizës.

Vlerësohet se nuk është ngritur ende sistemi i menaxhimit të çështjeve penale ose sistemi i menaxhimit unik i çështjeve, pavarësisht se ka qenë rekomandim i rezolutës së Kuvendit dhe i progresraportit të Komisionit Europian në mënyrë të përsëritur për disa vite radhazi.

Janë mbartur nga viti i kaluar 348 çështje, pothuajse 50% e procedimeve penale, duke sjellë ngarkesë për Prokurorinë e Posaçme.

Nga të dhënat e raportimit vjetor rezulton se për vitin 2021 vetëm për 48 procedime penale është paraqitur kërkesës për gjykim. Ndërkohë në vitin 2020 është paraqitur kërkesë për gjykim për 70 procedime penale, gati 22 çështje më pak, çka flet për një ritëm më të ulët të çështjeve të mbyllura për një vit.

Bazuar në nenin 28 të ligjit organik parashikohet se Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kane akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e duhur për hetimin e veprave penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Sipas raportimit, rezulton se është realizuar aksesi në një pjesë të databazave shtetërore, konkretisht 9 sisteme, si: Sistemi i Gjendjes Civile, ASHK-ja, Drejtoria e Burgjeve, Regjistri i Llogarive Bankare, Sistemi elektronik i DPT-së, SEMD-ja, DPSHTRR-ja, TIMS-i. Një pjesë tjetër janë në proces, si: Regjistri Noterial Shqiptar, Regjistri i Pronarëve Përfitues, sistemet e Policisë se Shtetit ADAM, DEEPSE, E-Gjoba, Raporte Statistika, Memex, sistemi i APP-së.

SPAK ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunksionimit të strukturës së posaçme dhe funksionimit efektiv të mbikëqyrjes në zbatim të detyrimeve të nenit 42 të ligjit nr. 95/2016.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 i rekomandon Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:

1. Të konsiderojë thelbësore në veprimtarinë e saj pavarësinë institucionale dhe funksionale të strukturës, veçanërisht pavarësinë e prokurorëve në hetim dhe vendimmarrje, si dhe përgjegjshmërinë e llogaridhënien e tyre në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit duke krijuar një sistem të qartë treguesish për punën e çdo prokurori e hetuesi si bazë edhe për vlerësimin e promovimin e tyre individual mbështetur në rezultatet konkrete të punës.

2. Të vlerësojë si prioritet forcimin e cilësisë së hetimeve përmes përdorimit me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit, rritjes së numrit të çështjeve të hetimeve kryesisht dhe hetimeve proaktive, përdorimit më efikas dhe në kufijtë e ligjit të udhëzimeve të përgjithshme nga ana e drejtuesve të Prokurorisë së Posaçme, rritjen e shpejtësisë në hetime duke rritur numrin e çështjeve që përmbyllen në një vit dhe dërguar për gjykim, si dhe marrjen e masave për aksesin e drejtpërdrejtë në të gjitha databazat shtetërore nga struktura e posaçme për të hetuar çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

3. Të forcojë mekanizmat e kërkesës dhe llogaridhënies së brendshme administrative të prokurorëve dhe hetuesve të SPAK-ut për eficiencën dhe efikasitetin e punës, pa cenuar pavarësinë e nevojshme për marrjen e vendimeve

gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre ligjor duke rivlerësuar metodologjinë e hedhjes së shortit, plotësimin e detyrimit për ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve që janë objekt shqyrtimi i SPAK-ut në përmbushje të rekomandimeve të progresraporteve të KE-së, rezolutave të Kuvendit, si dhe zbatimit të detyrimeve ligjore.

4. Të nxisë prokurorët dhe hetuesit e SPAK-ut, sidomos drejtuesit e tyre për të pasur më shumë fokus, përgjegjshmëri dhe hetime kryesisht dhe proaktive në çështjet e korrupsionit në nivelin e zyrtarëve të lartë, me prioritet çështjet me interes të veçantë publik, pavarësisht kohës së kryerjes së tyre dhe personave të përfshirë në to, për të cilat mbetet ende e fortë pritshmëria dhe shpresa e qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë për respektimin e barazisë para ligjit nga institucionet e reja të drejtësisë, dhe veçanërisht nga SPAK-u.

5. Të vijojë forcimin e luftës kundër korrupsionit nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin dhe të zbatohen standardet më të mira në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut në procedimet penale, të drejtës për proces të rregullt, parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit dhe parimit të proporcionalitetit, parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

6. T'i kushtojë një vëmendje të shtuar zbatimit të kërkesave të ligjit në çështjet penale, të cilat transferohen nga Prokuroria e Posaçme në prokuroritë e rretheve gjyqësore për efekt të juridiksionit.

7. Të përmbyllë procesin e plotësimit të vendeve vakante në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe funksionalitin e saj, si dhe të përmbyllë të gjitha vakancat në strukturën e BKH-së për sa i përket rekrutimit të 60 hetuesve dhe të krijohet struktura e masave për ushtrimin e kontrollit efektiv nga ana e prokurorëve për punën e hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

8. Të zbatojë në kohë detyrimet që rrjedhin nga ligji për funksionimin efikas të sektorëve të dokumentacionit, studimeve, sidomos atyre të ekspertizës e hetimit financiar pranë Prokurorisë së Posaçme, shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë BKH-së, si dhe, për sa çmohet e nevojshme, ngritjen e zyrave mbështetëse jashtë Tiranës.

9. Të vazhdojë puna për mirëfunksionimin e SPAK-ut për zbatimin e përcaktimeve të shkronjave "dh", "ë" dhe "f", të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", si dhe për bashkëpunimin me ekspertët ndërkombëtarë të drejtësisë penale për ngritjen dhe zhvillimin e BKH-së.

10. Të vijojë koordinimin e veprimtarisë ndërinstitucionale dhe efektivitetin për hetimet në ndjekjen penale të financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, në vijim të zbatimit të planit të veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG/FATF), si dhe të raportohet në Kuvendin e Shqipërisë çdo 6 muaj për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

11. Të miratojë një plan veprimi të mirëkoordinuar për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese në bashkëpunim me misionet dhe projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë.

12. Të vijojë zhvillimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve, hetuesve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave me agjencitë e zbatimit të ligjit.

13. Të realizojë marrëveshjet teknike të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen me korrupsionin, pastrimin e parave, krimin e organizuar, si dhe luftën kundër terrorizmit.

14. Të publikojë udhëzimet e përgjithshme në faqen zyrtare të institucionit sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 5, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

15. Të marrë masa për rritjen e transparencës publike përmes një strategjie komunikimi aktive me publikun, informimit të qytetarëve, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile.

16. Të raportojë në Kuvend në përputhje me përcaktimet e vendimit të Kuvendit nr. 134/2018

"Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik", si dhe, për aq sa është e mundur, për evidentimin e problematikave dhe rekomandimet përkatëse për parandalimin e kriminalitetit dhe korrupsionit në shoqërinë shqiptare, në funksion të nevojës për të ndërtuar politika më të mira shtetërore në interes të së ardhmes së vendit.

17. Të vijojë përpjekjet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit me Bashkimin Evropian referuar rekomandimeve të lëna në progresraportin e datës 19.10.2021, përfshi edhe marrjen e masave për krijimin e "*track rekordit*" solid për procedimet penale të korrupsionit në nivele të larta, kusht i vendosur edhe nga Komisioni Evropian.

Miratuar më datë 14.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë,

Vlerëson punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në drejtim të:

Nisjes së shqyrtimit fillestar të një numri të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magjistratëve, organizimin e burimeve njerëzore, si dhe nisjes së procesit të rekrutimit të inspektorëve dhe stafit të Zyrës.

Zhvillimit të një numri të konsiderueshëm të hetimeve disiplinore ndaj magjistratëve brenda vitit kalendarik 2021.

Raportimeve të detajuara vjetore dhe periodike, si dhe informimeve drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me aktivitetin e institucionit.

Angazhimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë institucionale në zbatim të nenit 204, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Bazuar në analizën e të dhënave, të referuara në raportin e paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për vitin 2021, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

Marrjen e 22 vendimeve për fillimin e hetimit disiplinor për 31 subjekte të hetimit disiplinor.

Hartimin dhe miratimin e 33 urdhrave të përgjithshëm me karakter administrativ dhe rregullator, që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit, menaxhimit e kontrollit financiar, sinjalizimit dhe sigurisë së të dhënave dhe informacionit.

Raportimet e detajuara vjetore dhe periodike, si dhe informacionet drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Kuvendit të Shqipërisë për aktivitetin e institucionit.

Marrjen e 2 vendimeve për inspektimet tematike, sipas përcaktimeve ligjore.

Përfitimin e statusit të vëzhguesit pranë Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë.

Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Pjesëmarrjen në një numër të lartë trajnimesh nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë për rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës.

Angazhimin në ndërveprim me qytetarët nëpërmjet informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes, si dhe angazhimin e Sektorit të Ndihmës Juridike dhe Ankesave.

Ndërtimin e bazës statistikore mbi të dhënat e përgjithshme për ankesat, ku përfshihen detajime me interes informativ dhe studimor, lidhur me grup-moshat e ankuesve, shkeljeve të pretenduara nga ankuesi dhe ankesat e trajtuara sipas objektit të padisë etj.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunksionimit të veprimtarisë së institucionit dhe rritjes së eficiencës së inspektimeve.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Inspektorin e Lartë të Drejtësisë:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Të forcojë më tej bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e detyrave të përcaktuara në ligj.

3. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura gjatë ushtrimit të detyrave, duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i rekomandon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

1. Hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, si dhe bërjen publik të informacionit të pjesshëm, sipas përcaktimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje dhe në zbatim të nenit 137, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe për hartimin e një metodologjie të përgjithshme inspektimi.

3. Vijimin me ritme të shpejta të punës për përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4. Nxitjen e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm ose institucione të tjera për paraqitjen e kërkesave të motivuara nga ana e tyre për realizimin e inspektimeve tematike apo institucionale nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të inspektimeve institucionale dhe tematike, si dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit.

6. Vijimin me ritme të shpejta të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare, si dhe trajtimin me përparësi të ankesave, të cilat për shkak të parashikimeve të nenit 117, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", mund të parashkruhen, duke shmangur kështu arkivimin e tyre pa bërë të mundur verifikimin dhe hetimin nga institucioni.

7. Ndjekjen me prioritet të ankesave ndaj magjistratëve në proces vetingu në funksion të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së tyre.

8. Trajtimin me prioritet të të gjitha rasteve të konfliktit të interesit, që mund të ndeshen gjatë aktivitetit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

9. Rishikimin e objektivave të punës dhe hartimin e një plani të ri strategjik, të shtrirë në kohë dhe sipas një metodologjie të bashkërenduar për të shërbyer si një bazë për planifikim të përgjithshëm dhe për menaxhimin e performancës.

10.Angazhimin në kryerjen e kontrollit të brendshëm në mënyrë periodike, kryesisht në llogaridhënien e inspektorëve.

11.Vijimin dhe rritjen e transparencës ndaj publikut nëpërmjet përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit publik.

Miratuar në datën 14.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 12, datë 13.7.2022

MBI PËRCAKTIMIN E NIVELEVE MAKSIMALE TË PRANISË SË KOKSIDIOSTATIKËVE DHE HISTOMONOSTATIKËVE NË QUMËSHT, MËLÇI, VESHKA, SI DHE USHQIME TË TJERA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka si qëllim dhënien e informacionit mbi përcaktimin e niveleve maksimale të pranisë së koksidiostatikëve dhe histomonostatikëve në produktet ushqimore të listuara në aneksin e udhëzimit.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

2.1 Koksidiostatikë janë preparate që kufizojnë përhapjen e koksidieve në aparatin tretës të shpendëve.

2.2 Histomonostatikë janë preparate që kufizojnë përhapjen e histomonave në aparatin tretës të shpendëve.

3. Ndalohet tregtimi i ushqimeve të cilat janë listuar në shtojcën e këtij udhëzimi nëse ato përmbajnë kontaminantë të renditur në këtë shtojcë në një nivel që tejkalon nivelet maksimale të përcaktuara në shtojcë.

4. Në rast se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit konstaton mbetje të kontaminantëve nën nivelin maksimal të përcaktuar në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi, në këtë rast ai kryen kontrolle për të vërtetuar që mbetja në ushqime është e pranishme si pasojë e bartjes së pashmangshme në ushqim dhe jo si pasojë e administrimit të paligjshëm të koksidiostatikëve dhe histomonostatikëve.

5. Kur zbatohen nivelet maksimale të përcaktuara në shtojcën e këtij udhëzimi tek produktet ushqimore të thara, të holluara, të përpunuara ose të përbëra nga më shumë se një përbërës, ndryshimet e përqendrimit të ndotësve të shkaktuara nga tharja, hollimi ose përpunimi, do të merret parasysh proporcioni relativ i përbërësve në produkt.

6. Nivelet maksimale të përcaktuara në shtojcën e këtij udhëzimi, nuk paragjykojnë dispozitat dhe MRL-të e përcaktuara në udhëzimin nr. 15, datë 5.10.2010, "Për limitet maksimale të mbetjeve të produkteve mjekësore veterinare në produktet ushqimore me origjinë shtazore".

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCË
NIVELET MAKSIMALE NË USHQIME

Substanca	**Ushqimet**	**Përmbajtja maksimale në µg/kg(ppb), peshë e lagësht**
1. Lasalocidsodium	Ushqim me origjinë shtazore nga lloje të tjera kafshësh përjashto shpendët dhe gjedhin: - qumësht - mëlçi - veshka -të tjera	 1 50 20 5

2. Narasin	Ushqime me origjinë nga kafshët e tjera përveç broiler: - vezët - qumësht - mëlçia - të tjera	 2 1 50 5
3. Salinomycinsodium	Ushqim me origjinë nga kafshët përveç zogj dhe lepuj majmërie: - vezët - mëlçia - të tjera ushqime	 3 5 2
4. Monensinsodium	Ushqim me origjinë nga kafshët përveç broiler, gjela deti dhe gjedh (përfshirë këtu lopët e qumështit): - mëlçia - të tjera ushqime	 8 2
5. Semduramicin	Ushqim me origjinë nga kafshët përveç broiler.	2
6. Maduramicin	Ushqim me origjinë nga kafshët përveç zogave për majmëri dhe gjelave të detit. - vezët	 12
7. Robenidinë	Ushqime me origjinë nga kafshët të tjera përveç zogave për majmëri, gjela deti, lepuj për majmëri dhe mbarështim: -vezë -mëlçi, veshka, lëkurë dhe dhjamë. -të tjera ushqime.	 25 50 5
8. Decoquinat	Ushqime me origjinë nga kafshët nga lloje të tjera përveç broiler, gjela deti dhe lepuj për majmëri dhe mbarështim.	20
9. Halofuginon	Ushqime me origjinë nga kafshët nga lloje të tjera përveç broiler, gjela deti gjedh përveç lopët e qumështit: - vezë - mëlçi dhe veshka - qumësht - të tjera ushqime	 6 30 1 3
10. Nicarbazin (mbetja:4,4-dinitrocarbanilide (DNC)	Ushqime me origjinë nga kafshët nga lloje të tjera përveç broiler: - vezë - qumësht - mëlçi - veshka - të tjera ushqime	 300 5 300 100 50
11. Diclazuril	Ushqim me origjinë nga kafshët të tjera përveç broiler, gjela deti për majmëri, lepuj për mbarështim dhe majmëri, ruminantë dhe derra: - vezë - mëlçi dhe veshka - të tjera ushqime.	 2 40 5

URDHËR
Nr. 133, datë 18.7.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 22, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë" dhe ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Brendshëm, drejtorit të Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, z. Bledar Skënderi, për datën 19.7.2022 për këtë çështje:

- nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues për fitimin e shtetësisë shqiptare pranë Presidentit të Republikës.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, z. Bledar Skënderi.

3. Këto kompetenca do të ushtrohen për datën e sipërcituar, me ndërprerje vetëm në rast kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

URDHËR
Nr. 325, datë 8.7.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI PRODUKTET MJEKËSORE VETERINARE", MIRATUAR ME URDHRIN NR. 370, DATË 29.7.2014

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 85, pika 1, nenit 88, nenit 92, nenit 94, nenit 102 dhe nenit 104, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Miratimin e ndryshimeve në rregulloren "Mbi produktet mjekësore veterinare", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas një muaji dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

Në rregulloren "Mbi produktet mjekësore veterinare", miratuar me urdhër ministri nr. 370, datë 29.7.2014, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3, pika 12 riformulohet si më poshtë:

"12. "Përfaqësuesi i mbajtësit të certifikatës së tregtimit" quhet personi i njohur si përfaqësues, i caktuar nga mbajtësi i autorizimit të tregtimit për ta përfaqësuar atë në Shqipëri dhe që mban certifikatën e tregtimit për Shqipërinë".

2. Në nenin 4 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në paragrafin e parë, togfjalëshi "*që lëshohet nga autoriteti kompetent*" zëvendësohet me togfjalëshin "*që nënshkruhet nga drejtori përgjegjës për veterinarinë në ministri*".

b) Në paragrafin e dytë, numri "60" zëvendësohet me numrin "100".

c) Paragrafi i katërt riformulohet si më poshtë:

"*Mbajtësi i certifikatës së tregtimit është përgjegjës për tregtimin e PMV me përgjegjësi të plotë ligjore".*

3. Në nenin 5, paragrafi dytë riformulohet si më poshtë:

"Pas miratimit të ndryshime lidhur me limitet maksimalë të mbetjeve për produktet mjekësore veterinare në ushqimet me origjinë shtazore, SPV i propozon Komisionit, brenda 60 ditëve nga data e botimit të ndryshimeve në Fletoren Zyrtare, ndryshimin ose tërheqjen e certifikatës së tregtimit. Komisioni shqyrton dhe merr vendim brenda 10 ditë pune nga propozimi".

4. Neni 6 riformulohet si më poshtë:

"Përdorimi i PMV të certifikuara në vende të BE-së në raste të veçanta.

Ministri, në rastet e veçanta të gjendjeve shëndetësore, me propozimin e Komisionit Shtetëror të PMV-ve, urdhëron lejimin e përkohshëm të tregtimit ose të përdorimit në kafshë të PMV-ve të autorizuara në një nga vendet anëtare të BE-së, në përputhje me legjislacionin përkatës."

5. Në nenin 7, pika 1 hiqet.

6. Neni 8, riformulohet si më poshtë:

a) Në rreshtin e parë, togfjalëshi "*lëshuar nga autoriteti kompetent*" zëvendësohet me togfjalëshin "*nënshkruar nga drejtori përgjegjës për veterinarinë në ministri*";

b) Në rreshtin e fundit togfjalëshi "*autoriteti kompetent*" zëvendësohet me "*Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar* (LSHKV)".

7. Neni 9 shfuqizohet.

8. Në nenin 10, pika 1, ndryshon si më poshtë:

a) Në paragrafin e parë, fjala "*joprodhuese*" zëvendësohet me fjalën "*prodhuese*".

b) Në shkronjën "b", nënparagrafi "ii" ndryshon si më poshtë:

"me një PMV të autorizuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorim në të njëjtat lloje kafshësh ose në lloje të tjera kafshësh për të njëjtën sëmundje ose për sëmundje të tjera; ose".

9. Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1, riformulohet si më poshtë:

"Aplikimi për të marrë certifikatë tregtimi për një PMV bëhet online në portalin qeveritar e-Albania. Dosja dërgohet pranë LSHKV-së".

b) në pikën 3, shkronja "n", riformulohet si më poshtë:

"Kopje të çdo certifikate tregtimi të marrë në vendet anëtare të BE-së, kopje të përmbledhjes të karakteristikave të produktit të propozuara nga kërkuesi në përputhje me nenin 16 ose të atyre të miratuara nga autoriteti kompetent i vendit të BE-së ku është autorizuar përdorimi i PMV-së;

Kopje të fletudhëzuesit të propozuar;

Hollësi mbi ndonjë vendim që kundërshton certifikatën në vendet e BE-së ose ndonjë vend tjetër dhe arsyet për këtë vendim.

I gjithë ky informacion duhet të përditësohet rregullisht nga kërkuesi i certifikatës së tregtimit. Brenda datës 30 janar të çdo viti, mbajtësi i certifikatës së tregtimit dorëzon pranë SPV kopje origjinale ose të noterizuar të certifikatës së tregtimit në një nga vendet e BE-së, linkun ku është publikuar, si dhe autorizimin nga mbajtësi i autorizuar i certifikatës së tregtimit".

10. Në nenin 17, pika 1, togfjalëshi "autoriteti kompetent" zëvendësohet me "LSHKV".

11. Neni 23 riformulohet si më poshtë:

"23. Kohëzgjatja e procedurës për certifikatën e tregtimit.

1. Në zbatim të nenit 87, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, procedura për shqyrtimin e dosjes së PMV-së nga LSHKV-ja, miratimi nga Komisioni Shtetëror i PMV-së dhe lëshimi i certifikatës së tregtimit, përfundon brenda një afati prej 100 ditësh pas aplikimit online.

2. Aplikimi dhe numri i referencës së kërkesës dërgohen me email nga SPV-ja në LSHKV. Dosjet përkatëse për secilën PMV së bashku me kampionet e PMV-së, si dhe kampionin e substancës aktive, dorëzohen nga kërkuesi në Laboratorin Shtetëror të Kontrollit Veterinar, pas aplikimit të kryer online dhe pranimit të aplikimit.

3. Kërkuesi, brenda 30 ditëve pune nga dorëzimi i dosjes për PMV ose ditën e parë të punës pas këtij afati 30- ditor, njoftohet me shkrim nga LSHKV-ja nëse dosja e dorëzuar për PMV është në përputhje me kërkesat e aneksit I të kësaj rregulloreje."

12. Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë rifomulohet me këtë përmbajtje:

"Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar, gjatë shqyrtimit të dosjes së paraqitur për certifikatën e tregtimit në përputhje me kërkesat e neneve, 11, 12, 13, 14, 15, kryhen veprimet si më poshtë".

b) Në pikën 2 togfjalëshi "*mund*" hiqet;

c) Në pikën 4, togfjalëshi "*autoriteti kompetent*" zëvendësohet me "*LSHKV*".

14. Në nenin 25, bëhen këto ndryshime:

a) Nënparagrafin e parë fjala "DV" zëvendësohet me "SPV";

b) Në paragrafin e dytë pas shkronjës "d" shtohen shkronjat "e" dhe "f" me këtë përmbajtje:

"e) fotokopje të certifikatës së tregtimit në një vend të BE-së të dorëzuar në LSHKV;

f) fletën e analizave të kryera në LSHKV."

c) Në pikën 3, fjala "DV" zëvendësohet me"SPV"

ç) Në pikën 5, togfjalëshin "15 deri 30" zëvendësohet me "*jo më pak se 5*" dhe togfjalëshi "*autoritet kompetent*" zëvendësohet me "*sekretari i komisionit*".

15. Në nenin 27, bëhen ndryshime si më poshtë:

a) Në pikën 1, togfjalëshi "autoritet kompetent" zëvendësohet me "SPV";

b) Pika 3 riformulohet me këtë përmbajtje: togfjalëshi *"autoritet kompetent"* zëvendësohet me "drejtori i SPV-së" dhe togfjalëshi "miratimi prej komisionit shtetëror" zëvendësohet me "kryerja e pagesës nga kërkuesi".

Fjalia e fundit riformulohet me këtë përmbajtje:

"Certifikata e tregtimit mban datën e miratimit nga Komisioni Shtetëror i PMV-së. Tarifa përkatëse përcaktohet në udhëzimin e përbashkët të ministrit dhe ministrit të Financave".

c) Në pikën 4, togfjalëshi "autoriteti kompetent" zëvendësohet me "LSHKV".

ç) Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"Sekretari i Komisionit regjistron PMV-të e miratuara në regjistrin zyrtar të PMV-ve brenda 10 ditëve nga lëshimi i certifikatës. Regjistrimi i përditësuar publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë, si dhe u dërgohet në rrugë zyrtare AKVMB-së dhe AKU-së".

16. Në nenin 31, bëhen ndryshime si më poshtë:

a) Në pikën 2, fjalia e fundit, togfjalëshi "Autoriteti kompetent" zëvendësohet me "SPV".

b) Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"8. SPV i propozon Komisionit çregjistrimin e certifikatave për tregtim të PMV-ve të regjistruara për produkte që nuk kanë certifikatë tregtimi nga një prej vendeve të BE-së ose të lëshuara nga EMA-ja, ose janë regjistruar në kundërshtim me ligjin. nr. 10465, datë 29.9.2011. Komisioni merr vendim brenda 20 ditë pune, i cili i njoftohet, menjëherë AKU-në e cila ndalon importin e produkteve mjekësore veterinare të çregjistruara.

Ndalohet tregtimi i produkteve të importuara pas çregjistrimit të certifikatës së tregtimit të tyre, dhe hiqen nga tregu brenda 1 muaji nga data e çregjistrimit të certifikatës."

17. Në nenin 33, pika 1 togfjalëshi "autoriteti kompetent" zëvendësohet me "LSHKV".

18. Në nenin 34, pika 1 togfjalëshi "autoriteti kompetent" zëvendësohet me "Komisioni Shtetëror i PMV-ve".

URDHËR
Nr. 327, datë 8.7.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA LLOJEVE KAFSHËSH DHE MISHIT TË FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA TERRITORE TË TJERA, NË ADMINISTRIM TË KËTYRE SHTETEVE", E MIRATUAR ME URDHRIN NR. 328, DATË 22.11.2011, TË MINISTRIT TË BUJQËSISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 42, dhe nenit 55, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe VKM-së nr. 807, datë 20.12.2021, "Për miratimin, në parim, të marrëveshjes për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, sigurisë ushqimore dhe ushqimit për kafshë dhe fitosanitare në Ballkanin Perëndimor",

URDHËROJ:

1. Pjesa I e aneksit I, ku përcaktohet lista e vendeve jashtë Bashkimit Evropian, territoreve ose pjesëve të tyre, të cilat lejohen të importojnë kafshë të gjalla drejt Republikës së Shqipërisë, ndryshohet sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Pjesa I e aneksit II, ku përcaktohet lista e vendeve jashtë Bashkimit Evropian, territoreve ose pjesëve të tyre, të cilat lejohen të importojnë mish të freskët drejt Republikës së Shqipërisë, ndryshohet sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave Veterinare në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

ANEKSI I
THUNDRAKËT

PJESA I

LISTA E VENDEVE JASHTË BASHKIMIT EUROPIAN, TERRITOREVE OSE PJESËVE TË TYRE

Shteti	Kodi i territorit	Përshkrimi i territorit	Certifikata veterinare		Kushte të veçanta
			Modeli	GSH	
1	2	3	4	5	6
MK – Maqedonia e Veriut	MK-0	I gjithë vendi	BOV-X , BOV-Y, OVI-X, OVI-Y, POR-X, POR-Y, RUM, SUI.		
RS – Serbi	RS-0	I gjithë vendi	BOV-X, BOV-Y, OVI-X, OVI-Y, POR-X, POR-Y, RUM, SUI.		

ANEKSI II
MISHI I FRESKËT

PJESA II

LISTA E VENDEVE JASHTË BASHKIMIT EUROPIAN, TERRITOREVE DHE PJESËVE TË TYRE

Kodi ISO dhe emri i vendit eksportues	Kodi i territorit	Përshkrimi i vendit eksportues, territorit ose pjesës së tij	Certifikata veterinare		Kushte të veçanta	Data e mbylljes	Data e hapjes ([3])
			Modeli	G SH			
1	2	3	4	5	6	7	8
MK – Maqedonia e Veriut	MK-0	I gjithë vendi	BOV, OVI, POR, EQU, RUF, RUW, SUF, SUW				
RS – Serbi	RS-0	I gjithë vendi	BOV, OVI, POR, EQU, RUF, RUW, SUF, SUW				

URDHËR
Nr. 335, datë 13.7.2022

PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA HUNGARIA, LETONIA, UKRAINA, RUMANIA, ITALIA, GJERMANIA, LITUANIA, MOLDAVIA, SLLOVAKIA, SERBIA , ESTONIA, BULLGARIA DHE POLONIA

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga:

Shteti i **Hungarisë**, qarku Borsod-Abaúj-Zemplén, qyteti Ózd, Tokaj, Miskolc, Gönc, Sátoraljaújhely, Mezőkövesd, Szikszó, Edelény, Szerencs dhe Encs; nga qarku Budapest, qyteti Budapest; nga qarku Fejér, qyteti Bicske; qarku Hajdú-Bihar, qyteti Hajdúhadház, Debrecen dhe Hajdúböszörmény; qarku Heves, qyteti Pétervására, Hatvan, Gyöngyös dhe Eger; qarku Jász-Nagykun-Szolnok, qyteti Tiszafüred; qarku Komárom-Esztergom, qyteti Tatabánya; qarku Nograd, qyteti Salgótarján, Bátonyterenye dhe Pásztó; qarku Pest, qyteti Szentendre, Pilisvörösvár dhe Budaörs; qarku Szabolcs-Szatmár-Bereg, qyteti Nagykálló, Tiszavasvári, Nyírbátor, Mátészalka, Nyíregyháza dhe Baktalórántháza;

Shteti i **Letonisë**, rajoni Latgales qyteti Augšdaugavas, njësia administrative Demenes, Ambeļu, Medumu dhe Kalkūnes; qyteti Balvu, njësia administrative Susāju, Rugāju, Krišjāņu; qyteti Dienvidkurzemes, njësia administrative Vērgales, Rucavas, Sakas, Dunalkas, Priekules, Bārtas, Cīravas, Dunikas; qyteti Krāslavas, njësia administrative Svariņu, Robežnieku, Bērziņu, Asūnes dhe Kalniešu; qyteti Kuldīgas, njësia administrative Rudbāržu, Rumbas, Turlavas, Īvandes, Kurmāles, Ēdoles, Laidu, Nīkrāces, Gudenieku dhe Skrundas; qyteti Ludzas, njësia administrative Salnavas, Pildas, Pureņu, Malnavas, Pildas, Istras, Cirmas, Rundēnu, Goliševas, Isnaudas Zaļesjes, Cirmas, Ņukšu, Nirzas, Briģu, Lauderu; qyteti Preiļu, njësia administrative Galēnu; qyteti Rēzeknes, njësia administrative Kaunatas, Ozolaines, Lūznavas, Silmalas, Sakstagala, Lendžu, Viļānu, Sokolku dhe Nautrēnu; qyteti Saldus, njësia administrative Kursīšu, Lutriņu, Zirņu dhe Jaunlutriņu; qyteti Talsu, njësia administrative Rojas, Ķūļciema, Laucienes, Valdgales dhe Abavas; qyteti Tukuma Irlavas, Jaunpils, Lestenes, Degoles, Slampes, Džūkstes, Zemītes, Tumes; qyteti Ventspils, njësia administrative Jūrkalnes, Ugāles, Zlēku, Piltenes, Tārgales, Vārves, Zlēku, Popes, Vārves, Usmas; rajoni Vidzemes, qyteti Madona, njësia administrative Vestienas dhe Barkavas, qyteti Limbažu, njësia administrative Skultes; rajoni Vizemes, qyteti Madonas, njësia administrative Indrānu, qyteti Saulkrastu, njësia administrative Sējas, qyteti Valmieras, njësia administrative Valmieras, Naukšēnu dhe Plāņu, qyteti Cēsu, njësia administrative Vecpiebalgasm, Stalbes dhe Priekuļu; qyteti Alūksnes, njësia administrative Annas; qyteti Cēsu, njësia administrative Stalbes; qyteti Limbažu, njësia administrative Limbažu, qyteti Valkas, njësia administrative Ērģemes; rajoni Zemgales, qyteti Aizkraukles, njësia administrative Skrīveru, Aizkraukles; qyteti Jelgavas, njësia administrative Valgundes, Zaļenieku, Cenu, Līvbērzes; qyteti Dobeles, njësia administrative Īles, Annenieku dhe Auru.

Shteti i Ukrainës, përkatësisht rajoni Konotops'kyi, qyteti Sumy; i gjithë territori i shtetit të **Rumanisë**.

Shteti i Italisë, rajoni i Lazio, qyteti i Romës; rajoni Piemonte, qyteti Alessandria; rajoni Liguria, qyteti Genova; rajoni Sardegna, qyteti Nuoro.

Shteti i Gjermanisë, rajoni i Baden-Württemberg, qyteti Emmendingen, njësia administrative Nördlicher Kaiserstuhl; rajoni Brandenburg, qyteti Barnim, njësia Britz-Chorin-Oderberg; qyteti Frankfurt (Oder), njësia

administrative Frankfurt (Oder); qyteti Märkisch-Oderland, njësia administrative Lebus, Bad Freienwalde (Oder), Golzow; qyteti Oberspreewald-Lausitz, njësia administrative Großräschen dhe Ruhland; qyteti Oder-Spree, njësia administrative Odervorland, Scharmützelsee dhe Rietz-Neuendorf; qyteti Spree-Neiße, njësia administrative Schenkendöbern, Döbern-Land, Spremberg, Guben, Forst (Lausitz) dhe Döbern-Land; qyteti Uckermark, njësia administrative Schwedt/Oder, Gartz (Oder), Oder-Welse dhe Angermünde; rajoni Mecklenburg-Vorpommern, qyteti Ludwigslust-Parchim, njësia administrative Parchimer Umland, Eldenburg Lübz, Grabow; rajoni Sachsen, qyteti Bautzen, njësia administrative Malschwitz, Schwepnitz, Königsbrück, Pulsnitz, Großdubrau, Spreetal, Lohsa, Wachau; qyteti Görlitz, njësia administrative Weißwasser/O.L., Diehsa, Markersdorf, Boxberg/O.L., Schleife, Niesky, Markersdorf, Bernstadt/Schönau-Berzdorf, Diehsa, Schleife, Reichenbach/O.L., Ostritz, Weißer Schöps/Neiße; qyteti Meißen, njësia administrative Thiendorf, Ebersbach, Moritzburg, Schönfeld, Radeburg, Thiendorf, Schönfeld; qyteti Nordsachsen, njësia administrative Wermsdorf; qyteti Sächsische Schweiz-Osterzgebirge, njësia administrative Lohmen/Stadt Wehlen.

Shteti i Lituanisë, qyteti Kauno, Bashkia Kėdainių, Kauno, Kaišiadorių, Prienų, Jonavos; qyteti Klaipedos, bashkia Kretingos dhe Skuodo; qyteti Marijampoles, Bashkia Šakių; qyteti Šiauliai, Bashkia Akmenės dhe Šiaulių; qyteti Taurages, Bashkia Tauragės dhe Jurbarko; qyteti Telšiai, Bashkia Telšių; qyteti Utenos, Bashkia Anykščių, Molėtų, Zarasų, Utenos, Ignalinos dhe Zarasų; qyteti Vilniaus, Bashkia Švenčionių, Trakų, Vilniaus.

Shteti i Moldavisë, qyteti i Edineţ, Dubăsari, Briceni dhe Rîşcani.

Shteti i Sllovakisë, rajoni Banskobystrický, qyteti Brezno, Banská Bystrica, Poltár, Rimavská Sobota, Zvolen, Lucenec, Krupina, Velký Krtíš, Detva, Revúca, Žiar nad Hronom, Revúca; rajoni Košický, qyteti Rožnava, Sobrance, Trebišov, Michalovce, Spišská Nová Ves, Košice-okolie; rajoni Prešovský, qyteti Bardejov Humenné, Levoca

Prešov, Vranov nad Toplou, Stropkov, Kežmarok, Sabinov, Kežmarok, Medzilaborce, Svidník, Snina dhe Poprad; rajoni Žilinský, qyteti Liptovský Mikuláš.

Shteti i Serbisë rajoni Borski, Bashkia Majdanpek dhe Kladovo; rajoni Braničevski, Bashkia Kučevo, Golubac dhe Veliko Gradište; rajoni Nišavski, Bashkia Ražanj dhe Niš; rajoni Pirotski, Bashkia Pirot, Dimitrovgrad dhe Babušnica; rajoni Zaječarski, Bashkia Sokobanja dhe Boljevac.

Shteti i Estonisë, qarku Harju, Bashkia Harju, fshati Tagadi; Bashkia Kose, fshati Tammiku; rajoni Ida-Viru, Bashkia Toila, fshati Voka; Bashkia Kohtla-Nõmme, fshati Kohtla-Nõmme; rajoni Järva, Bashkia Roosna-Alliku, fshati Oeti; qarku Jõgeva, fshati Torma, fshati Liikatku; rajoni Lääne-Viru, Bashkia Viru-Nigula, fshati Viru-Nigula, Pada, Malla, Mahu; Bashkia Laekvere, fshati Luusika; Bashkia Rägavere, fshati Viru-Kabala; Bashkia Väike-Maarja, fshati Pikevere; Bashkia Vihula, fshati Lauli; rajoni Pärnu, Bashkia Tõstamaa, fshati Päraküla; rajoni Põlva, Bashkia Mikitamäe, fshati Laossina; Bashkia Orava, fshati Kõvera, Kamnitsa; Bashkia Räpina, fshati Linte; rajoni Rapla, Bashkia Kohila, fshati Urge; rajoni Saare, Bashkia Kärla, fshati Hirmuste; rajoni Viljandi, Bashkia Abja, fshati Penuja; Bashkia Tarvastu, fshati Soe.

Shteti i Bullgarisë, rajoni Blagoevgrad, Burgas, Dobrich, Gabrovo, Haskovo, Kardzhali, Kyustendil, Pazardzhik, Pernik, Plovdiv, Razgrad, Ruse, Shumen, Sliven, Smolyan, Sofia, Stara Zagora, Tragovishte, Varna, Veliko Tarnovo dhe Yambol.

Shteti i Polonisë, rajoni Dolnośląskie, Lubelskie, Lubuskie, Małopolskie, Mazowieckie, Opolskie, Podkarpackie, Podlaskie, Pomorskie, Warmińsko-Mazurskie, Wielkopolskie dhe Zachodniopomorskie.

1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi

serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kur survejanca e kryer tregon se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit kjo periudhë mund të reduktohet në 12 muaj;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara in vivo të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kur survejanca e kryer tregon se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit kjo periudhë mund të reduktohet në 12 muaj;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në

mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 96, datë 24.2.2020, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në Greqi, Bullgari, Rumani, Estoni, Letoni, Lituani, Ukrainë, Poloni, Sllovaki, Belgjikë, Hungari, Serbi dhe Moldavi" dhe urdhri nr. 38, datë 8.2.2022, "Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga shteti i Italisë", shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

VENDIM
Nr. 1, datë 30.5.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelimit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	kryetare;
Natasha Mulaj	anëtare;
Ina Rama	anëtare;
Mimoza Tasi	anëtare;
Rezarta Schuetz	anëtare;
Sokol Çomo	anëtar,

- mori në shqyrtim në seancë plenare publike, në datat 17.2.2021, 19.1.2022, 14.2.2022, 17.2.2022, 18.2.2022, 15.3.2022, 7.4.2022, 9.5.2022, 10.5.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 3/2021, datë 30.4.2021, që i përket:

ANKUES: Bujar Memia, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Krujë, përfaqësuar nga avokatët Fatmir Braka dhe Anteo Papa, sipas prokurës së posaçme nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 8.9.2020.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, përfaqësuar nga z. Gerti Zela me autorizimin nr. {***}, datë 13.12.2021 dhe z. Alban Nako me autorizimin nr. {***}, datë 11.3.2022.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuar nga znj. Isida Koka dhe znj. Alma Troshani me autorizimin nr. {***}, datë 12.1.2022.

OBJEKTI:Shfuqizimi i vendimit nr. 81, datë 31.3.2021, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, "Për caktimin e masës disiplinore", ndaj prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Bujar Memia.

BAZA LIGJORE: Neni 44 e vijues i ligjit 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve Administrative", i ndryshuar.

Neni 27, neni 49, neni 51/a germa "b", neni 71 pika 3, neni 72 e vijues i ligjit nr. 8577, datë 10 shkurt 2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Nenet 131, germa "f" në lidhje me nenin 29, nenin 132, pika 1 dhe 134, germa "i" e Kushtetutës.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, magjistratin Bujar Memia dhe avokatin e tij Anteo Papa, përfaqësuesit e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Magjistrati Bujar Memia ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim "ILD"), me vendimin nr. {***}, datë 15.6.2020, ka vendosur verifikimin kryesisht të fakteve të bëra publike në median elektronike, në lidhje me vrasjen e shtetasit H.B., ndodhur më datë 12.6.2020, dhe marrjen e të dhënave shtesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë apo gjykatave të tjera lidhur me proceset gjyqësore për sa u përket të dënuarve H.B. dhe I.P.

2.1 ILD-së, nga të dhënat e përftuara gjatë procedurës së verifikimit, i rezultoi se përmbushen kriteret ligjore të cilat justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Bujar Memia, kështu me vendimin nr. {***} prot., datë 16.7.2020, ka vendosur: *Fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrati Bujar Memia, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë figurën e prokurorit parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës, dhe; i. shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja "c" e ligjit nr. 96/2016 për çështjen me nr. vendimi {***} akti, datë 6 nëntor 2017; ii. shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germa "c" dhe "dh" për çështjet me nr. {***} akti, datë 14 shkurt 2018 dhe nr. {***} akti, datë 21 nëntor 2018; dhe iii. shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germa "c" dhe "dh" dhe neni 102, pika 2, germa "a" për çështjen nr. {***} akti, datë 22 shkurt 2019.*

*Për qëllim të këtij hetimi disiplinor, të merren pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë, praktikat respektive që disponohen nga kjo prokurori në lidhje me çështjet e gjykuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Krujë, nr. {***} akti, datë 6 nëntor 2017, nr. {***} akti, datë 14 shkurt 2018, nr. {***} akti, datë 21 nëntor 2018 dhe nr. {***} akti, datë 22 shkurt 2019 [...].*

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim "KLP") ka administruar shkresën me nr. {***} prot., datë 15.1.2021, "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë", ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, shoqëruar me raportin për hetimin disiplinor nr. {***} prot., datë 14.1.2021, dhe dosjen hetimore për zhvillimin e procedurës disiplinore në ngarkim të këtij magjistrati, duke i propozuar Këshillit: *Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1, shkronjat "ç", "dh" dhe neni 102, pika 2, shkronja "a" e ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe propozimin e masës disiplinore "Shkarkim nga detyra", të parashikuar nga neni 111 i ligjit nr.*

96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1, shkronjat "ç", "dh" dhe neni 102, pika 2, shkronja "a" e ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3.1 KLP-ja, me vendimin nr. 81, datë 31.3.2021, ka vendosur: *Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nr. {***} prot., datë 15.1.2021, për procedim disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia. Shkarkimin nga detyra të magjistratit Bujar Memia, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. Bujar Memia brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes. Të njoftohet Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi. Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*

4. Kundër vendimit nr. 81, datë 31.3.2021, të KLP-së ka ushtruar ankim magjistrati Bujar Memia, duke kërkuar: Pranimin e kërkesës si të bazuar në ligj dhe në prova. Shfuqizimin e vendimit nr. 81, datë 31 mars 2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Bujar Memia". Detyrimin e ILD-së që të përgënjeshtrojë në median elektronike dhe të shkruar faktet e pavërteta të relatuara ndaj magjistratit Bujar Memia, pasi rrethanat e hetuara nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

5. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak për çështjen (JD) nr. 3/2021 të Juridiksionit Disiplinor, ka vlerësuar se kërkesa e magjistratit plotëson kushtet për t'u gjykuar në seancë plenare, bazuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar, "*Gjykata Kushtetuese shqyrton çështjet në seancë plenare me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë rast të jo më pak se të dy të tretave të tyre",* si dhe në referim të nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5.1 Me vendimin nr. {***}, datë 11.6.2021, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, bazuar në nenin 21, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ka vendosur: *Kalimin e çështjes (JD) nr. 3/2021, datë 30.4.2021, që i përket ankimit të magjistratit Bujar Memia, ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 81, datë 31.3.2021, për shqyrtim në seancë plenare publike. Të thirret si person i interesuar Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun të bëjë komunikimet respektive për të gjitha palët në proces.*

6. Kolegji, në kuadër të gjykimit në seancë plenare publike të çështjes nr. 3/2021, datë 30.4.2021, me kërkues Bujar Memia, kërkoi parashtrimet nga subjektet e interesuara: ILD - me shkresën nr. {***}, datë 21.10.2021, si dhe KLP - me shkresën nr. {***}, datë 21.10.2021. Me shkresën nr. {***}, datë 5.11.2021, ILD-ja ka paraqitur pranë Kolegjit parashtrimet mbi këtë çështje, ndërsa KLP-ja paraqiti prapësimet e saj me shkresën nr. {***} prot., datë 14.12.2021.

I. Pretendimet e magjistratit Bujar Memia në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

7. Magjistrati Bujar Memia, nëpërmjet përfaqësuesve të tij ligjorë Fatmir Braka dhe Anteo Papa, me shkresën nr. {***}, datë 6.12.2021, ka paraqitur në Kolegj parashtrimet dhe qëndrimin e tij ndaj vendimit nr. 81, datë 31.3.2021, të KLP-së dhe ndaj parashtrimeve të personave të interesuar, KLP dhe ILD. Në pjesën më të madhe të parashtrimeve të tij, magjistrati ka paraqitur të njëjtat argumente dhe qëndrime të pasqyruara në ankim duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

7.1 Shkaqet e ankimit lidhur me procedurën e hetimit dhe të shqyrtimit të çështjes në ILD dhe KLP

7.1.1 Vendimi nr. 81, datë 31.3.2021, i KLP-së është haptazi një vendimmarrje e gabuar, në kundërshtim të hapur dhe flagrant me Kushtetutën, Konventat Ndërkombëtare, ligjin procedural administrativ dhe atë procedural penal. Vendimi objekt shqyrtimi është rezultat i çmuarjes së gabuar të fakteve dhe të provave të administruara, rezultat i keqinterpretimit të ligjit procedural penal, ligjit material penal dhe kuadrit ligjor vendas dhe ndërkombëtar.

7.1.2 Në mungesë të elementeve të një procesi të rregullt ligjor dhe cenimit të sigurisë juridike, magjistrati pretendon se e gjithë veprimtaria e ILD-së është e paligjshme, pasi hetimi i saj nuk ka bazueshmëri për të identifikuar se cilat janë shkeljet disiplinore të kryera nga subjekti i hetimit disiplinor, dhe nga ana tjetër, baza ligjore e

pretenduar nga KLP-ja, konkretisht neni 148/d i Kushtetutës, është pasoja dhe jo shkaku i inicimit.

7.1.3 ILD-ja, sipas magjistratit, duhej të orientonte hetimet duke analizuar faktet (çështjet) dhe të identifikonte/ përcaktonte shkeljen disiplinore nga analizimi i çështjeve konkrete, bazuar në pikën 1 të nenit 148/d të Kushtetutës, pasi pika 2 është dispozita që rregullon funksionimin dhe vendimmarrjen e KLP-së. Me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017, dispozitat e ligjit material për statusin që përcaktojnë shkeljet disiplinoret, janë shfuqizuar dhe, për këtë arsye, nga perspektiva e parashtruar nga neni 29 i Kushtetutës, asnjë person nuk mund të dënohet për një fakt i cili në kohën kur ka ndodhur, nuk përbënte shkelje apo fakt dënues.

7.1.4 Procedura administrative e iniciuar nga ana e ILD-së dhe KLP-së, sipas magjistratit, është në kundërshtim me nenin 41, të ligjit nr. 44/2015, "Për Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", që sanksionon se: *Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative, kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës.* Ligji material ia kufizon fillimin e kësaj procedure, duke qenë se veprimtaria objekt gjykimi nuk konsiderohet shkelje nga ligji material nr. 96/2016, nisur nga fakti se dispozitat ligjore për shkeljet disiplinore të pretenduara, në raport me kohën kur ka ndodhur fakti i pretenduar, në kuptimin e *rationea temporis*, janë shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017.

7.1.5 KLP-ja ka dështuar që të çmojë të drejtë bazën ligjore të aplikuar nga ana e ILD-së, për sa i përket vendimit nr. {***} prot., datë 11.11.2020, konkretisht neni 92 i Kodit të Procedurave Administrative. Kjo bazë ligjore, sipas magjistratit, është e paligjshme, pasi rregullon rastet e zgjatjeve të afateve të parashikuara për procedurat administrative të parashikuara nga neni 91, pika 1 e Kodit të Procedurës Administrative, dispozitë e cila qartësisht referon vetëm rastet e procedurave administrative të iniciuara me kërkesë dhe jo rastet e procedurave administrative të iniciuara kryesisht nga organi publik, çka provon se vendimi nr. {***} prot., datë 11.11.2020, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është i paligjshëm, në kuptim të nenit 109 të K.PR.A. Nisur nga sa më sipër, magjistrati pretendon se kërkesa nr. {***} prot., datë 15.1.2021, e ILD-së është një kërkesë e nxjerrë në tejkalim të afatit ligjor të parashikuar nga vetë ILD-ja, çka ligjërisht, sipas tij, e bën këtë kërkesë absolutisht të paligjshme dhe të pashqyrtueshme nga KLP-ja.

7.2 Shkaqet e ankimit lidhur me vendimmarrjen e KLP-së

7.2.1 Magjistrati pretendon se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në vendimmarrjen e tij, i trajton dokumentet mjekësore si kartela klinike, epikriza dhe çdo lloj dokumenti tjetër mjekësor, në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, jo si prova, por si indicie, me qëllim për të justifikuar masën disiplinore të marrë ndaj tij.

7.2.2 Sipas magjistratit, KLP-ja është një organ administrativ, por që ka marrë rolin e një gjykate më të lartë, pasi me qëndrimin e tij ka cenuar bindjen e brendshme të prokurorit në çështjen konkrete, e cila është një bindje që bazohet në aktet dhe provat e çdo çështjeje konkrete dhe në zbatimin e drejtë të ligjit penal dhe procedural penal. KLP-ja, si një organ administrativ, nuk mund të vlerësojë si të drejtë apo të gabuar bindjen e brendshme të prokurorit. Magjistrati pretendon se ankimimi ndaj vendimit të gjykatës është mjet procedural penal në trajtën e një pushteti diskrecional, pra ankimimi është e drejtë, por jo detyrim.

7.2.3 Magjistrati pretendon se konkluzioni i arritur nga KLP-ja në vendimin e saj, është i gabuar dhe vjen si rrjedhojë e moszbatimit të drejtë të ligjit nga KLP-ja, pasi për njohjen e periudhës së paraburgimit, nga data 14.10.2008 deri më 20.7.2016, për shtetasin H.B., nuk gjejnë zbatim dispozitat ligjore të cituara më sipër, të pretenduara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Gjithashtu, pretendon se KLP-ja dhe ILD-ja injorojnë nenin 10 të Kodit Penal, i cili sanksionon se vendimet penale nga ana e gjykatave të huaja për shtetas shqiptarë vlejnë në Shqipëri për zbatimin e masave të sigurimit

7.2.4 Magjistrati pretendon se neni 5 i ligjit nr. 46/2016, "Për amnistinë", nuk e lidh të drejtën e përfitimit me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit, siç e kërkon neni 3 dhe, nisur nga ky fakt, nuk duhet të konfondohet koha e hyrjes në fuqi të ligjit me efektet se ndaj kujt do të zbatohet amnistia.

7.2.5 Lidhur me mosushtrimin e ankimit ndaj vendimit nr. {***} akti, datë 21.1.2018, magjistrati është bazuar në bindjen e brendshme të tij, duke iu referuar akteve dhe provave konkrete dhe kërkesave të ligjit sipas të cilit ky i dënuar duhej të

përfitonte uljen e dënimit për një vit, në zbatim të ligjit nr. 141/2016, "Për amnistinë", si dhe nuk mund të bënte ankim pasi do të binte në kundërshtim me veten e tij dhe qëndrimin e mbajtur në seancë, pra do të ishte jokoherent.

7.2.6 Sipas pretendimeve të magjistratit lidhur me pikat 147, 148 të vendimit nr. 81, datë 31.3.2021 të KLP-së, ai është njohur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me nr. {***}, datë 18.1.2019, vetëm më datë 21.2.2019, pra, sipas ankuesit, ky vendim kishte marrë formë të prerë. Më tej, magjistrati pretendon se ky vendim me objekt ulje dënimi për një afat prej 90 ditësh, është bërë në prezencë vetëm të përfaqësuesit të IEVP-së dhe ky organ nuk e ka kundërshtuar këtë vendim.

8. Pretendimet e KLP-së lidhur me shkaqet e paraqitura nga magjistrati

8.1 Mbi pretendimin e boshllëkut legjislativ, në kontekstin e mosdënimit pa ligj, duke cenuar nenet 6 dhe 7 të KEDNJ-së.

8.1.1 KLP-ja ka arsyetuar në pikën 48 të vendimit të saj, se legjislacioni në fuqi dhe konkretisht neni 124 i ligjit për statusin, përcakton se: "*Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.*". Ky kriter është vlerësuar i përmbushur, pasi sjellja e magjistratit është parashikuar si shkelje disiplinore nga neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon shprehimisht, se: "*Prokurori shkarkohet nga detyra kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.*".

8.1.2 Në qëndrimin që ka mbajtur ndër vite Gjykata Kushtetuese, në lidhje me nenin 4/3 të Kushtetutës, parashikohet se dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Gjithashtu, kjo gjykatë është shprehur se Kushtetuta nuk ka pasur për qëllim që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë rastet e shkarkimit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 148/d, pika 2 e tij, ndërsa sa i përket dhënies së masave të tjera disiplinore, neni 148/d, pika 1 e Kushtetutës ia ka deleguar kompetencat ligjvënësit të zakonshëm, për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit konkret të tyre.

8.1.3 Në jurisprudencën e deritanishme kushtetuese[1], është interpretuar përfundimisht koncepti i shkeljes së rëndë në kontekstin e neneve 128, 140 dhe 149, pika 2 e Kushtetutës, sipas të cilave shkelja e rëndë ka të bëjë me akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit e të prokurorit. Gjithashtu duhet të kemi në konsideratë edhe faktin se vendimi nr. 34/2017 i Gjykatës Kushtetuese nuk ka shfuqizuar kompetencat e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të shkarkuar prokurorët sipas rasteve që derivojnë drejtpërdrejt nga Kushtetuta, por ka shfuqizuar ato pjesë të ligjit të cilat ishin në tejkalim të kompetencave që parashikon dispozita kushtetuese.

8.1.4 KLP-ja, referuar praktikës së GjEDNj-së, ka vlerësuar se elemente, si: klasifikimi i veprës penale, natyra e veprës dhe shkalla e ashpërsisë së dënimit, të marra në mënyrë alternative ose kumulative, janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se nenet 6 dhe 7 të Konventës janë të pazbatueshme nën aspektin e tij penal. Pretendimi i kërkuesit për boshllëk legjislativ, në kontekstin e mosdënimit pa ligj, duke cenuar nenet 6 dhe 7 të KEDNj-së ka papajtueshmëri *ratione materiae* dhe, për rrjedhojë, nuk duhet pranuar dhe duhet rrëzuar.

8.2 *Pretendimet e KLP-së mbi përfaqësimin e akuzës nga magjistrati Bujar Memia*

8.2.1 KLP-ja, duke u referuar në nenin 148/1 të Kushtetutës, argumenton se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit, ku një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale. Bindja e brendshme në vetvete nënkupton një proces vlerësimi argumentues që shërben si një urë lidhëse midis faktit provues (provës) dhe elementit ligjor që duhet provuar, ku nëpërmjet arsyetimit logjik justifikohet juridikisht vendimmarrja ligjore.

8.2.2 Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria ka detyrimin kushtetues të hetojë me hollësi, si dhe të përfaqësojë akuzën publike në gjyq, në çdo fazë të procedimit, qoftë dhe gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal, ku prokurori ka detyrimin kushtetues që të garantojë një drejtësi penale funksionale, përkundrejt rasteve të mosveprimit të

[1] *Shih vendimin nr. 75, datë 19.4.2002, të Gjykatës Kushtetuese, qëndrim i rikonfirmuar në pikën 138, të vendimit nr. 1/2022 të Gjykatës Kushtetuese.*

provuar në vendimin nr. 81/2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga z. Bujar Memia.

8.2.3 Roli aktiv që luan prokurori në funksionalitetin e drejtësisë penale, përbën thelbin e garancisë për besimin që duhet të frymëzojë qytetarët në një shoqëri demokratike, ligjshmëria e rolit të prokurorit manifestohet jo vetëm nga paraqitja fizike e tij në procesin gjyqësor, por edhe nga diligjenca e posaçme që ai tregon, duke ushtruar një rol që është në mënyrë esenciale aktiv në mbrojtje të shtetit të së drejtës. Për rrjedhojë, në rastin objekt shqyrtimi, vlerësohet se prokurori nuk mund të justifikohet me pretendimin e "bindjes së brendshme", kur nuk përjashtohet dyshimi që mosveprimi i prokurorit është objektivisht i justifikueshëm duke cenuar rregullsinë e rendit kushtetues e duke minuar besimin te trupa e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

8.3 *Prapësimet e KLP-së lidhur me pretendimin e magjistratit për mungesën e arsyetimit ligjor të vendimit nr. 81/2012 të KLP-së*

8.3.1 KLP-ja sqaron se detyrimi për arsyetimin e vendimit nuk mund të interpretohet sikur kërkohet, arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese[2] rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet administrative të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre.

8.3.2 KLP-ja vlerëson se, në përfundim të procedurës administrative, ka analizuar dhe arsyetuar në vendimin e saj veprimet dhe mosveprimet e prokurorit Memia, duke arritur në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e tij, vendimi nr. 81/2021 plotëson kërkesën kushtetuese e të qenit i arsyetuar, në kuptim të përmbajtjes së nenit 99, pika 2 (elementet e pjesës hyrëse, arsyetuese dhe dispozitivi) dhe nenit 100 (elementet e qartësisë në vendim) të Kodit të Procedurës Administrative, pasi përmban përshkrimin e fakteve dhe argumenteve në lidhje me shkeljet e rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe është shoqëruar me provat përkatëse. Nuk konstatohen kundërthënie midis pjesës arsyetuese dhe urdhëruese. Në përfundim, KLP-ja vlerëson se pretendimi i parashtruar nga kërkuesi, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

8.3.3 Në lidhje me pretendimin për përbërjen e Komisionit Disiplinor, KLP-ja ka sqaruar se me vendimin nr. {***}, datë 26.12.2018, është vendosur krijimi i komisioneve të përhershme, ku Komisioni Disiplinor përbëhej nga z. B.SH. (kryetar) dhe B.C. e T.B. (anëtarë), ndërsa anëtarë zëvendësues ishin z. G. O. dhe znj. N.S. Me vendimin nr. 20, datë 31.7.2019, Kolegji i Posaçëm i Apelimit vendosi shkarkimin nga detyra për prokurorin dhe anëtarin zëvendësues, z. G. O., i cili u zëvendësua më pas nga prokurorja E.K. (C.), e cila, mbi bazën e shortit, u përzgjodh relatore e çështjes së këtij procedimi disiplinor.

8.3.4 Me vendimin nr. 2, datë 27.2.2020, Kolegji shkarkoi nga detyra dhe anëtarin tjetër të këtij komisioni disiplinor, z. B.C., i cili u zëvendësua më pas nga prokurorja E.G. Nisur nga fakti se kohëzgjatja e zëvendësimit të anëtarit të përhershëm, z. B.C. me znj. E.G. zgjati më shumë se shtatë ditë (afat i parashikuar nga rregullorja), me zgjedhjen e anëtares E.G., automatikisht ajo mori cilësinë e anëtares së përhershme të Komisionit Disiplinor. Referuar nenit 11, pika 3, germa "b" e rregullores "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", anëtari zëvendësues shërben deri në përfundim të kësaj çështjeje, për pasojë anëtarja E.K. vijoi mandatin e komisionit disiplinor në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

8.3.5 Në lidhje me pretendimin e magjistratit për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor nga ILD-ja, organi i KLP-së vlerëson se vendimi për zgjatjen e hetimit disiplinor ka si bazë ligjore të përcaktuar, si në pjesën hyrëse të vendimit, edhe në dispozitivin e tij, nenin 92 të Kodit të Procedurës Administrative dhe nenin 118 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar[3], pra ILD-ja e ka

[2] *Shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.*

Shih vendimin nr. 3, datë 23.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese.

[3] *"Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, brenda tre muajve nga marrja e ankesës. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit. 3. Inspektori i*

respektuar afatin 6-mujor të parashikuar nga neni 118 i ligjit, "Për statusin", dhe ky pretendim i kërkuesit nuk qëndron.

8.4 Shkeljet e konstatuara nga KLP-ja në vendimet gjyqësore në të cilat magjistrati ka përfaqësuar akuzën dhe janë objekt shqyrtimi

8.4.1 *Shkeljet disiplinore të konstatuara nga KLP-ja në shqyrtimin e çështjes që i përket vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 6.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*

8.4.1.1 KLP-ja ka konstatuar se qëndrimi i magjistratit në seancë, në ushtrimin e funksioneve të veta, roli i tij apo pyetjet e shtruara ndaj mjekut, nuk kanë qenë ezauruese në drejtim të hetimit gjyqësor mbi plotësimin e kushteve të kërkuara nga neni 59/a, pika 1, shkronja "c" e Kodit Penal për të dënuarin I.P.

8.4.1.2 Nuk ka paraqitur kërkesa procedurale për marrjen e një prove vendimtare për zgjidhjen e çështjes së parashtruar për shqyrtim, sipas parashikimeve të neneve 178 dhe 366 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht aktin e ekspertimit mjekoligjor për të përcaktuar gjendjen shëndetësore të të dënuarit.

8.4.1.3 Nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 6.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, pa u krijuar mundësia e kontrollit gjyqësor të kësaj vendimmarrje lidhur me provueshmërinë e kushteve të parashikuara në këtë dispozitë. KLP-ja vlerëson se magjistrati, me qëndrimin pasiv, duke mos kërkuar marrjen e provave, rezulton të jetë angazhuar në një vendim të paarsyeshëm, të rrezikshëm për shtetin e së drejtës dhe arbitrar.

8.4.2 *Shkeljet disiplinore të konstatuara nga KLP-ja në shqyrtimin e çështjes që i përket vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 14.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*

8.4.2.1 Magjistrati në këtë gjykim ka dështuar të konstatojë që, për të njëjtën periudhë objekt gjykimi me vendimin nr. {***}, datë 25.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, është vendosur: "Ulja e dënimit me 90 ditë për çdo vit, nga 14.10.2008–23.5.2017" *(diferenca 8 vjet, 7 muaj e 12 ditë, duke ulur dënimin me 24 muaj)*, për rrjedhojë duke mos treguar një diligjencë të posaçme për të konstatuar përfitimin e dyfishtë, si dhe duke mos njohur pozitën ligjore e procedurale të të dënuarit, nëpërmjet qëndrimit të tij pasiv, ka lejuar që i dënuari H.B. të përfitojë artificialisht ulje dënimi për të njëjtën periudhë kohe, me dy cilësi të ndryshme *(si i dënuar dhe si i paraburgosur, në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 154/2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)*, duke ulur aritmetikisht dënimin me 6 vjet e 4 muaj e 15 ditë.

8.4.3 *Shkeljet disiplinore të konstatuara nga KLP-ja në shqyrtimin e çështjes që i përket vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 21.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*

8.4.3.1 Magjistrati gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, ka dështuar të konstatojë se i dënuari H.B. ishte në kushtet e përjashtimit të përfitimit të amnistisë, sepse ishte dënuar për krime kundër jetës të kryera me dashje, në zbatim të nenit 4, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 141/2016, ky kriter përbën shkak ndalues që e përjashton atë nga përfitimi i amnistisë. Njëkohësisht, magjistrati ka dështuar të konstatojë se i dënuari H.B. nuk është as në kushtet e amnistisë së mbetur, pasi kategoria e personave të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, është kategoria e personave, në rastin konkret burra që u ka mbetur pa vuajtur deri në 1 (një) vit nga dënimi i dhënë.

8.4.4 *Shkeljet disiplinore të konstatuara nga KLP-ja në shqyrtimin e çështjes që i përket vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 22.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*

8.4.4.1 Magjistrati, në cilësinë e prokurorit të kësaj çështjeje, ka dështuar të verifikojë kushtin e vuajtjes së 3/4 të dënimit, duke llogaritur edhe kohën e përfituar nga amnistia, si dhe ka dështuar të verifikojë "arsyet e veçanta", në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 2, datë 25.5.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga prokurori, duke e kthyer vendimin e formës së prerë në përfundimtar dhe gjë të gjykuar.

8.5 Në përfundim, KLP-ja, duke marrë në konsideratë shkeljet e rënda profesionale të konstatuara përtej çdo dyshimi të arsyeshëm gjatë ushtrimit të funksionit nga prokurori/ankuesi, të cilat diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit,

Lartë i Drejtësisë mund të zgjasë afatin e hetimit, të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, për tre muaj të tjerë në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundjeje apo pamundësisë së magjistratit. 4. Në rastet kur, pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3, të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, Inspektori i Lartë i Drejtësisë riçel hetimin, me kushtin që nuk janë parashkruar afatet, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 4, të nenit 117, të këtij ligji. 5. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikat 1 deri në 4, të këtij neni, magjistrati ka të drejtën të ankimojë mosveprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës".

kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese që të rrëzojë të gjitha pretendimet e kërkuesit si të pabazuara në ligj dhe prova.

9. Prapësimet e ILD-së, lidhur me pretendimet e magjistratit Bujar Memia

9.1 *Lidhur me pretendimet e natyrës kushtetuese dhe procedurale të magjistratit*

9.1.1 Inspektori i Lartë i Drejtësisë u është referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikimeve kushtetuese. Konkretisht, neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës parashikon se: *Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.* Referimi i drejtpërdrejtë në dispozitat kushtetuese[4] mbështetet në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve normative

9.1.2 Për shkak të rëndësisë që merr përgjegjësia disiplinore e magjistratëve në këndvështrim të garancive për pavarësinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga funksioni, Kushtetuta parashikon që magjistrati mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Në këto kushte, vetë Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të posaçëm, i ngritur në nivel kushtetues, i zbatueshëm për rastin në procedim.

9.1.3 Në këtë rast, për shkak se nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ishin shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, në kohën e dhënies së vendimeve, për të cilat magjistrati Bujar Memia u gjet përgjegjës disiplinarisht, ILD-ja ka vlerësuar zbatimin e drejtpërdrejtë të normës më të lartë juridike, pikërisht të parashikimit të bërë nga neni 148/d, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës, normë e cila parashikon përgjegjësinë disiplinore të magjistratit në rastin e kryerjes së shkeljeve të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe masën disiplinore.

9.1.4 Ekzistenca e vakumit të përkohshëm ligjor të shkaktuar nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të interpretohet kurrsesi si cenim i procesit të rregullt ligjor, të konsiderohet si shkak i shmangies nga përgjegjësitë disiplinore, apo të mund të përdoret nga magjistrati si shkak për të mos përmbushur funksionin e tij në mënyrë të rregullt ose për të kryer shkelje profesionale të natyrës që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.

9.1.5 Procedura e hetimit disiplinor, sipas ILD-së, rezulton të jetë zbatuar me rigorozitet, kështu pasi ILD-ja ka vendosur kryesisht verifikimin e fakteve të bëra publike dhe pasi ka marrë të dhëna të besueshme nga aktet e paraqitura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, të cilat kanë krijuar dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e shkeljes disiplinore, ka vendosur me iniciativë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia, sipas parashikimeve të neneve 123 dhe 124 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

9.1.6 Në lidhje me pretendimin e magjistratit për mosrespektim të nenit 92 të Kodit të Procedurës Administrative për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor, ILD-ja sqaron se, nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 11.11.2020, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor, vendim i cili ka si mbështetje ligjore nenin 92 të Kodit të Procedurës Administrative, dispozitë e cila parashikon mundësinë e organit procedues për zgjatjen e afatit të përfundimit të procedurës administrative.

9.1.7 Në ndryshim nga sa interpreton magjistrati, dispozita nuk u referohet në asnjë parashikim të saj, vetëm procedurave administrative të filluara me kërkesë të organit administrativ. Nga ana tjetër, në funksion të parimit të barazisë dhe të paanësisë në marrjen në marrjen e vendimeve, është e kuptueshme që rregullat e zgjatjes së afatit të një procedure administrative të zbatohen në mënyrë të njëjtë, pavarësisht faktit nëse procedura administrative fillon me kërkesë apo me iniciativën e organit administrativ.

9.1.8 ILD-ja thekson se magjistratit gjatë procesit të hetimit disiplinor, por edhe gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i janë siguruar të gjitha të drejtat dhe garancitë e parashikuara nga neni 42, pika 2 e Kushtetutës, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ato të parashikuara në ligjin "Për statusin".

[4] *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 78/2017, nr. 55/2016.*

9.2 *Prapësimet e ILD-së, lidhur me themelin e çështjes*

9.2.1 Në analizë të elementeve të referuara në vendimin nr. 75/2002 të Gjykatës Kushtetuese[5], në raport me sjelljen e magjistratit Bujar Memia, ILD-së i rezultoi, se:

9.2.2 Për sa i takon elementit të rrethanave të kryerjes së tyre, gjatë hetimit disiplinor rezultoi e provuar se:

Magjistrati nuk ka respektuar dispozitat e ligjit penal dhe procedural me natyrë urdhëruese, si dhe nuk ka mbajtur në konsideratë jurisprudencën e unifikuar të Gjykatës së Lartë dhe praktikën e Kolegjit Penal të kësaj gjykate.

Magjistrati nuk ka kërkuar marrjen e provave vendimtare për zgjidhjen e çështjes, në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë.

Si dhe nuk ka përmbushur funksionet në zbatim të parimeve të ligjshmërisë dhe paanësisë së prokurorit, në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale. Ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e parashikuar në nenin 48, pika 5, e ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Magjistrati nuk ka respektuar dispozitat penale me karakter urdhërues, të cilat parashikojnë kritere me karakter objektiv, ndalues dhe me një përmbajtje të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme për lirimin e të dënuarit, ku përvoja e gjatë profesionale e magjistratit e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita.

Magjistrati nuk ka mbajtur një qëndrim ligjor gjatë gjykimit të dhënë nga e njëjta gjykatë e cila në shkelje të ligjit, i kishte ulur dënimin të njëjtit të dënuar, në masën 90 ditë, në funksion të pranimit të çdo kërkese të paraqitur nga ana e tij, të cilat sollën dhe rritje fiktive të periudhës së dënimit, të llogaritur për efekt lirimi.

Gjithashtu, nuk ka mbajtur qëndrim ligjor gjatë gjykimit të çështjes që i përket kërkesës lirim me kusht të të dënuarit, megjithëse mori dijeni se në këtë gjykim mbi dy vendime të dhëna nga e njëjta gjykatë, e cila, gjatë periudhave të njëjta, i ka njohur të dënuarit dy cilësi: si i paraburgosur dhe si i dënuar, në funksion të pranimit të çdo kërkese të paraqitur nga ana e tij, të cilat sollën dhe rritje fiktive të periudhës së dënimit, të llogaritur për efekt lirimi.

Magjistrati nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimeve të dhëna në kundërshtim me ligjin. Këto veprime/mosveprime të tij janë kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustifikuar në 3 procese gjyqësore me të njëjtin kërkues, H.B., dhe në 1 (një) proces tjetër me kërkues I.P.

9.3 *Inspektori i Lartë i Drejtësisë, lidhur me qëndrimin subjektiv të magjistratit në seanca gjyqësore, si përfaqësues i akuzës*

9.3.1 ILD-ja, në parashtrime, pretendon se nga magjistrati Bujar Memia janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, pasi jo vetëm nuk është respektuar kërkesa e një dispozite të ligjit material apo procedural, por nuk është respektuar një tërësi dispozitash, si nenet 57, 59/a, pika 1 shkronja "c", 64 të Kodit Penal, nenet 149, 152, 178, 366, 438, 514, 518 të Kodit të Procedurës Penale, nenet 4 dhe 5 të ligjit nr. 141/2016, "Për dhënie amnistie", neni 9, pika 3 e ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës 'Për transferimin e personave të dënuar'", neni 61, pika 2, e ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", si dhe parashikimet e vendimeve nr. 154/200 dhe nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Siç u argumentua më sipër, shkeljet e magjistratit nuk janë të natyrës së gabimeve në interpretimin apo zbatimin e legjislacionit material dhe procedural, ato janë kryer me dashje duke synuar edhe ardhjen e pasojës.

9.3.2 Në lidhje me elementin tjetër, atë të pasojave që i shkaktohen shoqërisë, rezulton se shkeljet disiplinore të kryera nga magjistrati kanë

[5] *Shprehja "akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën [...]", parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2 e Kushtetutës, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.*

sjellë pasoja jo vetëm në cenimin e imazhit të prokurorit dhe humbjen e besimit ndaj tij, por kanë cenuar edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

9.3.3 Qëndrimi i prokurorit në seancë, vendimmarrja e gjykatës në rastin e të dënuarit H.B. dhe mosankimi i vendimit nga ana e prokurorit, solli një pasojë të rëndë, shmangien e të dënuarit me burgim të përjetshëm të caktuar nga autoritetet e huaja, i njohur nga autoriteti gjyqësor vendas me konvertimin e tij në 25 vjet burgim, e që në vijim u pasua me vuajtjen e vetëm 3 vjetëve burgim, ka sjellë si pasojë diskreditimin e figurës së magjistratit shqiptar dhe në raport me autoritetet e huaja. Pasiviteti dhe mosveprimi i prokurorit për të kontrolluar ligjshmërinë e kësaj vendimmarrjeje, ka ndikuar në uljen e besimit publik te sistemi i drejtësisë.

9.4 Në përfundim, ILD-ja konstaton se në analizë të sa më sipër, rezulton se përmbushen të gjitha elementet e vlerësuara në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, të cilat vërtetojnë se magjistrati ka kryer shkelje të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe klasifikohen si shkelje shumë e rëndë disiplinore në referim të nenit 148/b, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A) Për legjitimimin e ankuesit

10. Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është një juridiksion kushtetues, i cili do të shoqërojë veprimtarinë e tij gjatë mandatit 9-vjeçar (nëntëvjeçar), sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon: *Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

10.1 Në vijim të këtij parashikimi kushtetues, neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i përcakton Kolegjit të Posaçëm të Apelimit bazën ligjore, mbi të cilën do të procedojë gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues që lidhet me Juridiksionin Disiplinor, konkretisht: *Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

10.2 Çështja e legjitimimit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10.3 Ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10.4 Në çështjen objekt shqyrtimi, lidhur me legjitimimin e ankuesit, Kolegji vlerëson se kërkuesi Bujar Memia legjitimohet *ratione personae,* pasi vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë të cilin ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj tij dhe kërkuesi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10.5 Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f" e Kushtetutës, konstatohet se neni 192, pika 1, e ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", parashikon se vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për masat disiplinore ndaj prokurorëve ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë mandatit 9-vjeçar (nëntëvjeçar), e

ushtron Kolegji i Posaçëm të Apelimit. Pra, ankuesi nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç kërkesës drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

10.6 Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ankimohet, është i datës 31.3.2021, ndërsa kërkesa e ankuesit është protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit më datë 20.4.2021, dhe është regjistruar pas plotësimit të dokumentacionit, në datën 30.4.2021, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 8577/2000.

10.7 Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* Kolegji çmon se pretendimet e ankuesit ndaj vendimit nr. 81, datë 31.3.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, janë pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe do të shqyrtohen në vijim.

11. Mbi kërkesat procedurale të magjistratit përgjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj

11.1 Kolegji, me vendimin e ndërmjetëm, në seancën e datës 14.12.2021, bazuar në nenet 1, paragrafi 2 dhe 42 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendosi t'i drejtohet Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të kërkuar sjelljen brenda datës 29.12.2021, të fashikujve me të gjitha aktet e administruara dhe të krijuara në funksion të procedimit disiplinor, në bazë të të cilit është marrë dhe vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr. 81, datë 31.3.2021.

11.2 KLP-ja ka përcjellë në Kolegj, me shkresën nr. {***}, datë 29.12.2021, fashikujt me të gjitha aktet e administruara dhe të krijuara në funksion të këtij procedimi disiplinor. Magjistrati Bujar Memia është njohur me këto akte në ambientet e Kolegjit më datë 14 janar 2022, si dhe ka marrë kopje për një pjesë të këtyre akteve.

11.3 Gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore në Kolegj, magjistrati dhe përfaqësuesi i tij ligjor u drejtuan një seri pyetjesh subjekteve të interesuara pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor, të cilat u paraqitën edhe me shkrim dhe u depozituan në Kolegj.

11.4 Përfaqësuesit e KLP-së, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.3.2022, me lëndë: "Përcillen përgjigjet me shkrim në lidhje me pyetjet e drejtuara nga kërkuesi në procedimin e juridiksionit disiplinor nr. 3/2021, datë 30.4.2021", u kanë dhënë shpjegime të hollësishme pyetjeve të magjistratit. Përfaqësuesit e ILD-së, më datë 7.4.2022, kanë depozituar në Kolegj, krahas parashtresave për seancën plenare publike, edhe përgjigjet e pyetjeve të magjistratit.

11.5 Magjistrati ka paraqitur në seancën e datës 17.2.2022, kërkesën paraprake mbi moskompetencën e Kolegjit në shqyrtimin e masave disiplinore ndaj magjistratëve.

11.5.1 Kolegji, me vendimin e ndërmjetëm të datës 17.2.2022, vendosi rrëzimin e kësaj kërkese si të pabazuar në Kushtetutë dhe në ligj, pasi, bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës, *Kolegji shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë,* si dhe në nenin 5, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", *Kolegji shqyrton ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

11.6 Lidhur me kërkesën e magjistratit për çmuarjen si të pavlefshme të aktit të përfaqësimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kolegji, bazuar në nenin 1, pika 2 e ligjit 8577/2000, si dhe në referim të përcaktimeve të germës "c" të nenit 96[6] të Kodit të Procedurës Civile, *Kolegji vlerësoi se akti i përfaqësimit të Inspektorit të Lartë Drejtësisë është lëshuar konform ligjit nga ana formale dhe vlerësoi se është dhënë brenda tagrave që i njihen nga ligji drejtuesit të ILD-së.*

11.7 Lidhur me kërkesën e magjistratit për marrjen e disa akteve, të cilat, sipas tij, mungojnë në fashikujt e përcjellë nga KLP-ja, në të cilën pretendon se e ka paraqitur pranë KLP-së më datë 22.1.2022, për dijeni dhe Kolegjin me shkresën nr. {***}, datë 2.2.2022, *rezultoi se gjatë shpjegimeve të përfaqësuesit të KLP-së, në seancën e datës 18.2.2022 në Kolegj, magjistratit i është kthyer përgjigje më shkresën nr. {***}, datë 16.2.2022, dhe ka rezultuar se i është dhënë materiali i kërkuar nga KLP-ja. Kolegji, pasi u njoh me aktin e administruar, vendosi të rrëzojë kërkesën e magjistratit Bujar Memia.*

---

[6] *Si përfaqësues të palëve me prokurë, mund të jenë: a) avokatët; b) bashkëshortët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat; c) juristët dhe punonjësit e tjerë të autorizuar të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë.*

11.8 Më datë 15.3.2022, magjistrati paraqiti kërkesën paraprake me objekt: "Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të vendimit nr. {***}, datë 9 nëntor 2021, për njoftimin e gjykimit të seancës publike", për sa i përket përbërjes së trupit gjykues që do të gjykojë çështjen e juridiksionit disiplinor (JD) nr. 3/2021.

11.8.1 Sipas magjistratit, Kolegji ka disponuar me vendimin për njoftimin e gjykimit në seancë plenare publike, duke përcaktuar dhe përbërjen e trupit gjykues për gjykimin e kësaj çështjeje që duhet të ishte me pjesëmarrjen e plotë të gjithë gjyqtarëve të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, ku Kolegji i Apelimit përbëhet nga 7 gjyqtarë.

11.8.2 Përfaqësuesit e ILD-së dhe KLP-së kërkuan rrëzimin e kësaj kërkese të paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i magjistratit Bujar Memia.

11.8.3 Kolegji, lidhur me këtë kërkesë, vlerëson se, bazuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000, Gjykata Kushtetuese shqyrton në seancë plenare, me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të saj, por në asnjë rast jo më pak se 2/3 e tyre. Me vendimin nr. 13 të datës 7.2.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ka vendosur pezullimin e anëtarit të Kolegjit A. Hajdari, pavarësisht këtij fakti në shqyrtimin e çështjes në seancë plenare të ankimit të magjistratit Bujar Memia, Kolegji ka qenë me pjesëmarrjen e 6 (gjashtë) anëtarëve të tij, çka ka përmbushur kushtin e përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000, atë të pjesëmarrjes së jo më pak se 2/3 së anëtarëve të Kolegjit.

11.9 Magjistrati paraqiti kërkesën për pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje në Kolegj, deri në ushtrimin e kontrollit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, të kërkesës së tij drejtuar kësaj gjykate më datë 8.3.2022, me objekt: *Shfuqizimin e togfjalëshit "ligjin për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të parashikuar në nenin 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

11.9.1 Lidhur me këtë kërkesë, përfaqësuesit e KLP-së dhe ILD-së kërkuan rrëzimin e saj, pasi magjistratit i mungon interesi i ligjshëm për të vënë në lëvizje kontrollin incidental; Gjykata Kushtetuese ka një jurisprudencë tashmë të mirëpërcaktuar, në lidhje me elementet që duhet të plotësojë kontrolli incidental i një norme nga gjykatat e niveleve më të ulëta. Në kërkesë referohen një sërë dispozitash kushtetuese për antikushtetutshmërinë e këtij togfjalëshi, por nuk jepet asnjë argument se cilin nga këto parime kushtetuese ka shkelur ky togfjalësh. Kolegji ka në dispozicion të tij të gjitha instrumentet e nevojshme ligjore për garantimin e një të drejte për një proces të rregullt ligjor dhe ofrimin e të gjithave garancive të magjistratit gjatë shqyrtimit të këtij ankimi. Ligji nr. 84/2016, ashtu edhe ligji nr. 115/2016 janë bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese dhe, me vendimmarrjet përkatëse, e kanë kaluar tashmë testin e kushtetutshmërisë.

11.9.2 *Kolegji, lidhur me këtë kërkesë, çmon se nuk gjendet në kushtet e nenit 145, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kur ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, siç pretendon ankuesi në kërkesën e tij, pasi referuar Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", Kolegji nën dritën e këtyre dispozitave vazhdon procedurën e gjykimit, pavarësisht kërkesës së bërë nga ankuesi pranë Gjykatës Kushtetuese, si në rastin konkret.*

11.10 Me shkresën nr. {***}, datë 5.5.2022, drejtuar Kolegjit, magjistrati Bujar Memia ka depozituar disa akte shkresore[7], të cilat kërkoi të merren në cilësinë e provës.

11.10.1 Kolegji, bazuar në nenet 42, pikat 1 dhe 2 të ligjit 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në nenin 224 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të administrojë aktet e depozituara nga magjistrati Bujar Memia, përfshirë edhe përgjigjen e sjellë nga ShISh, si dhe vendosi rrëzimin e kërkesës së tij që Kolegji të kërkojë informacion shtesë në ShISh, pasi jo vetëm nuk u vlerësua i domosdoshëm dhe i nevojshëm,

[7] *1. Shkresë nr. {***} prot., datë 16.2.2022, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me lëndë "Kthim përgjigje", bashkëngjitur dokumentacioni sipas shkresës.*

*2. Urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr. {***}, datë 14 janar 2020.*

*3. Shkresë nr. {***} prot., datë 21 prill 2022, të Drejtorisë së Shërbimit të Provës për të dënuarin I.P.*

*4. Shkresë nr. {***} prot., datë 21 prill 2022, të Drejtorisë së Shërbimit të Provës për të dënuarin H.B.*

*5. Shkresë nr. {***} prot., datë 8 prill 2022, e Ministrisë së Drejtësisë.*

*6. Shkresë nr. {***} prot., datë 21 prill 2022, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.*

*7. Shkresë nr. {***} prot., datë 28 prill 2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Departamenti i Policisë Kriminale.*

por u konsiderua jorelevant në zgjidhjen e çështjes në shqyrtim.

11.11 Në seancën e datës 9.5.2022, magjistrati Bujar Memia paraqiti kërkesa verbale të njëpasnjëshme, të cilat, në vlerësimin e Kolegjit, *kishin si qëllim zvarritjen e procesit të gjykimit ndaj tij në Kolegj, si më poshtë.*

11.11.1 Pezullimin e këtij gjykimi deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përjashtimin e kryesueses së trupit gjykues, gjyqtares së Kolegjit Albana Shtylla, mbrojtje me tjetër avokat, si dhe shtimin e objektit të ankimit. Kërkesat u paraqitën verbalisht në seancën plenare publike, në të cilën palët ishin njoftuar paraprakisht nga Kolegji për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare.

11.11.2 Përfaqësuesit e KLP-së dhe të ILD-së nuk ishin dakord për pranimin e këtyre kërkesave, por kërkuan rrëzimin e tyre, si kërkesa abuzive, të cilat kishin si qëllim zvarritjen e procesit nga ankuesi Bujar Memia.

11.11.3 Lidhur me kërkesën për pezullimin e gjykimit në Kolegj deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit ndaj tij pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, *Kolegji vendosi mospranimin e kësaj kërkese verbale, pasi çmoi se gjykimi i procedimit disiplinor me procesin e rivlerësimit që zhvillohet ndaj magjistratit pranë KPK-së, janë të ndarë dhe nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin, pasi janë dy juridiksione të ndryshme dhe bërja e kësaj kërkese në këtë moment procedural, në seancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, përveçse u konsiderua se kishte si qëllim zvarritjen e procesit disiplinor ndaj tij, u gjend e pabazuar në ligj dhe në prova.*

11.11.4 Lidhur me kërkesën për përjashtimin e kryesueses së trupit gjykues, gjyqtares Albana Shtylla, e cila u paraqit në formë verbale, pastaj u formalizua me shkresën nr. {***}, datë 13.5.2022, bazuar në nenin 75, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Civile, *Kolegji çmoi se kërkesa për përjashtimin e gjyqtares nuk pezullon gjykimin e çështjes, por gjyqtari nuk do të marrë pjesë në dhënien e vendimit deri në shqyrtimin e kësaj kërkese. Mbledhja e Gjyqtarëve, më datë 24.5.2022, pas shqyrtimit të kësaj kërkese, bazuar në nenin 37 të ligjit nr. 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendosi rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtares së Kolegjit Albana Shtylla nga gjykimi i çështjes.*

11.11.5 Lidhur me kërkesën për shtimin e objektit të ankimit, *Kolegji çmoi se magjistrati nuk specifikoi në mënyrë konkrete se çfarë duhet të shtohet në objektin e ankimit, nuk u paraqit sipas formës së kërkuar nga neni 43, pika 2 e ligjit nr. 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe, për pasojë, nuk u konsiderua dhe nuk u mor parasysh.*

11.11.6 Lidhur me kërkesën verbale të tij për mbrojtjen me avokat, *Kolegji çmon se e drejta e tij për t'u mbrojtur me avokat, i është garantuar përgjatë gjithë procesit disiplinor në Kolegj. Në seancën e fundit, avokati i tij, i pajisur me prokurë të posaçme, u largua nga seanca plenare publike pa dhënë asnjë shpjegim dhe pa vënë në dijeni Kolegjin, mosprania e avokatit në përfundim të procesit gjyqësor ndodhi për shkaqe që varen tërësisht nga magjistrati dhe mbrojtja e zgjedhur prej tij, ndërsa i gjithë shqyrtimi i çështjes në Kolegj është zhvilluar në praninë e mbrojtësit të tij.*

11.11.7 Si përfundim, lidhur me kërkesat verbale të njëpasnjëshme nga ankuesi në seancën plenare publike të datës 9.5.2022, Kolegji çmon se ato kishin për qëllim zvarritjen e procesit disiplinor dhe, si të tilla, nuk u pranuan.

12. Vlerësimi i Kolegjit mbi shkaqet e ankimit të magjistratit Bujar Memia, lidhur me cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe parimit të sigurisë juridike

12.1 Magjistrati Bujar Memia pretendon se vendimi nr. 81, datë 31.3.2021, i KLP-së, është marrë pa pasur një referencë për atë që konsiderohet shkelje disiplinore, pasi neni 102 i ligjit nr. 96/2016 nuk ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar nga KLP-ja. Gjithashtu referon çështjen *Kafkaris kundër Qipros*, ku GjEDNj-ja mban qëndrimin, se: "*Vetëm ligji mund ta përcaktojë një shkelje dhe të parashikojë një penalizim për këtë shkelje (nullum crimen, nulla poena sine lege)*, dhe neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndalon që ligji të shtrijë efektet në kohë për diçka që nuk konsiderohej si shkelje në kohën e kryerjes.".

12.1.1 Në lidhje me këtë pretendim, nga analiza e vendimit të KLP-së, rezulton se ky vendim është bazuar në pikën 2, germa "a" e nenit 148/d të Kushtetutës, prandaj Kolegji vlerëson se ky argumentim është në frymën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 20.2.2006, e cila ka shfuqizuar një pikë të nenit 42 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku ndër të tjera, citohet: *[...] Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi, si dhe organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim rregullohen drejtpërdrejt nga*

Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionin që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria [...]. Shfuqizimi i kësaj dispozite nuk krijon boshllëk ligjor, sepse mund të zbatohet direkt rregullimi i nenit 147/6 të Kushtetutës [...]. Nisur nga këto arsye, Gjykata Kushtetuese konstaton se Kushtetuta nuk ka pasur për qëllim që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë rastet e shkarkimit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 147/6 të saj, sipas të cilit gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte a sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Ndërsa, sa i përket dhënies së masave të tjera disiplinore, neni 147/4 i Kushtetutës ia ka deleguar kompetencat ligjvënësit të zakonshëm, për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit konkret të tyre [...].

12.2 Magjistrati pretendon se nga KLP-ja, në vendimin nr. 81/2021, është aplikuar norma me frymë të përgjithshme kur, në rastin konkret, ligji i posaçëm përfshin aplikimin e normave specifike të posaçme, përbën cenim të sigurisë juridike për subjektin aktual të procedimit dhe për të gjitha subjektet e ardhshme të një hetimi të iniciuar nga ILD-ja.

12.2.1 Kolegji e vlerëson të pabazuar këtë pretendim të kërkuesit, duke e konsideruar të ezauruar dhe shterues shpjegimin e dhënë nga KLP-ja në paragrafin 51 të vendimit të saj, ku citohet: *[…] normalisht dispozita kushtetuese prevalon mbi çdo normë tjetër ligjore, bazuar kjo mbi parimin e hierarkisë së akteve, sanksionuar nga neni 4, pika 2, dhe neni 116, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte kur vetë Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të posaçëm, i ngritur në nivel Kushtetues, i zbatueshëm për rastin në procedim, si dhe bazuar mbi të drejtën e organit procedues për të referuar dhe zbatuar drejtë për drejtë Kushtetutën, vlerësohet se kriteri i përcaktuar në nenin 124 në lidhje me nenin 120, pika 1, shkronja d, të Ligjit për Statusin, konsiderohet i përmbushur, duke legjitimuar verifikimin, hetimin dhe në vijim edhe procedimin disiplinor të magjistratit Bujar Memia [...].*

12.3 Lidhur me pretendimin e magjistratit se ky hetim nuk duhej të fillonte, pasi ligji material ia kufizon fillimin e kësaj procedure, pasi veprimtaria objekt gjykimi nuk konsiderohet shkelje nga ligji material nr. 96/2016, *Kolegji vlerëson se pretendimi i magjistratit nuk qëndron, pasi fillimi i procedurës hetimore të kryer nga ILD-ja është i parashikuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat "b", "ç", "d" dhe "dh". Pra, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka pasur të gjithë kompetencën dhe bazën ligjore për të nisur procedimin disiplinor ndaj ankuesit Bujar Memia.*

12.4 Magjistrati pretendon se kërkesa e ILD-së nr. {***}. prot., datë 15.1.2021, e ILD-së, me lëndë "Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia", është një kërkesë e nxjerrë në tejkalim të afatit ligjor të parashikuar nga vetë ILD, çka ligjërisht, sipas tij, e bën këtë kërkesë absolutisht të paligjshme dhe të pashqyrtueshme nga KLP-ja, pasi, sipas tij, neni 92 i Kodit të Procedurave Administrative nuk parashikon zgjatjen e afatit të procedurave administrative të nisura kryesisht.

12.4.1 *Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se, me vendimin nr. {***}, datë 16.7.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Bujar Memia, në të cilin është përcaktuar afati 4-mujor për kryerjen e hetimit disiplinor dhe hartimin e raportit. Me vendimin nr. {***}, datë 11.11.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas kërkesës së Inspektores së çështjes, ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor me dy muaj të tjerë, vendim i cili i është njoftuar magjistratit Bujar Memia, si dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë me shkresën nr. {***}, datë 11.11.2020. Kolegji vëren se vendimi për zgjatjen e hetimit disiplinor, ka mbështetje ligjore nenin 92 të Kodit të Procedurave Administrative, nen i cili nuk bën përjashtim për rastet e zgjatjes së afatit të hetimeve administrative, aq më tepër që neni 92 i K.PR.A. është pjesë e kreut që trajton përfundimin e procedurës administrative, kapitull i cili nuk bën një ndarje ndërmjet procedurave të nisura kryesisht dhe atyre të nisura me kërkesë. Në përfundim, rezulton se ILD-ja e ka respektuar afatin 6-mujor të hetimit disiplinor të parashikuar në nenin 118 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përpos sa më sipër, zgjatja e hetimeve nuk ka sjellë asnjë pasojë për ankuesin, përkundrazi i ka dhënë atij më shumë kohë që të përgatisë mbrojtjen para këtyre organeve në kuadër të procedimit disiplinor.*

12.5 Sipas pretendimeve të magjistratit, KLP-ja ka shqyrtuar një procedurë të paligjshme, pasi, në arsyetimin e vendimit, nuk gjejnë pasqyrim

pohimet dhe shumica e provave të depozituara prej tij. Sipas magjistratit, gjykata/organi administrativ ka detyrimin ligjor që të mbajë qëndrim për të gjitha provat dhe pohimet gjyqësore, qofshin këto të administruara së bashku me padinë (në kuptimin e nenit 154 e vijues të K.PR.C apo nenit 21 të ligjit nr. 49/2012), apo provave të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu sikurse bazuar në nenin 214 dhe nenin 281 e vijues të K.PR. Civile janë pohimet gjyqësore. Akte provuese, në rastet e vendimeve gjyqësore, objekt të procedimit disiplinor, janë aktet të cilat janë hartuar dhe depozituar në cilësinë e provës (për qëllim të procesit gjyqësor), nga institucione të ndryshme, sikurse IEVP, shërbimi mjekoligjor i IEVP-së, Zyrat e Shërbimit të Provës etj., si dhe palë të treta publike dhe private dhe praktika të shumta gjyqësore.

12.5.1 Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vëren se nga analiza e vendimit të KLP-së, ka rezultuar se janë përfshirë si në pjesën hyrëse dhe arsyetuese, pretendimet dhe argumentet që ka paraqitur magjistrati pranë këtij organi, si dhe janë respektuar në tërësinë e tij, procedurat e një procesi të rregullt ligjor. Konstatohet se më datë 16.3.2021, është zhvilluar nga KLP-ja seanca dëgjimore në të cilën palët kanë paraqitur parashtrimet dhe pretendimet e tyre dhe, dy javë më pas, më datë 31.3.2021, është shpallur vendimi mbi këtë procedim disiplinor. Në këtë mënyrë, rezulton se është respektuar nga KLP-ja parimi i barazisë së armëve, si një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, i cili konsiston kryesisht në depozitimin e provave dhe në të drejtën për të kundërshtuar provat nëpërmjet argumenteve arsyetuese. GJEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj, ka nënvizuar se *detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre, nuk do të thotë dhënie përgjigje për çdo çështje/argument, të ngritur nga pala për të mbështetur mbrojtjen e saj. Fushë veprimi/shtrirja e këtij detyrimi mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit. Për të respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, arsyetimi duhet të demonstrojë që gjyqtari/gjykata ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë ngritur përpara tij/saj*[8], jurisprudencë që duket se ka gjetur zbatim edhe në vendimin e KLP-së objekt shqyrtimi.

12.5.2 Në jurisprudencën kushtetuese[9], është evidentuar dallimi që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në një proces gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet kontrollit të gjykatës, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. *Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete*[10].

12.5.3 Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese[11] e ka pranuar të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar, si elemente të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, duke i trajtuar këto të drejta të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. *Këto dy të drejta, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që para marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht mbi thelbin e çështjes. Në këtë mënyrë, garantohet edhe zbatimi i një parimi thelbësor në procesin gjyqësor, ai i kontradiktoritetit. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklarimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore. Kushdo, qoftë në procesin penal, qoftë në procesin civil, duhet të ketë mundësinë t'i paraqesë gjykatës, në mënyrën e duhur, çështjen e vet, në kushte që nuk e vendosin atë në situatë dukshëm të pafavorshme në raport me palën kundërshtare.*

12.6 Magjistrati pretendon se vendimi nr. 81, datë 31.3.2021, i KLP-së është në kundërshtim me praktikën e GJEDNJ-së, e cila ka mbajtur qëndrim edhe ndaj Shqipërisë në rastet e cenimit të një procesi të rregullt ligjor, kur në çështjen *Alimuça kundër Shqipërisë* ka disponuar se: *[...] Gjykata fillimisht rithekson se, si rregull, u takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat para tyre, të konstatojnë faktet dhe të interpretojnë ligjin e brendshëm [...].* Në këtë

[8] *Shih çështjet Boldea kundër Rumanisë, 15 shkurt 2007 § 29 dhe Helle kundër Finlandës, 19 shkurt 1997, § 60. Në çështjen Jahnke dhe Lenoble vs. Francës*[8]*, aplikimi nr. 40490/98, GJEDNJ-ja ka cituar: "Nëse shikohet se qëllimi i procesit gjyqësor dhe vendimit është që t'u tregojë palëve se ata janë dëgjuar, atëherë arsyetimi i vendimit nuk duhet bërë nga gjykata në mënyrë të detajuar, për çdo pretendim dhe argument të paraqitur nga palët".*

[9] *Vendimi nr. 1, datë 12.1.2007, i Gjykatës Kushtetuese.*

[10] *Vendimi nr. 9, datë 26.2.2015, i Gjykatës Kushtetuese.*

[11] *Vendimi nr. 12, datë 6.6.2005, i Gjykatës Kushtetuese.*

kontekst, nisur nga qëndrimi i mbajtur nga KLP-ja në vendim, sipas magjistratit, rezulton se gjykata vendase (KLP, në këtë rast) ka mbajtur vetëm një qëndrim sipërfaqësor në lidhje me procedurën e hetimit disiplinor, realizuar nga ILD-ja dhe, nga ana tjetër, nuk ka mbajtur asnjë qëndrim të konsoliduar për pohimet dhe provat e paraqitura (para KLP-së) nga magjistrati, duke cenuar në këtë mënyrë nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "Konventa"), për një proces të rregullt ligjor.

12.6.1 Lidhur me këtë pretendim, referuar nenit 6/1, parimeve të GJEDNJ[12]-së, Kolegji vlerëson se detyrimi i gjykatës është të krijojë barazinë, kushte të njëjta palëve në proces. Në vendimin nr. 7/2000 të Gjykatës Kushtetuese, është vlerësuar se *analiza e provave të administruara gjatë gjykimit ose mënyra e vlerësimit të tyre janë e drejtë ekskluzive e gjykatave të zakonshme, pasi vetëm gjykatat më të larta mund të shqyrtojnë bazueshmërinë në ligj e në prova të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta. Vlerësimi i marrjes së provave nuk bën pjesë në gjykimin kushtetues. Shkelja e parimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor nuk varet nga zbatimi i ligjit material, as nga mënyra e vlerësimit të provave. GJK-ja nuk ka për detyrë të kontrollojë vendimet e gjykatave të zakonshme nga pikëpamja e bazueshmërisë së tyre në prova.*

12.6.2 Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se nuk jemi në kushtet kur është cenuar neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili, ndër të tjera, citon, se: *"[...] Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]"*. Magjistrati është dëgjuar para organit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (organ tërësisht i pavarur i krijuar me ligj), në një seancë publike, brenda një afati plotësisht të arsyeshëm. Kolegji çmon se pretendimet e magjistratit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, janë të pabazuara.

12.7 Magjistrati pretendon se KLP-ja, në vendimmarrjen e saj, nuk e ka mbështetur vetëm në rastet e ngritura në kërkesën nr. {***} prot., datë 15.1.2021, të ILD-së, por e ka zgjeruar hetimin në 10 (dhjetë) vendime, të cilat jo detyrimisht kanë koneksitet me 4 çështjet e ngritura nga ILD-ja. Në këtë kontekst, vendimi i KLP-së është në tejkalim të parashikimeve të nenit 612 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se gjykata duhet të shprehet për atë që kërkon pala që e ka investuar Gjykatën dhe vetëm për atë kërkim, që në rastin konkret janë 4 (katër) çështjet dhe vendimet e lidhura pazgjidhshmërisht me këto 4 (katër) çështje. Nisur nga sa më sipër, magjistrati pretendon se vendimi nr. 81, datë 31.3.2021, i KLP-së është një vendimmarrje e marrë në kundërshtim me ligjin procedural civil, ligjin procedural administrativ dhe me ligjin nr. 49/2012 dhe, si i tillë, duhet shfuqizuar kërkesa e ILD-së si e pabazuar në ligj dhe në prova.

12.7.1 Lidhur me këtë pretendim të magjistratit, nga analizimi i vendimit të KLP-së, rezulton se janë marrë për analogji disa vendime gjyqësore për të arritur në një konkluzion sa më të saktë lidhur me sjelljen e prokurorit, në të cilat magjistrati ka qenë përfaqësues i akuzës. Kjo është bërë me qëllimin për të treguar sjelljen dhe inkoherencën e mbajtur në qëndrime nga ana e prokurorit, si dhe për t'iu referuar vendimeve gjyqësore që ndodheshin në dosjet e trajtuara nga ana e magjistratit. Nuk rezulton që këto vendime që pretendon magjistrati, të jenë marrë në konsideratë në vendim nga KLP-ja. Në pjesën arsyetuese të vendimit të KLP-së, analizohen vetëm 4 katër vendimet penale te gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë, objekt hetimi në ILD, shqyrtimi në KLP dhe në Kolegj.

12.8 Magjistrati, në ankimin e paraqitur në Kolegj, ka kërkuar që në përputhje me nenin 44 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, të riçelë hetimin gjyqësor dhe të marrë në cilësinë e provës: a) kthim-përgjigjet nga organet publike, konkretisht nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, Tiranë, Kuvendi i RSh për mbledhjen e Komisionit të ligjeve të datës 25.3.2021, procesverbalin e seancës të KLP-së; b) artikull në median elektronike, gazeta Panorama; c) artikull në median elektronike, gazeta *Shqiptarja.com*; d) artikull në median elektronike, A2News; dh) vendim nr. {***}, date 21.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë; e) planifikimi i punimeve

[12] *"Neni 6 garanton të drejtën për një proces të rregullt, por nuk përcakton rregullat për pranimin e provave si të tilla, çështje e cila i përket kryesisht rregullimit sipas legjislacionit të brendshëm" (shih Schenk kundër Zvicrës, 12 korrik 1988, § 45).*

të Kuvendit për periudhën 1–26 mars 2021; e) programi i punës i Komisionit të Ligjeve pranë Kuvendit për periudhën 19–30 mars 2021. Gjithashtu, për realizimin një procesi hetimor gjyqësor shterues ankuesi kërkoi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit që të thirren në cilësinë e dëshmitarëve prokurorët të cilët kanë përfaqësuar akuzën në lidhje me kërkesën për lirim para kohe me kusht për arsye shëndetësore të të dënuarit I.P.

12.8.1 Në përgjigje të këtij pretendimi, *Kolegji vlerëson se aktet e sipërcituara që kërkohen të merren si provë shkresore apo persona në cilësinë e dëshmitarëve, nuk përcjellin informacion thelbësor në kuptim të ligjit procedural që do të ndihmonin Kolegjin në zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes. Në këtë qëndrim, argumenton dhe GJEDNJ, konkretisht në çështjen "Caka kundër Shqipërisë": "[...] Zakonisht, u takon gjykatave vendase të vendosin nëse është e nevojshme, ose e këshillueshme, që të dëgjohet një dëshmitar i caktuar. Neni 6§3 (d) nuk kërkon pjesëmarrjen dhe shqyrtimin e çdo dëshmitari në emër të të akuzuarit: qëllimi i tij thelbësor, siç tregohet përmes formulimit "nën të njëjtat kushte", është ofrimi i "barazisë së armëve" për çështjen në fjalë.*

12.9 Magjistrati pretendon se KLP-ja nuk ka mbajtur asnjë qëndrim në lidhje me veprimtarinë e ILD-së dhe inicimin e një hetimi me iniciativë, pa pasur bazueshmërinë ligjore. Faktet e pretenduara si shkelje të rënda profesionale, përbëjnë haptazi një cenim të sigurisë juridike të veprimtarisë së magjistratit, çka provon, sipas tij, se vendimi i KLP-së është një vendimmarrje e marrë në kundërshtim të hapur me parimin e një procesi të rregullt ligjor sipas praktikës së brendshme dhe ndërkombëtare të detyrueshme për organet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

12.9.1 Kolegji vlerëson se pretendimi i ankuesit është i pabazuar pasi në vendimin KLP-së, gjendet i arsyetuar argumenti lidhur me bazën ligjore të përdorur nga ILD-ja: *Duhet të theksohet se ndonëse pika 2 e nenit 101 të Ligjit për Statusin është ndryshuar me ligjin nr. 48/2019 dhe nuk ka qenë në fuqi në kohën kur kanë ndodhur faktet objekt procedimi disiplinor, ato do të merren në analizë, me qëllim që subjekti i procedimit disiplinor, prokurori Bujar Memia, të mos gjendet në një pozitë më pak të favorshme se çdo prokuror tjetër, veprimet/mosveprimet e të cilit mund të jenë kryer pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 48/2019.*

12.9.2 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut[13] ka theksuar se: *detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë" [...] "arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës".*

12.10 Sipas magjistratit, veprimtaria antikushtetuese e ILD-së është pranuar pa asnjë argumentim ligjor nga KLP-ja në vendimin e saj, ku qartazi pasqyrohet fakti se KLP-ja ka keqinterpretuar "parimin e specialitetit" dhe konceptin e "rezervës ligjore absolute".

12.10.1 KLP-ja, në vendim, argumenton se: *[...] parimi i specialitetit do aplikohej nëse do të kishim konflikt ndërmjet një ligji specifik dhe një ligji të përgjithshëm. Në këtë rast nuk mund të kemi konkurrim ndërmjet një norme kushtetuese dhe një norme ligjore. Në rastin konkret jemi përpara një norme kushtetuese që rregullon në mënyrë specifike këtë çështje, si dhe vakumit ligjor i cili është shkaktuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2016. Kushtetuta, si dhe legjislacioni në fuqi nuk përcaktojnë në mënyrë shteruese se cilat janë shkeljet të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit, gjatë ushtrimit të detyrës. Mbetet detyrë e organit procedues (në varësi të fazës në të cilën ndodhet procedura disiplinore) të përcaktojë rast pas rasti nëse veprimet apo mosveprimet analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte [...].* Këto shkelje marrin karakterin e "rëndë" të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëzgjatjen e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur (vendimi 75/2002 Gjykatës Kushtetuese).

[13] *Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105–106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51.*

12.10.2 *Pas vlerësimit të pretendimeve të magjistratit, Kolegji çmon se mungesa e parashikimeve ligjore nuk mund të sjellë mungesën e ushtrimit të kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve nga organi i parashikuar me ligj dhe nga ana tjetër, nuk mund të përdoret nga magjistrati si shkak për të mos përmbushur funksionin e tij në mënyrë të rregullt apo për të kryer shkelje profesionale të natyrës që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.*

12.11 Magjistrati pretendon se një element tepër i rëndësishëm i mbrojtur nga neni 6 i Konventës në kontekstin e një procesi të rregullt ligjor, është edhe ekzistenca e një gjykate të pavarur, e cila merr vendime pa pasur ndikimin e palëve apo e institucioneve të treta, ndërkohë që qartazi sipas tij, rezulton se vendimi i KLP-së është një vendimmarrje e cila është ndikuar pazgjidhshmërisht nga faktorët polikë dhe qëndrimet e mbajtura nga përfaqësues të partive politike në favor të ILD-së.

12.11.1 Lidhur me këtë pretendim, Kolegji nënvizon se KLP-ja është një institucion kushtetues i pavarur ku, referuar nenit 149 të Kushtetutës: *Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. 2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë. 3. Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga radhët e prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë. Anëtarët joprokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.* Për sa i përket pretendimit mbi cenimin e parimit të paanshmërisë së KLP-së, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese, edhe nën dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së, ka analizuar dhe ka dhënë përkufizimet e nevojshme mbi nocionin "*gjykatë e paanshme*", duke theksuar se ky parim ka të bëjë kryesisht me përbërjen e trupit gjykues.

12.11.2 Sa më sipër, Kolegji e gjen të pabazuar dhe të paargumentuar pretendimin për ndikim politik nga këto organe, pasi nuk konstatohet në asnjë moment procedural apo veprim të kryer gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por mbetet vetëm në supozimin deklarativ të ankuesit.

12.12 Në vijim, magjistrati ka pretenduar se vendimi i KLP-së është marrë në kundërshtim me nenin 14 të Konventës, praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së[14] (në çështjen *Beian kundër Rumanisë*, gjykim i vitit 2008,) provuar kjo nga qëndrimi diskriminues i KLP-së, lidhur ***me*** argumentimin se marrja e provës me ekspert ka qenë detyrim i magjistratit si përfaqësues i organit të akuzës në vendimin nr. {***} akti, *datë 6 nëntor 2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë,* bie ndesh me qëndrimin e mbajtur nga KLP-ja në një çështje të ngjashme[15], konkretisht në vendimin nr. {***} prot., datë 17.11.2020.

12.12.1 *Kolegji çmon se në referim të rasteve dhe çështjeve të tjera të trajtuara nga KLP-ja, nuk mund të bëhet paralelizëm apo të analizohen vendime të marra në kontekste të ndryshme. Nuk mund të gjykohet dhe arrihet në përfundimin se janë mbajtur qëndrime të ndryshme nga ana e një organi vendimmarrës, kur rastet, rrethanat dhe motivet, edhe pse në dukje të ngjashme, mund të jenë të ndryshme në themel të çështjes, për shkak të individualitetit, referuar jurisprudencës së Kolegjit, por dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese[16] mbi trajtimin e këtyre rasteve.*

---

[14] *[...] Në vend që të përmbushte detyrën që të vendoste një interpretim të unifikuar, i cili duhet të udhëhiqet nga subjektet, gjykata u bë vetë një shkaktare e pasigurisë juridike, duke mbajtur qëndrime të ndryshme për raste të ngjashme, në këtë mënyrë duke ulur besimin e publikut në sistemin e drejtësisë [...].*

[15] *[...] Për sa i përket gjykatës, mosveprimi i prokurores nuk ka asnjë ndikim për arsyen se është gjykata ajo që drejton dhe administron seancën gjyqësore, që ka marrë në dorëzim dhe ka vlerësuar provat [...] prokurori vërtet është organi procedues gjate fazës së hetimeve paraprake, por jo në gjykim [...] thënë më thjesht organi procedues është ai organ i cili drejton procedurën në një fazë konkrete të procesit [...] vlerësohet se si organ procedues, i përket gjykatës e drejta për të marrë iniciativën për kryerjen e ekspertimit pavarësisht qëndrimit të prokurorit në seancë, detyrim ky i përcaktuar dhe në parashikimet e neneve 43, 44, 46 të K.PR. Penale [...], gjithashtu, mosveprimi i prokurores, konsideruar si shkelje e procedurave të gjykimit në një gjykim të rregullt, mendojmë se nuk ka ndikim në vendimmarrjen e gjykatës [...].*

[16] *Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 71, datë 2.12.1998 [...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk duhet kuptuar se për çështje gjyqësore të pretenduara identike, të ketë zgjidhje të njëllojta nga gjykatat. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar me rrethana, faktorë, motive apo prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë absolutisht të njëjta. [...] Barazia në ligj dhe para ligjit nuk ka të*

12.12.2 *Kolegji vëren se neni 14 i Konventës parashikon se: "Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër" – dhe nga shqyrtimi i vendimit të KLP-së, nuk konstatohet ndonjë qëndrim diskriminues gjatë vendimmarrjes ndaj ankuesit. Sa më sipër, rezulton se nuk janë cenuar apo shkelur parimet e Konventës dhe konkretisht neni 14 i saj e, për rrjedhojë, këto konstatime të magjistratit mbeten në kuadrin deklarativ, të pambështetura në ndonjë fakt konkret.*

12.12.3 Ky argumentim mbështetet edhe nga praktika e GJEDNJ-së, konkretisht në çështjen *Tomić dhe të tjerët kundër Malit të Zi,* ku ndër të tjera citohet: "*Gjykata përsëriti se nuk i përket asaj të vërë në pikëpyetje interpretimin e ligjit të brendshëm nga gjykatat vendase. Gjithashtu, në parim, nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendase, edhe nëse ato jepen në procese dukshëm të ngjashme; ajo duhet të respektojë pavarësinë e këtyre gjykatave vendase. […] Së fundmi, është pranuar se trajtimi i ndryshëm i dy mosmarrëveshjeve nuk mund të konsiderohet se shkakton konflikt në praktikën gjyqësore, kur kjo justifikohet nga një ndryshim në situatat faktike në fjalë.".*

12.13 Sipas magjistratit, KLP-ja nuk ka pasur për qëllim të barazojë pozitën e magjistratit Bujar Memia, por ta diskriminojë atë në raport me rastet e tjera, pasi nëse KLP-ja do të çmonte ligjin e aplikueshëm *de jure* dhe *de facto,* do të analizonte veprimtarinë e magjistratit, mbështetur në kriteret që parashikon neni 115, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, kurse në fakt ka bërë pikërisht të kundërtën, duke mos i marrë në analizë këto kritere ligjore. KLP-ja, në të vërtetë, ka prodhuar diskriminim, në kundërshtim me atë çka paraqet në pikën 57 të vendimit, pasi edhe në eventualitetin që shkeljet disiplinore qëndrojnë, masa e caktuar është në disproporcion me kriteret e nenit 115, pika 1 e ligjit nr. 96/2016.

12.13.1 *Kolegji çmon se pretendimi i magjistratit është i pasaktë dhe i pabazuar, pasi, nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, në paragrafët 58, 59 dhe 60 të tij, arsyetimi i KLP-së është mbështetur pikërisht në parashikimet e germës "a", pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, Këshilli merr parasysh këto kritere: a) llojin dhe rrethanat e shkeljes. Në analizë të kriterit "lloji dhe rrethanat e shkeljes" në raport me faktet e provuara gjatë procedimit disiplinor, rezulton se pas një vlerësimi të hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, konstatohet se në rastin konkret, nga ana e magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor, Bujar Memia, janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë të bëjnë me: "Mospërmbushjen e pajustifikuar të funksioneve gjatë gjykimit, mosveprim e sjellje të magjistratit që ka sjellë përfitim të padrejtë për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin si dhe mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural".*

12.14 Magjistrati gjithashtu pretendon se në materialin e ILD-së nuk citohet në asnjë moment konflikti i interesit ndërmjet anëtarëve të KLP-së dhe të ILD-së, pasi në dijeninë e tij, 3 (tre) prej anëtarëve të KLP-së, E.K., K.B. dhe E.G., në momentin e shqyrtimit të kërkesës së ILD-së, kanë qenë subjekte të procedimeve disiplinore të ILD-së. Lidhur me këtë fakt, magjistrati, me shkresën e datës 26.11.2021, i është drejtuar subjektit të interesuar ILD, mbi vendimmarrjet për këto procedime disiplinore në ngarkim të tre anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

12.14.1 Lidhur më këtë pretendim, përfaqësuesit e ILD-së kanë dhënë shpjegime gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore në Kolegj, duke konfirmuar faktin se ndaj tre anëtarëve të KLP-së, nuk ka asnjë vendim për fillimin e hetimit disiplinor, gjithashtu ky fakt konfirmohet me shkresën nr. {***}, datë 17.1.2022, "Kthim përgjigje" të ILD-së, ku sqarohet se nuk ka asnjë vendimmarrje nga ana e këtij institucioni, lidhur me vendimmarrjet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për tre anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

12.14.2 *Në vështrim të dispozitave ligjore që parashikojnë rastet e përjashtimit të anëtarëve të KLP-së dhe konfliktin e interesit, vëren se në nenin 171 të ligjit nr. 115/2016, parashikohet, se "Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhjen e komisionit ose në mbledhjen plenare, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, është i detyruar për sa më poshtë: a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës; b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse; c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.". Kurse neni 172 i këtij ligji*

bëjë me mënyrën se si është zgjidhur çështja në themel, por me garancitë ligjore, me të drejtat që shteti ka vënë në dispozicion të qytetarëve të tij për zgjidhjen e problemeve të tyre [...].

sanksionon rastet e papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në procedim "Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një prokurori, si në komisionin disiplinor, ashtu dhe në mbledhjen plenare, kur ai ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen që është objekt i procedimit disiplinor, për shkak të cilësisë si gjyqtar, prokuror, inspektor, dëshmitar, përfaqësues i palëve, ekspert ose në çdo cilësi tjetër", ndërsa neni 174[17] *ka përcaktuar rastet e heqjes dorë të anëtarit të KLP-së nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një prokurori. Gjithashtu, referuar nenit 7 të rregullores*[18] *"Mbi funksionimin e Komisionit Disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", miratuar nga* Këshilli i Lartë i Prokurorisë me *vendimin nr.* {***}*, datë 17.11.2020, janë përcaktuar rastet kur anëtari i KLP-së nuk merr pjesë në diskutimin ose votimin e çështjes përkatëse në Komision dhe në Këshill, kur vihet në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten, lidhur me një çështje të rendit të ditës, në përputhje me nenet 172, 173, 174, 175 të ligjit 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".*

12.14.3 Kolegji, duke vlerësuar sa më sipër, si dhe duke marrë në konsideratë shkresën nr. {***}, datë 17.1.2022, "Kthim përgjigje" të ILD-së, vlerëson se nuk ekzistojnë pengesa ligjore të tilla si konflikti i interesit ose pengesa të tjera në zbatim të ligjit për konfliktin e interesave ose të Kodit të Procedurave Administrative, që mund të sillnin si pasojë përjashtimin apo heqjen dorë të ndonjë anëtari të KLP-së në procedimin disiplinor ndaj magjistratit, për rrjedhojë, e gjen të pabazuar pretendimin e ankuesit për ekzistencën e konfliktit të interesit për tre anëtarët e KLP-së.

12.15 Kolegji vlerëson se në tërësinë e tij, nga ana e KLP-së, janë respektuar standardet dhe elementet e një procesi të rregullt ligjor, magjistrati është dëgjuar në një seancë publike, ka paraqitur mbrojtjen dhe provat e tij, vendimmarrje kjo në harmoni dhe me praktikën e GJEDNJ-së[19].

13. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me vendimet penale objekt shqyrtimi në KLP

13.1 Vendimi nr. {***} akti, datë 6.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë

13.1.1 Me vendimin nr. {***} akti, datë 6.11.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë është aplikuar dënimi alternativ "Qëndrim në shtëpi", parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, duke vendosur: *Pranimi i kërkesës. Aplikimin e dënimit alternativ "Qëndrim në shtëpi" për kërkuesin I.P. për pjesën e mbetur të dënimit prej 1 (një) viti, 8 (tetë) muajsh dhe 9 (nëntë) ditësh burgim duke e vënë në provë për një periudhe kohore prej 1 (një) viti dhe 8 (tetë) muajsh. Të lejohet kërkuesi I.P., që të largohet nga banesa e tij për plotësimin e nevojave të domosdoshme e konkretisht të trajtimeve dhe shërbimeve shëndetësore, kjo referuar dhe raportit të vlerësimit, datë 12.10.2017, të Shërbimit të Provës. Urdhërohet i dënuari I.P. që gjatë kohës së qëndrimit në shtëpi, t'i raportojë rregullisht Shërbimit të Provës. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit I.P., nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë për ekzekutimin e këtij vendimi.*

13.1.2 Nga shqyrtimi i akteve, KLP-ja ka konstatuar se gjykimi i kësaj çështjeje është

[17] *"[...] a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet ose promovohet, transferohet ose komandohet, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën; b) kur mbrojtësi a përfaqësuesi i subjektit të procedimit administrativ është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij; c) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet apo promovohet, transferohet ose komandohet; ç) kur ai ose ndonjë nga të afërmit e tij ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij është dëmtuar nga veprimet ose aktet e subjektit të procedimit, të cilat janë bërë shkas për fillimin e procedimit disiplinor; d) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit /bashkëjetuesit ka bërë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesën, hetimi i së cilës ka çuar në fillimin e procedimit disiplinor".*

[18] *Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose komisionit, në rastin kur: a) anëtari ka paraqitur tek ILD-ja kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor; b) ka marrë vendim si anëtar i komisionit të përkohshëm, për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të arkivimin ose pushimin e hetimit, ndaj një prokurori, sipas parashikimit të nenit 160, pika 13 e ligjit "Për qeverisjen". Në rastet e konfliktit të interesit, sipas nenit 174 të ligjit "Për qeverisjen", anëtari kërkon heqjen dorë nga diskutimi ose votimi.*

[19] *Çështja Golder k. Mbretërisë së Bashkuar, 21 shkurt 1975 – "[...] do të ishte e pakuptimtë që neni 6/1 i Konventës të përshkruante me detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve në proces dhe të mos mbronte në radhë të parë atë që bën në të vërtetë të mundur që të përfitohet nga këto garanci: pra, pjesëmarrjen në gjyq dhe dëgjimin nga gjykata". Çështja Axen k. Republikës Federale të Gjermanisë – "[...] Seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Karakteri i hapur i procedimeve para organeve gjyqësore, sipas nenit 6/1 të Konventës, mbron palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike. Publiciteti në ushtrimin e drejtësisë, kontribuon në përmbushjen e synimit për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike".*

zhvilluar me pjesëmarrje të prokurorëve B. C. (në seancat e datës 8.9.2017, 20.9.2017), F.B. (në seancat e datës 12.10.2017, 16.10.2017) dhe në fund të prokurorit Bujar Memia (në seancat e datës 3.11.2017 dhe 6.11.2017), deri në dhënien e vendimit nr. {***} akti, datë 6.11.2017. Prokurori Bujar Memia është paraqitur në seancën e datës 3.11.2017, në të cilën është pyetur përgjegjësi i shërbimit shëndetësor në IEVP, lidhur me gjendjen shëndetësore të kërkuesit I.P., si dhe është administruar raporti i shërbimit të provës dhe i provave të tjera shkresore.

13.1.2.1 KLP-ja ka arritur në përfundimin se në çështjen gjyqësore për të cilën është dhënë vendimi nr. {***} akti, datë 6.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për aplikimin e dënimit alternativ, parashikuar nga neni 59/a, shkronja "c" e Kodit Penal, *nuk është paraqitur kërkesë për prova nga prokurori dhe as është administruar një provë vendimtare për zgjidhjen e çështjes, e cila për nga natyra e saj, kërkon vlerësim të posaçëm nga ekspertë të fushës, ndërsa mosushtrimi edhe i ankimit nga ana e prokurorit, ka sjellë që zgjidhja e çështjes nga pikëpamja e provueshmërisë të mos i nënshtrohet kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, sjellje e cila tregon se prokurori nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale. Me anë të sjelljes dhe qëndrimit të tij, prokurori nuk ka mbikëqyrur nëse aplikimi i këtij dënimi alternativ gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal të caktuar për të dënuarin I.P., ka qenë nga pikëpamja e provueshmërisë në përputhje me parashikimet e ligjit material, nenit 59/a, shkronja "c" e Kodit Penal.*

13.1.2.2 Në vendim e KLP-së, është arsyetuar se dënimi alternativ, "Qëndrimi në shtëpi", është një formë e re e vuajtjes së dënimit me burgim, e parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, shtuar me nenin 2 të ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë". Kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet kur plotësohen njëkohësisht dy kushte: *Së pari,* kur të dënuarit i kanë mbetur për të vuajtur jo më shumë se dy vjet burgim, sipas një vendimi të dhënë më parë për një periudhë më të gjatë se dy vjet burgimi. *Së dyti*, gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezulton se ekziston një nga rrethanat vijuese. Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut, gjykata ka detyrimin ligjor të shqyrtojë gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit për të vendosur më pas sipas rregullave të parashikuara në ligj. Në gjykimin e kësaj çështjeje, gjykata duhej të ezauronte nga pikëpamja e provueshmërisë, plotësimin e njëkohshëm të parashikimeve të kësaj dispozite: *kushtet e rënda shëndetësore të të dënuarit; kushtet shëndetësore të jenë të natyrës që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor; ky kujdes i vazhdueshëm shëndetësor kërkohet jashtë burgut, pra që nuk mund të ofrohet brenda spitalit të burgut.*

13.1.2.3 KLP-ja gjithashtu në vendimin e saj, ka sqaruar se: *Raporti i Shërbimit të Provës është provë e cila sigurisht që ka vlerën e vet në kuadër të të gjitha provave të marra në gjykime të këtij lloji, referuar nenit 59/a të Kodit Penal dhe dispozitave të posaçme të ligjit, nr. 1024, datë 27.11.2008, "Për ekzekutimin e dënimeve penale", por në asnjë rast ai nuk zëvendëson mendimin e specializuar të ekspertëve të fushës për gjendjen shëndetësore të të dënuarit dhe për të vlerësuar nëse kujdesi i vazhdueshëm shëndetësor ndaj të dënuarit mund të jepet në kushtet e burgut apo vetëm jashtë tij ... të dhënat e administruara vërtetojnë problemet shëndetësore të të dënuarit, por jo impaktin që ato kanë në jetën dhe shëndetin e tij. Këto të dhëna nuk provojnë pamundësinë e dhënies së kujdesit të vazhdueshëm ndaj tij brenda spitalit të burgut. Të gjitha këto dokumente të cilat janë marrë në shqyrtim dhe vlerësuar nga gjykata, janë indicie dhe nuk përbëjnë provë në kuptimin që i jep ligjvënësi në dispozitën e nenit 149 të K.PR. Penale, i cili parashikon: "Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij".*

13.1.3 Magjistrati Bujar Memia pretendon në ankim se vetë dispozita ligjore, neni 59/a i Kodit Penal, nuk kërkon kryerjen e një akti ekspertimi mjekoligjor për zbatimin e masës alternative të "Qëndrimit në shtëpi". Gjendja e rëndë shëndetësore dhe nevoja e kërkuesit për kujdes të vazhdueshëm jashtë IEVP-së, mund të konkludohet në gjykim, edhe në mungesë të kryerjes së aktit të ekspertimit mjekoligjor, siç janë provat shkresore, provat shkencore dhe ato me dëshmitarë, duke u vlerësuar nga gjykata sipas nenit 152/1 të Kodit të Procedurës Penale, në harmoni me të gjitha provat e tjera, fakt ky i pranuar edhe nga praktika gjyqësore e të gjitha gjykatave të vendit dhe e të gjitha shkallëve të gjyqësorit, ku në shumë raste, gjendja shëndetësore e të dënuarit në rastin e

zbatimit të masës alternative të "Qëndrimit në shtëpi", e parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, është nxjerrë edhe nga akte dhe prova të tjera, duke përjashtuar kryerjen e një akti ekspertimi mjekoligjor.

13.1.3.1 Lidhur sa me sipër, Kolegji çmon se magjistrati ka kryer shkelje procedurale që konsistojnë në qëndrimin e mbajtur në seancë gjyqësore; mosparaqitja e pyetjeve në mënyrë të plotë dhe ezauruese, drejtuar përfaqësuesit të IEVP-së, mosparaqitja e kërkesave procedurale për marrjen e provave vendimtare për zgjidhjen e drejtë të çështjes, sipas parashikimeve të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht neneve 178 dhe 366 të këtij kodi, për të përcaktuar në mënyrë të saktë gjendjen shëndetësore të të dënuarit. Magjistrati nuk duhet të ishte mjaftuar vetëm me provat e paraqitura nga i dënuari, por duhet të kishte bërë kërkesa për të evidentuar fakte të drejta lidhur me gjendjen shëndetësore të të dënuarit, në përputhje me parashikimet e kërkuara nga neni 59/a i Kodit Penal.

13.1.3.2 Magjistrati, me qëndrimin e tij pasiv në këtë gjykim, nuk ka ndërmarrë veprime procedurale për të evidentuar gjendjen shëndetësore të të dënuarit, duke mos i kërkuar gjykatës kryerjen e një akt ekspertimi nga mjekë specialistë të fushës, të autorizuar nga ligji për kryerjen e një akti ekspertimi.

13.1.3.3 Kolegji çmon se nga magjistrati nuk është marrë parasysh në trajtimin e çështjes, prova e administruar në dosjen gjyqësore, shkresa, *informacion mbi gjendjen shëndetësore të të dënuarit,* e hartuar dhe e nënshkruar nga përgjegjësi i shërbimit shëndetësor të IEVP-së, i cili garantonte përkujdesje mjekësore maksimale për të dënuarin I.P.

13.1.4 Lidhur me pretendimin e magjistratit se KLP-ja injoron dokumentin parlamentar të datës 21.11.2019, të nënkomisionit për të drejtat e njeriut ku pasqyrohen problematikat e konstatuara dhe rekomandimet e dhëna nga Këshilli i Evropës në funksion të nenit 3 të Konventës, ku Komiteti i Këshillit të Evropës për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor rekomandon për IEVP Fushë-Krujë këto problematika: *mbipopullim në këtë IEVP, mungesë të furnizimit me ujë e drita në mënyrë të vazhdueshme, marrje të masave të menjëhershme për sigurimin e mjekut me kohë të plotë në institucion, marrjen e masave nga stafi shëndetësor për përgjigjen në kohë të kërkesave të të dënuarve në lidhje me vizitat mjekësore dhe konsultat në qendra spitalore.*

13.1.4.1 Kolegji çmon se ky raport nuk ka vlerë provuese për çështjen objekt gjykimi, pasi është një raport monitorues mbi situatën e IEVP-ve në Republikën e Shqipërisë dhe jep rekomandime të përgjithshme për marrjen e masave organizative për përmirësimin e kushteve në këto institucione. Në këtë kuptim, problematikat e konstatuara nga ky raport nëpër IEVP nuk mund të përdoren si argumente për të justifikuar shkeljen e dispozitave procedurale penale nga ana e magjistratëve.

13.1.5 Për sa u përket gjykimeve penale-administrative, me objekt "Qëndrimin në shtëpi", sipas magjistratit, ka shërbyer praktika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, kështu në vendimin e saj të datës 16.2.2015, ku si provë për të përcaktuar respektimin e germës "c" të nenit 59/a të Kodit Penal kanë shërbyer kartela klinike e të dënuarit, dokumentet e tjera shëndetësore, si dhe pyetja e përgjegjësit të sektorit shëndetësor pranë IEVP-së Krujë.

13.1.5.1 Kolegji çmon se pretendimi i magjistratit është i pabazuar në kushtet kur ekzistonin praktika të konsoliduara lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit në çështje të ngjashme dhe për mënyrën e trajtimit të këtyre kërkesave. Magjistrati duhej të referohej në normat kushtetuese, në ligjin e posaçëm dhe në udhëzimet që gjenden në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë.

13.1.6 Magjistrati pretendon gjithashtu se nuk është bërë e mundur marrja e një prove vendimtare, siç është ajo e ekspertimit mjekoligjor, pasi nga rrethanat e faktit, rezulton se në momentin që ai ka përfaqësuar organin e akuzës, kishte kaluar momenti procedural i parashikuar nga neni 356 i K.PR. Penale.

13.1.6.1 Kolegji, bazuar ne aktet e administruara ne fashikull, si dhe duke analizuar vendimin e KLP-së, vëren se nuk kishte kaluar faza procedurale e parashikuar nga neni 356 i K.PR. Penale për paraqitjen e kërkesave për marrje prove nga palët në proces, për arsye se në të njëjtën seancë, avokati i kërkuesit ka paraqitur si provë të re dinamikën e vuajtjes së dënimit, dhe magjistrati ka qenë dakord me administrimin e tyre, prandaj rezulton se ky shkak ankimor nuk është i bazuar.

13.1.7 Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë për të dënuarin I.P., ka rezultuar se drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë aktin "Udhëzim", lidhur me vendimin gjyqësor nr. {***} akti, datë 6.11.2017, për të dënuarin I.P., në të cilin ka vlerësuar se në çështjen konkrete, vendimi i gjykatës nuk është marrë në analizë të të gjitha provave që duhej të administroheshin gjatë gjykimit dhe, si i tillë, nuk është i drejtë dhe i bazuar në prova, duke arsyetuar se: *[...] Në gjykimin tim, kjo ka qenë e pamjaftueshme dhe do të duhet që Gjykata të urdhëronte kryerjen e një ekspertimi mjekoligjor për të dënuarin, konkluzionet e të cilit do të shërbenin për të marrë një vendim të drejtë. Në këtë kuadër, gjykoj se është e nevojshme që ndaj këtij vendimi të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë [...].* Në përfundim të këtij akti, drejtuesi i prokurorisë, në zbatim të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe të udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016, kreu II, pikat 2 dhe 3 të Prokurorit të Përgjithshëm, ka udhëzuar: *Ankimin e vendimit nr. {***} akti, datë 6.11.2017, brenda afatit ligjor, datë 21.11.2017. Të njohë me këtë udhëzim prokurorin Bujar Memia. Në rast se prokurori i çështjes nuk është dakord me këtë udhëzim, të paraqesë arsyet me shkrim. Udhëzimi bëhet pjesë e fashikullit dhe është urdhëruar sekretaria të bëjë njoftimet përkatëse.*

13.1.7.1 Në lidhje me urdhrin jodetyrues të drejtuesit të prokurorisë datë 17.11.2017, magjistrati pretendon se ky urdhër i është komunikuar vetëm më datë 23.11.2017, për shkak të disa mosrakordimeve të ndodhura në sekretarinë e Prokurorisë së Rrethit Krujë, që kishte çuar në kalimin e afatit kohor për ankimin e vendimit nr. {***} akti, datë 6.11.2017, duke marrë formë të prerë më datë 21.11.2017.

13.1.8 Nga analizimi i fashikullit penal, ashtu siç e pranon edhe vetë magjistrati, rezulton se ai nuk e ka ankimuar këtë vendim. Kolegji, për sa më sipër, vlerëson se ky është një fakt tjetër provues që përforcon argumentin se ankimi lidhur me këtë vendim, duhej të ishte kryer brenda parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe jo të vlerësohej vetëm mbështetur në bindje të brendshme, pasi prokurori fillimisht është mbrojtës i interesit publik dhe përfaqësues i akuzës në procesin penal. Në qoftë se bëhet një vlerësim i përgjithshëm i të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të kryera nga magjistrati, të krijohet bindja se qëndrimi i magjistratit ka qenë pasiv dhe jo konform detyrave të përcaktuara për prokurorin e çështjes.

13.1.8.1 Magjistrati pretendon se KLP-ja është një organ administrativ që ka marrë rolin e një gjykate më të lartë, pasi me qëndrimin e tij, ka cenuar bindjen e brendshme të prokurorit në çështjen konkrete, e cila është një bindje që bazohet në aktet dhe provat e çdo çështjeje konkrete dhe në zbatimin e drejtë të ligjit penal dhe procedural penal. KLP-ja, si një organ administrativ, nuk mund të vlerësojë si të drejtë apo të gabuar bindjen e brendshme të prokurorit.

13.1.8.2 Kolegji çmon se KLP-ja në vendim ka analizuar veprimtarinë profesionale të prokurorit, ku thekson se roli i prokurorit në çështjet e shqyrtimit të kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale nuk është formal dhe nuk mund të mjaftohet vetëm me prezencë formale të prokurorit në seancë, por duhet të ketë rol aktiv në mënyrë që të parashtrojë para gjykatës të gjitha rrethanat dhe faktet të cilat kanë lidhje me objektin e kërkimit. Në rastin konkret, pjesëmarrja formalisht në seancë duke u shprehur "në çmim të gjykatës", nuk provon aspak rolin aktiv të magjistratit ku ka rezultuar në shkelje të ligjit dhe konkretisht me mosparaqitjen nga ana e tij të kërkesave procedurale për marrjen e një prove vendimtare për zgjidhjen e çështjes në shqyrtim, sipas parashikimeve të neneve 178 dhe 366 të Kodit të Procedurës Penale.

13.1.8.3 Referuar pretendimit të sipërcituar, Kolegji vlerëson se elementi i bindjes së brendshme të magjistratit nuk është prekur dhe nuk është cenuar nga KLP-ja, pasi vendimmarrja e KLP-së ka qenë e lidhur me mungesën e ushtrimit të mjeteve procedurale përgjatë gjykimit të çështjes dhe të ankimit, që provojnë ushtrimin me përgjegjshmëri të funksionit të tij si prokuror i çështjes. Kolegji vlerëson gjithashtu se roli i prokurorit, sipas Kushtetutës dhe ligjit, duhet të jetë aktiv, në mbrojtje të interesit publik, duke mbajtur qëndrim për pranimin ose rrëzimin e kërkesës, si dhe duke e argumentuar atë ligjërisht.

13.1.9 Në analizë sa më sipër, Kolegji çmon se magjistrati duhej të vlerësonte dhe të analizonte faktin se i dënuari I.P. kishte paraqitur disa kërkesa penale drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, madje duke ndryshuar edhe emrin në kërkesë, me qëllim që të kishte mundësi të ndikonte në përzgjedhjen e gjyqtares. Konkretisht, i dënuari

I.P., më datë 7.10.2016, kishte paraqitur kërkesën penale me objekt "Lirim për shkak sëmundje", në momentin që gjyqtarja e çështjes kishte marrë vendimin për caktimin e një grupi ekspertësh nga Instituti i Mjekësisë Ligjore për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të të dënuarit, ky i fundit ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtares, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin e datës 23.1.2017. Në vijim, i dënuari ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi. Më datë 17.7.2017, i dënuari I.P. ka paraqitur kërkesën tjetër me objekt "Aplikim dënimi alternativ, qëndrimi në shtëpi", ndërsa në datën 25.7.2017, ka paraqitur përsëri kërkesë përpara gjykatës, me objekt "Qëndrimi në shtëpi", ku sipas shortit elektronik, është caktuar gjyqtare E.H. dhe i dënuari është tërhequr nga gjykimi i kërkesës së bërë më parë më datë 17.7.2017, duke vijuar me gjykimin e kërkesës datë 25.7.2017, me gjyqtare E. H., e cila në përfundim ka vendosur pranimin e kërkesës së tij.

13.1.10 Lidhur me sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimet e magjistratit nuk janë të bazuara në ligj dhe nuk arritën të provojnë të kundërtën e asaj që ka vendosur KLP-ja.

*13.2 Vendimi nr. {***} akti, datë 14.2.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*

13.2.1 Me vendimin nr. {***} akti, datë 14.2.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur: *Pranimin e kërkesës së të dënuarit H.B. Njohjen e ditëve të paraburgimit të të dënuarit nga data e arrestimit të tij nga autoritetet angleze më datë 15.11.2007, deri kur vendimi i gjykatës së Apelit Tiranë ka marrë formë të prerë më datë 20.7.2016*. (Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.)

13.2.2 Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të përcjellë nga KLP-ja, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur: "Njohja e vendimit penal të huaj nr. {***}, datë 14.10.2008, të Gjykatës së Kurorës Snaresbook, Angli, dhënë ndaj shtetasit shqiptar H.B., i dënuar për veprat penale: vrasje, vrasje e mbetur në tentativë dy herë, plagosje me dashje për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor, vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale të 'Vrasjes', parashikuar nga neni 76 i K. Penal dhe caktimin e dënimit me 20 vjet burgim, për veprën penale të "Vrasjes së mbetur në tentativë" dhe, në bazë të neneve 76 dhe 23 të K. Penal caktimin e dënimit me 15 vjet burgim, për veprën penale të 'Plagosjes së rëndë me dashje' dhe në bazë të nenit 88/1 të K. Penal dënimin e tij me 10 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit H.B. me 25 vjet burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data 15.11.2007.".

13.2.3 Me urdhrin e prokurorit të ekzekutimit të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 7.9.2016, është kryer përllogaritja e kohës së paraburgimit sipas nenit 57 të Kodit Penal dhe ajo e dënimit me burgim të vuajtur nga i dënuari në shtetin e huaj, duke përcaktuar se nga dita e ekstradimit në Shqipëri, datë 26.1.2016, e në vazhdim i mbeteshin për të kryer edhe 16 vjet, 4 muaj dhe 3 ditë burgim.

13.2.4 KLP-ja ka konstatuar se me vendimin nr. {***} akti, datë 14.2.2018, gjykata i ka njohur kërkuesit cilësinë e të paraburgosurit për periudhën 15.11.2007, deri kur vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë ka marrë formë të prerë, më datë 20.7.2016. Konstatohet gjithashtu se pavarësisht disponimit të gjykatës, prokurori nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 14.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke mos përmbushur në mënyrë të pajustifikuar funksionet e veta gjatë gjykimit, si dhe ka sjellë përfitim të padrejtë të të dënuarit në kundërshtim me nenin 518, paragrafët 1 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale, nenet 9, 10, 22 dhe 53 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

13.2.4.1 KLP-ja ka arritur në përfundimin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. {***} akti, datë 14.2.2018, pavarësisht përllogaritjes së kohës së paraburgimit të kryer nga prokurori i ekzekutimit, i ka rinjohur të dënuarit H.B., kohën e paraburgimit në shtetin e huaj, në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave procedurale e materiale penale, përkatësisht pikën 1 të nenit 518 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: *"Pasi janë njohur, vendimet penale të gjykatave të huaja, ekzekutohen sipas ligjit shqiptar",* dhe pika 3: *"Dënimi me burgim i vuajtur në shtetin e huaj, llogaritet për efektet e ekzekutimit"*, vendimin unifikues nr. 154/2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nenin 438 të K.PR. Penale, i cili parashikon se: *Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme",* nenin 57 të Kodit Penal dhe nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", duke sjellë përfitim të padrejtë për të dënuarin H.B. Në analizë të këtyre dispozitave ligjore, KLP-ja ka arritur në konkluzionin se pozitën e të dënuarit,

shtetasi H.B. e ka fituar që në momentin kur vendimi në shtetin e huaj ka marrë formë të prerë, pra nga data 14.10.2008.

13.2.5 Magjistrati Bujar Memia pretendon se konkluzioni i arritur nga KLP-ja në vendimin e saj, është i gabuar dhe vjen si rrjedhojë e moszbatimit të drejtë të dispozitave ligjore të cituara në vendimin e saj, pasi për njohjen e periudhës së paraburgimit, nga data 14.10.2008 deri më 20.7.2016, për shtetasin H.B., nuk gjejnë zbatim dispozitat ligjore të cituara më sipër nga KLP-ja, pasi në kushtet kur shtetasit H.B i është bërë njohja e vendimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 20.7.2016, duke u ndryshuar vendimi i autoriteteve gjyqësore angleze, shtetasi H.B, rifiton statusin e të pandehurit për gjithë këtë periudhë, pasi sipas legjislacionit shqiptar, Kodit të Procedurës Penale, neni 462, pika 3, germa "b" e tij, vetëm vendimi i Gjykatës së Apelit konsiderohet si vendim i formës së prerë dhe e gjithë periudha e qëndrimit në burg nga shtetasi H.B, para se vendimi ndaj tij të marrë formë të prerë, duke qenë se ai rifiton statusin e të pandehurit, duhet të llogaritet si periudhë paraburgimi.

13.2.5.1 Lidhur me sa më sipër, Kolegji çmon se në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës për njohjen e kohës së paraburgimit, dispozitat e zbatueshme që duhet të ishin marrë në konsideratë nga gjykata në shqyrtimin e kësaj çështjeje, janë si vijon: *neni 9 i ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës 'Për transferimin e personave të dënuar", në pikën 3 të të cilit parashikohet, se: 'Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse [...]'"; neni 61 i ligjit 10193 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale" që parashikon, se: "Gjatë ekzekutimit, dënimi i dhënë me vendimin gjyqësor të huaj mund të ulet, falet ose amnistohet, sipas rregullave të legjislacionit shqiptar"; nenet 438, 518 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave: (neni 438) "Vendimi i Kolegjit Penal dhe kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme"; (neni 518) "Pasi janë njohur, vendimet penale të gjykatave të huaja, ekzekutohen sipas ligjit shqiptar"; vendimi Unifikues 154/2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin përcaktohet, se: "Për efekt të njësimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara pranojnë se për të gjykuarin [...] dhe në çdo rast, vendimi i gjykatës shqiptare nuk është një vendim i ri. Për këtë shkak, gjykata shqiptare nuk shqyrton çështjen në themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e huaj. Ajo verifikon nëse ekzistojnë kushtet për njohjen e vendimit të huaj dhe duhet t'i përgjigjet atij vendimi me një vendim që konverton dënimin e huaj me një dënim të parashikuar nga legjislacioni shqiptar, duke përcaktuar edhe dispozitat përkatëse të cilat aplikohen. E rëndësishme, sipas Kolegjeve të Bashkuara, është të evidentohet fakti se është vendimi i huaj ai që vihet në ekzekutim nëpërmjet një vendimi njohës të gjykatës shqiptare.* Siç rezulton nga dispozitat e mësipërme, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, në rastin e të dënuarit H.B., Kolegji vëren se ligji i zbatueshëm për uljen e dënimit ishte ligji shqiptar, si ligji i shtetit që po ekzekutonte dënimin.

13.2.5.2 Sipas akteve të administruara në fashikull, dënimi i H.B. nuk ka filluar në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, siç pretendon magjistrati, por me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Mbretërisë së Bashkuar të datës 14.10.2008. Kolegji çmon se llogaritja e kohës së vuajtur të dënimit [20] nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, është bërë në kundërshtim me nenin 518 të Kodit të Procedurës Penale dhe me vendimin unifikues 154/2000 të Gjykatës së Lartë, dhe vlerësimi i KLP-së është i drejtë për këtë çështje.

13.2.6 Kolegji vlerëson se magjistrati, me veprimet e tij, ka pranuar që në fillim të seancës kërkesën e të dënuarit për njohjen e kohës së paraburgimit në shkelje të ligjit dhe në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare që rregullojnë këto marrëdhënie. Magjistrati, në këtë rast, nuk ka bërë dallimin mes të pandehurit dhe të dënuarit. Qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore ka qenë tërësisht pasiv dhe i dakordësuar me kërkimet e të dënuarit, pasi nuk rezulton që të ketë shtruar për diskutim asnjë çështje ligjore lidhur me objektin e kërkesës dhe nuk ka argumentuar në asnjë moment se pse është dakord për pranimin e kësaj kërkese, duke e humbur rolin e prokurorit si përfaqësues i një organi që ka si qëllim mbrojtjen e interesit publik.

Ndërsa, pas përfundimit të gjykimit, me mosveprimin e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimit, magjistrati ka ndikuar në përfitimin e padrejtë të uljes së kohës së burgimit, për të dënuarin H.B., në kundërshtim me ligjin.

[20] *Nga data 15.11.2007 deri në datën 20.7.2016.*

*13.3 Vendimi nr. {***} akti, datë 21 nëntor 2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*

13.3.1 Me vendimin nr. {***}, datë 21.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për të dënuarin H.B., "Për njohje amnistie", gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit H.B., njohjen e amnistisë për kërkuesin H.B. duke i ulur 1 (një) vit nga dënimi, sipas ligjit nr. 141/2016 "Për amnistinë". Gjykimi është zhvilluar me praninë e përfaqësuesit të organit të akuzës, prokurorit Bujar Memia, i pranishëm në 3 seancat e fundit gjyqësore, në datat 4.10.2018, 14.11.2018 dhe 21.11.2018. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 6.12.2018, pa u ankimuar nga prokurori.

13.3.2 Sipas raportit hetimor të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendimi nr. {***} akti, datë 21.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është marrë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenet 4/b dhe 4/c të ligjit nr. 141/2016, "Për amnistinë", sipas të cilit: *Pavarësisht nga përcaktimet e nenit 3, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për: b) krime kundër jetës, të kryera me dashje të parashikuara në nenet 76 [...] c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara nga nenet [...] 88 të Kodit Penal.* Vendimi është dhënë në shkelje të parashikimeve të nenit 5 të këtij ligji, i cili parashikon shprehimisht se: *Të gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht nga kriteret ndaluese të nenit 4, lirohen nëse u kanë mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë: b) deri në 1 vit për personat e dënuar burra*, pasi nuk rezulton që i dënuari H.B. të plotësonte kushtin e parashikuar në ligj. Në kohën e dhënies së vendimit, nuk rezulton që këtij të dënuari t'i kishte mbetur pa vuajtur 1 (një) vit nga dënimi i dhënë me vendimin nr. {***}, datë 20.7.2016, prej 25 vjetësh burgim.

13.3.3 KLP-ja, në vendim shprehet se: *me anë të dhënies së vendimit nr. {***}, datë 21.11.2018, gjykata dukshëm në kundërshtim me parashikimet e neneve 4 dhe 5 të ligjit nr. 141/2016, "Për dhënie amnistie", ka sjellë një përfitim të padrejtë për kërkuesin H.B., me uljen 1 (një) vit të dënimit me burgim. Ky përfitim rezulton të jetë pasqyruar në dinamikën e vuajtjes së dënimit të administruar dhe i përfshirë në kohën totale të vuajtjes së dënimit, mbi bazën e të cilit e njëjta gjykatë ka disponuar në vijim me dhënien e vendimit për lirimin e të dënuarit H.B., me nr. {***} akti, datë 22.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me objekt "Lirimin me kusht të kërkuesit (të dënuarit) H.B., ku përfaqësues i organit të akuzës rezulton të jetë sërish ankuesi Bujar Memia.* KLP-ja, në vendimin e saj, mban qëndrimin se veprat penale të parashikuara nga legjislacioni penal shqiptar, për të cilat H.B. është dënuar, konkretisht ajo e "Vrasjes", "Vrasjes së mbetur në tentativë" dhe "Plagosjes së rëndë me dashje", të parashikuara nga nenet 76, 76–23 dhe 88/1 të K. Penal, kategorizohen si ndaluese për përfitim amnistie,

13.3.4 Magjistrati pretendon se neni 5, i ligjit nr. 46/2016, "Për amnistinë", nuk e lidh të drejtën e përfitimit me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit, siç e kërkon neni 3 i këtij ligji dhe, nisur nga ky fakt, nuk duhet të konfondohet koha e hyrjes në fuqi të ligjit me efektet se ndaj kujt do të zbatohet amnistia.

13.3.5 Nga aktet e depozituara, konstatohet se sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 1016, datë 20.7.2016, me të cilin është bërë njohja e vendimit penal të huaj nr. {***}, datë 14.10.2008, të Gjykatës së Kurorës Snaresbook Angli, rezulton se i dënuari H.B. është dënuar për veprën penale të vrasjes, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë, parashikuar në nenet 76 e 23 të Kodit Penal dhe për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje, të parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal. ligji nr. 141/2016, "Për amnistinë", sipas të cilit është bazuar vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, parashikonte: *(neni 4) Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë, pavarësisht nga parashikimet e nenit 3, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për: a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a e 75 të Kodit Penal; b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83/a, 83/b e 84/a të Kodit Penal, si dhe në nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak; c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88, 89/a e 99 të Kodit Penal [...].*

13.3.5.1 Nga dispozita e mësipërme, si dhe referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 20.7.2016, rezulton se ankuesi H.B. nuk mund të ishte përfitues nga amnistia, pasi ai ishte i dënuar për veprat penale të "Vrasjes me dashje", "Vrasjes me dashje të mbetur në tentativë" dhe "Plagosjes së rëndë me dashje", të parashikuara në nenet 76, 76 - 23, si dhe 88 të Kodit Penal, dhe që përbëjnë kriter ndalues për përfitimin nga amnistia.

13.3.5.2 Ligji për amnistinë 141/2016, në nenin 5 ka parashikuar lehtësi edhe për personat e dënuar, të cilët hyjnë në kategoritë e përcaktuara në nenin

4, por këtë përfitim e ka lidhur me kohën e mbetur të dënimit, duke përcaktuar se: *1. Të gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht nga kriteret ndaluese të nenit 4, lirohen nëse u kanë mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë: a) deri në 2 vjet për të dënuarat gra apo personat që në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të mitur; b) deri në 1 vit për personat e dënuar burra.*

13.3.5.3 Nga vendimi nr. {***} akti, datë 21.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit të datës 23.7.2018, rezulton se në kohën e paraqitjes së kërkesës për njohje amnistie, kërkuesit i kishin mbetur 7 vjet, 7 muaj dhe 6 ditë burgim, pra më shumë se 1 vit që parashikon neni 5 i ligjit nr. 141/2016, "Për amnistinë".

13.3.5.4 Në analizë të dispozitave të mësipërme, të rrethanave konkrete të vendimit të formës së prerë për njohjen e dënimit të H.B., si dhe periudhës që atij i mbetej për të vuajtur dënimin, sipas raportit për dinamikën e vuajtjes së dënimit të IEVP-së Fushë-Krujë, Kolegji vlerëson se vendimi nr. {***} akti, datë 21.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, është marrë në kundërshtim me parashikimet e nenit 5 të ligjit nr. 141/2016, "Për amnistinë".

13.3.6 Gjithashtu, Kolegji vlerëson se prokurori Bujar Memia, nëpërmjet qëndrimit të mbajtur në seancë gjyqësore, të shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit H.B, duke e lënë në çmim të gjykatës kërkesën e kërkuesit për njohje amnistie, pa u shprehur për pranim apo mospranim të kërkesës, pa kryer asnjë debat gjyqësor, duke marrë të mirëqenë çdo vendimmarrje të gjykatës, e bën magjistratin pa rol në këtë vendimmarrje. Mosveprimi i tij në këtë rast vjen në kundërshtim me detyrat që i ka përcaktuar Kushtetuta dhe ligji prokurorit, si përfaqësues i një organi të rëndësishëm, siç është organi i prokurorisë, për mbrojtjen e interesit publik, gjithashtu mosushtrimit të ankimit ndaj vendimit nr. {***}, datë 21.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e ka përforcuar edhe më shumë qëndrimin e tij pasiv, duke mos përmbushur funksionet e parashikuara në nenin 24 të K.PR. Penale, si mbikëqyrës i ekzekutimeve të vendimeve penale, si dhe duke sjellë përfitimin e padrejtë për të dënuarin, referuar kriterit ndalues të parashikuar në nenet 4/b dhe 4/c të ligjit nr. 141/2016, "Për amnistinë".

*13.4 Vendimi nr. {***} akti, datë 22 shkurt 2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*

13.4.1 Me vendimin nr. {***} akti, datë 22.2.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur: *Pranimin e kërkesës së kërkuesit (të dënuarit) H.B.; Lirimin me kusht të kërkuesit (të dënuarit) H.B. për dënimin e mbetur të pavuajtur prej 5 vjetësh, 2 muajsh dhe 11 ditësh, për një kohë prove prej 5 vjetësh. Në zbatim të nenit 60, pika 1 e Kodit Penal, i dënuari H.B të ushtrojë një veprimtari profesionale referuar kontratës së punës pranë personit fizik dhe referuar nenit 60, pika 9 e Kodit Penal, i dënuari H.B. përgjatë kohës së provës të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar. Urdhërohet i dënuari H.B. të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. Urdhërohet lirimi i tij nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë për ekzekutimin e këtij vendimi [...].*

13.4.2 Nga aktet në dosjen gjyqësore të këtij vendimi, rezulton se magjistrati në seancën e datës 22.2.2019, ndër të tjera, është shprehur se: *mendoj se plotësohen të gjitha kushtet sipas objektit, paraqitur nga i dënuari, por duke qenë se jemi organ procedues, për mos sugjestionuar gjykatën, ne mendojmë ta lëmë në çmim të gjykatës.*

13.4.3 Mbi bazë të fakteve të mbledhura gjatë hetimit, ILD-ja ka argumentuar se vendimi nr. {***}, datë 22.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është marrë në shkelje të rëndë procedurale, në kundërshtim me nenin 64, paragrafi 1, ndarja e tretë e Kodit Penal, për shkak të mosplotësimit të kushtit parësor për të përfituar lirim me kusht, atë të periudhës efektive të dënimit të vuajtur nga i dënuari H.B. prej 3/4, si dhe shkeljen e kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64, paragrafi 2 i Kodit Penal, i cili parashikon shprehimisht se: "Në masën e dënimit të vuajtur, nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje". Magjistrati, në të njëjtën ditë të marrjes së vendimit penal nr. {***} akti, të datës 22.2.2019, ka nxjerrë urdhër për ekzekutimin e tij dhe, më datë 13.3.2019, ka nxjerrë urdhrin për zbatimin e këtij vendimi, duke mos ushtruar mjetin procedural që i njeh ligji, atë të ankimit të vendimit.

13.4.4 Kolegji, nga shqyrtimi i akteve të përcjella nga KLP-ja, vëren se magjistrati ka qenë në dijeni të ekzistencës së dy vendimeve gjyqësore nr. {***}, datë 25.5.2017 (në të cilin nuk ka qenë pjesëmarrës) dhe atij nr. {***}, datë 14.2.2018 (në të cilin ka qenë pjesëmarrës), me të cilat kërkuesi H.B. ka përfituar ulje dënimi me dy cilësi të ndryshme për

të njëjtën periudhë kohe, atë të të paraburgosurit dhe të të dënuarit, me anë të këtyre dy vendimeve ka një rritje fiktive të periudhës së dënimit të kryer nga i dënuari H.B., rezultat i lirimit me vendimin nr. {***} akti, datë 22.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me objekt "Lirimin me kusht të kërkuesit (të dënuarit) H.B.". Në të njëjtën frymë, rezulton të jetë marrë edhe vendimi nr. {***}, datë 18.1.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i cili i ka ulur dënimin të dënuarit në masën 90 ditë për llogari të vitit 2007, në kundërshtim me disponimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë[21], pasi në mungesë të uljes së dënimit të dhënë me anë të këtij vendimi, do të ishim në kushtet ku i dënuari H.B., më datë 22.2.2019, nuk do të plotësonte kriterin e parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, ku koha e vuajtur e dënimit të dhënë duhej të ishte e barabartë me 3/4.

13.4.5 KLP-ja, në vendimin objekt shqyrtimi, ka arsyetuar se në kushtet kur vendimi nr. {***}, datë 18.1.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me të cilin është ulur dënimi për një afat prej 90 ditësh, është marrë në shkelje të ligjit, dhe që afekton vendimin nr. {***}, datë 22.2.2019, për lirimin e tij me kusht, magjistrati, në ushtrim të funksioneve të tij si prokuror i çështjes, duhet të kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtares E.H. nga gjykimi i mëtejshëm i kërkesës, pasi dukshëm kjo gjykatë nuk ishte e paanshme, referuar edhe vendimeve të mëparshme të saj nga e njëjta gjyqtare për të dënuarin H.B. KLP-ja, në vendim, e ka cilësuar këtë mosveprim të prokurorit një mospërmbushje të pajustifikuar të funksionit, ndërkohë që në bazë të nenit 18 dhe germës "ë" të pikës 1 të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtares. Prokurori i çështjes, sipas KLP-së, nuk mund të ishte pasiv, nisur nga predispozita e gjykatës për të favorizuar të dënuarin me vendimmarrjet e saj.

13.4.6 Magjistrati kundërshton vendimin e KLP-së, me argumentimin se është njohur me vendimin nr. {***}, datë 18.1.2019, vetëm më datë 21.2.2019, pra pasi ky vendim kishte marrë formë të prerë. Më tej, ai pretendon se ky vendim me objekt ulje dënimi për një afat prej 90 ditësh, është bërë në prezencë vetëm të IEVP-së dhe ky organ nuk e ka kundërshtuar. Në këto kushte, magjistrati Bujar Memia pretendon se nuk ka pasur detyrim ligjor për të studiuar vendimet e formës së prerë për çështje që nuk lidhen fare me veprimtarinë e Prokurorisë.

13.4.7 Kolegji, referuar sa më sipër, konstaton se magjistrati ka pasur dijeni për kronologjinë e uljes së dënimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, për të dënuarin H.B. Gjithashtu, Kolegjit i rezulton se magjistrati Bujar Memia, në shqyrtimin e çështjes që i përket vendimmarrjes me nr. {***} akti, të datës 22.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ka paraqitur konkluzionet për çështjen në mënyrë verbale, pa e dokumentuar atë me shkrim, si dhe dukshëm ka rezultuar se magjistrati ka qenë dakord me kërkesat e të dënuarit, pasi ka mbështetur kërkesat e tij të paraqitura përpara gjykatës, duke u shprehur se: *Kërkuesi, gjatë gjykimit, ka paraqitur akte shkresore të cilat provojnë rrethana të veçanta për t'u liruar me kusht dhe Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Krujë ka sjellë raport pozitiv për kërkuesin H.B., në lidhje me kërkesën e tij, me objekt lirimin para kohe me kusht.*

13.4.8 Magjistrati, në pretendimet e tij para KLP-së dhe në Kolegj, është shprehur se ka zbatuar afatin 3-vjeçar të vlerësimit të sjelljes me objekt të lirimit me kusht, ashtu sikurse ka disponuar me të njëjtin afat 3-vjeçar Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr. 2, datë 25.5.2015.

13.4.9 KLP-ja, në vendimin e saj, ka arsyetuar se, që gjykata të vendosë zbatimin e lirimit me kusht, është e nevojshme që të plotësohen disa kushte ose kërkesa me karakter ndalues dhe objektiv, si koha e vuajtjes së dënimit dhe mospërfshirja në këtë kohë e pjesës së përfituar nga i dënuari me amnisti apo falje, të cilat janë të parashikuara shprehimisht nga ligji penal. Me plotësimin me sukses të këtyre kërkesave (kushteve), meqenëse lirimi me kusht është një alternativë e vuajtjes së dënimit, i dënuari përjashtohet nga pjesa e vuajtjes së dënimit të mbetur, duke përfituar kështu lirinë e plotë.

13.4.10 Në vendimin unifikues nr. 2, datë 25.5.2015, përveç kërkesave ligjore me natyrë objektive, për akordimin e lirimit me kusht, parashikohen edhe plotësimi i disa kritereve ligjore me natyrë subjektive, siç janë prania e "arsyeve të veçanta", "arsyeve të jashtëzakonshme" apo "sjelljes shembullore", të cilat tregojnë se me anë të

[21] *Me vendimin nr. {***}, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është përcaktuar koha e fillimit të vuajtjes së dënimit nga data 15.11.2007.*

sjelljes dhe punës, dënimi i dhënë ia ka arritur qëllimit të tij për riedukimin e individit, apo se ka nisur rrugën e sigurt për arritjen e këtij qëllimi, paçka se ende nuk e ka përfunduar atë. Arsyet e veçanta, të cilat tregojnë rehabilitimin e të dënuarit, kërkojnë një interpretim dhe vlerësim rast pas rasti, në bazë të provave që i paraqiten gjykatës.

13.4.11 Referuar këtij vendimi unifikues, në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit H.B, KLP-ja ka vlerësuar se gjykata nuk ka vlerësuar ato çështje të përcaktuara në këtë vendim unifikues për evidentimin e shprehjes "arsye të veçanta", duke mos zbatuar plotësimin e këtij kriteri ligjor të parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, sikurse janë: natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i të dënuarit ndaj veprës penale, si dhe pendimi i të dënuarit bazuar në të dhëna objektive, ndonjë vepër penale e mëparshme e kryer nga i dënuari, dinamika e sjelljes së të dënuarit, raporti i autoriteteve të IEVP-së, duke u mjaftuar me një konstatim formal të tyre. Këto fakte nuk janë evidentuar gjatë gjykimit dhe as nuk janë arsyetuar në konkluzionet përfundimtare nga ana e prokurorit Bujar Memia dhe as pas njohjes me arsyetimin e vendimit gjyqësor (në formën e një ankimi), të cilit i mungon arsyetimi dhe analiza në lidhje me konceptin "arsye të veçanta".

13.4.12 Kolegji e gjen të bazuar arsyetimin në vendimin e KLP-së, pasi neni 64 i Kodit Penal parashikon kërkesat që i dënuari duhet të plotësojë që të mund të lirohet me kusht, konkretisht: i. për arsye të veçanta[22], nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur, i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe ii. të ketë vuajtur atë pjesë të dënimit sipas masës së dënimit të parashikuar në këtë nen. Nga interpretimi literal e logjik i kësaj dispozite, këto kërkesa duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, pasi plotësimi vetëm i një kërkese nuk legjitimon zbatimin e lirimit me kusht.

[22] *Vendimi unifikues nr. 2, datë 25.5.2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, citon: "[...]Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe "arsyet e veçanta" nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri".*

13.4.13 Ndërsa sa i përket pretendimit të magjistratit se ushtrimi i ankimit lidhet me bindjen e brendshme të tij, Kolegji vlerëson se koncepti i "bindjes së brendshme" të magjistratëve është i lidhur vetëm me interpretimin e ligjit në kontekstin e fakteve dhe provave të një çështjeje të caktuar. Magjistrati mban përgjegjësi disiplinore për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive, rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin apo me praktikat unifikuese të gjykatave më të larta. Në çdo rast, bindja e brendshme duhet të jetë në përputhje me ligjin, me analizën fakteve dhe provave në brendësi të çështjes, për ta kualifikuar atë sipas ligjit, por jo siç ka vepruar magjistrati, pa analizuar rrethanat e çështjes, duke shkuar edhe më tej, shmangien e gjykimit të çështjes në një instancë më të lartë.

14. Në analizë të sa më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelimit arrin në përfundimin se shkeljet e magjistratit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në vendimet objekt procedimi dhe gjykimi, të konstatuara nga ILD-ja dhe të shqyrtuara dhe konkluduara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në procedimin disiplinor ndaj tij, janë të tilla që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore dhe se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, e dhënë ndaj magjistratit, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera prej tij.

15. Kolegji çmon se veprimet dhe mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Bujar Memia, në kuptim të nenit 148/d, pika 2 e Kushtetutës, përbëjnë "*Shkelje të rënda profesionale*".

Për sa më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të kërkuesit, çmon se vendimi nr. 81, datë 31.3.2021, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe kërkesa e magjistratit Bujar Memia nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" e Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të magjistratit Bujar Memia, kundër vendimit nr. 81, datë 31.3.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, "*Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit Bujar Memia*".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.5.2022.

Shpallur më 12.7.2022.

Kryetare: Albana Shtylla

Anëtarë: Rezarta Schuetz, Ina Rama, Mimoza Tasi, Natasha Mulaj, Sokol Çomo

VENDIM
Nr. 85, datë 14.2.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR Nr. 109, DATË 18.9.2020, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME MIRDITË"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 14.2.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 109, datë 18.9.2020, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mirditë"

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Mirditë (UK Mirditë), me shkresën nr. 50 prot., datë 20.1.2022, me lëndë "Shkresë përcjellëse", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Mirditë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Mirditë me vendimin nr. 109, datë 18.9.2020, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mirditë, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Mirditë sh.a., z. Nikolin Kaçorri, ka përfunduar studimet e larta në Biokimi në vitin 1992.

5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mirditë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë, në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Mirditë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. nr. 109, datë 18.9.2020, "Për licencimin e sh.a.

Ujësjellës-Kanalizime Mirditë" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: z. Nikolin Kaçorri."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 102, datë 28.2.2022

PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KAMZË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence"(VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 28.2.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kamzë sh.a.",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kamzë (UK Kamzë), me shkresën nr. 6 prot., datë 5.1.2022, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për herë të parë.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për herë të parë të UK Kamzë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve, që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kamzë sh.a. (NUIS L72320034A) është themeluar me statut nga Bashkia Kamzë më 13.11.2017 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 13.11.2017, me aksionarë të vetëm Bashkinë Kamzë;

b) Shoqëria UK Kamzë aplikon për licencim për herë të parë si shoqëri e re, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, e shkëputur nga UK Tiranë, në të cilën ka pasur 14.6 % aksione.

c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Jurgen Ocelli është diplomuar në "Universitetin Politeknik Tiranë", në degën hidroteknikë në vitin 2009;

d) Shoqëria UK Kamzë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 99 882 banorë të Bashkisë Kamzë.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kamzë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Kamzë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kamzë sh.a. me (NUIS L72320034A), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kamzë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) Drejtues ligjor – Gentjan Murataj;

b) Drejtues teknik – Jurgen Ocelli.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kamzë sh.a. është Bashkia Kamzë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kamzë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Kamzë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 103, datë 28.2.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR Nr. 67, DATË 19.12.2019, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER"

Në mbështetje të nenet 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-në nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 28.2.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 67, datë 19.12.2019, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Fier'"",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fier (UK Fier), me shkresën nr. 116 prot., datë 26.1.2022, me lëndë "Shkresë përcjellëse", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Fier për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe më procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Fier me vendimin nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Fier, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Fier sh.a., z. Petrit Kanani, ka përfunduar studimet e larta në Juridik në vitin 2013.

5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Fier sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-ja nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat

e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Fier është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Fier" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: z. Petrit Kanani.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 150, datë 1.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 84, DATË 4.3.2021, "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 1.4.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 84, datë 4.3.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a.",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UK Tiranë), me shkresat nr. 8647 prot., datë 25.5.2021, me lëndë "Mbi pajisjen e shoqërisë me aktmiratime higjieno-sanitare", nr. 4910 datë 11.3.2022, me lëndë "Kërkesë për modifikim licence", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për zgjerimin e zonës së shërbimit, aktmiratimet higjieno-sanitare, në të cilat përfshihen njësitë e tjera administrative Baldushk, Pezë, Farkë, Bërzhitë dhe Krrabë, që kishin mbetur jashtë zonës së shërbimit të kësaj shoqërie.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të zgjerimit të zonës së shërbimit të UK Tiranë, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Tiranë, me vendimin nr. 84, datë 4.3.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a." me një afat 2-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit, si më poshtë:

1. Njësia Administrative nr. 1;
2. Njësia Administrative nr. 2;
3. Njësia Administrative nr. 3;
4. Njësia Administrative nr. 4;
5. Njësia Administrative nr. 5;
6. Njësia Administrative nr. 6;
7. Njësia Administrative nr. 7;
8. Njësia Administrative nr. 8;
9. Njësia Administrative nr. 9;
10. Njësia Administrative nr. 10;
11. Njësia Administrative nr. 11;
12. Njësia Administrative Dajt;
13. Njësia Administrative Kashar;
14. Njësia Administrative Ndroq;
15. Njësia Administrative Petrelë;
16. Njësia Administrative Shëngjergj;
17. Njësia Administrative Vaqarr;
18. Njësia Administrative Zall Bastar;

19. Njësia Administrative Zall Herr.

4. KKRR-ja, në vendimin nr. 84, datë 4.3.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a." i rekomandoi shoqërisë UK Tiranë, që të punonte në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë të të gjithë zonës së shërbimit me aktmiratim higjieno-sanitar;

5. Akt miratimet higjieno-sanitare për zonën e shtuar janë, si më poshtë:

Nr.	Njësitë administrative që i shtohen zonës së shërbimit	Aktmiratimi higjiena-sanitar
1	Bërzhitë	Nr. 151, datë 10.5.2021, "Stacion pompimi"
2	Farkë	Nr. 148, datë 10.5.2021, "Depo uji"
3	Baldushk	Nr. 746, datë 23.11.2021, "Stacion pompimi"
4	Krrabë	Nr. 747, datë 23.11.2021, "Depo uji"
5	Pezë	Nr. 751, datë 25.11.2021, "Stacion pompimi", Grecë

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Tiranë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3 të vendimit të KKRR-së nr. 84, datë 4.3.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a.", bëhen këto ndryshime:

"Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. është Bashkia Tiranë.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 151, datë 1.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 319, DATË 20.8.2021, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS HAS"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 1.4.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 319, datë 20.8.2021, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës Has",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës Has (U Has), me shkresën nr. 15 prot., datë 8.3.2022 , me lëndë "Shkresë përcjellëse", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së U Has për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë U Has, me vendimin nr. 319, datë 20.8.2021, "Për licencimin e sh.a Ujësjellës Has, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë U Has sh.a. z. Ferit Mazrreku, ka përfunduar studimet e larta në Biokimi, *Bachelor* në vitin 2013 dhe Master në vitin 2021.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të

drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e U Has sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i U Has është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. nr. 319, datë 20.8.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës Has", bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: z. Ferit Mazrreku.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 184, datë 4.5.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 191, DATË 14.5.2021, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME POGRADEC"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 4.5.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 191, datë 14.5.2021, 'Për licencimin e sh.a Ujësjellës-Kanalizime Pogradec'"".

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Pogradec (UK Pogradec), me shkresën nr. 389 prot., datë 8.4.2022, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a Ujësjellës-Kanalizime Pogradec", ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Pogradec për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Pogradec me vendimin nr. 191, datë 14.5.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Pogradec", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Pogradec sh.a., z. Oltion Begollari, ka mbaruar studimet e larta në Inxhinieri hidroteknike, në vitin 2010.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Pogradec sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i

UK Pogradec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën "2/b" të vendimit të KKRR-së nr. 191, datë 14.5.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Pogradec", bëhet ndryshimi, si më poshtë:

"Drejtues teknik: Oltion Begollari.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 245, datë 2.6.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME VLORË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 2.6.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a.",

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Vlorë, me shkresën nr. 941 prot., datë 19.4.2022, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së, për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit – largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Vlorë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Vlorë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 166 045 banorë të Bashkisë Vlorë;

b) Drejtuesi ligjor, znj. Entela Hodaj, është diplomuar në Universitetin Teknologjik "Ismail Qemal Vlora", dega Biznes, profili Marketing në vitin 2007;

c) Drejtuesi teknik, z. Kastriot Memaj, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, dega Inxhinieri Mekanike për Impiante, në vitin 1991 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vlorë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e

UK Vlorë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a., me (NUIS K07303204A), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) Drejtuese ligjore – Elona Hodaj;

b) Drejtues teknik – Kastriot Memaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. është Bashkia Vlorë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 279, datë 24.6.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KONISPOL SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 24.6.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Konispol sh.a.",

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Konispol, me shkresën nr. 54 prot., datë 11.5.2022, dhe plotësimet me shkresën nr. 60 prot., datë 6.6.2022, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së, për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Konispol, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Konispol ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 13 005 banorë të Bashkisë Konispol;

b) Drejtuesi ligjor i shoqërisë, z. Altier Xhaferri, është diplomuar në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, dega Administrim Publik, në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në vitin 2009, si dhe Master shkencor "E drejta publike" në Universitetin Mesdhetar në vitin 2018;

c) Drejtues teknik i shoqërisë, z. Mikelo Taka, është diplomuar në *Bachelor* në Inxhinieri Mekanike, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, në vitin 2014 dhe Master profesional në Operacione Industriale dhe Navale, në viti 2018.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Konispol, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin

e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Konispol është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Konispol sh.a. me (NUIS L74829801V), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Konispol sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor – Altier Xhaferri;

b) Drejtues teknik – Mikelo Taka.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Konispol sh.a. është Bashkia Konispol.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Konispol sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Konispol sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 280, datë 24.6.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 317, DATË 20.8.2021, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME MAT"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 24.6.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 317, datë 20.8.2021, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mat'".

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Mat (UK Mat), me shkresën nr. 277 prot., datë 8.6.2022, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mat" ka paraqitur pranë ERRU kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Mat për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Mat me vendimin nr. 317, datë 20.8.2021, "Për licencimin e sh.a Ujësjellës-Kanalizime Mat", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuese teknike e shoqërisë UK Mat sh.a., znj. Marisa Mamica, ka mbaruar studimet e larta në "Inxhinieri mjedisi", dega trajtim ujërash, në vitin 2018.

5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mat sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë, në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Mat është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën "2/b" të vendimit të KKRR-së nr. 317, datë 20.8.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mat", bëhet ndryshimi, si më poshtë:

"Drejtues teknik: Marisa Mamica.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 281, datë 24.6.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 87, DATË 4.3.2021, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LUSHNJË"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 24.6.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 87, datë 4.3.2021, 'Për licencimin e sh.a Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë, me shkresën nr. 330 prot., datë 25.5.2022, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe teknik", ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Lushnjë për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Lushnjë, me vendimin nr. 87, datë 4.3.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i shoqërisë UK Lushnjë sh.a., z. Maldin Çela, ka mbaruar studimet e larta në degën "Inxhinieri elektrike" në vitin 2020.

5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Lushnjë sh.a., z. Klaidi Shkurti, ka mbaruar studimet e larta në Universitetin Politeknik të Tiranës, Master profesional në degën Inxhinieri Mekatronike, në vitin 2019.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Lushnjë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë, në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Lushnjë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 87, datë 4.3.2021, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellë-Kanalizime Lushnjë", bëhet ndryshimi, si më poshtë:

"Drejtues ligjor: Maldin Çela.".

"Drejtues teknik: Klaidi Shkurti.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 301, datë 5.7.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence"(VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 5.7.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a.'",

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Dibër, me shkresat nr. 209 prot., datë 5.5.2022, nr. 217/1 prot., datë 26.5.2022, nr. 275 prot., datë 20.6.2022, për ndryshim të drejtuesit teknik dhe me shkresën me nr. 328 prot., datë 1.7.2022, njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik, ka paraqitur pranë ERRU-së, dokumentacionin përkatës të kërkesës për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit – largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Dibër në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Dibër ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 45 814 banorë të Bashkisë Dibër;

b) Drejtuesit ligjor i shoqërisë, z. Bedri Kamberi, është diplomuar për Agronomi, Universiteti Politeknik Korçë në vitin 1991, gjithashtu, zotëron dhe diplomë të nivelit të dytë Biologji-Kimi nga universiteti "Aleksandër Moisiu" Elbasan, në vitin 2010;

c) Drejtues teknik i shoqërisë, znj. Sara Osmani, ka diplomë *Bachelor* në Inxhinieri Ndërtimi, Universiteti Politeknik i Tiranës, në vitin 2021. Nga nëntori 2021, vazhdon studimet Master shkencor në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturiste.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Dibër, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Dibër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. me (NUIS J66702738B), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor: Bedri Kamberi;

b) Drejtuese teknike: Sara Osmani.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. është Bashkia Dibër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 323, datë 14.7.2022

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime".

KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 14.7.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

KONSTATOI SE:

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 55, datë 28.10.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a.", për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 3474 prot., datë 30.6.2022, me lëndë: "Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura".

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Elbasan është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosjes së Tarifave.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Elbasan është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 539, datë 30.12.2021, dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan, për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan dhe Bashkinë Elbasan, për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 324, datë 14.7.2022

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR MIRATIM TË TARIFAVE TË SHITJES SË UJIT ME SHUMICË TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME DURRËS

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime",

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 14.7.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi kërkesën e Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a., për miratimin e tarifave të shitjes së ujit me shumicë të shërbimit të furnizimit me ujë,

KONSTATOI SE:

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Durrës është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 344, datë 23.9.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a.", për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Durrës ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 3938 prot., datë 30.6.2022, me lëndë "Kërkesë për nivel tarifor për shitje të ujit me shumicë për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm".

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Durrës është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosjes së Tarifave, përveç shlyerjes së detyrimit vjetor për pagesën rregullatore.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Durrës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 539, datë 30.12.2021, dhe kuadrin rregullator në fuqi.

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Durrës për nivel të ri tarife, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Durrës dhe Bashkinë Durrës, për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

KËRKESË
Nr. 183/8, datë 15.7.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga projekti 'Rehabilitimi i lumit Gjanica', faza II, segmenti nga ish-Ura me shkallë deri tek Ura e Sheqit", Fier.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", ndërsa vlerësimi i objektit të banimit është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, i ndryshuar, me çmimin mesatar të shitblerjeve për tre muajt e fundit, referuar shkresës nr. 8732/3, datë 28.10.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Fier, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **64,006,655 (gjashtëdhjetë e katër milionë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë)** lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMERORE PARAPRAKE E PRONAREVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I LUMIT "GJANICA", FAZA II, SEGMENTI NGA ISH URA ME SHKALLË DERI TEK URA E SHEQIT", FIER

Nr	EMER ATESIA MBIEMER	Zona Kad.	NR. Pas.	Sip. totale e pasurise (m2)	Sip. e objektit te banimit (m2)	Sip. e truallit (m2)	Sip. e objektit te sherbimit (m2)	Çmimi objektit te banimit (l/m2)	Cmimi I truallit (l/m2)	Vlera e objektit te sherbimit sipas situacionit (lek)	Vlera e objektit te banimit (lek)	Vlera e truallit (lek)	VLERA Totale e truallit, objektit te banimit dhe sherbimit (lek)	KONFIRM ZVRPP
1	Gezim Meçe	8532	6/666	550		550			12458		-	6,851,900	**6,851,900**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
2	Lumturi Hamdi Meçe, Genci Xhevat Meçe, Ermira Xhevat Malasi	8532	6/667	34		34			12458		-	423,572	**423,572**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
3	Klamona Lena & Irena Skëndaj	8532	6/552	300		300			12458		-	3,737,400	**3,737,400**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
4	Merushe Gjoedeshi, Artur Sabri Gjojdeshi, Neritan Gjojdeshi, Flora Sabri Gjojdeshi, Natasha Sabri Gjojdeshi, Arben Sabri Gjojdeshi	8532	6/253	300		300			12458		-	3,737,400	**3,737,400**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
5	Olimbi Kilo Gjeçi, Niko Kilo Gjeçi, Kozma Kilo Gjeçi, Afroviti Kilo Gjeçi, Parashqevi Kilo Gjeçi, Vllasji Kilo Gjeçi, Dhori Kilo Gjeçi, Foto Kilo Gjeçi, Grigor Kilo Gjeçi	8532	6/548	1300		346			12458		-	4,310,468	**4,310,468**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
6	Elis Kuçi & Blerina Kuçi	8532	13/203	414		80.2			12458		-	999,132	**999,132**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
7	Vjollca Breca & Luan Breca	8532	13/202	413		62.6			12458		-	779,871	**779,871**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
8	Isa Dobra	8532	13/201	413		71.3			12458		-	888,255	**888,255**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
9	Bashkim Rakipaj	8531	1/206	300	105.7	194.3		52,062	12458		5,502,929	2,420,589	**7,923,518**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
10	Agim Kamberaj	8531	1/199	170		170			12458		-	2,117,860	**2,117,860**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE

Nr	EMER ATESIA MBIEMER	Zona Kad.	NR. Pas.	Sip. totale e pasurise (m2)	Sip. e objektit te banimit (m2)	Sip. e truallit (m2)	Sip. e objektit te sherbimit (m2)	Çmimi objektit te banimit (l/m2)	Cmimi I truallit (l/m2)	Vlera e objektit te sherbimit sipas situacionit (lek)	Vlera e objektit te banimit (lek)	Vlera e truallit (lek)	VLERA Totale e truallit, objektit te banimit dhe sherbimit (lek)	KONFIRM ZVRPP
11	Nuri Sako	8532	6/48	1260		355.8			12458		-	4,432,556	**4,432,556**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
12	Kristaq Goga, Dhoksie Goga, Niko Goga, Eglantina Goga	8531	1/529-ND	0	315.5			52,061.77			16,425,488		**16,425,488**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
13	Faslli Lika, Xhevdet Lika	8531	1/133	500.14		500.14			12458		-	6,230,744	**6,230,744**	ME VERTETIM HIPOTEKOR
14	Vitori Beta, Arben Beta, Arjan Beta, Alketa Beta	8531	1/133-ND	0	130.0			52,061.77			5,148,490	-	**5,148,490**	ME ÇERTIFIKATE PRONESIE
												SHUMA TOTALE	**64,006,655**	

Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM nr. 89, datë 03/02/2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
Vlerësimi i objekteve të banimit është bërë me çmimin mesatar të shitblerjeve për tre muajt e fundit, referuar shkresës nr.8732/3 prot, datë 28.10.2020 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier.Vlerësimi i pasurisë "objekt shërbimi", është bërë sipas VKM nr.138, datë 23.03.2000 I ndryshuar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHËRBIMIN KOMBËTAR - SEKRETARI

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 108
Datë: 2022/08/03 15:54:31
2a8a77e1-7017-432b-a95d-5286beadb64e

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1040 lekë